amfALBANIA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BULETINI ZYRTAR '06-'08

VËLLIMI I PARË

E drejta e Autorit

Materiali në këtë publikim është pronësi e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ju mund ta riprodhoni këtë material në një formë të patjetërsuar, për qëllime personale jo komerciale ose brenda organizatës tuaj, duke cituar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Kërkesa për përdorim të mëtejshëm të informacionit në këtë publikim duhet të drejtohen pranë Departamentit të Çështjeve Juridike.

Rezervimi

Ndërkohë që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përpiqet të sigurojë cilësinë e këtij publikimi, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk mbart detyrim ligjor për ndonjë humbje apo dëm të mundshëm si pasojë e përdorimit apo referimit në këtë publikim.

Për më shumë informacion në lidhje me këtë publikim:

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi", Pall.10, Kati 2, Tiranë
Tel: + 355 4 2257560, 557
Faks: + 355 4 2250686
E-mail: amf@amf.gov.al
URL: www.amf.gov.al

amfALBANIA

Autoriteti i
Mbikëqyrjes Financiare

BULETINI ZYRTAR

Vëllimi I, 2006-2008

Data e botimit
30.12.2009

2006

2007

2008

PËRMBAJTJA

Vendime Bordi të AMF-së, miratuar gjatë vitit 2006 7-40

Vendime Bordi të AMF-së, miratuar gjatë vitit 2007 42-302

Vendime Bordi të AMF-së, miratuar gjatë vitit 2008 304-509

Vendime Bordi të AMF-së, miratuar gjatë vitit 2006

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 04.10.2006

PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE DETYRAVE PËR ÇDO NJËSI TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE SIPAS STRUKTURËS 2006

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 04.10.2006

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË PAGAVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 04.10.2006

MBI

PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË PUNONJËSVE NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 04.10.2006

PËR

NGRITJEN E KOMISIONEVE TË POSAÇME PËR MARRJEN NË DORËZIM TË ARKIVAVE DHE AKTIVITETEVE TË QENDRUESHME TË KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË, AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE DHE INSPEKTORIATIT TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 04.10.2006

PËR

MIRATIMIN E STEMËS SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 04.10.2006

PËR

NJOFTIMIN E PUBLIKUT BRENDA DHE JASHTË VENDIT PËR KRIJIMIN E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 04.10.2006

PËR

PROCEDURAT E ZBARDHJES SË VENDIMEVE TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 02.11.2006

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RREGULLAT E BRENDSHME TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr.3, datë 02.11.2006

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT TË MBLEDHJES SË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 02.11.2006

PËR

MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT DHE TË DIETAVE TË PUNONJËSVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDBANIMIT TË TYRE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr.5, datë 02.11.2006

PËR

PROCEDURAT DHE SHPENZIMET PËR DALJET JASHTË SHTETIT PËR SHËRBIM, KUALIFIKIM TË PUNONJËSVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 02.11.2006

PËR

PROCEDURAT E KRYERJES SË SHPENZIMEVEN PËR ORGANIZIMIN E PRITJE-PËRCJELLJEVE NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 02.11.2006

PËR

PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË DREJTUESVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 02.11.2006

PËR

REKRUTIMIN ME KOHË TË PJESSHME PRANË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE TË PUNONJËSVE TË JASHTËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 02.11.2006

PËR

PËRFTIMIN E NJË SHTESE MBI PAGËN MUJORE TË PUNONJËSVE ME PROFESION AKTUAR TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 02.11.2006

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2006

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 07.12.2006

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 07.12.2006

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË KRYETARIT, NËNKRYETARËVE DHE ANËTARËVE TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 07.12.2006

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTBUXHETIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 07.12.2006

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR TREGTIMIN ME PAKICË TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË SË R.SH"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 40, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin me ndryshimet e propozuara te Rregullores "Për tregtimin me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Rregullorja nr. 8/2, datë 28.09.2005 "Mbi tregun me pakicë të bonove të thesarit të Qeverisë së R.SH" shfuqizohet.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI TREGUN ME PAKICË TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË SË R.SH

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 5, datë 07.12.2006

Në bazë të nenit 40, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe të nenit 66 të Ligjit nr. 8080, datë 01.03.1996 "Për Letrat me Vlerë", ndryshuar me Ligjin nr. 8168, datë 05.12.1996 dhe me Ligjin nr. 8745, datë 22.02.2001, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për funksionimin dhe mbikëqyrjen e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë ku përfshihen: bono thesari dhe obligacione.

Neni 2

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është tregu i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara, për kryerjen e transaksioneve me investitorët të cilët mund të jenë, persona fizikë ose juridikë, rezidentë dhe jorezidentë.

Asnjë bankë apo subjekt tjetër nuk mund të kryejë tregtim me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë pa u licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për këtë qëllim.

Tregtimi i letrave me vlerë të Qeverisë ndërmjet bankave rregullohet me akte të posaçme të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Llojet e Transaksioneve në Tregun me Pakicë

Transaksionet që mund të kryhen nga bankat dhe subjektet e tjera të licencuara në tregun me pakicë janë:

- Blerje të bonove të thesarit në tregun primar (ankand) nga investitori nëpërmjet bankës, apo subjektit të licencuar;

- Shitja e letrave me vlerë të qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo subjektit të licencuar;
- Blerja e letrave me vlerë të qeverisë nga banka apo subjekti i licencuar para datës së maturimit nga çdo investitor, pavarësisht nëse veprimet e mëparshme nuk janë kryer nga e njëjta bankë apo subjekt i licencuar;
- Vendosja e letrave me vlerë të qeverisë si kolateral;
- Shlyerja e vlerës nominale në datën e maturimit.

Neni 4

Procedura të tregtimit me pakicë të bonove të thesarit

Në tregun me pakicë shitet ose blihet çdo lloj bono thesari që i kanë mbetur jo më pak se 7 ditë nga data e maturimit.

Periudha e mbetur deri në maturim për bonot e thesarit, është numri i ditëve ndërmjet datës së lëvizjes së fondeve dhe datës së maturimit të bonos së thesarit.

Shuma minimale për pjesëmarrje në ankand përcaktohet nga Ministria e Financave ndërsa për transaksionet e tjera në tregun me pakicë shuma minimale blerje/shitje bono thesari është 10.000 lekë, shumë e cila shtohet me pas me shumëfisha të 1.000 lekëve.

Banka apo subjekti i licencuar përdor të njëjtën metodë llogaritje si për çmimin e blerjes ashtu dhe për atë të shitjes, me bazë vjetore 365 ditë për transakisonet me bono thesari.

Pagesat për blerjen e bonove të thesarit në tregun me pakicë, mund të bëhen në para (cash), nëpërmjet çeqeve të firmosura mbi llogarinë bankare të klientit ose nëpërmjet llogarive bankare.

Neni 4/1

Procedura e tregtimit me pakicë për obligacionet

Obligacionet tregtohen sipas kushteve të përcaktuara nga emetuesi.

Neni 4/2

Dokumentacioni vërtetues

Banka apo subjekti i licencuar harton kontratën tip me investitorin në lidhje me kryerjen e transaksioneve në tregun me pakicë.

Banka apo subjekti i licencuar që shet bono thesari në tregun me pakicë, pajis blerësin:

- me një vërtetim për shpallje fitues për veprimet e tregut primar,
- me një vërtetim blerje për veprimet e shitjes nga portofoli i vet.

Vërtetimi për bonot e thesarit, sipas llojit të mësipërm, duhet të përmbajë emrin dhe adresën e investitorit, datën e transaksionit dhe datën e kryerjes së veprimit, vlerën nominale të bonos të blerë, Yield-in, çmimin e skontuar dhe mënyrën e pagesës në maturim. Kërkesat bazë të

Vërtetimit janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje, të paraqitura në Aneksin 2.

Banka apo subjekti i licencuar që shet obligacione në tregun me pakicë, pajis blerësin me një vërtetim blerje për veprimet e shitjes nga portofoli i vet.

Vërtetimi për obligacionet duhet të përmbajë emrin dhe adresën e investitorit, datën e transaksionit dhe datën e kryerjes së veprimit, vlerën nominale të obligacionit, çmimin e shitjes, vlerën e kuponit të ofruar, yield uniform i pranuar, shpeshtësinë e pagesës së kuponit, datën e pagimit të kuponit dhe mënyrën e pagesës në maturim. Kërkesat bazë të Vërtetimit janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje, të paraqitura në Aneksin 2.

Banka apo subjekti i licencuar me kërkesë të investitorit e pajis atë me njoftim mbi lëvizjet e llogarisë së tij në regjistër.

Neni 5

Mbajtja e regjistrit analitik

Të dhënat mbi transaksionet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë regjistrohen në një regjistër analitik të administruar nga bankat apo subjektet e tjera e licencuara për këtë aktivitet, sipas Rregullores "Mbi licencimin e regjistruesve të letrave me vlerë" i ndryshuar.

Ky regjistër siguron mbajtjen e të dhënave në mënyrë analitike për investitorët mbi pronësinë e letrave me vlerë të Qeverisë, transaksionet e kryera në lidhje me këto letra me vlerë apo të dhëna në lidhje me vendosjen e tyre si garanci.

Bankat apo subjektet e tjera të licencuara për tregtim me pakicë, të cilat nuk mbajnë regjistër analitik duhet të sigurojnë mbajtjen e të gjitha të dhënave sipas paragrafit të dytë të këtij neni në një regjistër analitik të një banke apo subjekti tjetër të licencuar për këtë qëllim, bazuar në një marrëveshje midis tyre.

Mbajtja e regjistrit analitik sipas këtij neni përbën kusht për licencimin e bankës apo subjektit tjetër për tregtimin me pakicë të letrave me vlerë të qeverisë.

Neni 6

Detyrimi për informim të investitorit

Bankat apo subjektet e tjera të licencuara janë të detyruara të informojnë publikun për të dhënat mbi letrat me vlerë të qeverisë të ofruara, çmimin e shitjes dhe të blerjes, llojet e transaksioneve, yield-et, kuponin dhe komisionet që aplikohen, nëpërmjet publikimit të dukshëm ne sportele dhe forma të tjera komunikimi.

Neni 7

Raportimi dhe Monitorimi

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë nëpërmjet raportimit të të dhënave dhe inspektimit në vend të ecurisë së procesit.

Bankat apo subjektet e tjera të licencuara, pasi të kenë rakorduar të dhënat me Bankën e Shqipërisë, raportojnë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për aktivitetin e kryer gjatë çdo muaji në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë brenda javës së parë të muajit pasardhës, më të dhënat sipas aneksit 1 bashkëngjitur.

Neni 8

Referenca

Për terma dhe procedura të parashikuara në këtë rregullore vlen referenca në marrëveshjen midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë "Mbi emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi" dhe marrëveshjen "Mbi emetimin e obligacioneve në formë regjistri".

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ne datën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

Aneksi 1

Mbi raportimin mujor
"Për Tregun me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë"

Banka _____

Data raportimit_____

Periudha raportuese_____

Transaksione në Tregun me Pakicë të Bonove të Thesarit*

Lloji i transaksionit	Bono 3-mujore**		Bono 6-mujore		Bono 12-mujore	
	Vlera nominale	Nr transak	Vlera Nominale	Nr transak	Vlera nominale	Nr transak
Blerje në tregun primar						
Shitje nga portofoli i bankës apo subjektit të licencuar						
Blerje e bonove nga banka/ subjekti i licencuar para maturimit						
Shlyerja e vlerës nominale në maturim						
Bono e vendosur si kolateral						

Transaksione në Tregun me Pakicë të Obligacioneve të Qeverisë*

Lloji i transaksionit	Obligac. 2-vjecare			Oblig. 3-vjecare			Oblig. 5-vjecare		
	Vl.nom	Nr.	Kup	Vl.nom	Nr.	Kup	Vl.nom	Nr.	Kup
Shitje nga portofoli i bankës/subjekt të licenc									
Blerje e oblig nga banka/ subjekti i licenc para maturimit									

Shlyerja e vlerës nominale në maturim									
Obligacion vendosur si kolateral									

** Pasqyrat plotësohen veç për individët dhe veç për personat juridikë. Për personat juridikë të tregohet e ndarë për rezidentë dhe jorezidentë.*

*** Të identifikohet transaksioni nga lloji i letrës me vlerë sipas emetimit, pavarësisht nga ditët e mbetura në maturim të bonos/obligacionit.*

Nënshkrimi

Drejtuesi i Regjistrit

Aneksi 2 *Faqja 1*

Kërkesat bazë të Vërtetimit që lëshon Banka/Subjekti i licencuar mbi llojin e transaksionit të kryer në Tregun me pakicë të Bonove të Thesarit/ obligacioneve

- **Të përgjithshme**
  - Stema e Bankës/subjektit të licencuar që lëshon vërtetimin
  - Data e lëshimit të vërtetimit
  - Nënshkrimi nga firma e autorizuar

- **Të dhëna mbi klientin**
  - Emri, Atësia, Mbiemri
  - Adresa
  - Nr. i identifikimit , Kodi i identifikimit të klientit (nëse ka)
  - Llogaria bankare

- **Të dhëna mbi transaksionin në tregun me pakicë**

  (plotësimi i çdo pike të mëposhtme sipas llojit të transaksionit)

  - **Lloji I transaksionit**
    - *Blerje e bonove në tregun primar*

- *Shitje nga portofoli i bankës të letrës me vlerë të qeverisë*
- *Blerje e bonove/obligacioneve nga Banka/subjekti i licencuar para maturimit*
- *Shlyerja e vlerës nominale në maturim*
- *Bono/obligacion e vendosur si kolateral*

- Data e kontratës (e kryerjes së transaksionit)
- Date valuta (e bërjes efektive)
- **Të dhëna mbi bonon e thesarit/obligacionin**
  - Emërtimi ose Kodi i bonos së thesarit/obligacionit (nëse ka)
  - Nr. i ankandit
  - Data e emetimit
  - Data e maturimit
  - Nr. i ditëve të bonos/obligacionit deri në maturim
  - Vlera nominale
  - Prorate
  - Çmimi i blerjes
  - Çmimi i shitjes
  - Yield i bonos/obligacionit
  - Kuponi i përcaktuar/i llogaritur
  - Shpeshtësia e pagimit të kuponit
  - Mënyra e pagimit të kuponit

➢ **Të dhëna të tjera**

- Tatimi mbi interesin
- Komisioni apo pagesa të tjera

➢ **Informacion mbi Bonot e Thesarit/obligacionet**

∗ Sugjerojmë që këto çështje të shënohen në pjesën e prapme të Vërtetimit, sipas formulimit të dhënë në faqen 2 të këtij aneksi (opsionale), ose në rast të vendoset në formën e shënimit disa fjali-informacion, në fund të faqes së Vërtetimit.

Aneksi 2 *Faqja 2*

- Stema e Ministrisë së Financave

Informacion mbi Bonot e Thesarit

Të përgjithshme

Bonot e Thesarit janë letra me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave në formë regjistrimi.

Bonot e Thesarit janë letra me vlerë afatshkurtër me afat maturirmi deri në 1 vit. Aktualisht në Shqipëri emetohen Bono Thesari me afati maturimit 3, 6 dhe 12 mujore.

Bonot e Thesarit shiten me zbritje ndaj vlerës së tyre nominale. Diferenca mes çmimit të blerjes dhe vlerës nominale përfaqëson interesin e fituar nga bonot. Investitori në datën e blerjes paguan vetëm çmimin e blerjes në përputhje me vlerën nominale dhe normën e zbritjes (Yield), që përcaktohet në ankand.

Në datën e maturimit, paguhet vlera nominale ose Bonot e Thesarit mund të ri investohen.

Bonot e Thesarit emetohen në formë regjistri në llogari, që do të thotë se nuk kanë një formë fizike, por investitorit i jepet një vërtetim pronësie, apo vërtetim për transaksionin që bën me to. Regjistri i pronësisë së bonove të Thesarit për individët mbahet pranë Bankës së Shqipërisë, apo një Banke tjetër të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për këtë qëllim.

Emetimi i Bonove të Thesarit

Emetimi i Bonove të Thesarit bëhet nëpërmjet shitjes me ankand në tregun primar të organizuara nga Banka e Shqipërisë në periudha kohe të rregullta.

Norma fillestare e emetimit:	Norma e zbritjes përcaktohet nga ankandi
Vlera minimale për pjesëmarrje në ankand:	300.000 lekë
Vlera maksimale:	-për pjesëmarrësit me kërkesa jo konkurruese 50 milion lekë -për kërkesa konkurruese 80% e shumës së ofruar në ankand, pas pjesëmarrjes së Bankës së Shqipërisë.
Rritja e shumës së investuar në bono:	Shumëfishohet me 10.000 lekë
Metoda e emetimit:	Ankandi nëpërmjet pjesëmarrjes në sportelet e bankave

Tregtimi i Bonove të Thesarit

Bonot e Thesarit janë lirisht të tregtueshme, ato mund të shiten dhe blihen para afatit të maturimit në sportelet e bankave dhe subjekteve te tjera të licencuara.

Interesi i fituar nga Bonot tërhiqet në çdo kohë, duke filluar nga data e emetimit deri në datën e maturimit.

Tatimi

Interesi nga bonot është objekt i tatimit mbi të ardhurat. Tatimi mbahet në datën e maturimit.

Risku

Ministria e Financave është përgjegjëse për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Për vërtetimin e obligacioneve *Faqja 2*

- Stema e Ministrisë së Financave

Informacion mbi obligacionet

Të përgjithshme

Obligacioni është letër me vlerë e borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave në formë regjistrimi.

Obligacioni është letër me vlerë me afat maturirmi afatmesëm dhe afatgjatë duke filluar nga 1 vit deri në disa dhjetëra vjet. Aktualisht në Shqipëri emetohen obligacione me afati maturimit 1, 2 dhe 5 vjet.

Obligacioni ofron një interes vjetor, të quajtur kupon i përcaktuar që në datën e emetimit. Kuponi paguhet çdo 6-muaj deri në maturimin e obligacionit. Obligacionet shiten me çmimi me të lartë, më të ulët ose me vlerë nominale në varësi të yield të tregut. Norma e kuponit e llogaritur mbi vlerën nominale dhe diferenca mes çmimit të blerjes dhe vlerës nominale përfaqëson të ardhurat e fituara nga obligacioni. Investitori në datën e blerjes paguan vetëm çmimin e blerjes në përputhje me çmimin e përcaktuar nga kushtet e tregut.

Në datën e maturimit, paguhet vlera nominale.

Obligacionet emetohen në formë regjistri në llogari, që do të thotë se nuk kanë një formë fizike, por investitorit i jepet një vërtetim pronësie, apo vërtetim për transaksionin që bën me to. Regjistri i pronësisë së obligacioneve për individët mbahet pranë një Banke apo subjekti tjetër të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për këtë qëllim.

Emetimi i Obligacioneve

Emetimi i Obligacioneve bëhet nëpërmjet shitjes me ankand në tregun primar të organizuara nga Banka e Shqipërisë në periudha kohe të rregullta.

Tregtimi i Obligacioneve

Obligacionet janë lirisht të tregtueshme, ato mund të shiten dhe blihen para afatit të maturimit në sportelet e bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara.

Diferenca e çmimit me vlerën nominale tërhiqet në çdo kohë, duke filluar nga data e emetimit deri në datën e maturimit.

Tatimi

Interesi (kuponi) nga obligacionet është objekt i tatimit mbi të ardhurat.

Risku Ministria e Financave është përgjegjëse për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 07.12.2006

PËR MIRATIMIN E FORMATIT DHE RINOVIMIN E LICENCËS SI PËRFAQËSUES I TREGTARIT TË LICENCUAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 8080, datë 1.03.1996 "Për Letrat me Vlerë", të nenit 13 dhe 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të licencës "Përfaqësues i tregtarit të licencuar", bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Rinovimin për një periudhë të njëjtë kohe të licencës si përfaqësues i tregtarit të licencuar "Banka Amerikane e Shqipërisë", zj. Suela Totokoçi dhe zj. Elona Korini.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 29.12.2006

PËR

MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT MIDIS AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIATRE DHE AUTORITETIT TË KONKURENCËS

Në bazë dhe për zbatim të pikës 14 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Kryetarit, Bordi i Autoritetit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Memorandumin e Bashkëpunimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoritetit të Konkurencës sipas teksit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për firmosjen dhe ndjekjen e procedurave të formalizimit të Memorandumit ngarkohet Kryetari i Autoritetit.
3. Ngarkohet Administrata e Autoritetit për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij Memorandumi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

AUTORITETI KONKURRENCËS AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

DHE

AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE dhe

AUTORITETI I KONKURRENCËS,

duke parë nevojën për bashkëpunim dhe mirëkuptim dypalësh, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve të tyre përkatëse mbikëqyrëse;

BIEN DAKORT:

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

Neni 1

Parime të Përgjithshme

a) Kjo marrëveshje synon sigurimin e asistencës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis dy institucioneve: Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoritetit të Konkurrencës.

b) Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të bëhet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy institucioneve.

c) Kjo marrëveshje shërben si bazë kooperimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Kjo marrëveshje nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Gjithashtu, nuk ndikon ndonjë marrëveshje tjetër, që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ose Autoriteti i Konkurrencës kanë me institucione të tjera. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cënojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej autoriteteve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit autoritetet janë krijuar dhe funksionojnë.

d) Autoritetet njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunim, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatore. Kërkesa mund të mos plotësohet në keto situata:

(i) kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit,

(ii) kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

Neni 2

Autoritetet Nënshkruese

1. Autoriteti i Konkurrencës (në vijim AK), i cili është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë, efektive në treg, është organ publik i pavarur në kryerjen e detyrave të veta.

   - AK, kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve në treg,
   - nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre,
   - bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën.

2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim AMF) është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006.

AMF është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë, i specializuar për të rregulluar e mbikëqyrur veprimtarinë e subjekteve, që ushtrojnë një ose disa nga veprimtaritë në fushat e letrave me vlerë, të sigurimeve, të pensioneve suplementare si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Autoriteti, për veprimtarinë që ushtron, në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

AMF me strukturat e veta ka si objekt të veprimtarisë:

1. Rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura prej tij, nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore, të parashikuara nga ky ligj dhe nga ligjet e fushës, si dhe botimin e udhëzimeve e materialeve shpjeguese.
2. Sigurimin e mbikëqyrjes shtetërore mbi tregun e letrave me vlerë, tregun e sigurimeve, skemat e pensioneve suplementare dhe veprimtari të tjera financiare jobankare, të cilat rregullohen e funksionojnë në përputhje me ligjet në fuqi.

Në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në nenin 2 të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, Autoriteti ka të drejta të plota për:

a) miratimin, lëshimin apo refuzimin e licencave për subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jobankare,

b) vëzhgimin dhe organizimin e mbikëqyrjes së subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jobankare,

c) ndjekjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij e të ligjeve të fushës dhe të akteve nënligjore dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Neni 3

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të bashkëpunimit dypalësh në mënyrë që të sigurohet:

a) shkëmbimi i informacionit midis dy Autoriteteve nënshkruese;

b) bashkëpunimi për arritjen e një konkurrence të lirë dhe efektive, për zbatimin e rregullave të vendosjes së politikave jo diskriminuese për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushat që AMF ushtron funksionet e veta mbikëqyrëse.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje nëpërmjet vendosjes së rregullave për bashkëpunim dypalësh, i shërben lehtësimit të zbatimit të funksioneve të vetë Autoriteteve nënshkruese.

Neni 4

Kërkesat për Informacion ose Bashkëpunim

a) Kërkesat për informacion ose bashkëpunim bëhen me shkrim, në shqip dhe të plota. Ato duhet t'i drejtohen personit të kontaktit të institucionit marrës të kërkesës (shiko Aneksi 1);

b) Kërkesat për informacion ose bashkëpunim duhet të sigurojnë:

(i) një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për te cilin kërkohet informacion,

(ii) qëllimin për të cilin i kërkohet informacion,

(iii) kohën e dëshiruar për marrjen e përgjigjes.

Neni 5

Ekzekutimi i Kërkesës për Informacion

Institucioni marrës i kërkesës pasi analizon çdo kërkesë për informacion, i siguron Institucionit kërkues informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, Institucioni marrës i kërkesës duhet të japë përgjigjen me shkrim Institucionit që kërkon informacionin, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit.

Neni 6

Përdorimi i Informacionit dhe Konfidencialiteti

a) Çdo informacion i siguruar sipas kësaj marrëveshje nuk duhet të përdoret nga asnjë palë e tretë, pa parapëlqimin e Autoritetit që e ka siguruar këtë informacion.

b) Autoriteti kërkues do të përdorë informacionin që ka marrë vetëm:

i. për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose

ii. për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.

Neni 7

Shqyrtimi i Marrëveshjes

a) Autoritetet do të rishikojnë vazhdimisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do ta konsultojnë atë me synimin e përmirësimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme që mund të dalin. Në mënyrë të veçantë Autoritetet, sipas kërkesave, do të konsultohen në rastet e:

   i. refuzimit nga ndonjëri prej Institucioneve për të respektuar dhënien e një informacioni të kërkuar;

   ii. ndryshimit të kushteve të tregut apo të aktivitetit, ligjeve apo rregulloreve, apo kur del ndonjë vështirësi tjetër e cila e bën të domosdoshëm ndryshimin apo plotësimin e kësaj Marrëveshjeje në mënyrë që të realizohen qëllimet e saj.

Neni 8

Ndërprerja e Marrëveshjes

a) Ngarkohen AMF dhe AK me strukturat e tyre përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

b) Çdo rregullim ose ndryshim sipas nenit 7, në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve, e cila realizohet me miratimin e tyre.

c) Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.

d) Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

e) Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.

Neni 9

Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pakufizuar dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga AMF dhe AK.

Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje dhe secila nga palët mban një kopje në origjinal.

Nënshkruar sot, më datë 29.12.2006, në Tiranë.

AUTORITETI KONKURRENCES	AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
K R Y E T A R	**K R Y E T A R**
_____	_____
Lindita MILO (LATI)	**Elisabeta GJONI**

ANEKS I

Personi i kontaktit për AUTORITETIN E MBIKEQYRJES FINANCIARE

Znj. Aljona MANSAKU

Shefe e Sektorit Juridik në Departamentin Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë e Publikun

Adresa: Rruga "Perlat Rexhepi" Pallati 10 përballë Gardës së Republikës

Tel: 04 247 148

Fax: 04 250 686

E-mail: amancaku@amf.gov.al

Personi i kontaktit për AUTORITETIN E KONKURRENCËS

Znj. Daniela MEHMETI

Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike

Adresa: Rruga "Sami Frashëri" Nr. IV, Tiranë

Tel: 04 234 504

Fax: 04 234 497

E-mail: dmehmeti@caa.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 07.12.2006

PËR

SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE DHE ANËTARËVE TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 29.12.2006

PËR

MIRATIMIN E Z. SAIMIR ZËMBLAKU NË POSTIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" sh.a

Në bazë dhe për zbatim të nenit 62, pika 3, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Sipas propozimit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, të miratojë z. Saimir Zëmblaku, në postin e drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 29.12.2006

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR HAPJE ZYRE PËRFAQËSIMI

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të nenit 14, pika 6/ë, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin për hapjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të një zyre përfaqësimi të shoqërisë "Intersalonika General Insurance SA".

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 29.12.2006

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT STATUTIT DHE ORGANEVE DERJTUESE TË SHOQËRISË "KAPITAL-INVEST"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 29.12.2006

PËR

SHPENZIME TË VOGLA TË PËRDITSHME PËR PUNONJËSIT NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIATRE

Vendime Bordi të AMF-së, miratuar gjatë vitit 2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 15.01.2007

MBI

REKOMADIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA ANALIZA E GJENDJES FINANCIARE PËR 9-MUJORIN E VITIT 2006 TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A DHE INSPEKTIMI I USHTRUAR NË KËTË SHOQËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 15.01.2007

MBI

REKOMADIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA ANALIZA E GJENDJES FINANCIARE PËR 9-MUJORIN E VITIT 2006 TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A DHE INSPEKTIMI I USHTRUAR NË KËTË SHOQËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 15.01.2007

MBI

REKOMDIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA ANALIZA PËR 9-MUJORIN E VITIT 2006 TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A DHE INSPEKTIMI I USHTRUAR NË KËTË SHOQËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 15.01.2007

MBI

REKOMDIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA ANALIZA PËR 9-MUJORIN E VITIT 2006 TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A DHE INSPEKTIMI I USHTRUAR NË KËTË SHOQËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 15.01.2007

MBI

REKOMANDIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA INSPEKTIMI I USHTRUAR NË INSTITUTIN PRIVAT TË PENSIONEVE "CAPITAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 15.01.2007

MBI

REKOMANDIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA INSPEKTIMI I USHTRUAR NË INSTITUTIN PRIVAT TË PENSIONEVE "GARANTSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 15.01.2007

PËR

RINOVIMIN E AFATIT TË PUNËSIMIT PART TIME TË SHOFERIT TË ADMINISTRATËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 15.01.2007

PËR

REKRUTIMIN ME KOHË TË PJESSHME PRANË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE TË PUNONJËSVE TË JASHTËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 29.01.2007

MBI

REKOMADIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA ANALIZA E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A PËR 9-MUJORIN E VITIT 2006 DHE INSPEKTIMI I USHTRUAR NË KËTË SHOQËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 29.01.2007

MBI

REKOMADIMET DHE MASAT E PROPOZUARA PËR SHKELJET E KONSTATUARA NGA ANALIZA E GJENDJES FINANCIARE PËR 9-MUJORIN E VITIT 2006 TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A DHE INSPEKTIMI I USHTRUAR NË KËTË SHOQËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 29.01.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 29.01.2007

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME DHE LICENCIM AGJENTËSH

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të licencës "Agjent i shoqërisë së Sigurimit....." sipas aneksit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Miratimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë "Insig" sh.a, të zotërinjve: Frane Laskaj, Selman Caka, Bukurie Shehu, Artan Alikaj, Mirgen Dervishi, Mirjana Drevishi (Janushaj), Marin Zymaj, Arta Saliu, Menduha Hoxha.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 29.01.2007

PËR

ZGJERIMIN E OBJEKTIT TË LICENCËS SI REGJISTRUES I LETRAVE ME VLERË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 29, të Ligjit nr. 8080, datë 1.03.1996 "Për letrat me vlerë" dhe të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Objekti i licencës nr. 79, datë 28.09.2005, dhënë "Raiffeissen Bank" sh.a, për ushtrim veprimtarie si regjistrues i letrave me vlerë të skontueshme të Qeverisë" ndryshon si më poshtë:

   "I jepet e drejta të ushtrojë veprimtari si regjistrues i letrave me vlerë të Qeverisë në R.SH"

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 29.01.2007

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË "CAPITAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 16, datë 29.01.2007

PËR

PËRFTIMIN E NJË SHTESE MBI PAGËN MUJORE TË PUNONJËSES SË SHËRBIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 08.02.2007

PËR

MRATIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË AUDITIMIN E BRENDËSHËM TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIRE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KUFIJTË E INVESTIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores *"Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit",* sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE
PËR
KUFIJTË E INVESTIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 4, datë 08.02.2007

Neni 1

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 58 dhe 95, pika 2, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime risigurime".

Neni 2

Kjo rregullore përcakton kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit. Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorura në të kanë të njëjtën kuptim si ato të shprehur në nenin 3 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" i shprehur si "Ligji" në këtë rregullore.

Neni 3

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse.

Neni 4

Objekti i vendosjes së këtyre raporteve mbikëqyrëse është, që shoqëritë e sigurimit të mos ushtrojnë në mënyrë të pakufizuar investimin e kapitalit të tyre , në mënyrë që të mos përballen në mënyrë të pakontrolluar me rreziqe të ndryshme.

Neni 5

Investimi i kapitalit të një shoqërie sigurimi bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet ruajtja e vlerës, përfitueshmëria dhe likuiditeti.

Neni 6

1. Kapitali i shoqërisë së sigurimit përbëhet nga kapitali themeltar dhe kapitali shtesë.

2. Kapitali i lejuar për t'u investuar nga shoqëritë e sigurimit është ajo pjesë e kapitalit, e cila kalon kufirin minimal të fondit të garancisë të llogaritur sipas nenit 98 të Ligjit nr. 9267 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime risigurime" .

Neni 7

1. Drejtimet e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit janë si më poshtë:

a. Pasuri të paluajtshme (toka dhe ndërtesa)

b. Investime financiare (letra me vlerë të Qeverisë dhe të borxhit publik, letra borxhi, mjete të tjera të tregjeve të parasë dhe të kapitalit).

Neni 8

1. Shoqëritë e sigurimit investojnë kapitalin e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, shoqëritë mund të investojnë jo më shumë se 10% të kapitalit të tyre në tregjet ndërkombëtare jashtë Shqipërisë, vetëm në letra me vlerë të garantuara të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Amerikës së Veriut, pasi kanë marrë më parë miratim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 9

1. Kapitali i shoqërisë së sigurimit të mund të investohet deri në 5 % (për qind) në hua të garantuara, me kusht që investimet individuale për hua të kësaj natyre të shoqërive të sigurimit nuk duhet të kalojnë më shumë se 1 % (për qind) të vlerës së kapitalit të shoqërisë së sigurimit dhe duhet të shlyhen brenda një periudhe 1 vjeçare.

2. Investimet financiare të shoqërisë së sigurimit në një bankë, nuk mund të kalojnë 25 % (për qind) të kapitalit të shoqërisë së sigurimit.

3. Investimet financiare të shoqërisë së sigurimit në një person juridik jobankar (institucione

financiare jo bankare), nuk lejohet të tejkalojnë 10 % (për qind) të kapitalit të shoqërisë së sigurimit.

Neni 10

Në rast të mospërmbushjes nga shoqëritë e sigurimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare merr masat administrative të parashikuara në nenin 164 e vijues të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

Neni 11

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE KUSHTET E RAPORTIMIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores *"Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare",* sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR

RREGULLAT, MËNYRAT DHE KUSHTET E RAPORTIMIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 08.02.2007

Baza ligjore: Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 122 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

1. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj të sigurimit është e detyruar të raportojë dhe depozitojë pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të gjitha të dhënat e parashikuara në këtë rregullore. Sa herë që në këtë rregullore do të përdoret termi "shoqëria e sigurimit" do të nënkuptohet edhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari në sigurime/risigurime.

2. Shoqëria e sigurimit përpara çdo ndryshimi të të dhënave në rregjistrin tregtar, raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare brenda 10 ditëve kalendarike. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në rast se konstaton shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, në një afat prej 30 ditësh kalendarike nga data e depozitimit të njoftimit, mund të kërkojë ndryshimin e tyre.

3. Shoqëria e sigurimit, njofton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për datën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të zakonshme apo të jashtëzakonshme të aksionerëve, 5 ditë kalendarike përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe depoziton një kopje të vendimeve të marra në këtë mbledhje brenda 5 ditëve kalendarike nga zbardhja e tyre.

4. Shoqëria e sigurimit, njofton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për datën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes së këshillit mbikëqyrës, 5 ditë kalendarike përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe depoziton një kopje të vendimeve të marra në këtë mbledhje brenda 5 ditëve kalendarike nga zbardhja e tyre.

5. Shoqëria e sigurimit, raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare çdo ndryshim të listës së aksionarëve dhe pjesëmarrjes së tyre në kapitalin aksionar brenda 10 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së ndryshimeve për rastet kur nuk ka ndryshim të pjesëmarrjes influencuese. Nëse ndryshimet e listës së aksionarëve dhe pjesëmarrjes së tyre në kapitalin aksionar janë sipas nenit 16 dhe 56 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, shoqëria e sigurimit merr më parë miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

6. Shoqëria e sigurimit, raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Zv/Drejtorit të Përgjithshëm, drejtoreve të drejtorive, drejtorëve të degëve dhe çdo ndryshim të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit duke e shoqëruar atë me argumentet përkatëse.

7. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare propozimin për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe anëtarit të këshillit mbikëqyrës, administratorit të degës së shoqërisë së huaj, të Zv/ Drejtorit të Përgjithshëm dhe njofton emërimin e drejtorëve të drejtorive dhe drejtorëve të degëve. Autoriteti shprehet në përputhje me parashikimet e neneve 40 dhe 63 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

8. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare çdo tre mujor, së bashku me të dhënat e pasqyrave financiare të periudhës përkatëse, strukturën e kapitalit të saj apo ndryshimin e tij.

9. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare kopje të çdo marrëveshje risigurimi brenda 10 ditëve kalendarike nga nënshkrimi i tyre si dhe dokumentet që vërtetojnë pagesat e primit tek risigururesi ose brokeri kur Autoriteti e gjykon të nevojshëm.

10. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare kushtet e kontratave të reja të sigurimit përpara hedhjes së tyre në treg. I njëjti detyrim qëndron edhe në rastet e ndryshimit të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratave ekzistuese të sigurimit. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i shqyrton ato brenda 1 muaji nga data e depozitimit.

11. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare bazat teknike dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të primeve të produkteeve të reja të sigurimit vullnetar, si dhe ndryshimin e atyre ekzistuese përpara një muaji nga aplikimi i tyre. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë ti rekomandojë shoqërisë së sigurimit implementimin e elementëve shtesë në bazën e të dhënave apo metodave të përdorura për llogaritjen e tyre.

12. Shoqëria e sigurimit depoziton pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare çdo material me karakter publicitar, 10 ditë kalendarike përpara publikimit të tyre. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund të kërkojë ndryshimin e tyre nëse ato janë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, apo kanë karakter abuziv që shkelin rregullat e konkurrencës, në një afat prej 10 ditë kalendarike nga data e depozitimit. Nëse në mbarim të këtij afati, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk ka bërë vërejtje me shkrim, shoqëria e sigurimit mund ti publikojë ato.

13. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ndryshimet apo përmirësimet e planit të biznesit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së ndryshimeve apo përmirësimeve.

14. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare çdo ndryshim të selisë qendrore apo të degëve të tyre, 10 ditë kalendarike përpara ndryshimit të tyre.

15. Shoqëria e sigurimit raporton dhe depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare kontratat e lidhura midis shoqërisë së sigurimit dhe agjentëve apo shoqërive të agjentëve sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave për licencimin e agjentëve në sigurime, kontratave të lidhura me brokerin, shoqërinë e brokerimit, vlerësuesin e dëmeve, konsulentin në sigurime dhe aktuarin, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të tyre.

16. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare çdo marrëveshje të lidhur ndërmjet saj dhe shoqërisë së brokerimit vendas apo të huaj brenda 20 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të tyre.

17. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare kontratat e lidhura midis shoqërisë së sigurimit dhe vlerësuesve të dëmeve, konsulentëve sigurime apo aktuarëve në sigurime, kur këto veprimtari ushtrohen nga persona fizikë apo juridikë të licencuar. I njëjti detyrim qëndron edhe në rastet e zgjidhjes së këtyre kontratave.

18. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare menjëherë, nëse aftësia paguese e shoqërisë së sigurimit e llogaritur në përputhje me nenin 96 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 ka rënë:

- Nën nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, parashikuar ne nenin 96 dhe 97 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

- Nën minimumin e fondit të garancisë parashikuar në nenin 98 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

19. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, mbas marrjes së raportit të parashikuar në pikën 18 të kësaj rregulloreje merr masat e nevojshme sipas parashikimeve të pikës a, të nenit 126 dhe nenit 127 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2005.

20. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare menjëherë, nëse likuiditeti i shoqërisë së sigurimit bie nën nivelin minimal të likuiditetit të përcaktuar me rregulloren përkatëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

21. Shoqëria e sigurimit detyrohet të zbatojë kërkesat e parashikuara në këtë rregullore, në të kundërt do të jetë subjekt i sanksioneve të parashikuara në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin me ndryshimet e propozuara të rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 7, datë 08.02.2007, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 10, datë 17.12.2007, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 95, datë 14.08.2008

Ne bazë të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", neni 71, 72, 73 dhe 74, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

Neni I

Dispozita të përgjithshme

Në këtë rregullore përcaktohen:

*Kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

*Përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar.

1.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje përbëhet nga: Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", nenet 71,72,73,74, Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, kreu III, neni 14 dhe Ligji nr. 7638, datë 19.11. 1992 "Për shoqëritë tregtare".

1.2 Subjekte të kësaj rregulloreje janë shoqëritë e sigurimit dhe degët e shoqërive të huaja, të licencuara ose që janë në proces licencimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë, që në vijim do të quhen "shoqëri sigurimi" ose/dhe "shoqëri risigurimi".

1.3 Për efekt të kësaj rregulloreje "Kontrolli i ushtruar nga Shoqëritë e Ekspertëve kontabël të autorizuar" përfshin:

a) kontrollin e raporteve bazë financiare, që në vijim do të quhen "raporte financiare" që përgatiten nga shoqëria e sigurimit në përputhje me "Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar " përveç kur është parashikuar ndryshe në Ligjin "Për kontabilitetin" dhe Ligjin nr. 9267, datë 29/07/2004 "Për veprimtarinë në sigurime, risigurime dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime". b) vlerësimin e pasqyrave financiare me karakter specifik të përgatitura nga shoqëria e sigurimit në përputhje me Ligjin nr. 9267, datë 29/07/2004 dhe aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës Financiar; c) vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë së zbatimit të akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operon shoqëria e sigurimit.

Neni 2

Kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar

2.1 Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për shoqërinë e ekspertëve kontabël të autorizuar të zgjedhur nga vetë ajo, jo më vonë se 30 Korrik i çdo viti kalendarik.

2.2 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton shoqërinë e ekspertëve kontabël të autorizuar kur kandidati për ekspert kontabël i paraqitur për miratim është "Shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar", e regjistruar në listën e IEKA-s.

2.3 Për të marrë miratimin e Shoqërisë së Ekspertëve kontabël të autorizuar të emëruar, shoqëria e sigurimit paraqet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, dokumentacionin si më poshtë:

- Vendimin e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë së sigurimit, për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar;

- Programin e kontrollit;

- Letrën e angazhimit të paraqitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël;

- Vërtetimin nga IEKA që ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë si shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar në auditimin e subjekteve të sektorit financiar. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar, duhet të depozitojë në Autoritet të dhëna se ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë, në auditimin e subjekteve të cilat kanë zbatuar standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

- Të dhëna në lidhje me aktuarin e certifikuar dhe të kontraktuar nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar,

- si dhe të dhëna të tjera specifike të kërkuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2.4 Dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose fotokopje të noterizuar. Kur dokumentacioni është në gjuhë të huaj, origjinal ose fotokopje e noterizuar, do të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

2.5 Shoqëria e sigurimit është e detyruar të marrë miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare , për çdo ndryshim të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 3

Miratimi ose refuzimi i Shoqërisë së Ekspertëve kontabël të autorizuar

3.1 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare brenda një muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë të kërkuar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje miraton ose refuzon Shoqërinë e Ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit.

3.2 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare njofton shoqërinë e sigurimit brenda 10 ditëve. Mangësitë duhet të plotësohen nga shoqëria e sigurimit brenda 15 ditëve pune.

3.3 Miratimi i emërimit të Shoqërisë së Ekspertëve kontabël të autorizuar bëhet nga Bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me pikën 11 të nenit 14 të Ligjit nr. 9572 datë, 03.07.2006.

3.4 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund të refuzojë Shoqërinë e Ekspertëve kontabël të autorizuar kur gjykon se ky ekspert, në auditimin e mëparshëm, nuk ka vepruar në përputhje me ose nuk ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e nenit 4, të pikës 5.1 të nenit 5, të pikës 6.1, 6.4 të nenit 6 dhe të nenit 7 të kësaj rregulloreje ose të kërkesave të tjera për të cilat është rënë dakord me shkrim.

Neni 4

Kontrolli i raporteve financiare

4.1 Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kontrollon, nëse raportet financiare të shoqërisë së sigurimit janë përgatitur në përputhje me "Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar", përveç kur është parashikuar ndryshe në Ligjin "Për kontabilitetin", Ligjin nr. 9267, datë 29/07/2004 dhe aktet nënligjore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

4.2 Kontrolli i raporteve financiare, sipas pikës 4.1 të këtij neni, kryhet në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit).

4.3 Mbi bazën e ekzaminimit të bërë, sipas pikës 4.1 dhe 4.,2 të këtij neni, shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar jep një opinion, duke vënë në dukje nëse raportet financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit, provigjoneve teknike ose

matematike, të cash-flow-t etj. dhe nëse shoqëria e sigurimit përmbush kërkesat për aftësinë paguese apo kërkesa të tjera të autoritetit siç përcaktohen në Ligjin nr. 9267, datë 29/07/2004.

Neni 5

Opinioni i shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar

5.1 Në bazë të kontrollit që i ka bërë raporteve financiare për vitin ushtrimor, shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit raportin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit) dhe ia dorëzon këtë raport drejtuesve të shoqërisë së sigurimit dhe komitetit të kontrollit të brendshëm.

5.2 Drejtuesit e shoqërisë së sigurimit i paraqesin për miratim asamblesë së zakonshme të aksionarëve raportet financiare vjetore të audituara nga Shoqëria e Ekspertëve kontabël te autorizuar, së bashku me opinionin e tij. Drejtuesit e shoqërisë nënshkruajnë raportet financiare të audituara nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar.

5.3 Pas marrjes së vendimit përkatës nga asambleja e aksionerëve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 5.2 të këtij neni, shoqëria e sigurimit publikon në një nga botimet periodike financiare: paketën e plotë të pasqyrave financiare, së bashku me raportin përmbledhës të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar brenda 15 ditëve nga data e miratimit të raportit vjetor nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare por jo më vonë së gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

5.4 Një kopje e botimit të shoqërisë së sigurimit, publikuar sipas pikës 5.3 të këtij neni, dërgohet edhe në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 6

Vlerësimi i pasqyrave financiare me karakter specifik

6.1 Në rastet kur shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar nuk mund të japë një vlerësim mbi bazën e rezultateve të arritura nga ekzaminimi i pasqyrave financiare, ai bën komente mbi çdo pasqyrë për të cilën nuk mund të jepet vlerësim pozitiv dhe paraqet parregullsitë e vëna re në pasqyrën në fjalë.

6.2 Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar dorëzon vlerësimin me shkrim tek drejtuesit e shoqërisë së sigurimit dhe te komiteti i kontrollit të brendshëm.

6.3 Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me aktet nënligjore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, së bashku me raportin/vlerësimin e Shoqërisë së Ekspertëve kontabël të autorizuar, paraqiten nga drejtuesit e shoqërisë së sigurimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare brenda 8 ditëve nga data e marrjes dhe jo më vonë se 30 prill i vitit pasardhës.

6.4 Çdo pasqyrë financiare e shoqërisë së sigurimit do të jetë e nënshkruar paraprakisht nga drejtuesit e shoqërisë së sigurimit.

Neni 7

Procedura të tjera kontrolli

7.1 Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar bën vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë së akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operon shoqëria e sigurimit dhe zbatimin e tyre. Kjo përfshin vlerësimin nga ana e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar për: a) organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit; b) cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të shoqërisë së sigurimit për administrimin e aktiveve dhe pasiveve; c) organizimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e biznesit dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave.

7.2 Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar kërkon paraprakisht dhe vlerëson shqetësimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për aspekte të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

7.3 Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit një raport në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e saj mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit; mbi cilësinë e rregulloreve të shoqërisë së sigurimit dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e shoqërisë së sigurimit.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

8.1 Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit, e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kryen kontrollin në të njëjtën shoqëri sigurimi për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë së sigurimit pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën 2 vjetësh.

8.2 Sipas kërkesës së bërë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, drejtuesit e shoqërisë së sigurimit paraqesin për dijeni në Autoritet "Letrën për drejtimin" që Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit për drejtuesit e lartë të shoqërisë së sigurimit.

8.3 Një kopje e raporteve të Shoqërisë së Ekspertëve kontabël të autorizuar së bashku me vlerësimet e komitetit të kontrollit të brendshëm, të përgatitura sipas kërkesave të neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje apo çdo raporti tjetër të kërkuar i dërgohen Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nga drejtuesit e shoqërisë së sigurimit, jo më vonë se afatet e përcaktuara në nenet 72 dhe 75 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

8.4 Përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (Departamenti i Mbikëqyrjes), të Shoqërisë të Ekspertëve kontabël të autorizuar dhe përfaqësues të shoqërisë së sigurimit zhvillojnë takime të rregullta periodike;

- para ose pas përfundimit të ekzaminimit të plotë të kryer nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare pranë shoqërisë së sigurimit;
- në rrethana kur merren vendime të rëndësishme për shoqërinë e sigurimit.

8.5 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë ti kërkojë shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit, çdo informacion mbi veprimtarinë e saj. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar është e çliruar nga sekreti profesional në dhënien e informacionit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

8.6 Rregullorja nr 5, datë 28.01.2005 "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", miratuar me Vendimin nr. 12, datë 28.01.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI BAZAT, METODAT E LLOGARITJES SI DHE MËNYRAT E MBAJTJES SË PROVIGJONEVE MATEMATIKE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

– Miratimin e rregullores "Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

– Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI BAZAT, METODAT E LLOGARITJES SI DHE MËNYRAT E MBAJTJES SË PROVIGJONEVE MATEMATIKE

Miratuar me vendimin e Bordit nr.8, datë 08.02.2007

Baza ligjore: Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 101, pika 10, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.

Ne nenin 7 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, si sigurime për jetën klasifikohen:

Klasa 19: Jetë-vdekje

Klasa 20: Martesë-lindje

Klasa 21: Sigurime të lidhura me fonde investimi

Klasa 22: Administrimi i fondeve kolektive

Klasa 23: Sigurimi i fondeve për pagesa

Përkufizime:

Konceptet që do të përkufizohen më poshtë kanë të bëjnë me grupin 19. Policat e sigurimit të jetës që i përkasin grupit 19, ndahen në dy grupime të mëdha sigurime dhe anuitete.

Sigurime: Përfitimi është shuma e sigurimit, e cila i paguhet përfituesit nëse policmbajtesi vdes brenda një periudhe të caktuar, të specifikuar në policë ose mbijeton periudhën e specifikuar në policë.

Anuitete: Përfitimi është një seri e rregullt pagesash që i bëhen përfituesit të policës përgjatë afatit të shënuar dhe përderisa ai jeton.

1. Sigurimi i pastër me elemente kursimi me afat n vjet[1)]: Policmbajtësit me moshë x në momentin e blerjes së policës, i paguhet shuma e sigurimit S pas n vjetëve, nëse ai jeton deri në atë kohë. Nuk bëhet asnjë pagesë nëse policmbajtësi nuk jeton deri në moshën $x+n$. Shënimi standard aktuarial për vlerën e tashme të pritshme të përfitimit kur $S=1$ është: ${}_nE_x$ **ose** $A^{\ 1}_{x:\overline{n}|}$

2. Sigurimi i përkohshëm i jetës me afat n vjet[2)]: Përfituesit të policmbajtësit me moshë x në momentin e blerjes së policës, i paguhet shuma e sigurimit S nëqoftëse dhe vetëm nëqoftëse policmbajtësi vdes brenda afatit n – vjeçar. Shënimi standard actuarial për vlerën e tashme të pritshme të përfitimit kur $S=1$ është: $A^{1}_{x:\overline{n}|}$

3. Sigurim jetë me elemente kursimi me afat n vjet[3)]: Përfituesit të policmbajtësit me moshë x në momentin e blerjes së policës i paguhet shuma e sigurimit S, në fund të vitit të vdekjes së tij ose në fund të afatit n – vjeçar, cila të jetë më e shpejtë. Pra në këtë rast gjithmonë paguhet shuma e sigurimit S. Shënimi standard actuarial për vlerën e tashme të pritshme kur $S=1$ është $A_{x:\overline{n}|}$

   Rezulton që $A_{x:\overline{n}|} = A^{1}_{x:\overline{n}|} + A^{\ 1}_{x:\overline{n}|}$

4. Sigurim për të gjithë jetën[4)]: Ky lloj sigurimi eshte rast i veçantë i sigurimit të përkohshëm të jetës, kur $n \to \infty$. Shënimi standard aktuarial për vlerën e tashme të pritshme të përfitimit kur $S=1$, është A_x.

Sigurimet e përkufizuara në pikat 1,2,3,4, janë më kryesoret në grupin e sigurimeve diskrete.

5. Anuitete të përjetshme[5)]: Përfitimi është një seri e rregullt pagesash që i bëhen përfituesit përderisa ai jeton. N.q.s personi që blen anuitete ka moshën x në momentin e blerjes dhe kësti i parë i anuitisë paguhet pas nje viti, shënimi standard aktuarial për vlerën e tashme të pritshme të përfitimit kur çdo kést ka vlerën 1 njësi, është a_x. N.q.s personi që blen anuitete ka moshën x në momentin e blerjes dhe kësti i parë i anuitisë paguhet në atë moment, atëhere shënimi standard aktuarial për vlerën e tashme të pritshme të përfititmit kur çdo kést ka vetëm 1 njësi, është $\ddot{a}_x$.

   Rezulton që $a_x = \ddot{a}_x - 1$

1 Në literaturën e shkencës aktuariale njihet me termin "Pure Endowment"
2 Në literaturën e shkencës aktuariale njihet me termin "Term Assurance of n years"
3 Në literaturën e shkencës aktuariale njihet me termin " Endowment Assurance of n years"
4 Në literaturën e shkencës aktuariale njihet me termin " Whole Life Assurance"
5 Në literaturën e shkencës aktuariale njihet me termin " Whole Life Annuity"

6. Anuitete të përkohshme me afat *n* vjet[6]: Këto janë të ngjashme me anuitetet e përjetshme, përveçse numri i kësteve që i paguhen përfituesit vazhdon deri në përfundim të afatit prej *n* vjet. Vlerat e tashmë të pritshme të përfitimit kur çdo këst është 1 njësi janë respektivisht $a_{x:\overline{n}|}$ dhe $\ddot{a}_{x:\overline{n}|}$

Këto janë tipet bazë të sigurimeve dhe anuiteteve diskrete. Mund të ndërtohen shumë tipe të tjera në bazë të specifikave të dhënies së përfitimeve, mënyrës së pagimit të primit, etj, por duke marrë miratimin paraprak nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Për një studim të hollësishëm mund të përdoret cdo tekst mbi Sigurimet e Jetës (Life contingencies) ose Shkencën Aktuariale (Actuarial Scince).

7. $P_{x:\overline{n}|}^{1}$: Primi neto vjetor për sigurimin e pastër me elemente kursimi me afat *n* vjet (referojuni 1). Ky prim paguhet i përfshirë në primin bruto çdo vit për *n* vjet përderisa personi i siguruar jeton.

Ky prim kënaq ekuacionoin $P_{x:\overline{n}|}^{1} * \ddot{a}_{x:\overline{n}|} = {}_{n}E_{x}$

8. $P^{1}{}_{x:\overline{n}|}$: Primi neto vjetor për sigurimin e përkohshëm të jetës me afat *n* vjet (referojuni 2). Ky prim kënaq ekuacionin $P^{1}{}_{x:\overline{n}|} * \ddot{a}^{1}{}_{x:\overline{n}|} = A^{1}{}_{x:\overline{n}|}$

9. $P_{x:\overline{n}|}$: Primi neto vjetor për sigurimin e jetës me elemente kursimi me afat *n* vjet (referojuni 3). Ky prim paguhet i përfshirë në primin bruto çdo vit për *n* vjet përderisa person i siguruar jeton. Ky prim kënaq ekuacionin $P_{x:\overline{n}|} * \ddot{a}_{x:\overline{n}|} = A_{x:\overline{n}|}$

10. P_x: Primi vjetor për sigurimin për të gjithë jetën (referojuni 4); i cili paguhet i përfshirë në primin bruto çdo vit përderisa person i siguruar jeton. Ky prim kënaq $P_x * \ddot{a}_x = A_x$

11. ${}_{t}P_x$: Primi neto vjetor për sigurimin për të gjithë jetën[7] (referojuni 4); i cili paguhet i përfshirë në primin bruto çdo vit për tre vjet përderisa personi i siguruar jeton. Ky prim kënaq ekuacionin ${}_{t}P_x * \ddot{a}_{x:\overline{t}|} = A_x$

6 Në literaturën e shkencës aktuariale njihet me termin "Temporary Annuity of n years"
7 Përkufizimet 11 dhe12 janë dhënë për të treguar që mënyrat e pagimit të primit mund të jenë nga më të ndryshmet

12. ${}_tP^{(m)}_{x:\overline{n}|}$: Primi neto vjetor që paguhet në m këste çdo vit me vlerë $\left({}_tP^{(m)}_{x:\overline{n}|}\right)/m$ secili, gjatë një periudhe prej t vjetësh përderedisa personi i siguruar jeton, për sigurimin e jetës me elemente kursimi me afat n vjet(referojuni 3). Ky prim kënaq ekuacionin

$${}_tP^{(m)}_{x:\overline{n}|} * \ddot{a}^{(m)}_{x:\overline{t}|} = A_{x:\overline{n}|}$$

Për të dhënë formulat e provigjioneve të disa prej policave kryesore të sigurimit të jetës është e nevojshme të përmenden edhe disa koncepte të tjera.

Shpenzimet

Tipet kryesore të shpenzimeve që kanë të bëjnë me një policë sigurimi janë:

- Shpenzimet për çdo policë (p.sh. kostoja e dokumentacionit)
- Shpenzimet proporcionale me primin (p.sh komisioni ndaj ndërmjetësit)
- Shpenzimet proporcionale me përfitimin (p.sh taksat, kostoja e marrjes në sigurim, etj.)

Ekuacioni i vlerës.

Ekuacioni i vlerës për gjetjen e primit neto për një policë të sigurimit të jetës ka këtë trajtë të përgjithshme:

(Vlera e pritshme e primeve neto në kohën $t = 0$) = (Vlera e pritshme e përfitimeve[8)] në kohën $t = 0$)

Koha $t = 0$ është moment i blerjes së policës, kur policmbajtësi ka moshën x. Ekuacionet e dhëna në përkufizimet 7, 8, 9, 10, 11, 12 janë ekuacione vlerë.

Ekuacioni i vlerës që do të përmbante në të primin bruto ka këtë trajtë të përgjithshme:

(Vlera e pritshme e pritshme e primeve bruto në kohën $t = 0$)=

(Vlera e pritshme e përfitimeve[9)] në kohën $t = 0$) +

(Vlera e pritshme e shpenzimeve në kohën $t = 0$) +

(Vlera e pritshme e përfitimit të siguruesit në kohën $t = 0$)

8 Me përfitim këtu nënkuptohet shuma e sigurimit, pra përfitim I policmbajtësit
9 I njëjti shënim si tek 8)

Ekuacioni i vlerës që përmban primin bruto, me trajtë të përgjithme:

(Vlera e pritshme e pritshme bruto në kohën $t = 0$)=

(Vlera e pritshme e përfitimeve në kohën $t = 0$) +

(Vlera e pritshme e shpenzimeve në kohën $t = 0$);

është shprehje e parimit të ekuivalencës. Sipas këtij parimi, primet që paguan i siguruari përdoren vetëm për përfitimin e të siguruarit dhe të përfituesve të tij dhe për të mbuluar shpenzimet e përgatitjes, blerjes dhe administrimit të policës. Sipas këtij parimi, siguruesi nuk nxjerr asnjë përfitim nga biznesi i sigurimeve.

PROVIGJONET

Për një policë sigurimi jetë të çfarëdoshme:

Humbja në kohën t = (Vlera në kohën t e harxhimeve të së ardhmes

– Vlera në kohën t e të ardhurave të së ardhmes[10])

N.q.s konrtata ose polica e sigurimit vlerësohet sipas parimit të ekuivalencës i cili u përmend më lart, atëhere,

E(humbja në kohën $t = 0$) = 0

Pasi polica e sigurimit ka hyrë në fuqi për ndonjë farë periudhe t, janë kryer disa harxhime (P.sh shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative, etj), dhe siguruesi ka marrrë disa të ardhura (kështet e primeve deri në kohën t). Si rrjedhim

E(humbja në kohën t) $\neq$ 0.Për më tepër

E(humbja në kohën t) = Provigjone prospektive në kohën t

Për një policë jetë, rezerva prospektive në kohën t duke mos konsideruar shpenzimet është:

Vlera e pritshme në kohën t e harxhimeve të së ardhmes[11] –

Vlera e pritshme në kohën t e të ardhurave të së ardhmes[12].

10 Në literaturë: loss at time t=present value at t of future outgo – present value at t of future income.
11 Me harxhime të së ardhmes këtu nënkuptohet shuma e sigurimit që siguruesi i detyrohet të siguruarit.
12 Me të ardhura të së ardhmes këtu nënkuptohen primet neto që i siguruari I\i detyrohet siguruesit që nga koha t e më pas

Formula të provigjoneve prospective pa konsideruar shpenzimet për policat kryesore të sigurimit të jetës.

1. Sigurimi i pastër me elemente kursimi me afat *n* vjet

$$ {}_tV_{x:\overline{n}|}^{1} = A_{x+t:n-\overline{t}|}^{1} - P_{x:\overline{n}|}^{1} * \ddot{a}_{x+t:n-\overline{t}|} \qquad 0 \le t \le n $$

2. Sigurim i përkohshëm i jetës me afat *n* vjet

$$ {}_tV^{1}{}_{x:\overline{n}|} = A^{1}{}_{x+t:n-\overline{t}|} - P^{1}{}_{x:\overline{n}|} * \ddot{a}_{x+t:n-\overline{t}|} \qquad 0 \le t \le n $$

3. Sigurim jete me elemnte kursimi me afat *n* vjet

$$ {}_tV_{x:\overline{n}|} = A_{x+t:n-\overline{t}|} - P_{x:\overline{n}|} * \ddot{a}_{x+t:n-\overline{t}|} \qquad 0 \le t \le n $$

4. Sigurim për të gjithë jetën:

$$ \begin{aligned} {}_tV_x &= A_{x+t} - P_x * \ddot{a}_{x+t} = \\ &= 1 - d * \ddot{a}_{x+t} - (A_x / \ddot{a}_x) * \ddot{a}_{x+t} = \\ &= 1 - (\ddot{a}_{x+t} / \ddot{a}_x) * (A_x + d * \ddot{a}_x) = \\ &= 1 - (\ddot{a}_{x+t} / \ddot{a}_x) \qquad t \ge 0 \end{aligned} $$

Vërejmë që formulat e mësipërme janë për një njësi shumë sigurimi

Provigjonet retrospektive.

Provigjoni retrospektiv në kohën *t* për një policë të sigurimit të jetës është i barabartë me vlerën e akumuluar të primeve[13] të marra deri në kohën *t* nga siguruesi minus vlerën e akumuluar të përfitimeve të të siguruarit dhe të shpenzimeve të paguara deri në kohën *t*.

Provigjoni i sapopërkufizuar është provigjon retrospektiv bruto. Provigjoni retrospektiv neto do të përkufizohej në mënyrë të ngjashme, duke konsideruar primet neto dhe duke përjashtuar shpenzimet në përkufizimin e mësipërm.

Për një policë të sigurimit të jetës, provigjoni retrospektiv është i barabartë me provigjonin prospektiv n.q.s:

a) Të dyja tipet e provigjoneve llogariten duke përdorur të njëjtën bazë vlerësimi.

b) Baza e llogaritjes së primit është e njëjtë me bazën e vleresimit.

13 Këtu bëhet fjalë për prime bruto

Sqarojmë që me bazë vlerësimi kuptohen hipotezat e bëra për:

1. Shpenzimet,
2. Tabelën e mortalitetit,
3. Interesin teknik,

të cilat përdoren për llogaritjen e provigjoneve.

Me bazë të llogaritjes së primit, përsëri nënkuptohen hipotezat e bëra për shpenzimet, tabelën e mortalitetit dhe interesin teknik në llogaritjen e primit.

N.q.s në bazën e vlerësimit shgpenzimet merren 0 dhe në formulën e llogaritjës së provigjoneve është i inkorporuar primi neto, kuptohet që po llogaritet një rezervë neto: dhe n.q.s në bazën e llogaritjes së primit shpenzimet merren 0 kuptohet që po llogaritet një prim neto.

Provigjonet që përfshijnë shpenzimet

Provigjonet që përfshijnë shpenzimet llogariten në mënyrë të ngjajshme me sa u paraqit më lart. Për një policë jete, provigjone prospektive duke përfshirë edhe shhpenzimet në kohën t është:

(*) Vlera pritshme në kohën t e harxhimeve të së ardhmes[14] – Vlera e pritshme në kohën t e të ardhurave të së ardhmes[15]

Për çdo policë të sigurimit të jetës provigjoni prospektiv që përfshin shpenzimet llogaritet sipas përkufizimit (*).

Më poshtë po japim një shembull llogaritjeje të provigjonit prospektiv që përfshin shpenzimet për një policë sigurimi për të gjithë jetën.

Në përgjithesi struktura e shpenzimeve të një police të sigurimit të jetës është: Shpenzimet fillestare $\mathbf{1+c}$ shpenzime të përvitshme (duke përjashtuar vitin e parë) $\boldsymbol{c}$, dhe shpenzime proporcionale me primin $\boldsymbol{k * P}$ ku $\boldsymbol{P}$ është primi vjetor bruto për çdo vit.

Atëhere sipas ekuacionit të vlerës:

14 Me harxhime të së ardhmes këtu nënkuptohen harxhimet e siguruesit, pra shuma e sigurimit që siguruesi I detyrohet të siguruarit si edhe shpenzimet për policën në fjalë që nga koha t e me tej

15 Me të ardhura të së ardhmes këtu nënkuptohen të ardhurat e siguruesit, pra primet bruto që i siguruari I detyrohet siguruesit që nga koha t e më tej

$$P * \ddot{a}_x = A_x + 1 + (c + k * P) * \ddot{a}_x$$
$$= P_x * \ddot{a}_x + 1 + (c + k * P) * \ddot{a}_x$$

Atëhere $P * (1k)\epsilon = P_x + (1/\ddot{a}_x)$

Provigjoni prospektiv që përfshin edhe shpenzimet në kohën t, sipas përkufizimit të dhënë më lart është:

$$_tV_x^{mod} = A_{x+t} + (k * P + c) * \ddot{a}_{x+t} - P * \ddot{a}_{x+t}$$
$$= A_{x+t} - (P * (1 - k) - c) * \ddot{a}_{x+t}$$
$$= A_{x+t} - (P_x + (1/\ddot{a}_x)) * \ddot{a}_{x+t}$$
$$= A_{x+t} - P_x * \ddot{a}_{x+t} - 1 * (\ddot{a}_{x+t} / \ddot{a}_x)$$
$$= {}_tV_x - 1 * (\ddot{a}_{x+t} / \ddot{a}_x)$$

Pra[16] $_tV_x^{mod} = {}_tV_x - 1 * (\ddot{a}_{x+t} / \ddot{a}_x)$

Relacione rekursive ndërmjet provigjoneve.

Po supozojmë që do përdoren e njëjta shkallë interesi dhe e njëjta tabelë mortaliteti gjithandej: atëhere për një policë sigurimi për të gjithë jetën, më shumë sigurimi të pagueshme në fund të vitit të vdekjes, mund të provohet që:

$(_tV_x + P_x) * (1 + i) = q_{x+t} + p_{x+t} *_{t+1} V_x$ ku $_tV_x$ dhe $_{t+1}V_x$ janë provigjone pa përfshirë shpenzimet

Të tilla relacione rekursive mund të ndërtohen për të gjitha policat e sigurimit të jetës.

Më poshtë po jepet relacioni rekursiv ndërmjet provigjoneve që përfshijnë shpenzimet, në formën e tij më të përgjitheshme, pra të aplikueshëm për të gjitha policat e sigurimit të jetës.

Për çdo policë jetë të lëshuar një personi me moshë x, le të jetë $_tV$ provigjoni duke përfshirë shpenzimet në kohën t.

- Le të jetë $P_{x,t}$ prim i cili duhet të paguhet në fillim të vitit të $(t+1)$–të, të policës së sigurimit, pra $P_{x,0}$ është primi që paguhet në kohën $t = 0$ pra në filim të vitit të parë të policës, $P_{x,1}$ është primi që paguhet në kohën $t = 1$ pra në fillim të vitit të dytë të policës e keshtu me rradhë, (primet vjetore nuk duhet të jenë domosdoshmërisht të barabartë).

- Le të jenë shpenzimet E_t shpenzimet e kryera në kohën t, pra në fillim të vitit $(t+1)$ të policës. Këto shpenzime duhet të përkojnë me shpenzimet në bazën e vlerësimit.

- Le të jetë S_t shuma e sigurimit plus shpenzimet që shoqërojnë pagimin e saj, e cila

16 Provigjoni I llogaritur ne kete shembull quhet reserve Zillmer sipas emrit te matematikanit qe eshte marre me te

paguhet n.q.s person i siguruar vdes gjatë vitit të $(t+1)$ të policës. Ne do të supozojmë që shuma e sigurimit paguhet në fund të vitit të vdekjes.

Atëhere forma e përgjithshme e relacionit rekursiv për provigjonet e një police jete është:

$$({}_tV + P_{x,t} - E_t)*(1+i) = S_t * q_{x+t} + p_{x+t} *_{t+1} V$$

Ku supozimet për shpenzimet, interesin teknik dhe tabelën e mortalitetit janë të njëjta me ato të përdorura në llogaritjen e primeve dhe të provigjoneve ${}_tV$ dhe ${}_{t+1}V$.

Relacionet recursive ndërmejt provigjoneve që përfshijnë edhe shpenzimet janë të rëndesishme për faktin që n.q.s është llogaritur vlera e provigjonit në kohën t, mund të llogariten lehtësisht vlera e provigjonit në kohën pasardhëse n.q.s njihen vlerat e primeve vjetore dhe duke patur supozimet përkatëse mbi shpenzimet, interesin teknik dhe tabelën e mortalitetit.

Gjithashtu për çdo policë të klasave 20, 21, 22, 23 të shtojcës së ligjit, dt. provigjoni prospektiv duke përfshirë shpenzimet llogaritet sipas perkufizimit(*).

Kështu:

Provigjoni prospektiv në kohën t duke përfshirë shpenzimet =

Vlera e pritshme në kohën t e harxhimeve të së ardhmes – Vlera e pritshme në kohën t e të ardhurave të së ardhmes.

Me harxhime të së ardhmes, njësoj si më lart, nënkuptohen harxhimet e siguruesit, pra shuma e sigurimit ose llojet e tjera të përfitimeve që siguruesi i detyrohet të siguruarit si edhe të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me policen në fjalë që nga koha t e më tej. Me të ardhura të së ardhmes nënkuptohen primet bruto që i siguruari i detyrohet siguruesit që nga koha t e më tej.

Ngarkohen shoqëritë e sigurimit për zbatimin e parashikimeve të kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI BAZAT, METODAT E LLOGARITJES SI DHE MËNYRAT E MBAJTJES SË PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMEVE TË JO-JETËS"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores "Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI BAZAT, METODAT E LLOGARITJES SI DHE MËNYRAT E MBAJTJES SË PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMEVE TË JO-JETËS

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 9, datë 08.02.2007

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 101, pika 10, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

1. Llojet e provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës.

Provigjonet teknike të sigurimeve të jo-jetës klasifikohen:

(i) **Provigjoni teknik i primit të pafituar(PPP)**-Provigjoni teknik për atë pjesë të primit të marrë, që i përket përiudhes së rrezikut pas daljes së mbylljes së periudhës financiare. Në këtë provigjon teknik duhet të merret parasysh përgjegjësia për vazhdimësinë e mbulimit deri në përfundimin ose rinovimin e ardhshem të policës, si edhe nëse i siguruari kërkon ndërprerjen e kontratës para afatit të shënuar në policë, deri në datën e ndërprerjes. Provigjoni teknik duhet përllogaritur në veçanti për çdo policë në fuqi. Kjo interpretohet si pjesë e primeve të shkruara që i përshtaten përiudhave të tjera financiare, proporcional me të tërë përiudhën për të cilën primi është shkruar. Nëse është e paarsyeshme të supozohet së rreziku i sigurimit është shpërndarë në mënyrë uniforme, vlera e PPP duhet të jetë proporcionale me rrezikun që i përshtatet përiudhave në të ardhmen më tepër sesa shtrirja e kësaj periudhe.

(ii) **Provigjoni teknik i rrezikut të paskaduar (PRP)**-Një vlerësim i përgjegjësisë totale, (dmth duke përfshirë edhe shpenzimet) në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar për policat e lëshuara para asaj date, mund të tregojë që provigjoni teknik i primit të pafituar është i pamjaftueshem për të mbuluar rreziqet në të ardhmen. Në këtë rast nevojitet një provigjon teknik shtesë, i cili njihet si "provigjoni teknik i rrezikut të paskaduar". Në pasqyrat e provigjoneve teknike të shoqërisë PPP dhe PRP mund të paraqiten veç e veç, ose shifra për PRP mund

të përfshihet në PPP dhe të paraqitet si një e vetme. PPP dhe PRP janë provigjone teknike primesh.

(iii) **Provigjoni teknik i dëmeve**-Ky provigjon teknik përfshin provigjonin teknik për dëmet e raportuara por të përcaktuara ose të papërcaktuara (dmth ato dëme për të cilat nuk është përcaktuar përfundimisht masa e dëmit apo është përcaktuar po ende papaguar), dhe provigjonin teknik për dëmet e ndodhura por të paraportuara. Provigjoni teknik për dëmet e ndodhura por të paraportuara shkurtimisht po shënohet INBR (terminologji e përdorur në literaturë).

(iv) **Provigjoni teknik për katastrofat**-Mund të ndodhë që një fenomen i vetëm ose kombinim i disave, të shkaktojë dëme të shumëllojshme me madhësi totale jashtëzakonisht të mëdha. Të tilla janë termetet ose fenomene të tjera natyrore me efekte shkatërruese, epidemi sëmundjesh, etj. Të tilla dëme, e tejkalojne shumë herë madhësinë e provigjoneve teknike që mbahen për ekspërience të zakonshme. Ky provigjon teknik, duhet të jetë i konsiderueshëm sidomos n.q.s. shoqëria ka degë të saj në disa vënde.

(v) **Provigjoni teknik për mbrojtjen ndaj rrezikut të investimeve-**Vlera e provigjonit teknik në praktikë, do të mbulohet me aktive të investuara në drejtime të ndryshme në përputhje me kërkesat e nenit 101 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004. Çdo lloj invstimi paraqet rreziqe të natyrave të ndryshme, p.sh. rrezik ndaj inflacionit të lartë, rreziku i zgjedhjeve të përshtatshme të investimeve, një gjendje e vështirë ekonomike e vendit, rreziqe politike, etj. Këto lloj rreziqesh duhet të merren parasysh në këtë provigjon teknik, në përputhje me natyren e investimeve që bën shoqëria e sigurimit.

(vi) **Provigjoni teknik për barazimin e dëmeve**-Ky provigjon teknik ka për qëllim të zbusë luhatjet e medha nga viti në vit në ekspëriencen e dëmeve. Teorikisht, dëmet shumë të mëdha janë ngjarje të rralla por që do të ndodhin, si rrjedhim pa një provigjon teknik të tillë llogaritë e shoqërisë mund të rezultojnë shumë të çrregullta.

Shoqëritë e sigurimit duhet t'i formojnë provigjonet teknike në një masë të tillë, që të mbulojnë përgjegjesitë e parashikueshme, për të përmbushur vazhdimisht dhe në mënyrë të qëndrueshme detyrimet që shfaqen nga rreziqet e patransferuara në risigurim.

Në rastin e bashkësigurimit, palët që marrin pjesë në bashkësigurim, duhet t'i ndërtojnë provigjonet teknike të sigurimeve në një masë të tillë, që t'iu korrespondojnë detyrimeve të secilës palë.

2. **Mënyrat e llogaritjes së provigjoneve teknike të sigurimeve.**

(i) **Provigjoni teknik i primit të pafituar (njohur në literaturë me termin UPR) dhe mënyra e llogaritjes.**

Periudha e ekspozimit ndaj rrezikut në kontratat e sigurimit të dëmeve (jo-jetës), mund të shtrihet në më tepër së një vit financiar, si rrjedhim një propocion i caktuar i primeve të shkruara në një vit financiar, rezervohen për të mbuluar përgjegjësitë që dalin nga ekspozimi në vitin financiar pasardhës. Kjo rezervë quhet provigjon teknik i primit të pafituar. Për llogaritjen e tij mund të përdoren një nga katër mënyrat e mëposhtëme, nga të cilat më shumë rekomandohet e katërta, më pas e treta, dhe më pas e dyta.

2.1 Duke konsideruar që 20% e primit të shkruar konsumohet për shpenzimet fillestare dhe për komision dhe që shpërndarja e rrezikut është uniforme, atëhere gjysma e pjesës së mbetur prej 80% të primit rezervohet për UPR. Si përfundim, 40% e primeve bruto rezervohet për UPR.

2.2 Konsiderojmë një policë të vetme për sigurimin e dëmeve. Duke supozuar që shpërndarja e rrezikut gjatë kohëzgjatjes së policës është uniforme dhe se ekspozimi ndaj rrezikut nën një policë vjetore të shkruar në muajin m, fillon në mesin e muajit, atëherë UPR për policën në konsideratë do të jetë: $((2m-1)/24 * P * (1-E/100))$, ku P është primi i sigurimit, kurse $E\%$ mbulon shpenzimet fillestare dhe komisionin.

2.3 Konsiderojmë një policë të vetme për sigurimin e dëmeve. Duke supozuar që shpërndarja e rrezikut gjatë kohëzgjatjes së policës është uniforme gjatë ditëve të policës,

atëherë UPR për policën në konsideratë do të jetë:

$\left(\frac{(\textit{ditë të mbetura nga dita e fundit të muajit të policës})}{(\textit{ditë gjithsej të policës})} * P * (1-E/100)\right)$, ku P është primi i sigurimit kurse $E\%$ mbulon shpenzimet fillestare dhe komisionin.

2.4 Me metodën e mëposhtme, bëhet edhe rregullimi përkatës për inflacionin në llogaritjen për UPR. Një policë e sigurimit të dëmeve, e lëshuar në kohën $t = (0 < T < 1)$ në fund të vitit financiar kërkon një UPR të barabartë me $i^1 (1+i)^{0,5}\left[(1+i)^T 1\right] * (P-E)$, ku i është shkalla e inflacionit në koston e dëmeve, P është primi dhe E është masa e shpenzimeve fillestare dhe e komisionit për policën në konsiderate.

(ii) **Provigjoni teknik i rrezikut të paskaduar (njohur në literaturë me termin URR) dhe mënyra e llogaritjes.**

Provigjoni teknik i rrezikut të paskaduar llogaritet si një suplement i UPR dhe përfaqëson një diferencë midis shumës së pritshme të dëmeve në të ardhmen dhe shpenzimeve me shumën e provigjonit teknik të primeve të pafituara me primet e parashikuara për të ardhmen që do të merren nga kontratat e sigurimit që janë përfunduar.

Është një praktikë e zakonshme që URR krijohet duke përdorur metodën flat-rate për të gjithe klasat e sigurimeve për të cilat UPR nuk është i mjaftueshem për të mbuluar dëmet në të ardhmen dhe kostot nën kontratat e sigurimit në fuqi në datën e llogaritjes. Baza për llogaritjet e URR është vlera e UPR në datën e llogaritjes.

Për të vlerësuar nëse UPR është i mjaftueshëm për të mbuluar shumën e dëmeve të pritshme dhe shpenzimet, duhen kryer analiza të raportit të dëmeve dhe raportit të shpenzimeve. Duhet modifikuar raporti përfundimtar i dëmeve i llogaritur gjatë llogaritjes së provigjonit teknik $IBNR$ sipas formules së mëposhtëme:

$$ULR^{\text{mod}} = ULR \cdot \frac{(1+COST)}{(1-ACQ)}$$

Ku:

ULR -raporti përfundimtar i dëmeve, duke përjashtuar shpenzimet për rregullimin e dëmeve.

$COST$ -raporti bazë i shpenzimeve, duke përfshire shpenzimet e menaxhimit për dëmet dhe (jo në mënyrë të domosdoshme) shpenzimet administrative.

ACQ -raporti për shpenzimet e mëvonshme të parashikuara

Bazuar në ULR^{mod}, mund të llogariten vlerat e URR bdhe UPR e raportit bazë:

$$URR = UPR \cdot \left(ULR^{\text{mod}} - 1\right)$$

(iii) **Provigjoni teknik i dëmeve.**

Mënyrat e propozuara për llogaritjen e provigjonit teknik të dëmeve janë shtjelluar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

Vëmë re që provigjoni teknik $IBNR$ (Provigjoni teknik për dëmet e ndodhura por të paraportuara) nuk është e nevojshme të paraqitet në veçanti, në rast së përdoret njëra nga metodat e paraqitura në Aneksin 1. Gjatë përdorimit të njërës prej këtyre metodave automatikisht merret në konsideratë edhe provigjoni teknik për $IBNR$.

Në rastin kur metodat e propozuara në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, rezultojnë të papërshtatshme në lidhje me natyrën e dëmeve të shoqërisë, provigjoni teknik i dëmeve mund të përllogaritet si shumë e provigjonit teknik të dëmeve pezull dhe e provigjonit teknik $IBNR$, i cili mund të përllogaritet si një përqindje mbi provigjonin e dëmeve pezull ose të primeve të shoqërise bazuar në ekspëriencën e dëmeve në vitet paraardhes të shoqërisë apo të tregut në tërësi.

Shoqërite e sigurimit dhe/ose të risigurimit mund të përdorin edhe metoda të tjera për llogaritjen e provigjonit teknik të dëmeve, por duhet të kërkojne miratimin paraprak të metodës nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

(iv) **Provigjoni teknik për katastrofat.**

Nuk ekziston asnjë bazë specifike për vlerësimin e provigjoneve teknike të katastrofave, po të kishte , kjo do të thotë që katastrofat kanë pushuar së qëni të jashtëzakonshme. Teorikisht ky provigjon teknik, në aspektin afatgjate, pritet të jetë i barabartë me shumat e propocioneve për katastrofat e llogaritura në prime. Ky provigjon teknik duhet llogaritur në përputhje me eksperiencën e dëmeve që merr në sigurim shoqëria.

(v) **Provigjoni teknik për mbrojtjen ndaj rrezikut të investimeve.**

Për këtë provigjon teknik, gjithashtu nuk ekziston ndonjë metodë e përcaktuar. Ajo duhet të mbahet në përputhje me rreziqet e mundshme të investimeve që gjykon shoqëria.

(vi) **Provigjoni teknik për barazimin e dëmeve.**

Për këtë provigjon teknik gjithashtu nuk ekziston ndonjë metodë e përcaktuar. Ajo duhet të mbahet në përputhje me rreziqet e mundshme dhe me ekspëriencen e kaluar të dëmeve të shoqërisë.

3. **Baza e të dhënave për përllogaritjen e provigjoneve teknike.**

Baza e të dhënave që duhet të merret në konsideratë nga aktuarët e shoqërive të sigurumit për përllogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të dëmeve dhe që raportohet në Autoritet, paraqitet sipas Aneksit 2 bashkëngjtur kësaj rregulloreje

4. **Mbajtja e provigjoneve teknike.**

1. Provigjonet teknike krijohen para se të nxirret rezultati i çdo ushtrimi financiar, në përputhje me Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe Ligjin "Për kontabilitetin".

2. Provigjonet teknike të sigurimeve të dëmeve, duhet të paraqiten me seksione në pasqyrat financiare të shoqërisë më 31 dhjetor të çdo viti.

3. Shoqëria përllogarit provigjonet teknike çdo tremujor të çdo viti dhe paraqet në seksione, në pasqyrat financiare të shoqërisë të çdo tremujori.

4. Për provigjonet teknike të sigurimeve të dëmeve të paraqitura në bilancin e fundvitit dhe të secilit tremujor, duhet të bëhet mbulimi me aktive të investuara në drejtimet e ndryshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me provigjonet teknike të sigurimeve.

5. **Plani financiar**-Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e detyron shoqërinë e sigurimit dhe/ose risigurimit të paraqesë për miratim një plan financiar, nëse e gjykon që provigjonet teknike të sigurimit të dëmeve nuk janë të mjaftueshme, ose nëse mbulimi që është parashikuar për to nuk është i kënaqshëm.

Plani financiar duhet të jetë jo më tepër së gjashtë mujor dhe duhet të përmbaje masa për rimëkembjen e provigjoneve teknike të sigurimeve të shoqërive të sigurimit dhe të mbulimit të tyre. Shoqëria e sigurimit dhe/ose risigurimit duhet t'ia paraqesin planin financiar për miratim Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së Vendimit përkatës të Autoritetit.

Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare do të vendosë brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për miratim të planit financiar, nëse plani financiar është i përshtatshem për rimëkembjen e provigjoneve teknike të sigurimeve të dëmeve të shoqërisë.

Në rast së plani financiar nuk miratohet, ose zbatimi i tij dështon, Autoriteti ka të drejtë:

- Të kufizojë ose të ndalojë shoqërinë e sigurimit dhe/ose risigurimit, të përdorë provigjonet teknike të sigurimeve të dëmeve ose kapitalin për Fondin e Garancisë dhe nivelin minimal të aftësisë paguese.
- T'i imponojë shoqërisë së sigurimit dhe / ose risigurimit, transferim zyrtar të portofolit të sigurimeve.
- Të kërkojë përgatitjen e një plani tjetër financiar nga ana e shoqërisë së sigurimit dhe/ose të risigurimit dhe ta paraqesë për miratim në Autoritetin e Mbikëqyrjes Fianciare.

Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe / ose të risigurimit për zbatimin e parashikimeve të kesaj rregulloreje.

Aneks I dhe Aneks II janë pjesë përbërese e kësaj Rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

A N E K S 1

Provigjoni teknik i dëmeve dhe mënyrat e llogaritjes.

Më poshtë po paraqesim dy mënyra për llogaritjen e provigjonit teknik të dëmeve. Qëllimi i analizes që bëhet në këto dy metoda, është të vlerësoje sasinë e aktiveve (para, kapitali) që duhet mbajtur mënjanë, si provigjon teknik për të mbuluar dëmet për policat e lëshuara gjatë periudhës në konsideratë, në thelb këto metoda:

- Përpiqen të zbulojne një ecuri të qëndrueshme në rrjedhën e madhësisë së dëmeve në të kaluarën.
- Zbatojnë këtë ecuri (me rregullimet e nevojshme për inflacionin e pritur në të ardhmen), për të vlerësuar ecurinë e dëmeve që kanë ndodhur, por janë ose të papërcaktuara ose të paraportuara.

1. Metoda e shkallëzimit zinxhir.

1.1 Paraqitja e të dhënave.

Ne po i paraqesim të dhënat në formen e një trekëndëshi, e cila është mënyra e përdorur më tepër. Të dhënat mund të mblidhen në bazë të vitit të ndodhjes së dëmeve, në bazë të vitit të raportimit të ndodhjes së dëmeve, ose në bazë të vitit të lidhjes së kontratës që lidhet me atë dëm. Ky vit do të quhet viti I aksidentit, ndërsa numri I viteve derisa një dëm zhvillohet, quhet vit i zhvillimit ose vonesë. Viti i aksidentit është vit zhvillimi.

Tabela e mëposhtme është një shembull për të dhënat nga dëmet, të indeksuara sipas vitit të aksidentit dhe vitit të zhvillimit.

Viti I Aksi-dentit	Pagesat totale të dëmeve deri në dhe duke përfshirë vitin e zhvillimit					Vlerësi-mi për dëmet në 31/12/___	Vlerësimi i përgjegje-sisë totale
	0	1	2	3	4		
1986	580.222	1.079.901	1.319.902	1.453.503	1.508.415	168.987*	1.677.402
1987	494.534	993.827	1.186.054	1.345.061			
1988	551.136	1.060.211	1.298.456				
1989	648.031	1.312.219					
1990	746.003						

Shënim: Vlerësimi i shenuar me * është vlerësim i bërë nga përsoneli i dëmeve duke u bazuar në ekspëriencën e kaluar.

Fig.1

1.2 Metoda e shkallëzimit zinxhir pa rregullim për inflacionin.

Supozimi kryesor që bëjmë për të vlerësuar dëmet sipas kësaj metode, ka të bëjë me ecurinë e zhvillimit të dëmeve. Ne do të supozojmë që dëmet e ndodhura në secilin vit aksidenti shfaqen në mënyrë të ngjashme në vitet që pasojnë.

Për secilin vit aksidenti, raporti i rritjes së dëmeve kumulative nga viti i zhvillimit 0 në vitin e zhvillimit 1 është si me poshtë:

$$1986: \quad \frac{1.079.901}{580.222} = 1{,}861$$

$$1987: \quad \frac{993.827}{494.534} = 2{,}010$$

$$1988: \quad \frac{1.060.211}{551.136} = 1{,}924$$

$$1989: \quad \frac{1.312.219}{648.031} = 2{,}025$$

Për një vlerësim konservativ të dëmeve është mirë të merret raporti më i madh, d.m.th 2.025. Mund të mrret gjithashtu edhe një mesatare aritmetike, por më mirë është të merret një mesatare e ponderuar aritmetike, në të cilën peshat janë të barabarta me vlerat kumulative të dëmeve.

Kështu për raportin e zhvillimit nga viti 0 deri në vitin 1 do të kishim:

Viti i Aksidentit	Raporti	Pesha
1986	1,861	580.222
1987	2,010	494.534
1988	1,924	551.136
1989	2,025	648.031

Kështu raporti I zhvillimit nga viti 0 deri në vitin 1, duke marrë një mesatare të ponderuar të raporteve përkates së zhvillimit për secilin vit aksidenti është:

$$= \frac{1{,}861 * 580.222 + 2{,}010 * 494.534 + 1{,}924 * 551.136 + 2{,}025 * 648.031}{580.222 + 494.534 + 551.136 + 648.031}$$

$$= \frac{1.079.901 + 993.827 + 1.060.211 + 1.312.219}{580.222 + 494.534 + 551.136 + 648.031} = 1{,}955$$

dhe simbolikisht do të shenohet $m_{1/0} = 1{,}955$

Kështu, si një rregull praktik, raporti i zhvillimit $m_{1/0}$, është i barabartë me raportin e shumës së dëmeve për vitin e zhvillimit 1, me shumën e dëmeve për vitin e zhvillimit 0.

Në mënyre të ngjashme, raporti I zhvillimit $m_{2/1}$, është i barabartë me raportin e shumës së dëmeve për vitin e zhvillimit 2 me shumën e dëmve për vitin e zhvillimit 1, e kështu me radhë për $m_{3/2}$, $m_{4/3}$ dhe $m_{\infty/4}$

Kështu

$$m_{2/1} = \frac{1.319.902 + 1.186.054 + 1.298.456}{1.079.901 + 993.827 + 1.060.211} = 1{,}214$$

$$m_{3/2} = \frac{1.453.503 + 1.435.061}{1.319.902 + 1.186.054} = 1{,}117$$

$$m_{4/3} = \frac{1.508.415}{1.453.503} = 1{,}038$$

$$m_{\infty/4} = \frac{1.677.402}{1.508.415} = 1{,}112$$

Tani duke pasur raportet e zhvillimit, ne mund të projektojmë dëmet për të gjetur vlerësimet për dëmet që ndodhin në të ardhmen.

Kështu vlerësimi më i mirë i përgjegjësisë totale në 31.12.1990, në lidhje me dëmet e ndodhura në vitin 1987, është:

$= 1.345.061 * m_{4/3} * m_{\infty/4}$
$= 1.345.061 * 1{,}038 * 1{,}112$
$= 1.552.545$

Vlerësimi i përgjegjsisë totale në 31.12.1990 në lidhje me dëmet e ndodhura në vitin 1988, është:

$= 1.298.456 * m_{3/2} * m_{4/3} * m_{\infty/4}$
$= 1.298.456 * 1{,}117 * 1{,}038 * 1{,}112$
$= 1.674.104$

Vlerësimi i përgjegjisë totale në 31.12.1990, në lidhje me dëmet e ndodhura në vitin 1989, është:

$= 1.312.219 * m_{2/1} * m_{3/2} * m_{4/3} * m_{\infty/4}$
$= 1.312.219 * 1,214 * 1,117 * 1,038 * 1,112$
$= 2.053.905$

Vlerësimi i përgjegjisë totale në 31.12.1990 , në lidhje me dëmet e ndodhura në vitin 1990, është

$= 746.003 * m_{1/0} * m_{2/1} * m_{3/2} * m_{4/3} * m_{\infty/4}$
$= 746.003 * 1,955 * 1,214 * 1,117 * 1,038 * 1,112$
$= 2.282.766$

Duke mos konsideruar (për momentin), të ardhurat nga investimet në parashikimet për rezervat e dëmeve dhe efekte të tjera monetare, vlerësimet për rezervat e dëmeve për secilin vit do të jenë:

Viti i Aksidentit	Vlerësimi për provigjonin teknik të dëmeve				
1986				=	168.987
1987	1.552.545	–	1.345.061	=	207.484
1988	1.674.104	–	1.298.456	=	375.648
1989	2.053.905	–	1.312.219	=	741.686
1990	2.282.766	–	746.003	=	1.536.763
Total					3.030.568

Fig.2

N.q.s. ecuria e vonesës, ndërmjet një aksidenti që shkakton një dëm dhe pagesës së bërë në lidhje me ate dëm, është pak a shumë e stabilizuar në kohë, inflacioni nuk ekziston ose nuk ndryshon dhe shpërndarja e rrezikut në portofolin në konsiderate nuk ndryshon, atëherë metoda e mësipërme e shkallëzimit zinxhir jep rezultate të arsyeshme.

1.3 Metoda e shkallëzimit zinxhir me rregullim për inflacionin.

Le të supozojmë se përqindjet e inflacionit të dëmeve për përiudhen 1986 -1990 kanë qenë:

1 korrik 1986	–	1 korrik 1987	11.3%	interes vjetor i konvertueshëm njëherë në vit
1 korrik 1987	–	1 korrik 1988	12.4%	
1 korrik 1988	–	1 korrik 1989	14.0%	
1 korrik 1989	–	1 korrik 1990	17.3%	
1 korrik 1990	–	31 dhjetor 1990	10.0%	interes gjashtëmujor i konvertueshëm njëherë në gjashtë muaj

Dhe që inflacioni i supozuar për të ardhmen do të jetë konstant 20% në vit.

Të dhënat e figurës 1. mund të paraqiten si më poshtë, duke paraqitur për çdo vit zhvillimi pagesën e berë për atë vit, në lidhje me vitin e aksidentit përkatës.

Viti I Aksidentit	Pagesa e bërë në vitin e zhvillimit					
	0	1	2	3	4	$5-\infty$
1986	580.222	499.679	240.001	133.601	54.912	168.987
1987	494.534	499.293	192.227	159.007		
1988	551.136	509.075	238.245			
1989	648.031	664.188				
1990	746.003					

(Psh. 238.245 = 1.298.456 – 1.060.211)

Fig.3

Tani do të përpiqemi t'i shprehim këto pagesa sipas çmimeve të dhjetorit të vitit 1990. Vlerësimi 168,987 (i shënuar me një yll) është bërë në fund të vitit 1990, prandaj po supozojmë që është i vlerësuar sipas çmimeve të dhjetorit 1990.

Viti I Aksidentit	Pagesat (Cmimet e 1990) e bëra në vitin e zhvillimit					
	0	1	2	3	4	$5-\infty$
1986	1.067.705	826.139	353.028	172.385	60.403	168.987
1987	817.632	734.431	248.030	174.908		
1988	810.689	656.859	262.070			
1989	836.154	730.607				
1990	820.603					

Fig.4

Llogaritjet për figurën 4. po paraqiten më poshtë

Viti kalendarik 1986

$$580.222 * (1 + 0{,}113) * (1 + 0{,}124) * (1 + 0{,}140) * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 1.067.705$$

Viti kalendarik 1987

$$499.679 * (1 + 0{,}124) * (1 + 0{,}140) * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 826.139$$

$$494.534 * (1 + 0{,}124) * (1 + 0{,}140) * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 817.632$$

Viti kalendarik 1988

$$240.011 * (1 + 0{,}140) * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 353.028$$

$$499.293 * (1 + 0{,}140) * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 734.431$$

$$551.136 * (1 + 0{,}140) * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 810.689$$

Viti kalendarik 1989

$$133.601 * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 172.385$$

$$192.227 * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 248.030$$

$$509.075 * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 656.859$$

$$648.031 * (1 + 0{,}173) * (1 + 0{,}100) = 836.154$$

Viti kalendarik 1990

$$54.912 * (1 + 0{,}100) = 60.403$$

$$159.007 * (1 + 0{,}100) = 174.908$$

$$238.245 * (1 + 0{,}100) = 262.070$$

$$664.188 * (1 + 0{,}100) = 730.607$$

$$746.003 * (1 + 0{,}100) = 820.603$$

Të kihet parasysh që vitet kalendarike i'u korrespondojnë diagonaleve të paraqitjes në formë trekëndëshi. Kështu, p.sh pagesat e bëra në vitin zhvillimit 2 për dëmet e ndodhura në vitin e aksidentit 1986, pagesat e bëra në vitin e zhvillimit 1 për dëmet e ndodhura në vitin e aksidentin 1987 dhe pagesat e bëra në vitin e zhvillimit 0 për dëmet e ndodhura në vitin e aksidentit 1988, i korrespondojnë të gjitha vitit kalendarik 1988, me fjalë të tjera janë dëme të paguara në vitin 1988.

Atëherë pagesat kumulative, (d.m.th pagesat totale deri në dhe duke përfishirë vitin aktual të zhvillimit) janë paraqitur në tabelën e mëposhtëme:

Viti i Aksidentit	Pagesat totale të dëmeve (në çmimet e dhjetorit 1990) deri në dhe duke përfshirë vitin e zhvillimit					
	0	1	2	3	4	$5-\infty$
1986	1.067.705	1.893.844	2.246.872	2.419.257	2.479.660	2.648.647
1987	817.632	1.552.063	1.800.093	1.975.001	2.024.376	2.162.034
1988	810.689	1.467.548	1.729.618	1.878.365	1.925.324	2.056.246
1989	836.154	1.566.761	1.842.511	2.000.967	2.050.991	2.190.458
1990	820.603	1.505.807	1.770.829	1.923.120	1.971.198	2.105.239

Fig.5

Si më parë llogarisim faktorët e zhvillimit:

$$m_{1/0} = \frac{1.893.844 + 1.552.063 + 1.467.548 + 1.566.761}{1.067.705 + 817.632 + 810.689 + 836.154} = 1.835$$

$$m_{2/1} = \frac{2.246.872 + 1.800.093 + 1.729.618}{1.893.844 + 1.552.063 + 1.467.548} = 1{,}176$$

$$m_{3/2} = \frac{2.419.257 + 1.975.001}{2.246.872 + 1.800.093} = 1{,}086$$

$$m_{4/3} = \frac{2.479.660}{2.419.257} = 1{,}025$$

$$m_{\infty/4} = \frac{2.648.647}{2.479.660} = 1{,}068$$

Tani ne mund të llogarisim vlerësimet për dëmet nën vijen e thyer në figurën 5. Këto do të jene vlerësime për dëmet që do të paguhen në vitet 1991, 1992, 1993, 1994, 1995 si rezultat i dëmeve të ndodhura në vitet 1987, 1988, 1990.

Kështu

1.975.001 * $m_{4/3}$ = 2.024.376

= 2.024.313 * $m_{\infty/4}$ = 2.162.034

Deri tani kemi rregulluar parashikimet e dëmeve duke marrë parasysh inflacionin e së kaluarës, i cili me fjalë të tjera quhet inflacion i dëmeve.

Tani duhet të bëjmë rregullimet e nevojshme për inflacionin në të ardhmen.

Le të ndajmë pagesat totale (kumulative) në figurën 5 në pagesa sipas secilit vit zhvillimi, vetëm për vlerësimet e së ardhmes d.m.th. për shifrat nën vijën e thyer.

Viti i Aksidentit	Pagesat (Çmimet e dhjetorit 1990) në vitin e zhvillimit					
	0	1	2	3	4	5
1986						168.987
1987					49.375	137.658
1988				148.747	46.956	130.922
1989			275.750	158.456	50.024	139.467
1990		6845.204	265.022	152.291	48.078	134.041

Fig.6

Pagesat supozohen që janë bërë mesatarisht në mes të vitit përkatës të zhvillimit, kurse ato që janë paraqitur në kollonën $5-\infty$ supozohen që janë bërë mesatarisht në mes të vitit të zhvillimit 7. Kështu, ne mund të llogarisim pagesën që do të bëhet në çdo vit zhvillimi sipas çmimeve të vitit kur do të bëhet pagesa.

Pagesa 168.987 është vlera me 31 dhjetor 1990, e pagesës që do të bëhet në mes të vitit të zhvillimit, në lidhje me vitin e aksidentit 1986, d.m.th pagesa do të bëhet në mes të vitit 1993.

Kështu vlera që do të ketë 168,987 në mes të vitit 1993 është:

$168.987 * (1 + 0,20)^{2,5} = 266.567$

137.658 është pagesa (në lidhje me çmimet e dhjetorit 1990), e bërë në vitin e zhvillimit 7, në lidhje me vitin e aksidentit 1987, d.m.th pagesa do të bëhet në mesin e vitit 1994.

Kështu: $137.658 * (1 + 0,20)^{3,5} = 260.567$

E kështu me rradhë:

$130.922 * (1 + 0,20)^{4,5} = 297.391$

$139.467 * (1 + 0,20)^{5,5} = 380.162$

$134.041 * (1 + 0,20)^{6,5} = 438.446$

$49.375 * (1 + 0,20)^{0,5} = 54.088$

$46.959 * (1 + 0,20)^{1,5} = 61.729$

$50.024 * (1 + 0,20)^{2,5} = 78.910$

$48.078 * (1 + 0,20)^{3,5} = 91.008$

148.747 * (1 + 0,20)^0,5 = 162.944

158.456 * (1 + 0,20)^1,5 = 208.296

152.291 * (1 + 0,20)^2,5 = 240.230

275.750 * (1 + 0,20)^0,5 = 302.069

265.022 * (1 + 0,20)^1,5 = 348.380

685.204 * (1 + 0,20)^0,5 = 750.603

Vlerësimet për dëmet të rregulluara edhe për inflacionin e të ardhmes, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Viti i Aksidentit	Pagesat e bëra në vitin e zhvillimit					
	0	1	2	3	4	$5-\infty$
1986						266.567
1987					54.088	260.577
1988				162.944	61.729	297.391
1989			302.069	208.296	78.910	380.162
1990		750.603	348.380	240.230	91.008	438.446

Fig.7

Duke mos marrë parasysh të ardhurat nga investimet në vlerësimet për provigjonin teknik të dëmeve, kemi vlerësimet e meposhtme:

1986	është	266.567	266.567
1987	është	54.088 + 260.577	314.665
1988	është	162.944 + 61.729 + 297.391	522.064
1989	është	302.069 + 208.296 + 78.910 + 380.162	969.437
1990	është	750.603 + 348.380 + 240.230 + 91.008 + 438.446	1.868.667
		Total=	1.941.400

2. Metoda e ndarjes.

Më poshtë po shpjegojmë modelin matematik mbi të cilin bazohet metoda e shkallëzimit zinxhir dhe metodat e ndarjes.

Supozojmë që pagesat e bëra në vitin e zhvillimit (ose të vonesës) j dhe të ndodhura në vitin e aksidentit i, mund të modelohen nga $U_i S_j$.

Kështu, sipas paraqitjes së të dhënave në seksionin 4.1.1, modeli për metodën e shkallëzimit zinxhir pa rregullim për inflacionin mund të paraqitet si me poshtë:

Viti i Aksidentit	Pagesat në vitin e zhvillimit (ose të vonesës)				
	0	1	2	3	4
1986	U_0S_0	U_0S_1	U_0S_2	U_0S_3	U_0S_4
1987	U_1S_0	U_1S_1	U_1S_2	U_1S_3	
1988	U_2S_0	U_2S_1	U_2S_2		
1989	U_3S_0	U_3S_1			
1990	U_4S_0				

Fig.8

S_j mund të interpretohet si propocioni i dëmeve totale të cilat shfaqen (ose paguhen) në vitin e zhvillimit j. Si rrjedhim $S_0 + S_1 + S_2 + S_3 + S_4 = 1$

U_i modelon shumën totale të dëmeve si rezultat i aksidenteve të ndodhura në vitin i.

Meqënëse po përdorim të njëjtën bashkësi parametrash S_0, S_1, S_2, S_3, S_4 është e qartë që po supozojmë që për çdo vit aksidenti, ecuria e rrjedhjes së dëmeve në vitet që pasojnë është e njëjtë.

Kur morrëm parasysh inflacionin në seksionin 4.1.3 ne rregulluam të dhënat gjatë diagonaleve (me fjalë të tjera përgjatë viteve kalendarike), është i njëjtë. Dhe kjo është e qartë, përderisa bëhet fjalë për rregullimin sipas normave të inflacionit në të kaluaren ose në të ardhmen .

Ky rregullim mund të përfshihen në model duke shtuar një parametër të tretë λ, i cili i referohet inflacionit. Kështu modeli i plotë do të paraqitej si më poshtë:

Viti i Aksidentit	Pagesat në vitin e zhvillimit (ose të vonesës)				
	0	1	2	3	4
1986	$U_0S_0\lambda_0$	$U_0S_1\lambda_1$	$U_0S_2\lambda_2$	$U_0S_3\lambda_3$	$U_0S_4\lambda_4$
1987	$U_1S_0\lambda_1$	$U_1S_1\lambda_2$	$U_1S_2\lambda_3$	$U_1S_3\lambda_4$	
1988	$U_2S_0\lambda_2$	$U_2S_1\lambda_3$	$U_2S_2\lambda_4$		
1989	$U_3S_0\lambda_3$	$U_3S_1\lambda_4$			
1990	$U_4S_0\lambda_4$				

Fig.9

Vëmë re që modelet e figurave 8 dhe 9 nuk janë modele për dëmet kumulative , por modele për dëmet e paguara për çdo vit zhvillimi në veçanti sipas vitit të aksidentit përkatës .

Modeli i figurës 9 është modeli i metodës së shkallëzimit zinxhir me rregullim për inflacionin. Gjate zbatimit të kesaj metode ne përdorëm vlera për λ_1, λ_2, λ_3, λ_4, λ_5, të cilat i llogaritëm nga ekspërienca e së kaluares dhe nga vlerësimet për të ardhmen, për inflacionin.

Modeli i figurës 9 është gjithashtu modeli i medodës së ndarjes që do të paraqitet me poshtë. Ndryshimi nga metoda e shkallëzimit zinxhir me rregullimin për inflacionin, është që në metodën e ndarjes, synohet që parametrat λ të vlerësohen nga të dhënat. Për këtë qëllim është e nevojshme të menjanohet njera bashkësi parametrash nga modeli.

Është me lehtë për zbatimin e metodës , që të menjanohen parametrat U nga modeli. Për të menjanuar parametrat U nga modeli , do të bëjmë supozimin që parametrat U_i janë propocionalë me numrin e dëmeve të shkaktuara në vitin e aksidentit i (duke përfshirë $IBNR$). Me këtë supozim modeli mund të paraqitet si më poshtë:

Viti i Aksidentit	Pagesat në vitin e zhvillimit (ose të vonesës)				
	0	1	2	3	4
1986	$S_0\lambda_0$	$S_1\lambda_1$	$S_2\lambda_2$	$S_3\lambda_3$	$S_4\lambda_4$
1987	$S_0\lambda_1$	$S_1\lambda_2$	$S_2\lambda_3$	$S_3\lambda_4$	
1988	$S_0\lambda_2$	$S_1\lambda_3$	$S_2\lambda_4$		
1989	$S_0\lambda_3$	$S_1\lambda_4$			
1990	$S_0\lambda_4$				

Fig.10

Konsiderojmë shumat e diagonaleve dhe shumat e kolonave:

Shumat e diagonaleve:

$$S_0\lambda_0$$

$$(S_0 + S_1)\lambda_1$$

$$(S_0 + S_1 + S_2)\lambda_2$$

$$(S_0 + S_1 + S_2 + S_3)\lambda_3$$

$$(S_0 + S_1 + S_2 + S_3 + S_4)\lambda_4$$

Shumat e kolonave :

$S_0(\lambda_0 + \lambda_1 + \lambda_2 + \lambda_3 + \lambda_4)$

$S_1(\lambda_1 + \lambda_2 + \lambda_3 + \lambda_4)$

$S_2(\lambda_2 + \lambda_3 + \lambda_4)$

$S_3(\lambda_3 + \lambda_4)$

$S_4\lambda_4$

Kujtojmë që $S_0 + S_1 + S_2 + S_3 + S_4 = 1$. Kështu që shuma e diagonales së fundit është λ_4, dhe mund të vlerësohet nga të dhënat. Tani shikojmë kolonën e fundit. Ne kemi vlerësuar λ_4 kështu që mund të përdorim të dhënat për të vlerësuar S4. Tani shikojmë shumën e diagonales së parafundit . Meqë $S_0 + S_1 + S_2 + S_3 = 1 - S_4$ dhe ne e kemi vlerësuar S_4, ne mund të përdorim të dhënat për të vlerësuar λ_4 . tani mund të shkojmë tek shuma e kolonës së parafundit dhe të vlerësojmë S_3 e kështu me rradhë .

I referohemi përseri të dhënave të figurës 1 , për të përcaktuar rezervën e dëmeve me metodën e ndarjes . Supozojmë që kemi vlerësimet e meposhtme për numrin e dëmeve (duke përfshirë $INBR$), për vitet 1986,1987,1989 dhe 1990.(Ekzistojne metoda statikore për të vlerësuar numrin e dëmeve që ndodhin çdo vit).

Viti i Aksidentit	Numri i dëmeve (duke përfshirë $INBR$)
1986	48.298
1987	43.430
1988	41.454
1989	41.674
1990	39.265

Fig.11

Më poshtë po paraqesim tabelën e dëmeve mesatare të paguara për çdo vit zhvillimi në lidhje me vitin përkates të aksidentit . të dhënat e figurës 3 janë pjestuar me numrin e dëmeve në vitin përkatës të aksidentit.

Viti i Aksidentit	Pagesa e bërë në vitin e zhvillimit				
	0	1	2	3	4
1986	12.013	10.346	4.969	2.766	1.137
1987	11.387	11.496	4.426	3.661	
1988	13.295	12.280	5.747		
1989	15.550	5.938			
1990	18.999				

Fig.12

Shumat e diagonaleve nga e para tek e fundit , në figurën 12 janë:

12.013
21.733
29.760
35.022
35.482

Shumat e kolonave nga 0 në 4 , në figurën 12 janë:

71.244
40.060
15.142
6.427
1.137

Duke zbatuar procedurën e përshkruar më sipër, marrim këto vlerësime:

$\hat{S}_0 =$ 0,41407 $\hat{\lambda}_0 =$ 29.003

$\hat{S}_1 =$ 0,3499 $\hat{\lambda}_1 =$ 28.443

$\hat{S}_2 =$ 0,132 $\hat{\lambda}_2 =$ 33.211

$\hat{S}_3 =$ 0,0789 $\hat{\lambda}_3 =$ 35.920

$\hat{S}_4 =$ 0,025 $\hat{\lambda}_4 =$ 45.482

Shenja $\hat{}$ është vendosur për të treguar që vlerat e gjetura janë vlerësime të madhesive λ_i S_i. Tani ne mund të përdorim vlerësimet e gjetura për parametrat λ_i dhe S_i, për të rindertuar tabelën e figurës 10 (me afërsinë e një konstanteje).

Viti i Aksidentit	Vlerësimet e dëmeve mesatare të paguara në vitin e zhvillimit				
	0	1	2	3	4
1986	12.009	9.952	4.384	2.834	1.137
1987	11.777	11.621	4.741	3.589	
1988	13.752	12.568	6.004		
1989	14.873	15.914			
1990	18.833				

Fig.13

Tani ne mund të krahasojmë figurën 12 me figurën 13, për të vlerësuar saktësinë e zbatimit të metodës së ndarjes (në fakt kjo varet shumë nga saktësia e vlerësimit të numrit të dëmeve për secilin vit aksidenti).

Nga krahasimi duket që vlerat janë relativisht të përafërta. Tani duhet të projektojmë për të gjetur vlerat e dëmeve në diagonalet kryesore. Por parametrat që kemi vlerësuar deri tani nuk janë të mjaftueshme për të bërë parashikimet nën diagonalen kryesore. Ne duhet të vlerësojmë parametrat λ_5, λ_6 ,λ_7 dhe λ_8 . Modeli për trekëndëshin e meposhtëm të vlerave të dëmeve , mund të paraqitet si më poshtë:

Viti i Aksidentit	Vlerësimet e dëmeve mesatare të paguara në vitin e zhvillimit				
	0	1	2	3	4
1986					$S_4\lambda_5$
1987					$S_4\lambda_6$
1988				$S_3\lambda_5$	$S_4\lambda_6$
1989			$S_2\lambda_5$	$S_3\lambda_6$	$S_4\lambda_7$
1990		$S_1\lambda_5$	$S_2\lambda_6$	$S_3\lambda_7$	$S_4\lambda_8$

Fig.14

Vlerësimet që kemi bërë për λ_0, λ_1,λ_2, λ_3, λ_4, mund të konvertohen në një varg shifrash inflacioni dhe më tej prej tyre mund të vlerësojmë λ_5, λ_6, λ_7 dhe λ_8

$\hat{\lambda}_0 = 29.003$

$\hat{\lambda}_1 = 28.443 \quad \left(\hat{\lambda}_0/\hat{\lambda}_1\right) = 0{,}98 < 1,$

$\hat{\lambda}_2 = 33.211$ inflacioni nga 1987 në 1988 = $\left(\hat{\lambda}_1/\hat{\lambda}_2\right) = -1 = 0{,}17$

$\hat{\lambda}_3 = 35.920$ inflacioni nga 1988 në 1989 = $\left(\hat{\lambda}_2/\hat{\lambda}_3\right) = -1 = 0{,}08$

$\hat{\lambda}_4 = 45.482$ inflacioni nga 1989 në 1990 = $\left(\hat{\lambda}_4/\hat{\lambda}_3\right) = -1 = 0{,}27$

Inflacioni mesatar është (0.17 + 0.08 + 0.27)/3 = 0.17; si rrjedhim mund të përdorim një parashikim për inflacionin e të ardhmes të barabartë me 17 %. N.q.s duam të bëjmë një vlerësim më konservator të provigjonit teknik të dëmeve, shkalla e inflacionit të së ardhmes mund të merret më e lartë. Inflacioni i të ardhmes mund të merret p.sh. 20% siç u supozua në metodën e shkallëzimit zinxhir me rregullim për inflacionin.

Ne këtë shembull, po e marrim inflacionin e së ardhmes 17%, për të parë përveç të tjerash edhe efektin në provigjonin teknik të dëmeve.

Atëherë:

$$\hat{\lambda}_5 = \hat{\lambda}_4 * (1 + 0{,}17) = 45.482 * 1{,}17 = 53.106$$

$$\hat{\lambda}_6 = \hat{\lambda}_5 * (1 + 0{,}17) = 53.106 * 1{,}17 = 62.009$$

$$\hat{\lambda}_7 = \hat{\lambda}_6 * (1 + 0{,}17) = 62.009 * 1{,}17 = 72.403$$

$$\hat{\lambda}_8 = \hat{\lambda}_7 * (1 + 0{,}17) = 72.403 * 1{,}17 = 84.541$$

Tani mund të japim vlerësimet numerike për parashikimet e dëmeve , sipas modelit të fig. 14.

Viti i Aksidentit	Dëmet mesatare në vitin e zhvillimit				
	0	1	2	3	4
1986					
1987					1.330
1988				4.199	1.557
1989			7.024	4.912	1.821
1990		18.620	8.218	5.747	2.131

Fig.15

Tani në mund të shumëzojmë në fig.15 me numrat përkates të dëmeve për secilin vit të aksidentit, për të marrë parashikimet e dëmeve që do të paguhen në vitet 1991, 1992, 1993, dhe 1994, në lidhje me vitet e aksidenteve 1987, 1988, 1989, 1990. (tani mos e konsideroni kollonën $5-\infty$ të tabelës së mëposhtme.)

Tani mund të japim vlerësimet numerike për parashikimet e dëmeve, sipas modelit të Fig.14.

Viti I Aksidentit	Pagesat (Cmimet e Dhjetorit 1990) në vitin e zhvillimit					
	0	1	2	3	4	$5-\infty$
1986						250.218
1987					57.762	263.248
1988				174.065	64.544	294.222
1989			292.718	204.703	75.888	345.441
1990		731.114	322.680	225.656	83.674	380.396

Fig.16

Mbetet problemi i parashikimit të provigjonit teknik të nevojshëm pas vitit të zhvillimit k (në rastin tonë k=4). Duke supozuar që ky provigjon teknik, përbën vetem një propocion të vogel të provigjonit teknik total të dëmeve që do të mbahet, mund të konsiderohet relativisht e saktë të merret si vlerësim i provigjonit teknik pas vitit të zhvillimit k në lidhje me vitin e aksidentit i madhesia:

$$P_{i,k^+} = (n_i / n_0) * \left(\hat{\lambda}_{k+i+1} / \hat{\lambda}_{k+1} \right) * P_{0,k^+}$$

Në shembullin tonë k = 4 dhe $P_{0.k+} = P_{0.4+}$ = 168,987 është vlerësimi i bërë për provigjonin teknik të dëmeve në 31/12/90 në lidhje me vitin e aksidentit 1986, n_0 është numri i parashikuar për vitin e aksidentit 0 (viti 1986 në shembullin tonë), kurse

n_i është numri i dëmeve i parashikuar për vitin e aksidentit i .

Kështu;

$$P_{1,4^+} = (n_1 / n_0) * \left(\hat{\lambda}_6 / \hat{\lambda}_5 \right) * P_{0,4^+} = (43.430 / 48.298) * 1{,}17 * 168.987 = 177.787$$

$$P_{2,4^+} = (n_2 / n_0) * \left(\hat{\lambda}_7 / \hat{\lambda}_5 \right) * P_{0,4^+} = (41.454 / 48.298) * 1{,}17 * 168.987 = 198.706$$

$$P_{3,4^+} = (n_3 / n_0) * \left(\hat{\lambda}_8 / \hat{\lambda}_5 \right) * P_{0,4^+} = (41.674 / 48.298) * 1{,}17 * 168.987 = 233.297$$

$$P_{4,4^+} = (n_4 / n_0) * \left(\hat{\lambda}_9 / \hat{\lambda}_5 \right) * P_{0,4^+} = (39.265 / 48.298) * 1{,}17 * 168.987 = 256.904$$

Pagesat e dëmeve që iu referohen viteve të zhvillimit 5 e me tej, supozohet që mesatarisht në mes të vitit të zhvillimit 7 , prandaj secila nga vlerat e gjetura më sipër për $P_{1.4+}$, $P_{2.4+}$ $P_{3.4+}$ dhe $P_{4.4+}$ duhet të shumëzohen me $(1+0{,}17)^{2{,}5}$, ku 0.17 është shkalla e inflacionit në të ardhmen e vlerësuar më lart.

Vlerat e gjetura pas ketyre veprimeve përfundimtare , po papaqiten në kollonën $5-\infty$ të Fig. 16.

Duke mos marrë parasysh të ardhurat nga investimet në vlerësimet për provigjonin teknik të dëmeve, kemi vlerësimet e mëposhtme.

1986	është	250.218	250.218
1987	është	57.762 + 263.248	321.010
1988	është	174.065 + 64.544 + 29.222	532.831
1989	është	292.718 + 204.703 + 75.888 + 345.441	918.750
1990	është	731.114 + 322.680 + 225.656 + 83.674 + 380.396	1.743.520
		Total=	3.766.329

Tani mund të krahasojmë rezultatet e metodës së ndarjes me rezultatet e metodës së shkallëzimit zinxhir me rregullim për inflacionin . Shihet që vlerësimet e marra janë mjaft të afërta.

A N E K S 2

Baza e të dhënave që duhet të raportohet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe duhet të merret në konsideratë për përllogaritjen e provigjoneve teknike.

Baza e të dhënave që duhet plotësuar nga shoqëria e sigurimeve dhe që do sherbeje si bazë për llogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të dëmeve, paraqiten sipas tabelave më poshtë

TABELA I (të dhëna mbi rreziqet e kontraktuara nga shoqëria)

Seria e policës së sigurimit
Emri dhe mbiemri i policmbajtësit
Lloji i kontratës së sigurimit
Të dhëna të detajuara mbi objektin e siguruar
Periudha e mbulimit të kontratës së sigurimit
Primi bruto i sigurimit (i ndarë në mënyrë të detajuar sipas objekteve dhe rresiqeve të shënuara në kontratë)
Primi i cedimit në risigurim (i ndarë në mënyrë të detajuar sipas oblekteve dhe rresiqeve të shenuara ne kontratë)
Shuma e sigurimit (e ndarë në mënyrë të detajuar sipas objekteve dhe rresiqeve të shenuara ne kontratë)
Shuma e sigurimit e ceduar ne risigurim (e ndarë në mënyrë të detajuar sipas objekteve dhe rresiqeve të shenuara ne kontratë)
Shpenzimet fillestare dhe të shtyra të marrjes në sigurim (të ndara).

TABELA II(për dëmet e ndodhura)

Numri i praktikës së dëmit
Seria e policës së sigurimit
Të dhëna lidhur me dëmin
Data e fillimit të kontratës së sigurimit
Data e mbarimit të kontratës së sigurimit
Data e ndodhjes së dëmit
Data e Raportimit
Lloji i dëmit (ne mënyrë të veçuar nese është pasuror, dëmtim trupor, etj)
Vlera e dëmit të vlerësuar nga shoqëria e sigurimit (ne mënyrë të veçuar për llojin e dëmit) për çdo vlerësim të bërë
Data e vlerësimit të dëmit për çdo vlerësim të bërë
Vlera e dëmit e kërkuar nga i aksidentuari (ne mënyrë të veçuar për llojin e dëmit)
Vlera e dëmit e paguar nga shoqëria (ne mënyrë të veçuar për llojin e dëmit)
Data e pagesës se dëmit për çdo pagesë të bërë
Statusi i praktikës së dëmit (nëse është pezull, paguar, praktikë e mbyllur, etj.)
Provigjoni teknik (dëmi pezull) (në mënyrë të veçuar për llojin e dëmit)
Të dhëna të detajuara mbi pjesën e risiguruesit në dëm (duke përfshire pagesat, si dhe pjesën e risiguruesit në provigjonin e dëmit për çdo vlerësim të atij dëmi)

Këto të dhëna duhet të plotesohen nga shoqëria e sigurimit për të gjitha dëmet duke përfshire edhe periudhat e mëparshme, qofshin këto dëme pezull, në proces gjyqsor, të paguara, apo të refuzuara nga shoqëria e sigurimit.

Keto të dhëna raportohen në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, së bashku me ndryshimet përkatëse në historikun e tyre, në mënyrë të përmuajshme, brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Për qartësimin e kërkeses për dëmet e ndodhura mund të ndihmojë shembulli më poshtë:

Data dhe veprimi	Tabela e modifikuar	Fushat e modifikuara
11.10.2004 Aksident		
13.10.2004 Raportimi I dëmit	Dëmi	Praktika e dëmit: 1324 Data e raportimit: 13.10.2004 Data e ndodhjes: 11.10.2004 Statusi "proces në shqyrtim"
	Provigjoni teknik	Praktika e dëmit: 1324 Ndryshimi i provigjonit +500,000 lekë Data e ndryshimit: 13.10.2004 Përshkrimi: "vlerësimi i parë"
02.11.2004 Inspektimi (dëmi është vlerësuar 750,000 lekë)	Dëmi	Emir i ekspërtit që meret me rastin
	Provigjoni teknik	Praktika e dëmit: 1324 Ndryshimi i provigjonit +250,000 lekë Data e ndryshimit: 20.11.2004 Përshkrimi inspektim i provigjonit
20.11.2004 Parapagimi (pagesa e parë prej 400,000 lekë)	Provigjoni teknik	Praktika e dëmit: 1324 Ndryshimi i provigjonit: - 400,000 lekë Data e pagesës: 20.11.2004 Përshkrimi: "Parapagim"
	Pagesat	Praktika e dëmit: 1324 Pagesa: 400,000 lekë Data e pagesës: 20.11.2004 Përshkrimi: "Parapagim"

11.12.2004 Pagesa përfundimtare: 300,000 lekë	Dëmi	Statusi i dëmit: "i mbyllur"
	Provigjoni teknik	Praktika e dëmit: 1324 Ndryshimi i provigjonit: -50,000 lekë Data e ndryshimit: 11.12.2004 Përshkrimi: "Rivlerësim"
	Provigjoni teknik	Praktika e dëmit: 1324 Ndryshimi i provigjonit: -300,000 lekë Data e ndryshimit: 11.12.2004 Përshkrimi: "pagesë"
	Pagesat	Praktika e dëmit:1324 Pagesa: 300 Euro Data e pagesës: 11.12.2004 Përshkrimi: "Pagesë"

Gjithashtu, shoqëria e sigurimit duhet të plotësojë raporte mujore të këtyre dëmeve sipas shembullit më poshtë:

Muaji & Viti	Dëmet e Paguara	Rezervat e dëmeve	Dëmet e paguara + Rezervat e dëmeve
Tetor 2004	0 leke	500,000 leke	500,000 leke
Nentor 2004	400,000 leke	-150,000 leke	250,000 leke
Dhjetor	300,000 leke	-350,000 leke	-50,000 leke
Gjithsej	700,000 leke	0 leke	700,000 leke

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E UDHEZIMIT "PËR LISTËN E DOKUMENTAVE TË LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE E PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzimit "Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

UDHËZIM

PËR LISTËN E DOKUMENTEVE TË LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE E PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT E RISIGURIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit nr.10, datë 08.02.2007

Baza ligjore: Ky udhëzim hartohet ne bazë dhe për zbatim të nenit 115 të Ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Deri në hartimin, miratimin e vënien në zbatim të planit kontabël specifik për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit, kontabiliteti në shoqëritë e sigurimeve organizohet e mbahet sipas detyrimeve të përgjithshme e parimeve të përcaktuara në ligjin për kontabilitetin, duke përdorur metodën e regjistrimit të dyfishtë dhe parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Teknika e mbajtjes së llogarive mbështetet në Planin e Përgjithshëm Kontabël, duke reflektuar edhe veçoritë e veprimtarisë të sigurimit e të risigurimit.

Lista e dokumenteve që përbëjnë llogaridhënien e detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit, të cilat paraqiten në Autoritetin e Mbikeqyrjes Financiare, është si më poshtë:

1. Bilanci financiar *vjetor.*
2. Bilanci financiar *tremujor.*
3. Llogaria e Fitime dhe Humbje *vjetore*.
4. Llogaria e Fitime dhe Humbje *tremujore*.
5. Llogaria e Fitime dhe Humbje për veprimtarinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë *vjetore*.
6. Llogaria e Fitime dhe Humbje për veprimtarinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë *tremujore*.
7. Llogaria teknike e sigurimeve për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e dëmeve *tremujore*.

8. Llogaria teknike e risigurimeve për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e dëmeve *vjetore*.
9. Llogaria teknike e sigurimeve për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e jetës *vjetore*.
10. Llogaria teknike e risigurimeve për shoqeritë që ushtrojnë veprimtarinë e jetës *vjetore*.
11. Pasqyra analitike e shpenzimeve administrative, *vjetore*.
12. Pasqyra analitike e shpenzimeve administrative, *tremujore*.
13. Pasqyra e marrjes në sigurim *vjetore*.
14. Pasqyra e marrjes në sigurim *tremujore*.
15. Të dhënat për rreziqet me vlerë mbi 30 milionë lekë, *rast pas rasti*.
16. Të dhënat për dëmet mbi 10 milionë lekë, *rast pas rasti*.
17. Pasqyra e primeve dhe dëmeve sintetike dhe analitike, në lekë e valutë *mujore*.
18. Pasqyra e investimeve të provigjoneve teknike e matematike, *vjetore*.
19. Pasqyra e investimeve të provigjoneve teknike e matematike, *tremujore*.
20. Pasqyra e klasifikimit të provigjoneve teknike dhe matematike sipas llojit dhe grupit të aktiviteteve, si dhe drejtimet e investimit të tyre, *vjetore*.
21. Lista e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike të sigurimit, *vjetore*.
22. Lista e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike të sigurimit, *tremujore*.
23. Llogaritja e marzhit të afësisë paguese dhe elementët që e përbëjnë atë, *vjetore*.
24. Llogaritja e marzhit të afesisë paguese dhe elementët që e përbëjnë atë, *gjashtëmujore*.
25. Pasqyra e qarkullimit të mjeteve monetare, *vjetore*.
26. Pasqyra e qarkullimit të mjeteve monetare, *tremujore*.
27. Pasqyra e pagimit të dëmeve, *vjetore*.

BILANCI

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose risigurimit, janë të detyruara të regjistrojnë në librat e llogarive, në mënyrë analitike, kategoritë e veçanta të aktiveve, grupet bazë të sigurimit dhe/ose risigurimit, llojet e policave të sigurimit dhe/ose risigurimit brenda grupit.

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose risigurimit janë të detyruara të regjistrojnë në libra të veçantë, aktivet e qëndrueshme të trupëzuara sipas burimit të financimit: Nga provigjonet teknike të sigurimit dhe/ose risigurimit për aktivitetin e jetës, nga provigjonet teknike të sigurimit dhe/ose risigurimit të jojetës (dëmeve) dhe nga provigjonet e tjera sipas llojeve të provigjoneve.

Gjithashtu, të veçanta do të jenë librat ku pasqyrohen financimet nga kapitali dhe provigjonet e shoqërisë.

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose risigurimit, janë të detyruara të regjistrojnë në libra të veçantë aktivet e qëndrueshme financiare sipas burimit të financimit, si më lart.

Shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit të jetës, janë të detyruara të mbajnë në libra të veçantë investimet e realizuara në favor të policmbajtësve, të cilët kanë marrë përsipër rrezikun e investimeve.

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose risigurimit, janë të detyruara të mbajnë në libra të veçantë detyrimet e shoqërisë së sigurimit sipas veprimtarive si dhe sipas analizave të tyre në bilanc.

Kur shoqëria e sigurimit ushtron njëkohësisht veprimtarinë e sigurimit të jetës dhe të sigurimit të jojetës (dëmeve), mban libra kontabiliteti dhe përgatit bilance kontabile më vete për çdonjërën nga veprimtaritë e mësipërme.

Në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare paraqitet Bilanci Kontabël përmbledhës dhe bilancet e veçanta sipas veprimtarive të sigurimit (të jetës dhe jo-jetës).

Kur shoqëria e sigurimit dhe/ose risigurimit e ka shtrirë aktivitetin e saj jashtë territorit të Republikës, paraqet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare jo vetëm bilancin e veprimtarisë së sigurimit brenda territorit të Shqipërisë, por edhe Bilancin Kontabël përmbledhës (të konsoliduar) të shoqërisë.

Struktura dhe udhëzim për plotësimin e Bilancit:

Bilanci i shoqërive të sigurimit do te ketë strukturën e mëposhtme:

AKTIVI

A. Kapiali i nënshkruar i papaguar.

B. Aktive të patrupëzuara.

C. Investime.

D. Investime të kryera për policmbajtësit e sigurimt të jetës që mbajnë rrezikun e investimit.

E. Pjesa e provigjonit teknik të risigurimit.

F. Debitorë.

G. Aktive të tjera.

H. Parapagime dhe të ardhura të llogaritura.

I. Të tjera aktive.

PASIVI

A. Kapitali dhe rezervat.

B. Detyrime të varura.

C. Provigjonet teknike.

D. Provigjonet teknike për policat e sigurimit ku rreziku i investimit buron nga policmbajtësi.

E. Provigjone për shpenzime dhe rrisqe të tjera.

F. Detyrimet që rrjedhin nga risiguruesit.

G. Kreditorë.

H. Të ardhura të marra dhe regjistruara avancë.

I. Pasive të tjera.

Shoqëria e sigurimt regjistron dhe pasqyron kronologjikisht në librat e saj të analizuara, kategoritë e veçanta të aktiveve, sipas grupeve bazë të sigurimeve dhe llojeve të policave brenda grupit.

BILANCI FINANCIAR

Aktiv: C – *Investimet*

Në këtë grup regjistrohen të gjitha investimet sipas burimeve të financimit: Nga provigjonet teknike dhe matematike të sigurimeve nga veprimtaria e dëmeve, nga provigjonet teknike e matematike të sigurimeve nga veprimtaria e jetës, dhe nga investimet e kapitalit. Të veçanta mbahen edhe investimet në toka dhe në ndërtime.

Aktiv: C I - *Toka dhe ndërtime*

Këtu regjistrohen pagesat e kryera për toka dhe ndërtime, si dhe parapagimet dhe pagesat pjesore të kryera për ndërtimet në proces.

Shumat që i korrespondojnë asaj pjese të tokës dhe ndërtesës të zëna nga një shoqëri sigurimi për zhvillimin e aktivitetit të vet, pasqyrohen në shënimet e bilancit.

Këtu regjistrohen edhe të drejtat në pasuri të paluejtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme të përcaktuara në Kodin Civil.

Për vlerën e situacioneve të paraqitura, ky zë mund të pakësohet me shumën që zbritet nga paradhëniet.

Aktiv: C II - 1. *Aksione të lidhura me sipërmarrje (filiale jashtë territorit)*

Këtu regjistrohen aksione të lidhua me sipërmarrje, me të cilat do të kuptojmë filiale, degë, apo zyra përfaqësimi të shoqërisë së sigurimit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në emër dhe për llogari të shoqërisë vendase të sigurimit, por që aktivitetin e tyre e ushtrojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Aktiv: CII - 2. *Interesa pjesëmarrëse*

Këtu regjistrohen të drejtat në kapitalin e sipërmarrjeve të tjera, të cilat kanë për qëllim të krijojnë qëndrueshmëri në to. Zotërimi i pjesës së kapitalit në një sipërmarrje tjetër presupozon një interes pjesëmarrës.

Aktiv: CIII - 5. *Aksione dhe pjesëmarrje të përbashkëta*

Këtu regjistrohen aksionet e një sipërmarrje joint - venture, që krijohet nga bashkimi i disa sipërmarrjeve ose fonde pensioni, drejtimi i së cilës i është besuar njërit nga sipërmarrësit ose fondit të pensioneve.

Aktiv: C III - 8. *Depozita në institucione të tjera krediti:*

Këtu regjistrohen shumat e depozituara në institucione të autorizuara, me afate të përcaktuara në marrëveshje. Shumat e depozituara pa afat kohor, përfshihen në G III – 1 (banka).

Aktiv: CIII - 9. *Të tjera*

Këtu regjistrohen të gjitha investimet e tjera, që nuk janë përfshirë në zerat e mësipërm. Në rast se shumat e investimeve të tilla janë të konsiderueshme dhe zënë më shumë se 30 % të totalit të grupit kryesor - Investime - ato të pasqyrohen të analizuara në aneksin e bilancit në formularin "Shënime" .

Aktiv: C IV - *Depozita në shoqëritë ceduese*

Në bilancin e një shoqërie që pranon risigurime, këtu regjistrohen shumat që zotërohen nga shoqëria ceduese e sigurimit. Këto shuma i korrespondojnë garancive të depozituara në shoqëritë ceduese, ose pranë palëve të treta.

Keto shuma nuk mund të bashkohen me shuma të tjera të zoteruara nga shoqëritë ceduese të sigurimeve për risiguruesit, si dhe me shumat e zotëruara nga risiguruesit për shoqëritë ceduese (siguruese).

Garancitë e depozituara pranë shoqërive ceduese ose palëve të treta, të cilat mbeten pronë e shoqërisë që pranon risigurim, do të përfshihet në llogaritë e mëvonshme si një investim brenda grupit të investimeve, në përputhje me rregullat për vlerësimin e aktiveve.

Aktiv: E - *Pjesa e provigjonit teknik të risiguruesit*

Këtu regjistrohen shumat aktuale ose të vlerësuara të provigjonit teknik që shoqëria e risigurimit detyrohet të paguajë në rastet e ndodhjes së dëmeve, sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit, të cilat janë përgjegjësi e risiguruesit.

Kjo rubrikë e aktivit llogaritet e veçantë sipas llojit të provigjonit teknik për primin e pafituar, për sigurimin e jetës, për dëmet pezull, për bonuse e rabate, për provigjone të tjera teknike, si dhe nga policat e sigurimit të jetës, kur rreziku i investimit buron nga policmbajtësit.

Provigjoni teknik i risigurimit përfaqesohet detyrimisht nga depozita ose garanci për shoqërinë e sigurimit.

Provigjoni teknik për primet e pafituara (pjesa e risiguruesit), do të llogaritet në përputhje me metodat e përcaktuara për llogaritjen e këtij provigjioni ose në përputhje me kushtet e policës së sigurimit.

Aktiv: F - I *Debitorë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit*

Policmbajtësit,

- ku përfshihen policmbajtësit që detyrohen për këstet vijuese të kontratës, për të cilat ata kanë paguar të paktën një këst.

-Detyrime për dëmet e shkaktuara nga mbajtësit e mjeteve motorike të papajisur me çertifikatën e sigurimit.

-Detyrime të tjera të policmbajtësve; si dëme të paguara më tepër apo prime të arkëtuara më pak, etj.

Ndërmjetësit,

- ku përfshihen detyrimet e ndërmjetësve (agjentëve) për policat e sigurimit të shitura në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit, si dhe detyrimet e tjera që lindin nga marrëdhëniet e

ndërmjetësimit në sigurime.

- Përveç sa më sipër, këtu regjistrohen edhe arkëtimet në *sigurimin e shëndetit në udhëtim*.

Meqenëse, degët nuk paguajnë dëme për këtë sigurim, arkëtimet konsiderohen si detyrime për drejtorinë e përgjithshme.

Në këtë rast:

Në degët e shoqërisë, ku kjo llogari pasqyron marrëdhëniet me drejtorinë e përgjithshme,

evidentohet shuma totale e arkëtimeve ende e paxhiruar. Kjo llogari pakësohet për shumat që i xhirohen drejtorisë së përgjithshme, si dhe për shumat që mbahen si komision për shërbimet që kanë kryer agjentët.

Gjithashtu, kjo llogari pakësohet për shumat e policave të anulluara dhe që i kthehen klientit.

Në drejtorinë e përgjithshme. Kjo llogari përfaqëson shumat e të ardhurave nga sigurimi i shëndetit në udhëtim, që ende nuk janë xhiruar nga degët.

Aktiv: F - II *Debitorë që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit*

Këtu regjistrohen:

- Detyrime që rrjedhin nga shoqëritë ceduese (risiguruese) për kontratat e lidhura dhe ende të paarkëtuara, që përballohen nga risiguruesi si:

- Detyrimet e shoqërive risiguruese ndaj shoqërisë ceduese për pjesën e dëmeve, që sipas kontratave të lidhura përballohen nga shoqëritë risiguruese.

- Shuma e primit, e vendosur në formën e depozitës për risiguruesit.

- Të tjera detyrime që lindin nga marrëdhëniet midis shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, që nuk janë përfshirë në grupimet e mësipërme.

Aktiv: F - III *Debitorë të tjerë*

Këtu regjistrohen të gjithë debitorët e tjerë që nuk janë përfshirë në grupet e mësipërme, për të cilët evidentimi kontabël bëhet siç është përcaktuar në planin kontabël.

Këtu regjistrohen shumat e qirasë të mbartura periodikisht dhe të llogaritura, por të paarkëtuara.

Aktiv: G - *Aktive të tjera*

Aktiv: G - II 3 *Aksione të veta*

Këtu regjistrohen vlerat nominale të aksioneve të veta, të cilat pasqyrohen në formularin

"Shënime" në përputhje me rregullat e vlerësimit të aktiveve.

Aktiv: G - II 4 *Aktive të tjera*

Këtu shënohen ato aktive që nuk janë përfshirë në pikat G-1, G-2, G-3.

Aktive të tilla janë materiale, etj. Edhe këto do të pasqyrohen në formularin "Shënime"në përputhje me regullat e vlerësimit të aktiveve.

Aktiv: H - 1 *Shpenzime të marrjes në sigurim për sigurimin e jetës (të shtrira në vitet e ardhshme)*

Këtu regjistrohen shpenzime të marrjes në sigurim të jetës të shtrira në vitet e ardhshme në përputhje me kushtet e përcaktuara ne rregulloren e Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare për llogaritjen e provigjoneve teknike dhe matematike.

Aktiv: H - 2 *Parapagime të tjera*

Këtu regjistrohen shpenzime të tjera të kryera gjatë vitit financiar, por që lidhen me vitin ose vitet financiare në vijim, së bashku me çdo të ardhur tjetër, e cila megjithëse lidhet me vitin financiar aktual, pasqyrohet në këtë zë.

Aktiv: *Llogaritë jashtë bilancit*

Këtu regjistrohen angazhime të të tretëve ndaj shoqërisë së sigurimit për dhënien me qira etj., sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim. Këtu evidentohet vlera totale e qirasë (angazhimit) të përcaktuar për të gjithë periudhën e kontraktuar. Kjo vlerë pakësohet me arkëtimet e qirave (angazimit)të llogaritura.

Pasiv: A - 4 *Rezervat (kapitali)*

Rezervat e shoqërive të sigurimit janë rezervat e kapitalit. Ato përbëhen nga rezervat e krijuara nga fitimi. Këtu përfshihen rezervat e sigurisë ose rezervat për të arritur fondin e garancisë, si dhe rezervat të tjera që krijohen sipas legjislacionit dhe statutit të shoqërisë së sigurimit.

Pasiv: B - *Detyrime të varura*

Këtu regjistrohen përgjegjësitë (detyrimet) sipas një marrëveshje kontraktuale, që në rastin e mbylljes ose falimentimit të një shoqërie sigurimi, përgjegjësitë që burojnë nga kjo marrëveshje do të paguhen dëmet e të gjithë kreditorëve të tjerë. Vetëm këto përgjegjësi (detyrime) do të pasqyrohen në këtë pikë.

Pasiv: C - I *Provigjone për primin e pafituar dhe rrezikun e paskaduar*

Këtu regjistrohen provigjonet për primin e pafituar, si nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës dhe ato që ushtrojnë aktivitetin e jojetës. Shuma e këtij provigjoni i korrespondon pjesës së primit të shkruar që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar.

Provigjoni për rriskun e paskaduar është material, ai duhet të pasqyrohet i veçantë si në bilanc, ashtu edhe në shënimet e bilancit.

Pasiv: C - II *Provigjone për sigurimin e jetës*

Këtu regjistrohen provigjonet e sigurimit të jetës, të cilat përfshjnë vlerën aktuariale të përgjegjësive të një shoqërie sigurimi, përfshirë bonuset gjithashtu të deklaruara dhe pas pakësimit të vlerës aktuariale të primit të ardhshëm.

Pasiv: C - III *Provigjone për dëmet pezull*

Këtu regjistrohen provigjonet për dëmet, si nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës dhe ato të jojetës. Këtu përfshihen:

Provigjonet për dëmet pezull të ndodhura dhe të raportuara në vitin financiar aktual, por ende të papaguara brenda vitit financiar; të ndodhura në vitin financiar, por të paraportuara në këtë periudhë.

Pasiv: C - IV *Provigjone për bonuset dhe rabatet*

Këtu regjistrohen provigjonet për bonuse dhe rabate që përfaqësojnë shumat e parashikuara për policmbajtësit ose përfituesit, të llogaritura në përputhje me kontratat e sigurimeve.

Pasiv: C - V *Provigjone barazimi*

Këtu regjistrohen provigjone të llogaritura në mënyrë të tillë që shoqëria të përmbushë në çdo kohë, çdo detyrim të lindur nga kontratat e sigurimeve për aq sa parashikon vetë shoqëria e sigurimit.

Pasiv: D *Provigjone teknike për policat e sigurimit të jetës kur rrisku i investimit buron nga policmbajtësi*

Këtu regjistrohen vetëm provigjonet teknike të krijuara për mbulimin e përgjegjësive që lidhen me investimet, vlera ose kthimi i të cilave është përcaktuar në përputhje me investimet për të cilat policmbajtësi mban rriskun.

Çdo shtesë e provigjonit teknik të krijuar për të mbuluar rrezikun e vdekjes, shpenzimeve operative ose rrisqeve të tjera (siç janë përfitimet që paguhen në datën e maturimit ose vlera të përftuara nga anulimi i policave të sigurimit), duhet të jenë të përfshira në pikën C - II Pasivit (provigjone për sigurimin e jetës)

Pasiv: E - *Provigjone për shpenzime dhe rrisqe të tjera*

Pasiv: E-I *Provigjone për pensione dhe përgjegjësi të ngjashme*

Këtu regjistrohen provigjonet (rezervat) për shpenzime dhe rrisqe që synojnë mbulimin e humbjeve dhe detyrimeve të një natyre krejtësisht të përcaktuar të cilën në datën e mbylljes së bilancit, janë të sigurta për të ndodhur, por të pasigurta për datën në të cilën ato do të ndodhin.

Pasiv: E - 2 *Provigjone për taksa*

Këtu regjistrohen provigjonet për shpenzime dhe rrisqe që synojnë mbulimin e humbjeve nga origjina të tjera të vitit financiar, të një natyre krejtësisht të përcaktuar, pas shikimit ose parashikimit të vitit financiar, por të cilat në datën e mbylljes së bilancit janë të sigurta për të ndodhur, por të pasigurta për datën në të cilën do të ndodhin.

Pasiv: E - 3 *Të tjera provigjone*

Këtu regjistrohen provigjone të tjera të cilat nuk janë përfshirë në dy grupet e mësipërme.

Këtu mund të regjistrohen edhe provigjonet teknike për rregullimin apo përshtatjen e vlerave të aktivit.

Pasiv: F - *Detyrime të tjera që rrjedhin nga risiguruesit*

Këtu regjistrohen vlerat e depozituara nga ose të mbajtura nga shoqëria e sigurimit sipas një kontrate risigurimi. Këto vlera nuk do të bashkohen me vlera të tjera që zotërohen nga shoqëri të tjera në fjalë.

Në rastet kur një shoqëri ceduese risigurimi, ka marrë si garanci një depozitë, e cila është transferuar në pronësi të tij, kjo pikë do të përfshijë vlerën e garancisë së marrë nga shoqëria me cilësinë e depozitës.

Pasiv: G - I *Kreditorë që rrjedhin direkt nga veprimtaria siguruese*

Këtu regjistrohen detyrimet e shoqërisë ndaj të siguruarve si :

Shuma të vetë policmbajtësve, këtu regjistrohen shumat:

- që sipas kontratave të sigurimit shoqëria u detyrohet për kthimin e primeve;

- detyrime të shoqërisë ndaj të siguruarve për dëmet e ndodhura të rëna dakord për t'u paguar dhe të llogaritura, por akoma të palikuiduara;

- detyrime të shoqërisë së sigurimit ndaj mbajtësve të policave të sigurimit të jetës për të cilat është marrë përsipër rreziku i investimeve (interesi që përfitojnë klientët).

Të tjerë kreditorë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimeve këtu regjistrohen:

- detyrimet ndaj ndërmjetësve në sigurime për komisionet e ndërmjetësimit.

- detyrimet ndaj ndërmjetësve për dëmet që këta të fundit kanë paguar për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe/ose risigurimit,

- si dhe të tjera detyrime që rrjedhin nga shitja e policave.

Pasiv: G - II *Kreditorë që rrjedhin direkt nga veprimtaria risiguruese*

Këtu regjistrohen detyrimet e shoqërisë ndaj shoqërive të risigurimit për likuidimin e primit, sipas kontratës së risigurimit, detyrime të shoqërive ceduese ndaj shoqërive risiguruese për likuidimin e primit sipas kontratës, detyrime ndaj shoqërive ceduese për pjesën e dëmeve që duhet të paguhen sipas kontratës së risigurimit, detyrime të shoqërive risiguruese ndaj shoqërive ceduese për pjesën e dëmeve që duhet të paguajë sipas kontratës, detyrime për retrocensionet, si dhe detyrimet e tjera që lindin në veprimtarinë e risigurimit.

Pasiv: G - III *Hua të varura, të veçanta nga ato të kthyeshme*

Këtu regjistrohen shumat që shoqëritë e sigurimit detyrohen të paguajnë në vijim të kontratës së sigurimeve.

Pasiv: G - V *Kreditorë të tjerë përfshirë edhe taksat dhe sigurimet shoqërore*

Në këtë grup trajtimi kontabël bëhet siç është përcaktuar në Planin Kontabël të Përgjithshëm.

Këtu regjistrohen edhe shumat sipas kontratës për garancitë e punimeve për vlerën e situacioneve të paraqitura e të miratuara (në analizë "Mbajtje garanci për punime".)

Këtu regjistrohen detyrimet e qiramarrësve për llogaritjen e qirasë së maturuar periodikisht, por ende të paarkëtuar, e cila pakësohet me arkëtimet në periudhën pasardhëse.

Pasiv: G - *Të ardhura të marra dhe të regjistruara në avancë*

Këtu regjistrohen të ardhura të marra para datës së mbylljes së bilancit financiar, por këto të ardhura janë të lidhura me vitin financiar dhe që së bashku me ndonjë shpenzim tjetër do të paguhen në vitin financiar në vijim. Të gjitha këto do të pasqyrohen në pikën H.

Pasiv: - *Llogari jashtë bilancit*

Këtu regjistrohen angazhime të shoqërisë së sigurimit ndaj të tretëve, për marrjen me qira etj., sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim. Këtu evidentohet vlera totale e qirasë ose angazhimit të përcaktuar për të gjithë periudhën e kontraktuar. Kjo vlerë pakësohet me shlyerjen e qirave ose angazhimeve të llogaritura.

Udhëzime për plotësimin e pasqyrave anekse të bilancit.

LLOGARIA E FITIMEVE DHE HUMBJEVE

(VJETORE DHE TREMUJORE)

Llogaria "Fitime dhe humbje" ndërtohet në formën e llogarisë me dy anë, ku në njërën anë shënohen shpenzimet dhe në anën tjetër të ardhurat e shoqërisë.

Klasifikim i shpenzimeve dhe të ardhurave bëhet si në formularët bashkëngjitur.

A. Shpenzimet klasifikohen në shpenzime për dëmet, shpenzimet për parandalimin e dëmeve, shpenzime për arkëtimin e primit, bonuset dhe skontimet, shpenzimet operative, shpenzime për investime dhe shpenzime të tjera të sigurimeve.

- *Shpenzimet për dëmet* klasifikohen sipas grupeve të sigurimit duke paraqitur shumën bruto dhe shumën e risigurimeve. Shpenzimet për dëmet përfshijnë vlerën e kompensimit për dëmin e ndodhur dhe shpenzimet e trajtimit të dëmit. Vlera e kompesimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguruar në rastin e ndodhjes së dëmit. Në shpenzimet e trajtimit të dëmit përfshihen shpenzimet e brendëshme ose të jashtme, që lidhen me trajtimin e rastit të sigurimit, llogaritjen e vlerës së dëmit, shpenzimet gjygjësore dhe shpenzimet për ekspertë.

- *Shpenzimet operative* që kryhen nga shoqëritë e sigurimit klasifikohen në shpenzime për shitjen e policave të sigurimit (marrjes në sigurim) dhe shpenzime të tjera operative ku përfshihet

amortizimi i aktiveve të qëndrueshme, shpenzime personeli, shpenzime materiale, shërbime nga të tretët, etj. *Shpenzimet për shitjen e policave të sigurimit (marrjes në sigurim)* përbëhen nga shpenzimet për përgatitjen e policës, për komisionet e ndërmjetësimit, për publikime, përgatitja e ofertave për çmimin dhe shpenzimet për lëshimin e policës.

B. Të ardhurat klasifikohen; në të ardhura nga primet, të ardhura nga investimet, dhe të ardhura të tjera të shoqërisë.

- Të ardhurat nga primet përbëhen nga primet e sigurimit brito të korrigjuara me primet e paguara për risigurime, me ndryshimin e provigjoneve (rezervave) për primet bruto në

ndryshimet në provigjonet (rezervat) e primit të risigurimit.

- Të ardhurat nga investimet paraqiten të analizuara sipas kategorisë së investimeve, si të ardhurat nga letra me vlerë, nga aksione dhe pjesëmarrje të tjera me afat të gjatë zotërimi, nga kredi hipotekare, nga pasuri të paluejtshme, nga interesa dhe nga të tjera investime.

- Të ardhura të tjera të shoqërisë përfshihet çdo lloj tjetër e ardhure dytësore, që nuk bën pjesë në dy grupet e para, trajtimi kontabël i të cilave realizohet ashtu siç është përcaktuar në Planin Kontabël të Përgjithshëm.

Shoqëria e sigurimeve paraqet sipas kategorive të veçanta të sigurimeve, rezultatin teknik të sigurimeve dhe rritjen e rezultatit nga sigurimet, si diferencën midis të ardhurave e shpenzimeve nga investimet e financuara nga provigjonet teknike të sigurimeve dhe nga burime të tjera.

Rezultati teknik i sigurimeve është diferencë midis të ardhurave nga primet teknike dhe shpenzimeve për dëmet, të shtuara ose të pakësuara nga rritja ose pakësimi i provigjoneve teknike të sigurimit për periudhën.

LLOGARIA E FITIMEVE DHE HUMBJEVE PËR VEPRIMTARINË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kjo pasqyrë përmban të dhëna që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe shpenzimet të analizuara për veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

A. Të ardhurat: Këtu regjistrohen vetëm të ardhurat nga primet, nga depozitat në bankat e huaja, të tjera jashtë territorit, si dhe të ardhura të jashtëzakonshme.

Të ardhurat e jashtëzakonshme shoqërohen me një relacion, i cili jep të dhëna në lidhje me burimin e tyre.

B. Ndryshime në provigjonet teknike: Këtu regjistrohen vetëm provigjonet teknike që i takojnë përgjegjësive të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të klasifikuara në

provigjone teknike për primet, për sigurimin e jetës, për dëmet, për bonuse dhe rabate,

provigjone të tjera teknike dhe provigjone për policat e sigurimit të jetës ku rreziku i investimit buron nga policmbajtësit.

C. *Dëme të paguara*: Këtu regjistrohen të gjitha dëmet e paguara deri në datën e mbylljes së bilancit.

***D. Shuma të kaluara në risigurim*:** Këtu regjistrohen vetëm shumat e kalimit në risigurim që i takojnë aktivitetit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

E. Totali i shpenzimeve administrative: Këtu regjistrohet shuma totale e pasqyrës analitike të shpenzimeve administrative të kryera për vitin financiar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

LLOGARIA TEKNIKE PËR AKTIVITETIN E SIGURIMIT

Kjo pasqyrë raportohet e veçantë për sigurimin e jetës dhe sigurimin e jo-jetës (dëmeve).

Kolona "Prime të shkruara": Këtu regjistrohen të gjitha primet sipas kontratave të sigurimit, të cilat janë të lidhura tërësisht ose pjesërisht me vitin financiar të mëvonshëm (ose vitet financiare të mëvonshme për sigurimin e jetës). Primet e shkruara do të përfshjnë:

- Primet akoma të shkruara ku llogaritja e primit mund të bëhet vetëm në fund të vitit.

- Primet menjëherë të arkëtueshme,duke përfshirë primet anuiti.

- Primet shtesë, në rastet e arkëtimeve me këste mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe primet shtesë nga policmbajtësit për shpenzimet e lindura nga veprimtaria siguruese.

Në rastet e bashkësigurimit, pjesa që i takon secilit bashkësigurues në totalin e primeve.

- Primet e risigurimit nga cedimi dhe ritrocedimi i shoqërive të sigurimit, duke përfshirë portofolin e risqeve të paskaduara dhe primeve të pafituara.

Pasi janë zbritur:

- Tërheqjet në lidhje me primet e pafituara dhe risqet e paskaduara të kthyera nga cedimi dhe ritrocedimi i shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit.

- Anullimet.

Shumat e mësipërme nuk do të përfshijnë taksat ose shpenzimet të arkëtuara së bashku me primet për llogari të të tretëve.

Kolona" *Të ardhura neto nga investimet"* këtu regjistrohen të ardhurat financiare të siguruara nga shoqëritë e sigurimeve për të gjitha aktivet, neto nga shpenzimet, por për bruto duke përfshirë risigurimet. Kjo shumë i korrespondon totalit të shumave.

Të ardhurat nga investimet përfshijnë :

- Të ardhurat nga interesa pjesëmarrëse.

- Të ardhura nga investimet e tjera (të ardhura nga toka ndërtesa, të ardhura të tjera nga Investimet, vlera të përfituara nga rivlerësimi në investime, fitime të realizuara nga investimet.)

Shpenzimet për investimit përfshijnë:

- Shpenzime për menaxhimin e investimeve.

- Shpenzime për përshtatjen e vlerës së investimeve,

- si dhe humbjet nga realizimi i investimeve.

Këto shuma janë të barabarta me ato të përfshira në llogarinë *"Fitime dhe humbje."*

Të ardhurat nga investimet i referohen totalit të aktiveve në grupin C *"Investime"*. Kjo nënkupton që vlerat e treguara në këtë kolonë përfshijnë:

Të ardhurat e siguruara nga investimi i provigjoneve teknike, ashtu edhe nga investimi i fondeve të shoqërisë.

Fitimet e parealizuara dhe humbjet mund të përfshihen si përjashtim, nëse ato janë llogaritur në pasqyrën "Fitime dhe humbje" të aktivitetit të shoqërisë së sigurimit.

Pavarësisht nga ndarja sipas klasave të sigurimit dhe vendit në të cilin ndodhet rreziku, të ardhurat nga investimet neto ndahen në dy mënyra:

a) Sipas kategorisë në përputhje me territorin ku gjendet rreziku (edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.)

Të ardhurat nga investimet në këtë pasqyrë i korrespondojnë të njëjtit zë në pasqyrën e "Fitimeve dhe humbjeve", sikurse edhe shpenzimet për investime i korrespondojnë pikës të të njëjtit zë po në këtë pasqyrë.

Në përputhje me parimet e regjistrimit të shpenzimeve sipas qëllimit në shpenzimet për investime do të përfshihen edhe shpenzimet e brendëshme administrative që kryhen për menaxhimin e investimeve.

b) Sipas burimit në përputhje me pasqyrën e"Llogarisë së kalimeve në risigurim", kjo ndarje përfshin shumat që lidhen me aktivet që sigurojnë të ardhura financiare. Shoqëria evidenton veç të ardhurat financiare të siguruara nga investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe veç të ardhurave të siguruara nga investimi i aktiveve të tjera të shoqërisë.

Kolona *"Provigjone për primin e pa fituar më 1 janar të vitit financiar"* këtu regjistrohen provigjonet për këtë prim sipas bilancit të 31 dhjetorit të vitit paraardhës. Diferenca midis kësaj kolone dhe kolonës "Provigjone". Për primin e pafituar më 31 dhjetor të vitit financiar, është e barabartë me ndryshimet e provigjonit për primin e pafituar në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Provigjone për dëme më 1 janar të vitit financiar"* këtu regjistrohen Provigjonet (rezervat) për dëmet pezull sipas bilancit të 31 dhjetorit të vitit paraardhës.

Diferenca midis kësaj kolone dhe kolonës "Provigjone për dëme më 31 dhjetor të vitit financiar" është e barabartë me ndryshimet e këtij provigjoni në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Provigjone të tjera teknike më 1 janar të vitit financiar"* këtu regjistrohen të gjitha provigjonet e tjera me përjashtim të provigjoneve (rezervave) të mësipërme, sipas bilancit të 31 dhjetorit të vitit paraardhës. Diferenca midis kësaj kolone dhe kolonës "Provigjone të tjera teknike më 31 dhjetor të vitit financiar" është e barabartë me ndryshimet e këtyre provigjoneve në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Të ardhura të tjera teknike"* këtu regjistrohen të gjitha të ardhurat e tjera teknike, me përjashtim të atyre të specifikuara në këtë pasqyrë.

Kolona *"Kosto e marrjes në sigurim"* këtu regjistrohen shumat që kanë dalë nga pasqyra e "Shpenzimet e marrjes në sigurim" sipas portofolit përkatës.

Kolona *"Shpenzime administrative"* këtu regjistrohen vetëm shpenzimet administrative sipas pasqyrës analitike të këtyre shpenzimeve, pjesë e këtij raportimi të shpërndara sipas portofoleve. Kjo kolonë është e barabartë me totalin e shpenzimeve administrative.

Kolona *"Dëme të paguara"* këtu regjistrohen dëmet e paguara nga shoqëria brenda datës 31 dhjetor të vitit financiar.

Kolona *"Shpenzime të tjera teknike"* këtu regjistrohen të gjitha shpenzimet e tjera me përjashtim të atyre të specifikuara në këtë pasqyrë.

Kolona *"Bilanci teknik"* del si rezultat i diferencës midis dy pasqyrave. Bilanci jep rezultatin për secilin portofol gjatë vitit financiar.

Bilanci teknik = (1+2+3+4+5+6+7) - (8+9+10+11+12+13)

LLOGARIA E KALIMEVE NË RISIGURIM

Kjo pasqyrë është e veçantë për sigurimin e jetës dhe sigurimin e dëmeve.

Kolona "Prime të kaluara në risigurim" këtu regjistrohen të gjitha primet e paguara ose të pagueshme që i takojnë kontratave të risigurimit. Këtu do të përfshihen edhe primet e pafituara dhe risqet e paskaduara të pagueshme me mbylljen e kontratës së sigurimit ose me ndryshimet që mund t'i bëhen kontratës së risigurimit. Nga këto duhet të zbriten tërheqjet që kanë të bëjnë me primet e pafituara dhe rrisqet e paskaduara të marra nga shoqëria e sigurimit.

Shuma i korrespondon zërit *"Prime të kaluara në risigurim"* në pasqyrën "Fitime dhe humbje".

Kolona "Të ardhura neto nga investimet" (pjesa e risiguruesit) këtu regjistrohen shumat e paguara risiguruesit si rezultat i aktiveve të vendosura në dispozicion të/ose të depozituara nga risiguruesi me shoqëritë ceduese të sigurimit. Këto shuma tregojnë që ato janë në llogaritë e vet shoqërisë ceduese të sigurimit.

Në rast se llogaritë e shoqërisë së sigurimit për shpenzimet e investimeve dhe të ardhurat neto të risigurimeve janë pasqyruar në llogarinë "Fitime dhe humbje", ndarja midis shumës bruto dhe atyre neto, që lidhen me kalimet në risigurime pasqyrohen në kthimin e të ardhurave. Nga ana tjeter të gjitha shpenzimet për risigurimet që i takojnë vitit financiar, por që ende nuk janë kryer të përfshihen në këtë kolonë në bazë të parimit të të drejtave të konstatuara.

Kjo kolonë siguron informacionin për primet e pafituara (pjesa e siguruesit) në fillim të vitit financiar.

Kolona *"Provigjone për primin e pafituar (pjesa e risiguruesit) më 1 janar të vitit financiar"* këtu regjistrohen shumat e përgjegjësive që i takojnë risiguruesit, të llogaritura dhe të regjistruara në bilanc më 31 dhjetori të vitit paraardhës. Diferenca midis kësaj kolone dhe kolonës "Provigjone (rezerva) për primin e pafituar më 31 dhjetor të vitit financiar", (pjesa e risiguruesit) është e barabartë me ndryshimet e provigjonit (rezervës) për primet e risigurimit në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Provigjone(rezerva) për dëme (pjesa e risiguruesit) më 1 janar të vitit financiar"* këtu regjistrohen shumat e përgjegjësive që i takojnë risiguruesit, të llogaritura në bilanc më 31 dhjetorit të vitit paraardhës. Diferenca midis kësaj kolone dhe kolonës "Provigjone (rezerva) për dëme më 31 dhjetor të vitit financiar" (pjesa e risiguruesit) është e barabartë më ndryshimet e këtij provigjonit (rezerves) për dëmet e risigurimit në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Provigjone të tjera teknike (pjesa e risiguruesit) më 1 janar të vitit financiar"* këtu regjistrohen shuma e përgjegjësisë që i takon risiguruesit të llogaritura dhe të regjistruara në bilanc më 31 dhjetor të vitit paraardhës. Diferenca midis kësaj kolone dhe kolonës "Provigjone

të tjera teknike më 31 dhjetor të vitit financiar" (pjesa e risiguruesit) duhet të jetë e barabartë me ndryshimet e këtyre provigjoneve të tjera teknike të risigurimit në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Komisione risigurimi dhe fitime nga pjesëmarrja"* këtu regjistrohen të gjitha komisionet e përfituara nga risiguruesi, si dhe fitimi nga pjesëmarrja e përfituar sipas kontratës së risigurimit.

Kolona *"Dëme të paguara"* (pjesa e risiguruesit) këtu regjistrohen dëmet e paguara nga risiguruesi dhe që i korrespondojnë të njëjtit zë në llogarinë "Fitime dhe humbje" të aktivitetit.

Kolona *"Shpenzime të tjera risigurimi"* këtu regjistrohen shpenzimet e kryera, të cilat i takojnë shoqërisë së sigurimit si rezultat i kontratës së nënshkruar prej tyre.

Kolona *"Të ardhura të tjera nga risigurimet"* këtu regjistrohen të tjera të ardhura nga risigurimet, të cilat nuk janë përfshirë në kolona të tjera të kësaj pasqyre.

Bilanci i risigurimit = (1+2+3+4+5+6) - (7+8+9+10+11+12)

PASQYRA "PRIME DHE DËME"

(Mujore dhe progresive në lekë dhe valutë)

Këto pasqyra janë një dokument që i shërben Autoritetit Mbikeqyres Financiar për të nxjerrë konkluzione mbi ecurinë e shoqërisë së sigurimit.

Në kolonën "Primi i shkruar" regjistrohen të gjitha shumat e primeve të kontratave të sigurimit të shkruara gjatë vitit financiar, pavarësisht nga fakti, që ky prim i përket tërësisht apo pjesërisht vitit financiar apo viteve të mëvonshëm.

Në kolonën "Primi i paguar" regjistrohen të gjitha shumat e primeve të arkëtuara nga shoqëritë e sigurimit.

Kolona *"Dëme të raportuara"* këtu regjistrohen dëmet që janë raportuar pranë shoqërisë për të cilat është bërë një vlerësim paraprak, i përafërt nga vetë shoqëria mbi masën e mundshme të pagesës së këtij dëmi, pavarësisht nëse nje pjesë e tyre i takon të përballohet nga risiguruesi.

Kolona *"Dëme të paguara"* këtu regjistrohen të gjtha pagesat e bëra nga shoqëria në lidhje me dëmshpërblimet, pavarësisht se një pjesë e tyre janë përballuar nga risiguruesi. Në këte shumë dëmet pasqyrohen neto, d.m.th. nuk përfshihen shpenzime të tjera që lidhen me dëmet, si p.sh. trajtim dëmi, ekspertizë, etj.

Kolona *"Deme pezull"* këtu regjistrohen dëmet që janë raportuar pranë shoqërisë për të cilat është bërë një vlerësim paraprak, i përafërt nga vetë shoqëria mbi masën e mundshme të pagesës së këtij dëmi, pavarësisht nëse një pjesë e tyre i takon të përballohet nga risiguruesi.

Kolona *"Pjesa e risiguruesit në dëme "*. Këtu shënohet pjesa që i perket risiguruesit në dëmet e raportuara.

Shoqëria për efekt të një raportimi sa më të saktë e të detajuar, duhet që brenda grupeve të sigurimit të përfshijë rreshta të tjera n.q.s. policat që ajo ka lëshuar nuk janë përcaktuar saktësisht në nëndarjet e llojeve të sigurimit të kësaj pasqyre. Në këtë rast kjo do të shoqërohet me sqarimet përkatëse.

Këto pasqyra raportohen pranë autoritetit çdo muaj dhe do të paraqiten mujore dhe progresive.

Për këto pasqyra shoqëria duhet të paraqesë dhe kursin e këmbimit të valutave.

Gjithashtu shoqëritë për grupin 10 *"Përgjegjësi civile ndaj palëve të treta"* do të plotësojnë tabelat M-2, M-3, dhe M-4.

PASQYRA E SHPENZIMEVE TË MARRJES NË SIGURIM

Në kolonën "Komisione të paguara" regjistrohen vetëm komisionet e paguara agjentëve për lëshimin e kontratave të sigurimit.

Kolona *"Shpenzime të tjera të paguara"* këtu regjistrohen të tjera shpenzime të kryera, përveç atyre të agjentëve, të paguar nga shoqëria për marrjen në sigurim, siç janë shpenzimet direkte, si p.sh. shpenzime të emetimit dhe përpilimit të dokumenteve të sigurimit, shpenzime për trajnimin e agjentëve, etj. dhe të tjera shpenzime indirekte siç janë shpenzimet për botimet e njoftimeve, etj.

Në kolonën *"Ndryshimet në kostot e shtyra të marrjes në sigurim"* këtu regjistrohet çdo ndryshim i kostove eventuale të mëparshme të marrjes në sigurim. Këtu përfshihen edhe komisionet e anuluara të agjentëve edhe për ato të cilat shoqëria detyrohet të paguajë, pavarësisht se në momentin e hartimit të kësaj pasqyre nuk e ka kryer ende këtë pagesë.

Në kolonën *"Shpenzime që i përkasin vitit financiar"* regjistrohen shpenzimet e tjera të marrjes në sigurim pavarësisht nëse janë kryer (paguar) apo jo gjatë vitit financiar, por që I takojnë dhe janë në ngarkim të këtij viti. Këtu regjistrohen edhe shpenzime të kryera (paguara) një vit më parë, të cilat janë përfshirë në rubrikën "Parapagime të tjera" të aktivit të bilancit dhe që i takojnë këtij viti financiar.

Ndarja e kostove sipas llojit të sigurimit të bëhet kontratë për kontratë. Megjithatë, për kostot e marrjes në sigurim për të cilat nuk mund të bëhet një ndarje direkte, vetë shoqëria e sigurimit përcakton një mënyrë të ndarjes së tyre. Kjo pasqyrë depozitohet në AMF, bashkëngjitur bilancit vjetor të shoqërisë.

PASQYRA E PROVIGJONEVE SIPAS LLOJIT
DHE GRUPEVE TË AKTIVITETIT, SI DHE DREJTIMET E TYRE

Kjo pasqyrë shërben për të nxjerrë konkluzionet mbi drejtimet e investimit të provigjoneve, sipas grupeve dhe llojeve të policave të sigurimit. Në kolonat bosh midis grupeve vendosen llojet konkrete të policave të sigurimit të atij grupi, që trajtohen nga ana e shoqërisë së sigurimit ndërsa horizontalisht shënohen drejtimet e investimit të provigjoneve që i përkasin secilit grup dhe secilës police sigurimi.

Kjo pasqyrë është pjesë e raportimit tremujor dhe vjetor të shoqërisë së sigurimit.

PASQYRA E INVESTIMEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE

Kjo pasqyrë plotësohet duke marrë në konsideratë provigjonet sipas llojit dhe drejtimet e investimeve, të cilat detyrimisht duhet të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë kufijtë maksimalë të investimeve të pasurive në mbulim të provigjoneve teknike të sigurimit.

Kjo pasqyrë është pjesë e raportimit tremujor e vjetor të shoqërisë së sigurimit.

PASQYRA "LISTA E AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE"

Në këtë pasqyrë shënohen të gjitha aktivet (investimet dhe aktivet e tjera) të vlefshme për mbulimin e provigjoneve të përcaktuara në nenin 105 të Ligjit nr.9267, datë 29.7.2004. Në këtë pasqyrë shënohen në total investimet sipas formularit "Lista e investimeve në mbulim të provigjoneve teknike" ndërsa aktivet e tjera shënohen një për një me emërtimet perkatëse të tyre.

Kjo pasqyrë është pjesë e raportimit tremujor e vjetor të shoqërisë së sigurimit.

PASQYRA E QARKULLIMIT TË MJETEVE MONETARE

Me anën e kësaj pasqyre kontrollohet rrjedhja e parave (CASH), të hyrat e të dalat e mjeteve monetare në shoqërinë e sigurimit dhe arkëtime nga investimet.

Në të hyrat përfshihen arkëtimet nga primet e sigurimit neto (primet bruto minus pjesën e kaluar me risigurim), arkëtimet nga burime të tjera të veprimtarisë së sigurimit dhe arkëtime nga investimet.

Në të dalat perfshihen pagesat për dëmet (pa pjesën e përballuar nga risiguruesi, e cila shënohet në kolonë të veçantë) pagesat për komisione, pagesat për shpenzime administrative, pagesa për dividentë, pagesat për kalimin në investime etj.

Kjo pasqyrë është pjesë e raportimit tremujor e vjetor të shoqërisë së sigurimit.

PASQYRA "INFORMACION PËR RISQET E SIGURIMIT QË U PËRKASIN SENDEVE E PERSONAVE APO PËRGJEGJËSIVE E VLERË TË MADHE DHE TË MARRA PËRSIPËR NGA SHOQËRIA E SIGURIMIT"

Në risqe me vlerë të madhe konsiderohen të gjitha ato rreziqe, vlera e të cilave është jo më e ulët se 30 milionë lekë. Këtu përjashtohet sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike, për të cilat është përcaktuar vlera maksimale e përgjegjësisë. Shoqëritë e sigurimeve paraqesin në autoritetin mbikëqyrjes financiare: emrin e sendit, personit apo përgjegjësisë, vendndodhjen, shumën e sigurimit dhe të gjitha të dhënat e kontratës apo policës së sigurimit, mënyrën e shpërndarjes së rrezikut dhe një kopje të kontratës së sigurimit.

Ky informacion paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare rast pas rasti, brenda 5 ditëve nga marrja e përgjegjësisë.

PASQYRA" INFORMACION PËR DËMET ME VLERA TË MËDHA"

Konsiderohen dëme të mëdha ato që për një rast sigurimi kanë vlerën 10 milionë lekë.

Shoqëria e sigurimit raporton në AMF të dhënat që kanë të bëjnë me objektin apo personin e dëmtuar, vendndodhjen, të dhëna për policën e sigurimit, vlerën e demit, pjesën që ka përballuar shoqëria dhe pjesën që i takon risiguruesit, si dhe dokumente të tjera që i gjykon të arsyeshme Autoriteti.

Ky informacion paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare rast pas rasti, brenda 5 ditëve nga ndodhja e ngjarjes.

Të gjitha dokumentet që përbëjnë llogaridhënien vjetore paraqiten të përshkruara më lart,

paraqiten në Autoritetin e Mbikeqyrjes Financiare brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Dokumentet që përbëjnë llogaridhënien periodike janë:

- Bilanci financiar 3-mujor; 6-mujor; 9-mujor.
- Pasqyra e fitimeve dhe humbjeve 3-mujor; 6- mujor; 9-mujor.
- Pasqyra e qarkullimit të mjeteve monetare 3-mujor; 6- mujor; 9-mujor.
- Pasqyra e llogaritjes së marzhit të aftësisë paguese dhe elementët që e përbëjnë atë.
- Pasqyra analitike e shpenzimeve administrative 3-mujor; 6- mujor; 9-mujor.
- Pasqyra e investimeve të provigjoneve teknike 3-mujor; 6- mujor; 9-mujor.
- Lista e aktiveve në mbulim të rezervave teknike 3-mujor; 6- mujor; 9-mujor.
- Llogaritja e marzhit të aftësisë paguese dhe elementët që e përbëjnë 6-mujor; vjetor.

Këto dokumente paraqiten në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, brenda datës 30 të muajit pasardhës.

Dokumentet që përbëjnë llogaridhënien Pasqyrat M-1P, M-5D, M-2, M-3, M-4 ,M-6,M-7 paraqiten në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të nenit 121 të Ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" ka të drejtë t'u kërkojë shoqërive të sigurimit, informacione periodike, të njëjta me ato vjetore ose më të analizuara ashtu siç e çmon të nevojshëm ai për ushtrimin e mbikëqyrjes së këtyre shoqërive.

Moszbatimi i këtij udhëzimi i bën shoqëritë e sigurimit subjekt i sanksioneve të parashikuara në nenin 165 të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Udhëzuesi dhe formularët bashkëlidhur këtij udhëzimi, janë pjesë përbërëse e tij.

Udhëzimi nr 1, datë 22.12.2004 « Për listen e dokumentave te llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit», shfuqizohet.

Ky Udhëzim miratohet me Vendimin nr 10, datë 08.02.2007 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

UDHËZUES

Mbi mënyrën e plotësimit të formularëve bashkëlidhur

I. Pasqyrat e raportimit të primeve dhe dëmeve.

Ky fomular ka pësuar ndryshime në raport me atë të mëparshëm, përsa i përket zgjerimit të gamës së llojeve të sigurimit, gjithashtu dhe në roportmin e:

a) Primit të shkruar, me të cilin do të kuptojmë gjithë shumat e primeve të kontratave të sigurimit të shkruara gjatë vitit financiar, pavarësisht faktit që ky prim i përket apo pjesërisht vitit financiar apo një të mëvonshmi.

b) Primi i paguar, me të cilin do të kuptojmë shumën e primit të arkëtuar nga shoqëria e sigurimit.

c) Dëmet e raportuara, me të cilën do të kuptojmë dëmet që janë raportuar pranë shoqërisë, për të cilat është bërë një vlerësim paraprak, i përafërt nga vetë shoqëria mbi masën e mundshme të pagesës së këtij dëmi.

d) Dëme të paguara, me të cilën do të kuptojmë pagesat e bëra nga shoqeria në lidhje me dëmshpërblimet Në këtë shumë do të pasqyrohen neto d.m.th. nuk do të përfshihen shpenzime të tjera që lidhen me dëmet si psh. trajtim dëmi, ekspertizë, etj.

Shoqëria për efekt të një raportimi sa më të saktë është e lejuar që Brenda grupeve të sigurimit të përfshijë rreshta te tjerë n.q.s. policat që ajo ka lëshuar nuk e gjejnë veten

saktësisht në nendarjet e llojeve të sigurimit të kësaj pasqyre. Në këtë rast kjo do të shoqërohet me sqarimet përkarëse.

Pasqyra do të raportohet në AMF çdo muaj dhe do të paraqitet jo vetëm mujore por dhe progressive. Gjithashtu, pasqyra do të plotësohet e veçantë për çdo lloj valute si psh. Në mijë lekë ; USD ; EURO, etj.

Pasqyra e raportimit ne lekë do te përmbajë të gjitha të dhënat e mësipërme, pavarësisht nga lloji i monedhës me të cilën është arkëtuar primi apo është paguar dëmi (duke konvertuar valutën e huaj me një kurs mesatar i cili shënohet në fund të pasqyrës) ndërsa pasqyrat në valutë plotësohen për të dhënat e mësipërme, vetëm më rastet kur janë arkëtuar prime apo janë paguar dëme me monedha në fjalë.

Gjithashtu shoqëritë për grupin 10 *"Përgjegjësi civile ndaj palëve të treta"* do ta plotësojnë atë veçmas, në mënyrë më analitike, përsa i përket afateve të lëshimit të kontratave brenda këtij grupi.

II. Pasqyra e shpenzimeve të marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim kanë të bëjnë me shpenzimet që vijnë si rezultat i lidhjeve të kontratave të sigurimit. Ato do të perfshijnë njëkohësisht si kostot direkte të tilla si komisionet e marrjes në sigurim të përfituara nga ndërmjetësit (kolona e parë e formularit), apo kosto të tilla që kanë të bëjnë me reklamat dhe fushatat publicitare apo dhe shpenzimet administrative të lidhura me proçesin e lëshimit të policave.

Shpenzimet e marrjes në sigurim do të perfshijnë komisionet e ripërtëritjes së kontratave të sigurimit.

Është e rëndësishme të kuptohet që në kostot e marrjes në sigurim janë jo ato që janë paguar aktualisht gjatë vitit financiar por ato që i takojnë (që janë në ngarkim të)këtij viti financiar (kolona e katërt e formularit). Është gjithashtu e rëndësishme të merret në konsideratë dhe çdo ndryshim i kostove eventuale të marrjes në sigurim të mëparshëm (kolona e tretë e formularit).

Ndarja e këtyre kostove sipas llojit të sigurimit, duhet te bëhet kontratë më kontratë. Megjthatë për kostot e marrjes në sigurim për të cilat nuk mund të bëhet një ndarje direkte vetë shoqëria e sigurimit mund të përcaktojë një mënyrë të ndarjes së tyre.

Kjo pasqyrë depozitohet në AMF, bashkëlidhur bilancit vjetor të shoqërisë.

III. Llogaritja e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese dhe elementët që përfshihen në të.

Kjo llogaritet konform Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo-jetës".

Ajo llogaritet veç për aktivitetin e jo-jetës dhe veç për atë të jetës.

Megjthatë rreziqet aksesore të aktivitetit të jetës si rreziqet e dëmtimeve trupore që përfshijnë paaftësinë për punë, vdekjen aksidentale apo invaliditetin e rrjedhur nga aksidenti apo sëmundja, mund të përfshihen në llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguesetë aktivitetit të dëmeve.

Kjo pasqyrë depozitohet në AMF, bashkëlidhur bilancit vjetor të shoqërisë.

IV. Pasqyra e shpenzimeve të përgjithshme administrative.

Kjo pasqyrë plotësohet sipas zërave të përcaktuar në këtë pasqyrë. Megjithatë shoqëritë për shpenzime të tjera të përgjithshme të papërmendura në këtë pasqyrë mund të shtojnë zëra të tjerë duke ruajtur klasifikimin ne grupe. Në raste të tilla, shoqëria e sigurimit duhet të bëjë dhe shpjegimet përkatëse.

Kjo pasqyrë depozitohet në AMF, bashkëlidhur bilancit vjetor të shoqërisë.

Elementet që përfshihen në nivelin e kërkuar dhe aktual të aftësisë paguese

Metodat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të shoqerisë së sigurimit janë si më poshtë:

I.Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për shoqërine e sigurimit që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jo-jetës

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese është vlera më e madhe e përftuar nga llogaritjet me metodën me bazë primet dhe metodën me bazë dëmet si më poshtë:

Llogaritja me bazë primet

$a =$	(+)	Të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e drejtëpërdrejta të sigurimit në vitin e fundit ushtrimor
	(+)	Të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim në vitin e fundit ushtrimor
	(-)	Taksat dhe tatimet që i zbriten (debitojnë) të ardhurat nga primet e sigurimit të dëmeve (jo-jetës)

$a_1 =$	Pjesa e shumës "a" që nuk e kalon vleftën $1\ miliard\ leke$.
$a_2 =$	Pjesa e shumës "a" që e kalon vleften $1\ miliard\ leke\ \ (a > 1\ miliard\ leke)$

$b =$	***Koefiçienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhuarave,*** i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës në mes të rreziqeve aktuale dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

$b_1 =$	Koefiçienti i pasigurisë i llogaritur duke marrë për bazë shumën "a_1" ka vlerën 0.18
$b_2 =$	Koefiçienti i pasigurisë i llogaritur duke marrë për bazë shumën "a_2" ka vlerën 0.16

$$Raporti\ i\ risigurimit : c = \frac{Dëmet\ (përgjegjësitë)\ e\ mbajtura\ dhe\ ato\ të\ kaluara\ në\ risigurim}{Dëmet\ (përgjegjësitë)\ e\ mbajtura\ \{pa\ pjesën\ e\ risigurimeve\}}$$

Dëmet (përgjegjësitë) të mbajtura dhe të kaluara në risigurim: Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shuma e shtesave në provigjonet teknike të dëmeve, pa zbritur shumat e dëmeve dhe shtesave të provigjoneve teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Dëmet (përgjegjësitë) të mbajtura {pa pjesën e risigurimeve}: Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shuma e shtesave në provigjonet teknike të dëmeve, duke zbritur shumat e dëmeve dhe shtesave në rezerva teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Nëse $c < 0.50$, për efekt llogaritjeje do të merret vlera prej 0.50.

Vlera sipas llogaritjes së parë: $(a_1 x b_1 + a_2 x b_2)xc$

Llogaritja me bazë dëmet:

$a =$	(+)	Shuma e pagesës së dëmeve që lidhen me veprimet e drejtëpërdrejta të sigurimeve dhe të atyre që lidhen me marrjen në risigurim të tre apo shtatë vitet e fundit, duke zbritur pjesën e dëmeve (përgjëgjësive) të kaluara në risigurim.
	(+)	Rezervat për dëmet në fuqi (të pazgjidhura) deri në fund të periudhës mesatare.
	(-)	Rezervat për dëmet në fuqi (të pazgjidhura)në fillim të periudhës mesatare.

$b = \frac{a}{3}$ *ose* $b = \frac{a}{7}$ në varësi të periudhës mesatare përkatësisht tre dhe shtatë vite

Periudha mesatare është zakonisht **tre vjet**, por nëse më shumë se 60 % e të ardhurave nga primet e një aktiviteti sigurimesh bashkërisht ose të ndara rezultojnë nga kontrata sigurimi që lidhen me rrezikun e dëmeve të kreditit, ngricave, akullit, stuhive, tërmetit, periudha mesatare do të jetë **shtatë** vjet.

$b_1 =$	Pjesa e shumës "b" që nuk e kalon vleftën *750 milion lekë*.
$b_2 =$	Pjesa e shumës "b" qe e kalon vleften *750 milion lekë (b > 750 milion lekë)*

$c =$	***Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e dëmeve,*** i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe të rrezikut të marrë në konsideratë për llogaritjet.

$c_1 =$	Koefiçienti i pasigurisë i llogaritur duke marrë për bazë shumën "b_1" ka vlerën 0.26
$c_2 =$	Koefiçienti i pasigurisë i llogaritur duke marrë për bazë shumën "b_2" ka vlerën 0.23

Raporti i risigurimit : $d = \frac{Dëmet\ (përgjegjësitë)\ e\ mbajtura\ dhe\ ato\ të\ kaluara\ në\ risigurim}{Dëmet\ (përgjegjësitë)\ e\ mbajtura\ \{pa\ pjesën\ e\ risigurimeve\}}$

Nëse $d < 0.8$ *, vlera që do të merret në konsideratë për efekt llogaritjeje është* 0.8

Vlera sipas llogaritjes së dytë: $(b_1 x c_1 + b_2 x c_2) x d$

II. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për shoqërinë e sigurimit që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës.

1. Përcaktimi i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës që nuk lidhen me fondet e investimeve.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet të cilat i përkasin klasave të sigurimit të Jetës, të ndryshme nga Klasa 21 e nenit 7 të Ligjit 9267 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe

ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", datë 29.07.2004 "Sigurim jete i lidhur me fonde të investimeve", është shuma e dy rezultateve që dalin nga llogaritja e parë dhe llogaritja e dytë si më poshtë vijon:

Llogaritja e parë

(Për kontratat e sigurimit të jetës të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me fondet e investimit)

$a =$	Shuma e provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe ato të marra në risigurim, pa zbritur provigjonet matematike që i përkasin pjesës së ceduar në risigurim.
$b =$	Shuma e provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe ato të marra në risigurim, pasi zbriten provigjonet matematike që i përkasin pjesës së ceduar në risigurim

$$Raporti\ i\ risigurimit : c = \frac{b}{a}$$

Nëse $c < 0.85$*, vlera që do të merret në konsideratë për efekt llogaritjeje është* 0.85

$d =$	***Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e përfitimit nga investimet,*** i cili është vlera maksimale e diferencës midis llogaritjeve dhe përfitimit aktual në investime, kjo vlerë është e barabartë me 0.04.

Vlera sipas llogaritjes së parë *: axcxd*

Llogaritja e dytë:

a_1	Totali jo negativ, vlera totale e kapitalit të rrezikuar për kontratat individuale të sigurimit të jetës (duke mos zbritur vlerën e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim), të cilit i zbritet totali i vlerës së kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi 5 vjet).
a_2	Totali jo negativ, i vlerës së kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër, për një periudhë mbi tre vjet, por jo më shumë se pesë vjet (që nuk i është zbritur pjesa e vlerës së kapitalit të rrezikuar që i takon pjesës në risigurim)
a_3	Totali jo negativ, total i shumave të kapitaleve të rrezikuara për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër që nuk e kalojnë periudhën prej tre vjetësh, (duke mos zbritur vlerën e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së kaluar në risigurim)

b_1	Totali jo negativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar për kontratat individuale të sigurimit të jetës (duke zbritur pjesën e vlerës së kapitalit të rrezikuar që i takon pjesës së dhënë në risigurim), të cilit i zbritet totali i vlerës neto të kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi 5 vjet).
b_2	Totali jo negativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër dhe kontrata e sigurimit të jetës, me një periudhë mbi tre vjet, por jo më shumë se 5 vjet (duke zbritur pjesen e vlerës së kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim).
b_3	Totali jo negativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër, për një periudhë që nuk i kalon tre vjet (duke zbritur vlerën e kapitalit të rrezikuar që I përket pjesës së kaluar në risigurim).

Vlera e kapitalit të rrezikuar: Shuma e sigurimit që duhet të paguajë shoqëria e sigurimit, në rast vdekje të ndodhur në kohën e përcaktimit të kërkesave për nivelin e kërkuar të marzhit të aftesisë paguese, e reduktuar nga shuma e provigjoneve matematike të krijuara deri në atë datë në lidhje me sigurimin e dhënë. (Kur llogaritet niveli i kërkuar i aftësisë paguese, nuk mund të merret në konsideratë vlera negative e kapitalit të rrezikuar).

$$Raporti\ i\ risigurimit: c = \frac{(b_1 + b_2 + b_3)}{(a_1 + a_2 + a_3)}$$

Nëse $c < 0.50$*, vlera që do të merret në konsideratë për efekt llogaritjeje është* 0.50

d_1	Koeficienti i pasigurisë së rrezikut të vdekjes për kontratat e sigurimit të jetës, me përjashtim të kontratave të sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi 5 vjet). Vlera e tij është 0.003
d_2	Koefiçienti i pasigurisë për rastet e vdekjes në lidhje me kontratat e sigurimit të jetës me afat më të gjatë se tre vjet, por jo më të gjatë se pesë vjet. Vlera e tij është 0.0015
d_3	Koefiçienti i pasigurisë për rrezikun e vdekjes për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër, afati i të cilave nuk i kalon tre vjet. Vlera e tij është 0.001

$e_1 = a_1 x c x d_1$
$e_2 = a_2 x c x d_2$
$e_3 = a_3 x c x d_3$

Vlera sipas llogaritjes së dytë: $e_1 + e_2 + e_3$

Niveli i kërkuar të aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës që nuk lidhen me fondet e investimeve: *llogaritja e parë + llogaritja e dytë*

2.Përcaktimi i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jo jetës që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës

$a =$	(+)	Të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e drejtëpërdrejta të sigurimit në vitin e fundit ushtrimor
	(+)	Të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim në vitin e fundit ushtrimor
	(-)	Taksat dhe tatimet që i zbriten (debitojnë) të ardhurat nga primet e sigurimit të dëmeve (jo-jetës)

$a_1 =$	Pjesa e shumës "a" që nuk e kalon vleftën $1\ miliard\ leke$.
$a_2 =$	Pjesa e shumës "a" qe e kalon vleften $1\ miliard\ leke\ \ (a > 1\ miliard\ leke)$

$b =$	Koefiçienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhuarave, i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës në mes të rreziqeve aktuale dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

$b_1 =$	Koefiçienti i pasigurisë i llogaritur duke marrë për bazë shumën "a_1" ka vlerën 0.18
$b_2 =$	Koefiçienti i pasigurisë i llogaritur duke marrë për bazë shumën "a_2" ka vlerën 0.16

$$Raporti\ i\ risigurimit : c = \frac{Dëmet\ (përgjegjësitë)\ e\ mbajtura\ dhe\ ato\ të\ kaluara\ në\ risigurim}{Dëmet\ (përgjegjësitë)\ e\ mbajtura\ \{pa\ pjesën\ e\ risigurimeve\}}$$

Dëmet (përgjegjësitë) të mbajtura dhe të kaluara në risigurim: Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shuma e shtesave në provigjonet teknike të dëmeve, pa zbritur shumat e dëmeve dhe shtesave të provigjoneve teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Dëmet (përgjegjësitë) të mbajtura {pa pjesën e risigurimeve}: Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shuma e shtesave në provigjonet teknike të dëmeve, duke zbritur shumat e dëmeve dhe shtesave në rezerva teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Nëse $c < 0.50$, për efekt llogaritjeje do të merret vlera prej 0.50.

Niveli i kërkuar i aftesisë paguese për kontratat e sigurimit të jo jetës që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës: $(a_1 x b_1 + a_2 x b_2) x c$

3.Përcaktimi i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës te lidhura me fondet e investimeve.

Niveli i këkuar i aftëisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës të lidhura me fonde të investimit, është shuma e dy rezultateve që dalin nga llogaritja e parë dhe llogaritja e dytë si më poshtë vijon:

Llogaritja e parë

a_1	Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe ato që lidhen me marrjen në risigurim, pa zbritur provigjonet që i përkasin pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku i investimeve është marrë përsipër nga siguruesi.
a_2	Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe veprimtaritë e marrjes në risigurim, pa zbritur provigjonet që i përkasin pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku i investimeve nuk është marrë përsipër nga siguruesi, kur periudha e transaksioneve i kalon pesë vjet dhe shuma e shpenzimeve administrative është fiksuar për më shumë se pesë vjet.
b_1	Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta veprimtaritë e marrjes në risigurim, pas zbritjes së provigjoneve që i takojnë pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku i investimeve është marrë nga siguruesi.
b_2	Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe veprimtaritë në lidhje me risigurimet, pas zbritjes së rezervave qe I takojnë pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku nuk është marrë nga siguruesi, dhe periudha e transaksionit është me e gjatë së pesë vjet dhe kur shuma e shpenzimeve administrative është përcaktuar për më shumë se pesë vjet.

$$Raporti\ i\ risigurimit: c = \frac{(b_1 + b_2)}{(a_1 + a_2)}$$

Nëse $c < 0.85$*, vlera që do të merret në konsideratë për efekt llogaritjeje është* 0.85

d_1, d_2	**Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e përfitimit nga investimet,** i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis interesit të llogaritur dhe atij aktual të investimeve. Vlerat e tyre janë: $d_1 = 0.04$ dhe $d_2 = 0.01$.

Vlera sipas llogaritjes së parë : $(a_1 x c x d_1) + (a_2 x c x d_2)$

Llogaritja e dytë

Kjo do të llogaritet vetëm për ato kontrata sigurimi ku siguruesi merr përsipër rrezikun e vdekjes.

a	Totali jo negativ, totali i vlerës së kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të lidhura (të cilës nuk i zbritet pjesa e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim)
b	Totali jo negativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të lidhura (të cilës i zbritet pjesa e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim).

$$Raporti\ i\ risigurimit : c = \frac{b}{a}$$

Nëse $c < 0.50$, për efekt llogaritjeje do të merret vlera prej 0.50.

$d =$	***Koeficienti i pasigurisë në rrezikun e vdekjes për kontratat e sigurimit të jetës***, me përjashtim të kontratave të sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi pesë vjet). Ky koeficient ka vlerën $d = 0.003$.

Vlera sipas llogaritjes së dytë : $axcxd$

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës që lidhen me fondet e investimeve: *llogaritja e parë + llogaritja e dytë*

Totali i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për aktivitetin e sigurimit të jetës =

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës (I)

+ Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për kontratat e sigurimit te jo jetës që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës (II)

+ Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për kontratat e sigurimit të jetës që lidhen me fondet e investimeve (III).

2.Elementet që përfshihen në marzhin e aftësisë paguese

1. Kapitali aksioner i paguar (derdhur)
2. Rezervat që nuk u korrespondojnë përgjegjësive të marrjes në sigurim:
   - Rezerva ligjore.
   - Rezerva të lira.
3. Rezerva e sigurisë, që nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave të sigurimit në fuqi ose atyre që kanë qenë në fuqi.

4. Fitime të mbartura:
   - Te mbartura nga vitet e mëparshme.
   - Fitime të pashpërndara për vitin ushtrimor.
5. Me kërkesën e shoqerisë së sigurimit dhe paraqitjen prej saj të provave të mjaftueshme, rezervat (plusvlerat) e fshehura që rrjedhin nga nënvlerësimi i aktiveve, për aq sa keto rezerva (plusvlera) të fshehura nuk kanë natyrë jo të zakonshme.
6. Vlera e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara sipas bilancit.
7. Rezerva që rezultojnë nga rivleresimi i aktiveve.

Totali = 1 + 2 + 3 + 4 + 5 – 6 +7

SHOQËRIA ..... **AKTIVITETI I JO-JETËS**

PASQYRA E DËMEVE TË MUAJIT KORRIK

Kl	**Lloji i produktit**	**Nr. total i dëmeve**	**Dëme të Raportuara**			**Nr. Dëmeve të paguara**	**Dëme të paguara**			**Nr. Dëmeve pezull**	**Dëme pezull**			**Nr**	**Pjesa e Risiguruesit në Dëme**		
			000/ Leke	**USD**	**EURO**		**000/ Leke**	**USD**	**EURO**		**000/ Leke**	**USD**	**EURO**		**000/ Leke**	**USD**	**EURO**
		1	**2**	**3**	**4**		**5**	**6**	**7**		**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**
A	**Sig aksid dhe shënd**																
A1	Sig aksidenteve																
A2	Sig shënd etit																
A3	Sig i detyruar i udhëtarëve																
B	**Sig Motorike**																
B1	Sig.i vete mjetit motorik (Kasko)																
B2	TPL																
B3	Karton jeshil																
B4	Provizore																
B5	Kufitare																
C	**Sig Marinës**																
C1	Anijet																
C2	Pergjegjësi civile anije																
D	**Sig Avioneve**																
D1	Avionet																
D2	Pergjegjësi civile avionet																
E	**Zjarri e dëmtimet në pronë**																
E1	Zjarri dhe rreziqet shtesë																
E2	Vjedhje																
E3	Bujqësi e blegtori																
E4	Pasuri të tjera(Komplekse)																
F	**Mallrat në transport**																
F1	Mallra në transport nga anijet																
F2	Mallra ne transport nga Avionet																

F3	Mallra në transport të tjera																
G	**Sig Pergjegjësive**																
G.1	Sig i pergjegjësive																
G.2	Inxhinierike																
H	**Sig Kreditit**																
H.1	Rreziku i paaftësisë paguese																
H.2	Kreditë e eksportit																
H.3	Kreditë me këste																
H.4	Kreditë hipotekare																
H.5	Kredi bujqësore																
H.6	Kredi të tjera																
I	**Sig Garancive**																
I.1	Sigurimi i garancive																
I.2	Sigurim garanci ofertë																
I.3	sigurim garanci kontratë																
J	**Mjete që lëvizin mbi shina**																
K	**Sig.i humbjeve financiare**																
	TOTALI																

SHOQËRIA..... **AKTIVITETI I JO-JETËS**

PASQYRA E PRIMEVE TË SIGURIMIT TË Periudhës/ Muajit .....

Kl	**Lloji i Produktit**	**Numri i kontr. lidhura**	**TOTAL 000/ Lekë**	**PRIME TËSHKRUARA BRUTO**			**Primi mesatar**	**Diferenca „„„"„„„**	**Ndryshimi në %**
				TOTAL 000/ Lekë	**USD**	**EURO**	**000/ Lekë**		
A	**Sig aksid dhe shënd**	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**			**2**
A1	Sig aksidenteve								
A2	Sig shëndetit								
A3	Sig i detyruar i udhëtarëve								
B	**Sig Motorike**								
B1	Sig.i vete mjet.motorik (Kasko)								
B2	TPL								
B3	Karton jeshil								
B5	Kufitare								
C	**Sig Marinës**								
C1	Anijet								
C2	Pergjegjësi civile anije								
D	**Sig Avioneve**								
D1	Avionet								
D2	Pergjegjësi civile avionet								
E	**Zjarri e dëmtimet në pronë**								
E1	Zjarri dhe rreziqet shtesë								

E2	Vjedhje								
E3	Bujqësi e blegtori								
E4	Pasuri të tjera + p.KomplekseBBB								
F	**Mallrat në transport**								
F1	Mallra në transport nga aniijet								
F2	Mallra në transport nga Avionet								
F3	Mallra në transport të tjera								
G	**Sig Pergjegjësive**								
G.1	Sig i pergjegjësive								
G.2	Inxhinierike								
H	**Sig Kreditit**								
H.1	Rreziku i paaftësisë paguese								
H.2	Kreditë e eksportit								
H.3	Kreditë me këste								
H.4	Kreditë hipotekare								
H.5	Kredi bujqësore								
H.6	Kredi të tjera								
I	**Sig Garancive**								
I.1	Sig. i garancive(Mj. Monet.+CIS&CIT)								
I.2	Sigurim garanci ofertë								
I.3	Sigurim garanci kontratë								
J	**Mjete që levizin mbi shina**								
K	**Sig.i humbjeve financiare**								
	TOTALI								

SHOQËRIA..... **AKTIVITETI I JETËS**

PASQYRA E PRIMEVE TË SIGURIMIT TË Periudhës/ Muaji .....

Tabela M - 5P

KI	**Lloji i Produktit**	**Numri i kontr. lidhura**	**TOTAL 000/ Lekë**	**PRIME TË SHKRUARA**			**TOTAL 000/ Lekë**	**PRIME TË ARKËTUARA**		
				000/Lekë	**USD**	**EURO**		**TOTAL 000/Lekë**	**USD**	**EURO**
		1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**
	SIG. JETËS									
1	Jetë - Vdekje									
2	Kreditori									
3	Nxënësi e Studenti									
4	Depozitori									
5	Jeta në Grup									
6	Jetë e Kombinuar									
7	Jeta me Kursim									
8	Jeta me Studentin									
9	Jeta me Udhëtarët									
11	Martesë - Lindje									
12	Sig që lidhen me fond ivestimi									
13	Administrimi i Fondeve Kolektive									
	TOTALI									

M - 5D

SHOQËRIA..... **AKTIVITETI I JETËS**

PASQYRA E DËMEVE TË Periudhës / Muaji .....

Nr.	Lloji i Produktit	Nr.	Dëme të Raportuara			Nr. Dëmeve të paguara	Dëme të paguara			Nr. Dëmeve perzull	Dëme pezull			Nr.	Pjesa e Risiguruesit në Dëme		
			000/ Leke	USD	EURO		000/ Leke	USD	EURO		000/ Leke	USD	EURO		000/ Leke	USD	EURO
		1	2	3	4		5	6	7		8	9	10	11	12	13	14
	SIG. JETËS																
1	Jetë - Vdekje																
2	Kreditori																
3	Nxënësi e Studenti																
4	Depozitori																
5	Jeta në Grup																
6	Jetë e Kombinuar																
7	Jeta me Kursim																
8	Jeta me Studentin																
9	Jeta me Udhëtarët																
10	Martesë - Lindje																
11	Sig që lidhen me fond investimi																
12	Administrimi i Fondeve Kolektive																
	TOTALI																

M-2

PASQYRA PËR KONTRATAT E SIGURIMIT TPL E PROVIZOR TË MUAJIT .....

Dega.....

Kl	Lloji i Produktit	Gjendj në fillim	Furniz. muajit	Numri i kontr. Lidhur	Primi i sigurimit arkëtuar	Dublikate		Plotësuar gabim	Numri i kontr. zgjidh.	Primi i sigurimit i kthyer	Kthime mujore	Gjendja në fund	Primi i sigurimit neto
					000/ Lekë	Nr	000/ Lekë			000/ Lekë			000/ Lekë
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
I	**TPL**												
A	Motoçikletë												
B1	Autoveturë												
B2	Furgon												
C1	Autobuz												
D1	Kamionçinë												
D2	Kamion												
E	Rimorkio												
F	Mjete bujqësore												
G	Zjarrfikëse												
	TOTALI I												

M-4

SHOQËRIA.....

PASQYRA PËR KONTRATAT E SIGURIMIT Kartonit Jeshil TË MUAJIT .....

Dega.....

Lloji i Produktit	Gjendj në fillim	Furniz. i muajit	Numri i kontr. lidhura	Primi i Arkëtuar	Dublikatë			Plotësuar gabim	Numri i kontr. zgjidh.	Primi i sig. i kthyer	Kthime mujore	Gjendj në fund	Primi i sigurimit
				EURO	Nr	Lekë	EURO			EURO			EURO
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
15 ditore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
1 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
2 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
3 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
4 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
5 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													

Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
6 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
7 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
8 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
9 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
10 mujore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
Vjetore													
Autovetura													
Kamion deri në 35 kv													
Kamion mbi 35 kv													
Autobuzë													
Rimorkio													
Të tjera													
TOTALI (I-XII)													

Shoqëria e Sigurimeve .....

TË DHËNAT PËR DËMET ME VLERË MBI 10 MILION LEKË Muaji .....

M-7

	EMËRTIMI	Vlera përafërt e dëmit	Objekti i dëmtuar	Vendi i ndodhjes së dëmit	Numri dhe data e kontratës së sigurimit	Vlera e dëmit që i takon të paguajë siguruesi	Vlera e dëmit që i takon të paguajë risiguruesi	Shuma e paguar
A	**Sig.aksidenteve dhe shëndetit**							
1	Sigurimi aksidenteve							
	Sigurimi aksidenteve personale							
2	Sigurimi i shëndetit							
	Sigurimi detyrueshëm i udhëtarëve							
	Sigurimi shëndetit në udhëtim							
B	**Sigurimet motorike**							
1	Mjete tokësore							
	Sigurimi kasko							
2	Pergj.civile nga sigurimi automj.							
	TPL							
	Kartoni Jeshil (në euro)							
	Sigurimi kufitar							
	Sigurimi provizor							
C	**Sigurimi i marinës dhe transportit**							
	Mjete lëvizëse mbi shina							
	Sigurimi anijeve							
	Mallra gjatë transportit							
	Pergj.civile për anijet							
C	**Sigurimi avioneve**							
	Avionet							
	Pergj.civile per avionet							
D	**Zjarri dhe forcat e natyrës**							
	Zjarri dhe forcat e natyrës							
	Dëme të tjera të pasurisë							
DH	**Sigurimi përgj.civile të përgjithshme**							
	Sigurimi përgj.civile të përgjithshme							
E	**Sigurimi i kreditit dhe garancisë**							
1	Sigurimi i kreditit							
2	Sigurimi i garancisë							
	TOTALI							

Akt Rakoderimet

KI	Lloji i Produktit	LEKË					USD				EURO				LEKË			
		Numri total i kontratave të lidhura	Numri i kontratave të lidhura	Prime të arkëtuara	TVSH e mbledhur	Totali	Numri i kontratave të lidhura	Prime të arkëtuara	TVSH e mbledhur	Totali	Numri i kontratave të lidhura	Prime të arkëtuara	TVSH e mbledhur	Totali	Numri i kontratave të anulluara	prime të kthyera	TVSH e kthyer	Totali
A	**Sig aksid dhe shend**																	
A1	Sig aksidenteve																	
A2	Sig shëndetit																	
A3	Sig i detyruar i udhëtarëve																	
B	**Sig Motorike**																	
B1	Sig.i vete mjet. motorik (Kasko)																	
B2	TPL																	
B3	Karton jeshil																	
B5	Kufitare																	
C	**Sig Marinës**																	
C1	Anijet																	
C2	Pergjegjesi civile anije																	
D	**Sig Avioneve**																	
D1	Avionet																	
D2	Pergjegjësi civile avionet																	
E	**Zjarri e dëmtimet në pronë**																	
E1	Zjarri dhe rreziqet shtesë																	
E2	Vjedhje																	
E3	Bujqësi e blegtori																	
E4	Pasuri të tjera + p.Komplekse BB B																	
F	**Mallrat në transport**																	
F1	Mallra në transport nga anijet																	
F2	Mallra në transport nga Avionet																	
F3	Mallra në transport të tjera																	
G	**Sig Pergjegjësive**																	
G.1	Sig i pergjegjësive																	
G.2	Inxhinierike																	
H	**Sig Kreditit**																	
H.1	Rreziku i paaftësisë paguese																	
H.2	Kreditë e eksportit																	
H.3	Kreditë me këste																	
H.4	Kreditë hipotekare																	
H.5	Kredi bujqësore																	
H.6	Kredi të tjera																	
I	**Sig Garancive**																	
I.1	Sig. i garancive (Mj.Monet. +CIS&CIT)																	
I.2	Sigurim garanci ofertë																	
I.3	Sigurim garanci kontratë																	
J	**Mjete që levizin mbi shina**																	
K	**Sig.i humbjeve financiare**																	
	TOTALI																	

USD				EURO				LEKË				USD				EURO			
Numri i kontratave të anulluara	Prime të kthyera	TVSH e kthyer	Totali	Numri i kontratave të anulluara	Prime të kthyera	TVSH e kthyer	Totali	Numri i kontratave në fund të periudhës	Prime në fund të periudhës	TVSH në fund të periudhës	Totali	Numri i kontratave në fund të periudhës	Prime në fund të periudhës	TVSH në fund të periudhës	Totali	Numri i kontratave në fund të periudhës	Prime në fund të periudhës	TVSH në fund të periudhës	Totali

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E UDHEZIMIT "MBI RREGULLAT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT, SHOQËRIVE TË BROKERIMIT NË KUADRIN E TRANSPARENCËS NDAJ PUBLIKUT DHE MBROJTJEN KONSUMATORE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzimit "Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

U D H Ë Z I M

MBI RREGULLAT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT, SHOQËRIVE TË BROKERIMIT NË KUADRIN E TRANSPARENCËS NDAJ PUBLIKUT DHE MBROJTJEN KONSUMATORE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 11, datë 08.02.2007

Baza ligjore:

Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të Kreut X, nenit 75, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

1. Objekti i këtij udhëzimi është:

i) Përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit dhe për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmshpërblimeve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera.

ii) Përcaktimin e rregullave për dhënien e informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.

Shoqëria e sigurimit publikon të dhënat mbi veprimtarinë e saj sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Transparenca ndaj publikut.

2. Informacioni i publikuar nga shoqëria e sigurimit duhet :

a) të jetë i përshtatshëm për të bërë të mundur marrjen e një vendimi nga publiku;

b) të jepet në kohë dhe të jetë i përditësuar;

c) të jetë i besueshëm dhe të shërbejë si bazë për marrjen e një vendimi nga publiku;

d) të jetë i disponueshëm për të gjithë dhe pa kosto;

e) të jetë i plotë dhe i kuptueshëm për të bërë të mundur krijimin e një opinioni sa më të saktë për tregun e sigurimeve;

f)të jetë i krahasueshëm midis shoqërive të ndryshme të sigurimit dhe i vazhdueshëm në kohë.

3. Shoqëria e sigurimit publikon një raport vjetor, i cili përfshin raportin vjetor financiar dhe të dhëna të tjera të përfshira në këtë udhëzim. Ky raport publikohet, jo më vonë së gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

4. Raporti vjetor financiar përfshin:

a) Bilancin vjetor.

b) Llogarinë fitim-humbje.

c) Lëvizjen e mjeteve monetare.

d) Llogaria e fitime dhe humbje për veprimtarinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

e) Aftësinë paguese aktuale.

f)Raportin përmbledhës për shoqërinë e sigurimit të përgatitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar.

5. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të këtij udhëzimi, raporti përfshin :

a) ndarjen e portofolit të investimeve sipas kategorive të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) të dhëna vjetore mbi primet dhe dëmet sipas klasave ku ka ushtruar aktivitet;

c) vlerën, kohën dhe natyrën e përgjegjësive përfshirë këtu ato ekzistuese dhe të pritshme (do të jepet në total të përgjegjësive.);

d) tregues bazë (raporte) që rrjedhin nga të dhënat e llogarisë fitim-humbje dhe të dhënat e qarkullimit të mjeteve monetare, siç janë raporti dëme-prime, raporti i kombinuar dëme-prime që llogaritet si raport i dëmeve të ndodhura, plus shpenzime të përgjithshme ndaj primeve neto të shkruara, raportin e aftësisë paguese që llogaritet si raport i primeve të fituara duke zbritur primet e kaluara në risigurim ndaj kapitalit të shoqërisë, raporti i pagimit të dëmeve që llogaritet si raport i dëmeve të paguara ndaj dëmeve të ndodhura;

e) raportimi i numrit dhe vlerës së dëmeve të paguara dhe të ndodhura.

6. Të dhënat mbi veprimtarinë bazë të shoqërisë dhe drejtimin e saj përfshijnë:

a) strukturat drejtuese të shoqërisë dhe listën emërore të tyre;

b) statusin ligjor të shoqërisë së sigurimit, apo të grupit në të cilin ai bën pjesë;

c) listën e aksionarëve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar;

d) marrëveshjet që shoqëria e sigurimit ka lidhur me të tretë për kalimin në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të veprimtarisë së tij, ose aleanca strategjike nëse ka të tilla;

e) informacion për shpenzimet që bën shoqëria për kërkime dhe zhvillimin e biznesit për trajnime të stafit dhe reputacionin, tregtimin e produkteve të reja;

f) shtrirjen territoriale e shoqërisë së sigurimit (degë, filiale, zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit)

Mbrojtja konsumatore

7. Shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit, përveç sa është parashikuar në Kreun X të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, detyrohen të informojnë të siguruarin për produktin e

sigurimit, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, tarifat dhe primet që i siguruari duhet të paguajë.

8. Përpara lidhjes së kontratës, shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit informon konsumatorin në gjuhën shqipe dhe në mënyrë të qartë për:

a) emrin dhe formën ligjore të shoqërisë;
b) adresën e zyrës qendrore apo të degës e cila merr përsipër të lidhë kontratën e sigurimit;
c) kushtet e kontratës së sigurimit;
d) përkufizimet e terminologjisë së kontratës së sigurimit;
e) periudhën e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit;
f) totalin e primit dhe primet e ndara sipas rreziqeve të veçanta (nëqoftëse kontrata e sigurimit mbulon rreziqe që i përkasin disa klasave të sigurimit.);
g) shuma e taksave, komisionet dhe shpenzime të tjera që i ngarkohen primit dhe shuma totale e pagueshme;
h) e drejta për të shtyrë apo zgjidhur kontratën e sigurimit;
i) pagesa e primit dhe kohëzgjatja e pagesës;
j) procedurat dhe mënyra e pagimit të dëmit;
k) ligji i cili aplikohet në rastet kur nuk është përcaktuar nga palët në kontratën e sigurimit;

9. Në rastet e sigurimit të jetës, shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit përveç sa është parashikuar në pikën 8 të këtij udhezimi, informon si më poshtë:

a) Bazat dhe kriteret për shpërndarjen e fitimit.
b) Tabelën e vlerave të dorëzimit të kontratës së sigurimit.
c) Ligji tatimor i aplikueshëm.
d) Informacion në lidhje me trajtimin e ankesave, ekzistencën e një strukture ankimimi përpara se një konflikt i lindur midis shoqërisë së sigurimit dhe të siguruarit të kalojë në proçes gjyqësor.

10. Gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit informon të siguruarin përveç kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit edhe për:

a) Çdo ndryshim të emrit të shoqërisë së sigurimit apo brokerimit, formën ligjore të tij, adresën e selisë qëndrore apo degës e cila ka marrë në sigurim.
b) Çdo ndryshim të informacionit të parashikuar në pikën 9 të këtij udhëzimi.
c) Çdo ndryshim në kushtet e kontratës së sigurmit në fuqi si rezultat i ndryshimit të ligjit të aplikueshëm të kësaj kontrate.
d) Çdo vit, informacion për bonuset apo përfitimet e të siguruarit, aty ku janë të aplikueshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË SHOQËRIVE TË RISIGURIMIT ME TË CILAT SHOQËRITË E SIGURIMIT QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË MUND TË LIDHIN MARRËVESHJE RISIGURIMI"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzimit "Për përcaktimin e kritereve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të lidhin marrëveshje risigurimi", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

UDHËZIM

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË SHOQËRIVE TË RISIGURIMIT, ME TË CILAT SHOQËRITË E SIGURIMIT QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË MUND TË LIDHIN MARRËVESHJE RISIGURIMI

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 12, datë 08.02.2007

Baza ligjore: Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 4 të nenit 107 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime.

1. Shoqëria e sigurimit mund të risigurojë pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguruarit, me shoqëritë risiguruese vendase, degë të shoqërive risiguruese të huaja të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ose shoqëri risiguruese të huaja, që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë udhëzim.
2. Shoqëria e sigurimit detyrohet të nënshkruajë marrëveshje risigurimi vetëm me shoqëri risigurimi që përmbushin nivelet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare dhe sipas kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Shoqëria e sigurimit vepron në lidhje me risigurimin e përgjegjësive të kontraktuara me të siguruarit në bazë të programit të risigurimit, i cili paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
4. Shoqëria e sigurimit ka përgjegjësinë të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për të përcaktuar gjendjen financiare dhe pozicionin e shoqërisë risiguruese me të cilën do të lidhin marrëveshje risigurimi.
5. Shoqëria e sigurimit në përzgjedhjen e shoqërisë risiguruese me të cilën do të lidhë marrëveshje risigurimi, merr informacion në lidhje me :

- Strukturën ligjore dhe statutore të shoqërisë risiguruese;
- Treguesit në lidhje me përbërjen aksionere;
- Treguesit në lidhje me manaxhimin e shoqërisë risiguruese;
- Treguesit në lidhje me aktivitetin risigurues të paktën për tre vitet e fundit;
- Aftësinë paguese, rezervat , investimet.

6. Shoqëria e sigurimit paraqet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare informacion në lidhje me risiguruesin dhe marrëveshjen e risigurimit.

Ky infomacion përmban:

- Raport të hollësishëm në lidhje me mbulimin në risigurim;
- Programin dhe marrëveshjet e risigurimit;
- Raporte financiare;
- Rezultatet e risigurimit.

7. Informacioni i paraqitur nga shoqëritë e sigurimit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me vlerësimin e marrëveshjes së risigurimit është konfidencial.
8. Shoqëritë e risigurimit me të cilat shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë, lidh marrëveshje risigurimi, duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Nuk duhet të jetë në proces falimentimi;
- Lideri i marrëveshjes së risigurimit nuk mund të ketë klasifikimin BBB (ose më të ulët) nga Standart&Poor;
- Risiguruesi i kontraktuar për shtresat e pa limituara në marrëveshjen e risigurimit, nuk mund të ketë klasifikimin më të ulët se BBB nga Standart&Poor;
- Çdo risigurues, pjesë e kontratës së risigurimit i cili ka 10% ose me shumë, nuk mund të ketë klasifikimin më të ulët se BBB nga Standart&Poor.

9. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kur gjykon që shoqëritë risiguruese të kontrakuara nga shoqëria e sigriumit nuk përmbushin kriteret e parashikuara në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe këtë udhëzim, i kërkon shoqërisë së sigurimit:

- Të rrisë kapitalin e shoqërisë;
- Të vendosë provigjone teknike ose matematike shtesë;
- Çdo masë tjetër që shoqëria e sigurimit i propozon Autoritetit dhe pranohet nga ky i fundit.

10. Shoqëritë sigurimit nga data e hyjes në fuqi e këtij udhëzimi, janë të detyruara të lidhin marrëveshje risigurimi vetëm në zbatim të parashikimeve të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR DHËNIEN E LICENSËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI SIGURIMI OSE RISIGURIMI NË R.SH."

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores *"Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në R.Sh.",* sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI SIGURIMI OSE RISIGURIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 13, datë 08.02.2007

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 6, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare " dhe nenit 20 e vijues të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Neni 2
Dispozita të përgjithshme

Kjo rregullore përcakton:

a) Afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari si shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe degët e shoqërisë së sigurimit të huaj.

b) Procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit.

c) Procedurat për licencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur në të kanë të njëjtën kuptim si ato të shprehur në nenin 3, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" i shprehur si "Ligji" në këtë rregullore.

Neni 3

Autoriteti licencues

3.1 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili në këtë rregullore do të quhet Autoriteti, në zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare " është i vetmi autoritet që lëshon licencën si akt administrativ për dhënien e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit.

3.2 Për të ushtruar veprimtari sigurimi, shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit duhet të licencohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, konform rregullave dhe procedurave të parashikuara në "Ligjin" dhe në këtë Rregullore.

3.3 Bordi i Autoritetit është organi i vetëm, i cili merr vendimin për dhënien, refuzimin dhe tërheqjen e licencave të parashikuara në këtë Rregullore.

3.4 Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e interesuar për t'u licencuar, si dhe mban korrespodencën me përfaqësues të tyre.

Neni 4

Llojet e licencave

4.1 Autoriteti në zbatim të "Ligjit" jep llojet e licencave të mëposhtme:

a) "Licencë për ushtrim veprimtarie".

b) "Licencë për zgjerim veprimtarie".

c) "Licencë për ushtrim veprimtarie të degës së shoqërise së huaj".

4.2 Licenca është e pakufizuar në kohë dhe e patransferueshme.

Neni 5

Fazat e licencimit

5.1 Licencimi i veprimtarisë së sigurimit përfshin dy faza:

a) Miratimi paraprak.

b) Licenca.

5.2 E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit lind vetëm pasi shoqëria dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit është pajisur me licencë nga Autoriteti.

Neni 6

Forma ligjore e shoqërisë së sigurimit

6.1 Shoqëria e sigurimit krijohet ligjërisht si një shoqëri anonime në zbatim të ligjit për shoqëritë tregtare dhe "Ligjit".

6.2. Shoqëria licencohet si:

a) Shoqëri sigurimi.

b) Shoqëri risigurimi.

c) Shoqëri sigurimi dhe risigurimi.

d) Degë e shoqërisë së huaj të sigurimit.

Neni 7

Kapitali i kërkuar për fillimin e veprimtarisë

Kapitali i kërkuar për fillimin e veprimtarisë nga shoqëria e sigurimit ose risigurimit është ai i parashikuar në nenin 17 dhe 98 të "Ligjit".

Neni 8

Depozitimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar depozitohet në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në njërën nga bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, atje ku shoqëria ka selinë qendrore të saj.

Neni 9

Forma e paraqitjes së kërkesës për miratimin paraprak

9.1 Kërkesa për ushtrim veprimtarie si shoqëri sigurimi, paraqitet me shkrim pranë Autoritetit sipas formularit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në nenin 26, të "Ligjit". Dokumentacioni duhet të jetë i plotësuar në gjuhën shqipe në tekstin origjinal ose fotokopjen e noterizuar të tij.

9.2 Autoriteti ka të drejtë të kërkojë informacione të tjera shtesë, përveç sa parashikohet më sipër, mosdhënia e të cilave përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak të licencës.

Neni 10

Programi i veprimtarisë

10.1 Programi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit ose risigurimit të propozuar përmban kërkesat e parashikuara në nenin 24, të "Ligjit".

Përveç sa është parashikuar më lartë, shoqëria duhet të paraqesë edhe informacionin si më poshtë:

a) Vlerësimi i sistemit të sigurimeve, konkurrentet, karakteristikat e tregut të sigurimeve dhe tendencat e zhvillimit të tij.

b) Strategjia e shoqërisë së sigurimit të propozuar, objektivat, pozicioni i saj në treg.

9.2 Në veçanti, për shoqëritë e sigurimit të jetës, llogaritja për parashikimin e primeve përfshin në mënyrë të qartë dhe të hollësishme si më poshtë:

a) Tabelën e mortalitetit.

b) Metodën për llogaritjen e primit si dhe tabelat e primeve për;

i) sigurimin individual,

ii) sigurimin në grup.

c) metodën për llogaritjen e reservës.

d) metodën e llogaritjes së vlerës së përfituar nga anulimi i kontratës së sigurimit.

e) llogaritjen e të ardhurave nga investimet, llogaritjen e surplusit, si dhe madhësia dhe mënyra e shpërndarjes.

f) deklarimin e llojeve të bonuseve që shoqëria do të aplikojë, burimet e planifikuara për mbulimin e tyre si dhe mënyrën e llogaritjes dhe të shpërndarjes së tyre.

Neni 11

Plani i biznesit

Plani i biznesit për tre vitet e para, hartohet sipas kërkesave të parashikuara në nenin 24 të "Ligjit".

Neni 12

Dokumentacioni i kërkuar për burimin e kapitalit

12.1 Për burimin e kapitalit paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

a) Kur si burim janë të ardhurat e individit, ato vërtetohen nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve të tilla si vërtetimin e pagës nga punëdhënësi, librezë kursimi, certifikatë depozitë, akt trashëgimie, aktin e dhurimit, etj. të shoqëruara me dokumentacionin që vërteton pagimin e detyrimeve fiskale (tatim-taksave) mbi këto të ardhura.

b) Kur si burim janë të ardhurat nga veprimtaria e personit fizik tregtar ose personit juridik, ato vërtetohen me paraqitjen e bilanceve kontabël të audituar, të shoqëruara me dokumentacionin që vërteton pagimin e detyrimeve fiskale (tatim-taksave) mbi këto të ardhura.

c) Deklaratën noteriale të aksionarëve direkt, se burimi për kapitalin fillestar të shoqërisë që nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta ose veprimtari të paligjshme.

12.2 Autoriteti ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme për të dalë qartë burimi i krijimit të parave që do të shërbejnë si kapital i shoqërisë së sigurimit.

Neni 13

Dokumentacioni i kërkuar për aksionarët

13.1 Për aksionarët direkt (themeluesit) e shoqërisë së sigurimit:

a) Akt-marrëveshja e krijimit të kësaj shoqërie dhe objekti i veprimtarisë së saj.

b) Lista e themeluesve të shoqërisë së sigurimit, numri i aksioneve të propozuara për çdo aksionar direkt.

c) Struktura e aksionarëve të shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë aksionarët direkt dhe indirekt të saj.

d) Lista e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të propozuar.

13.2 Kur aksionarët direkt janë persona juridikë:

a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë, akti i themelimit dhe statuti i personit juridik, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, shumën e kapitalit, listën e aksionarëve/ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital, si dhe pjesëmarrjet e tyre influencuese në shoqëri të tjera; certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

b) Të dhënat për veprimtarinë tregtare për 3 vitet e fundit të çdo personi, që propozon të zotërojë, vetë ose së bashku me personat juridikë të lidhur, pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e sigurimit të propozuar, shumën e propozuar për zotërim si dhe pasqyrat financiare, pasqyrat e të ardhurave dhe të shpenzimeve të shoqërisë dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për aktivitetet e biznesit të tyre në 3 vitet e fundit. Dokumentet e mësipërme të jenë të shoqëruara me kopjen e raportit të ekspertit kontabël që ka bërë kontrollin e shoqërisë.

c) Të dhëna për reputacionin e personit juridik aksionar i shoqërisë së propozuar.

d) Vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim- taksave nga aksionarët direkt për 3 vitet e fundit të aktivitetit të tyre.

e) Deklaratë për shlyerje të detyrimeve dhe për shlyerje të rregullta të kredive (nëqoftëse ka).

13.3 Kur aksionarët direkt janë persona fizikë tregtarë ose individë:

a) Për personat fizikë tregtarë: të dhëna për bizneset ku ata kanë pjesëmarrje influencuese dhe për çdo pjesëmarrje përqindja e aksioneve/kuotave që disponojnë, akti i regjistrimit të shoqërisë, certifikata e regjistrimit në organin tatimor, të dhëna që nuk është subjekt i procedurave të likuidimit dhe falimentimit nëpërmjet deklaratës personale.

b) Për individët të dhëna personale: emër, mbiemër, adresa, kombësia, shtetësia, edukimi, punësimi aktual dhe për 3 vitet e fundit dhe interesat pasurore apo të biznesit, dëshmi penaliteti.

c) Të dhëna për pjesëmarrjen e tyre në këshillat drejtues, në këshillat mbikëqyrës dhe në organet drejtuese të shoqërive të tjera ose të organizatave të biznesit.

d) Të dhëna për lidhjet që mendohet të ketë midis aktivitetit të tyre dhe shoqërisë së sigurimit të propozuar.

dh) Të dhëna mbi llogaritë bankare të tyre.

e) Të dhëna për veprimtaritë tregtare ose profesionale për 3 vitet e fundit të çdo personi fizik tregtar ose individi, që propozon të zotërojë pjesëmarrjen influencuese të shoqërisë së sigurimit të propozuar, si dhe për secilën shoqëri ku ai ka pjesëmarrje influencuese paraqiten pasqyrat financiare, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë së tyre për 3 vitet e fundit.

f) Të dhëna për reputacionin e personit fizik tregtar ose të individit.

g) Vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga personi fizik tregtar ose individi për 3 vitet e fundit.

h) Deklaratë personale të personit fizik tregtar ose e individit, lidhur me shlyerjen e detyrimeve dhe shlyerje të rregullta të kredive(nëqoftëse ka).

Neni 14

Dokumentacioni i kërkuar për drejtuesit

14.1 Për drejtuesit e shoqërisë së sigurimit të propozuar, në Autoritet paraqitet lista e tyre duke përcaktuar:

a) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

b) Anëtarët e drejtorisë.

c) Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm.

d) Financieri.

e) Juristi.

f) Aktuari.

g) Personi i ngarkuar me marrjen në sigurim.

h) Trajtuesi i dëmeve.

i) Mjeku për shoqëritë që kërkojnë të licencohen për sigurimin e jetës.

14.2 Për secilin prej personave të përcaktuar në pikën 14.1 të këtij neni, të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

a) CV personale.

b) Fotokopje të pasaportës.

c) Dëshminë e penalitetit.

d)Dëshmi aftësie dhe licenca të ndryshme profesionale.

e) Lista e bizneseve ku ata kanë pjesëmarrje duke përfshirë si ato biznese ku zotërojnë aksione/ kuota, ashtu edhe ato me të cilët kanë lidhje të tjera, e shoqëruar me

informacionin përkatës me të dhënat për veprimtarinë e tyre tregtare ose profesionale për 3 vitet e fundit.

f) Lista e bizneseve ku ata kryejnë funksione drejtuese.

g) Raportet financiare aktuale të bizneseve ku kanë pjesëmarrje influencuese apo në të cilat ata kanë funksione drejtuese.

h) Kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve ose të Këshillit Mbikëqyrës për zgjedhjen/emërimin e tyre.

14.3 Për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e Drejtorisë, anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm përveç sa më lartë të kenë plotësuar kërkesat e Rregullores së Autoritetit "Për organet drejtuese të shoqërive të sigurimit."

14.4 Për mjekun e shoqërisë së sigurimit të jetës, përveç sa më lart, do të paraqitet edhe dokumentacioni si më poshtë:

a) Vërtetimin e kryerjes së studimeve të larta në mjekësi.

b) Eksperiencë pune në profesion jo më pak se 5 vjet.

c) Eksperiencë profesionale në fushën e sigurimeve jo më pak se 3 vjet.

Neni 15

Afatet për verifikimin e dokumentacionit

15.1 Autoriteti bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

15.2 Autoriteti brenda 6 muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, jep ose refuzon miratimin paraprak dhe njofton me shkrim shoqërinë për vendimin e tij.

15.3 Data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas "Ligjit" dhe kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim nga Autoriteti kërkuesit dhe që nga ky moment fillon llogaritja e afatit 6 mujor parashikuar në pikën 15.2 të këtij neni.

15.4 Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat e "Ligjit" si dhe kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Autoriteti do të dërgojë një njoftim për mangësitë, për konfliktet me ligjin si dhe do të kërkojë informacion shtesë.

15.5 Mangësitë dhe vërejtjet e tjera të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur sipas kësaj rregulloreje, të mënjanohen brenda një muaji nga data e njoftimit të tyre. Në rast të kundërt, dokumentet e paraqitura i kthehen personit që ka paraqitur kërkesën.

Neni 16

Procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit

16.1 Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Sektori i Licencimit, përgatit informacionin dhe jep opinionet për Bordin e Autoritetit lidhur me kërkesën e paraqitur pasi:

a) Ka analizuar të gjithë informacionin e siguruar nëpërmjet materialit të paraqitur, duke bërë verifikimet e duhura.

b) Ka organizuar takime me drejtuesit e propozuar të shoqërisë për të diskutuar objektivat e saj në treg, planbisnesin e paraqitur, organizimin e shoqërisë, projektet financiare të shoqërisë për tre vitet e ardhshme, politikat kryesore të propozuara, etj.

c) Ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur duke konsideruar edhe takimin e organizuar dhe sigurohet që plotësohet kualifikimi i nevojshëm i drejtuesve të shoqërisë.

d) Ka vlerësuar transparencën e strukturës së kapitalit aksionar të shoqërisë.

e) Ka vlerësuar në bazë të planbisnesit të paraqitur të renë që do të sjellë kjo shoqëri në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së saj në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg.

f) Ka shqyrtuar burimin e krijimit të kapitalit dhe strukturën e tij duke njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

g) Ka vlerësuar strukturën organizative të shoqërisë së propozuar.

h) Ka vlerësuar planbisnesin e paraqitur, nëse ai është real dhe bindës.

j) Ka vlerësuar rrezikun që parashikon të ndërmarrë shoqëria për periudhën trevjeçare, sipas planbisnesit të paraqitur, për të krijuar bindjen nëse shoqëria do të zhvillojë një aktivitet të sigurt dhe të suksesshëm.

l) Ka vlerësuar cilësinë e anëtarëve të Drejtorisë dhe të stafit ekzekutiv të propozuar.

m) Ka vlerësuar mundësinë e aksionarëve të propozuar të shoqërisë për të shtuar kapitalin, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit.

16.2 Autoriteti kërkon ndryshimin e emërtimit të shoqërisë së propozuar, kur ky krijon një konfuzion në publik, ose midis shoqërive të sigurimit ekzistuese.

16.3 Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Sektori i Licencimit në informacionin dhe në opinionet për Bordin e Autoritetit në lidhje me kërkesën e një shoqërie të huaj sigurimi për të hapur degë në Republikën e Shqipërisë, përveç kërkesave të pikës 16.1 të këtij neni, përfshin edhe të dhënat e mëposhtme për vendin e origjinës:

a) Kushtet ekonomike dhe politike.

b) Sistemin financiar dhe pozicionin në treg të kësaj shoqërie.

c) Skemën e mbikëqyrjes për aktivitetin e sigurimit dhe aftësinë e autoritetit të mbikëqyrjes së sigurimeve për ushtrimin e këtij funksioni.

d) Praktikat e kontabilitetit që zbatohen.

16.4 Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Sektori i Licencimit në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur për përgatitjen e materialit sipas pikës 15.1 të këtij neni, bashkëpunon me punonjësit e Autoritetit, organe të tjera shtetërore, si dhe me organe homologe për rastet e shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë së huaj të sigurimit.

Neni 17

Miratimi paraprak ose refuzimi

17.1 Bordi i Autoritetit jep miratimin paraprak, në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat sipas nenit 26, të "Ligjit" dhe akteve nënligjore.

17.2 Bordi i Autoritetit refuzon miratimin paraprak, në rast se shoqëria nuk ka përmbushur kushtet e kërkuara nga "Ligji" dhe aktet nënligjore në fuqi dhe njofton me shkrim kërkuesin për vendimin e saj.

17.3 Bordi i Autoritetit shpjegon arsyet në bazë të të cilave informacioni i paraqitur nga shoqëria, vlerësohet i pamjaftueshëm për të vendosur dhënien e miratimit paraprak.

Neni 18

Njoftimi i vendimit

18.1 Vendimi i Bordi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin paraprak duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet e ditur shoqërisë me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës.

18.2 Në vendimin e miratimit paraprak për licencë, Bordi i Autoritetit mund të përcaktojë kërkesa dhe kushte të arsyetuara shtesë, që duhet të plotësojë shoqëria për të marrë licencën për fillimin e veprimtarisë së saj.

Neni 19

Regjistrimi në gjykatë

19.1 Pas marrjes së miratimit paraprak, shoqëria regjistrohet në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, si shoqëri sigurimi.

Neni 20

Dhënia e licencës

20.1 Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, të cilës i është dhënë miratimi paraprak, pasi ka plotësuar kërkesat e nenit 29 të "Ligjit".

20.2 Autoriteti, para dhënies së licencës, organizon një verifikim në vend të kushteve në të cilat shoqëria e sigurimit do të zhvillojë aktivitetin, për të përcaktuar nëse janë kryer përgatitjet e nevojshme për fillimin e aktivitetit. Verifikimi ka për qëllim të vlerësojë nëse shoqëria ose dega e shoqërisë së huaj disponon materialet e printuara të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të sigurimit, si dhe nëse janë krijuar kushtet për shërbimin ndaj klientit, etj.

Neni 21

Afati i shqyrtimit

21.1 Autoriteti shqyrton brenda dy muajve nga data e depozitimit të dokumenteve të plotësuara sipas kërkesave të "Ligjit" dhe kësaj rregulloreje, dhe merr vendim.

21.2 Nëse shoqëria, brenda 6 muajve nga data e marrjes së vendimit për miratimin paraprak të kërkesës për licencë, nuk plotëson kushtet e përcaktuara në këtë rregullore për marrjen e licencës, miratimi paraprak i kërkesës për licencë bëhet i pavlefshëm, me përjashtim të rasteve kur ky afat është shtyrë me vendim të *Bordit të Autoritetit*. Në rast se shoqëria është pas shtyrjes së afatit nuk i plotëson kërkesat e mësipërme humbet të drejtën për marrjen e licencës.

21.3 Autoriteti ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të kërkesës për licencim deri në 3 muaj, për raste objektivisht të vërtetueshme, për të cilat Autoritetit i duhet koha e nevojshme për shqyrtim.

Neni 22

Miratimi ose refuzimi i licencës

Bordi i Autoritetit jep licencën në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat e "Ligjit" dhe kësaj rregulloreje, ose refuzon atë kur nuk janë përmbushur këto kërkesa.

Neni 23

Publikimi i licencës

23.1 Licenca për ushtrim veprimtarie botohet në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin e Autoritetit.

23.2 Vendimi për dhënien e licencës hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

23.3 Shoqëria e sigurimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin për datën e fillimit të veprimtarisë së saj.

23.4 Shoqëria e sigurimit duhet të fillojë punë brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës.

Neni 24

Informacion për fakte të tjera

24.1 Faktet e reja dhe rrethanat e konstatuara pas dhënies së miratimit paraprak, si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentet e paraqitura, të cilat kanë shërbyer si bazë për miratimin paraprak, do t'i njoftohen me shkrim Autoritetit.

24.2 Njoftimi sipas paragrafit të parë të këtij neni do të bëhet brenda 15 ditëve pas ndodhjes së faktit ose konstatimit të rrethanave përkatëse.

Neni 25

Tërheqja e licencës për ushtrim veprimtarie

25.1 Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit tërhiqet vetëm me vendim të Bordit të Autoritetit, në rastet e parashikuara në nenin 33, të "Ligjit".

25.2 Shoqëria së cilës i është tërhequr licenca, i ndalohet të angazhohet në veprimtari sigurimi e financiare pas hyrjes në fuqi të vendimit të tërheqjes së licencës dhe detyrohet të likuidojë sa më parë që të jetë e mundur aktivet e saj, të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore për policat e jetës dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kësaj kohe shoqëria vazhdon të jetë subjekt i "Ligjit", njësoj sikur të ishte e licencuar.

Neni 26

Publikimi

26.1 Vendimi për tërheqjen e licencës botohet në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin e Autoritetit.

26.2 Autoriteti dërgon vendimin për botim brenda 5 ditëve nga data e marrjes së tij.

Neni 27

Regjistrimi në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

27.1 Autoriteti mban një regjistër të veçantë për regjistrimin e të dhënave të shoqërive të licencuara, sipas kërkesave të nenit 42, të "Ligjit".

Neni 28

Kërkesa për licencim për "zgjerim veprimtarie"

28.1 Shoqëria e sigurimit e cila ka marrë licencë për "ushtrim veprimtarie" sigurimi, për një ose disa klasa, duhet të marrë një licencë nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në klasa të tjera sigurimi, përveç atyre për të cilat është licencuar më parë.

28.2 Kërkesa për licencim, për zgjerim veprimtarie referuar në pikën 28.1 të këtij neni, do të bëhet me shkrim duke plotësuar kërkesat e nenit 35 të "Ligjit".

28.3 Bordi i Autoritetit, jep licencën sipas parashikimeve të nenit 37, të "Ligjit" dhe kësaj rregulloreje.

Neni 29

Afati i shqyrtimit

29.1 Bordi i Autoritetit brenda tre muajve nga data e depozitimit të kërkesave të plotësuara sipas "Ligjit" dhe kësaj rregulloreje, miraton ose refuzon licencën "Zgjerim veprimtarie sigurimi".

29.2 Bordi i Autoritetit, ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të parashikuar në pikën 29.1 të këtij neni deri në 1 muaj, në raste objektivisht të vërtetueshme, për të cilat, Autoritetit i duhet koha e nevojshme.

Neni 30

Njoftimi i vendimit dhe publikimi

30.1 Vendimi për miratimin ose refuzimin e licencës për zgjerim veprimtarie, i cili jepet nga Bordi i Autoritetit duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet e ditur shoqërisë së sigurimeve ose degës së shoqërisë së huaj me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës.

30.2 Vendimi për dhënien e licencës për zgjerim veprimtarie hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 31

Kërkesa për licencim për ushtrim veprimtarie të degës së shoqërisë së huaj

31.1 Kërkesa për licencimin e degës së një shoqërie të huaj, bëhet nga shoqëria e huaj, me shkrim, në gjuhën shqipe dhe paraqitet pranë Autoritetit duke plotësuar kërkesat e nenit 39, 40 dhe 41 të "Ligjit".

31.2 Dega e shoqërisë së huaj të sigurimit të licencuar nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit, që nuk kryhet nga shoqëria e sigurimit-mëmë.

31.3 Shoqëria e huaj e sigurimit, e cila kërkon të hapë një degë në Shqipëri, deklaron se është e gatshme t'i sigurojë Autoritetit:

a) çdo lloj informacioni lidhur me gjendjen e saj financiare të konsoliduar, për qëllime të mbikëqyrjes financiare të veprimtarisë së sigurimit;

b) një informacion për zhvillimet ekonomike aktuale dhe perspektive të vendit të origjinës;

c) informacion, lidhur me klasifikimin e shoqërisë së sigurimit sipas shoqërive ndërkombëtare të pavarura të specializuara për vlerësimin e institucioneve financiare (International RatingAgency.);

d) informacion lidhur me çdo ndryshim të rëndësishëm në administrimin, strategjinë, strukturën e pronësisë, gjendjen financiare të shoqërisë së sigurimit.

31.4 Përveç sa parashikuar në nenin 40, të "Ligjit", administratori i degës së huaj duhet të plotësojë edhe kërkesat e Rregullores së Autoritetit "Për organet drejtuese të shoqërive të sigurimit".

Neni 32

Miratimi ose refuzimi i kërkesës për ushtrim veprimtarie jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

32.1 Shoqëria e sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të marrë më parë miratimin e Autoritetit.

32.2 Kërkesa e shoqërisë së sigurimit bëhet me shkrim duke u shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në nenin 43, të "Ligjit."

Neni 33

Miratimi ose refuzimi i kërkesës për hapje zyre përfaqësimi të shoqërisë së huaj të Sigurimit

33.1 Kërkesa për hapjen e zyrës së përfaqësimit të një shoqërie të huaj, bëhet me shkrim në gjuhën shqipe nga shoqëria e huaj. Kjo kërkesë i paraqitet Autoritetit duke u shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në nenin 44, të "Ligjit".

33.2 Autoriteti brenda një periudhe një mujore shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë së huaj për zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

33.3 Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e sigurimit të huaj brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

33.4 Zyra e përfaqësimit regjistrohet në gjykatë pasi ka marrë miratimin nga Autoriteti dhe njofton Autoritetin për këtë regjistrim.

Neni 34

Dispozita të fundit

34.1 Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

34.2 Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR DISA KRITERE QË DUHET TË PLOTËSOJNË PERSONAT E ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT OSE TË RISIGURIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores "Për disa kritere që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose të risigurimit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR DISA KRITERE QË DUHET TË PLOTËSOJNË PERSONAT E ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT OSE RISIGURIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 14, datë 08.02.2007

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të nenit 61, 62, 63 dhe 64 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Neni 2
Objekti

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërisë së sigurimit, si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.

Neni 3
Përkufizime

3.1 Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore, kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr. 9267, datë 27/09/2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i cili më poshtë do të quhet "Ligji".

3.2 Në vijim për thjeshtësi për shoqëritë e sigurimit dhe degët e shoqërive të sigurimit të huaja është përdorur termi "shoqëri sigurimi ".

Neni 4

Subjektet e kësaj rregulloreje

Subjektet e kësaj rregullore, janë:

a. anëtarët e këshillit mbikëqyrës ku përfshihet edhe kryetari,

b. anëtarët e komitetit të kontrollit të brendshëm,

c. drejtori i përgjithshëm i shoqërisë së sigurimit dhe administratori i degës së shoqërisë së huaj,

e. drejtues departamenti/drejtorie apo drejtuesit e degës.

Neni 5

Kualifikimi, reputacioni dhe përvoja

5.1 Të gjithë të zgjedhurit ose të emëruar si drejtues duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore, për sa i përket figurës së tyre morale dhe aftësisë profesionale.

5.2 Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si drejtues, të kenë arsimin e lartë.

5.3 Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si drejtues, të kenë eksperiencë pune të paktën dy vjet.

Neni 6

Kërkesa dhe dokumentacioni

6.1 Kërkesa për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të kandidaturës së propozuar bëhet nga shoqëria e sigurimit, në bazë të vendimit të:

a) Asamblesë së aksionarëve për anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

b) Këshillit mbikëqyrës për anëtarët e komitetit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit dhe për drejtuesit e përcaktuar në shkronjat c, d të nenit 3 të kësaj rregulloreje.

6.2 Kërkesa, ku përcaktohet pozicioni i propozuar i drejtuesit shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Një kopje e noterizuar e diplomës së arsimit të lartë.

b. CV-ja e firmosur sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

c. Të dhëna të detajuara për veprimtarinë tregtare dhe për bizneset e tyre për 3 vitet e fundit si dhe ato në të cilat ata kanë pjesëmarrje influencuese.

d. Vërtetim nga organet tatimore në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore për dy vitet e fundit para emërimit.

e. Deklaratë personale e çdo drejtuesi se gjatë aktivitetit të tij të punës nuk ka kryer veprimtari që bien në kundërshtim me rastet e parashikuara në nenin 64 të Ligjit.

f. Deklaratë personale për shkallën e interesave me përfitim material me shoqërinë e sigurimit që e propozon.

g. Për drejtuesit shtetas të huaj dokumentacioni i mësipërm të jetë në gjuhën shqipe dhe i vërtetuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme ose pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislacionit përkatës.

Neni 7

Kufizimet

7.1 Nuk lejohet të caktohet si drejtues i shoqërisë së sigurimit, për rastet e parashikuara në nenin 64 të Ligjit.

7.2 Drejtues i shoqërisë së sigurimit apo i degës së saj, nuk mund të pranohet një person, i cili ka ndërprerë marrëdhëniet juridike me shoqërinë e sigurimit apo me çdo subjekt tjetër që kryen veprimtari sigurimi, për shkak të shkeljeve të akteve ligjore e nënligjore, për shkak të shpërdorimit të detyrës, si dhe për paaftësi në kryerjen e funksioneve drejtuese.

7.3 Drejtuesi i shoqërisë së sigurimit apo degës së saj nuk mund të pranohet, për një periudhë 2 vjeçare nga data e largimit nga puna, një person i cili ka qenë në drejtimin apo në vendimmarrjen e mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit.

7.4 Anëtari i komitetit të kontrolli të brendshëm nuk mund të kryejë asnjë funksion tjetër në shoqërinë e sigurimit.

7.5 Nuk lejohet qenia si drejtues, i personave të punësuar tek shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit.

Neni 8

Miratimi

8.1-Shoqëritë e sigurimit i emërojnë ose zgjedhin anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e drejtorisë dhe administratorët e degës për shoqëritë e huaja, përfundimisht pasi është marrë më parë miratimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

8.2 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, jep miratimin e saj brenda 10 ditëve kalendarike pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë për marrjen e miratimit të pozicioneve të parashikuar në pikën 7.1 të këtij neni.

8.3 Shoqëria e sigurimit, për çdo ndryshim të personave në pozicionet e parashikuara në pikën 7.1 të këtij neni, njofton me shkrim Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare duke paraqitur;

a)dokumentin e emërimit sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje.

8.4 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund të kërkojë në mënyrë konfidenciale nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv, arsyet e largimit nga puna të drejtuesit të saj.

8.5 Miratimi sipas pikës 7.1 të këtij neni jepet nga bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare.

8.6 Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin për emërimin e drejtorëve të degëve.

8.7 Autoriteti rezervon të drejtën e refuzimit nëse shkelen kushtet e ligjit.

Neni 9

Refuzimi

9.1 Kur vërtetohet se personat e propozuar për tu emëruar apo për tu zgjedhur në postet drejtuese dhe ato mbikëqyrëse sipas pikës 7.1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, nuk plotësojnë kushtet e "Ligjit" dhe të kësaj rregulloreje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare refuzon dhënien e miratimit.

9.2 Vendimi i refuzimit nga Bordi i Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas pikës 8.1 të këtij neni, i dërgohet shoqërisë së sigurimit brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 10

Shkarkimi

Autoriteti i Mbikëqyrjes financiare, në rast përsëritje të shkeljeve të parashikuara në nenet 165-169 të ligjit kur drejtuesi është përgjegjës për këto shkelje, vendos shkarkimin e tij.

Neni 11

Regjistri i drejtuesve

Çdo miratim, shkarkim apo largim i drejtuesve të shoqërisë dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, regjistrohet në një regjistër të veçantë.

Neni 12

Dispozita të fundit

12.1 Personat që aktualisht janë emëruar ose zgjedhur në pozicionet e tyre pavarësisht parashikimeve të kësaj rregulloreje.

12.2 Për çdo emërim ose zgjedhje të re në pozicionet e parashikuara në pikën 7.3 të nenit 7 të kësaj rregullore zbatohen dispozitat e ligjit dhe kësaj rregullore.

Neni 13

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLLIN FINANCIAR TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores *"Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare",* sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen institutet private të pensioneve dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE
PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 15, datë 08.02.2007

Në mbështetje të nenit 35 të VKM nr. 908, datë 29.12.2004 "Për organizimin Dhe funksionimin e Inspektoriatit të Instituteve Private të Pensioneve dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes", pikës 3 të nenit 14 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Bordi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

VENDOSI:

Kreu I
Mbikëqyrja dhe Kontrolli Financiar
Qëllimi dhe Objekti

1. Mbikëqyrja dhe kontrolli financiar është procesi i verifikimit të fakteve të konstatuara nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që këtu e më poshtë do të quhet Autoriteti, për të garantuar dhe siguruar që instituti privat i pensioneve suplementare ushtron aktivitetin e tij, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe objektin e veprimtarisë së tij.

2. Mbikëqyrja dhe kontrolli në institutin privat të pensioneve suplementare ka për qellim parandalimin dhe zbulimin e te metave, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe marrjen e masave për korrigjimin e tyre, nëpërmjet:

   a) kontrollit të vazhdueshëm dhe të gjithanshëm të aktivitetit tërësor dhe të respektimit të përgjegjësive kontraktore ndaj kontribuesve dhe përfituesve në skemën e sigurimit privat të pensioneve;
   b) kontrollit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së institutit privat i pensioneve suplementare, cili ka të bëjë me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë administrimin e tyre;

c) kontrollit të administrimit të institutit privat të pensioneve suplementare, që ka të bëjë me saktësinë dhe plotësimin e informacionit financiar e të drejtimit, si dhe përdorimin e tyre.

3. Objekti i kontrollit përcaktohet nga sektori i kontrollit dhe miratohet nga Kryetari i Autoritetit, mbështetur në:

a) raportin e kontrollit të mëparshëm;

b) raportimet dhe korrespondencën midis Autoritetit dhe Institutit privat të pensioneve;

c) raporte të veçanta nga kontrolli i fundit, siç janë raportet e kontrolleve të pjesshme ose të ndërmjetme, për një qëllim të caktuar, si dhe programet e hartuara për ndreqjen e gabimeve dhe shkeljeve nga institute privat i pensioneve mbi bazën e kontrolleve të kaluara;

d) funksionimin e skemës së organizimit të institutit privat të pensioneve;

e) të gjithë dokumentet që pasqyrojnë veprimtarinë e institutit privat të pensioneve, me qëllim që të identifikojë fushat që paraqesin problem dhe ecuri jonormale dhe që duket që kanë nevojë për një analizë shtesë;

f) identifikimin e përgjegjësive sipas fushave të operacioneve dhe veprimtarive të kontrolleve të mëparshme.

Kreu II

Programi i Kontrollit

4. Sektori i inspektimit mund të hartojë programe vjetore të kontrollit në institutet private të pensioneve suplementare dhe e miraton atë tek Kryetari i Autoritetit. Programi vjetor përmban:

a) identifikim e aspekteve më të rëndësishme për tu kontrolluar;

b) specifikimin e objektivave të kontrollit;

c) përcaktimin e qëllimit të kontrollit;

d) përcaktimin e periudhës së kryerjes së kontrollit.

5. Ky program vjetor miratohet në fillin të çdo viti kalendarik. Në të njëjtën kohë sektori i inspektimit ushtron edhe kontrolle të ndërmjetme me objektiva specifike, mbi problemet aktuale të vërejtura ose të sinjalizuara në funksion të mirëfunsionimit të institutit privat të pensioneve suplementare. Përpara hartimit të kontrollit duhet të mbahet parasysh që program i kontrollit të korrespondojë me objektin e kontrollit.

Kreu III

Program i kontrollit

6. Procedurat qe do të ndiqen për zbatimin e kontrollit në fushën e veprimtarisë së institutit privat të pensioneve suplementare që do të kontrollohet, përfshijnë:

6.1 Drejtimet kryesore të kontrollit , të cilat fokusohen në një ose disa kërkesa si me poshtë:

a) gjendjen financiare të institutit privat të pensioneve dhe aftësinë e tij për pagimin e përfitimeve, nivelin e garancisë, mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e strukturës së kapitalit; si dhe prognoza për të ardhmen;

b) kontrollin e llogarive individuale duke verifikuar përbërjen e informacionit;

c) rezervat,llogaritjet aktuarjale;

d) investimet dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike dhe vlerësimi I tyre;

e) analizën e aktiveve të qëndrueshme;

f) analizën e aktiveve qarkulluese;

g) analizën e detyrimeve të institutit privat të pensioneve suplementare;

h) analizën e të ardhurave, e cila përbëhet nga:

   i) të ardhurat nga vjelja e kontributeve,

   ii) të ardhurat nga investimet.

i) analizën e shpenzimeve për periudhën e cila përbëhet nga:

   i) përfitime të paguara,

   ii) shpenzime operative të veprimtarisë,

   iii) shpenzime për investime.

j) garancinë e institutit privat të pensioneve suplementare ndaj të siguruarve;

k) marrëdhëniet e institutit privat të pensioneve me degët dhe agjentët, identifikimi, i ndonjë problem financiar me orgjinë nga ndonjë subjekt tjetër;

l) vlerësimin e përfitimeve të paguara në lidhje me:

   i) afatet dhe pagesat;

   ii) identifikimi i praktikave dhe vlerësimi i shkaqeve në rastet e refuzimit të përfitimeve;

   iii) identifikimi i ankesave të ngritura nga aderuesit në institutin privat të pensioneve;

   iv) evidentimi i padive të ngritura kundër institutit privat të pensioneve.

m) analizën e dokumentacionit që ka te bëjë me kushtet e përgjithshme të përfshirjes në institutin privat në pensioneve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe respektimin e përgjegjësive kontraktuale;

n) zbatimin e kuotave të kontributeve në përputhje me ligjin dhe kushtet e vendosura në kontrate dhe transferimin e tyre midis instituteve;

o) zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të rregulloreve dhe urdhrave të nxjerra nga Autoriteti dhe Këshilli i Ministrave, që rregullojnë veprimtarinë e institutit të pensioneve;

p) verifikimin e të dhënave financiare për investimet e fondit të raportuara në Autoritet, si dhe saktësia dhe besueshmëria e raportimeve të bëra;

q) verifikimin e transferimin e pjesëmarrësve, së bashku me kontributet e tyre nga një institut në tjetrin, me rastin e shkrirjes së institutit;

r) saktësinë e llogaritjes së përfitimeve sipas kontratës me aderuesin;

s) analizimin e procedurës së vlerësimit të naseteve të institutit privat të pensioneve;

t) vlerësimin e eksperiencës dhe aftësitë menaxhuese për drejtimin e institutit privat të pensioneve;

u) nivelin e informimit të përgjithshëm të shpërndarë aderuesve dhe përfituesve të institutit privat të pensioneve;

v) protokolli i mbledhjeve;

w) efektivitetin e drejtimit;

x) vlerësimin e drejtimit dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm;

y) organizimin e sistemit të informacionit, mbajtja e një informacioni analitik dhe periodik që ka lidhje me gjendjen financiare të institutit privat të pensioneve suplementare;

z) të tjera që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore.

6.2 Format e kryerjes së kontrollit.

Format e kryerjes së kontrollit janë si më poshtë:

a) Kontrolli mbi dokumente: Ky kontroll konsiston në vlerësimin e raportimeve periodike të bëra nga instituti privat i pensioneve suplementare, në zbatim të aktit normativ përkatës.

b) Kontroll në vend ose i plotë.

c)Kontrolli elektronik, që ka te bëjë me:

i) hedhjen e të dhënave;

ii) infrastrukturën e nevojshme për kontrollin "online" të të dhënave financiere etj. në përputhje me legjislacionin përkatës.

6.2.1 Dy kontrollet e para mund të përfshijnë:

a. kontroll të treguesve dhe aspekteve financiare;

b. kontroll për respektimin e kërkesave ligjore;

c. kombinimin e të dyjave.

6.3 Grupi i kontrollit

Kontrolli si rregull ushtrohet në grup dhe në raste të veçanta edhe nga një inspektor i vetëm. Kur është në grup ai kryesohet nga përgjegjësi i sektorit, i cili përcaktohet edhe në programin e kontrollit. Programi i kontrollit, pasi është miratuar nga Kryetari i Autoritetit, i vihet në dispozicion institutit privat të pensioneve i cili do të kontrollohet dhe 2 kopje të tjera, një e mban grupi i kontrollit dhe tjetra në arshivën e Autoritetit.

6.4 Kohëzgjatja e kontrollit

Kontrolli duhet të kryhet në mënyrë efikase, me qëllim që të kufizohet koha e gjatë e qëndrimit në institutin privat të pensioneve suplementare. Kontrolli, në varësi të objektit, përcakton kohëzgjatjen dhe në raste të veçanta, kur nuk realizon objektivat e kontrollit, afati mund të shtyhet me miratim te përgjegjësit të sektorit të kontrollit.

6.5 Dokumentimi i rezultateve

Dokumenti përfundimtar që evidenton rezultatin e kontrollit të ushtruar nga grupi i kontrollit është akti i kontrollit.

Kreu IV

Akti dhe Raporti i Kontrollit

7. Përpara hartimit të aktit të kontrollit, grupi është i detyruar të parashtrojë dhe të diskutojë me të kontrolluarin faktet e gjetura, shkeljet dhe parregullsitë.
8. Vërejtjet e bëra nga instituti privat i pensioneve suplementare i kontrolluar duhet të reflektohen në aktin e kontrollit dhe kur nuk merren parasysh, ato duhet të argumentohen dhe të jepen arsyet.
9. Kur konstatohen mungesa, ose shkelje të akteve nënligjore, grupi mban proces-verbal të veçantë me shkaktarin ose shkaktaret. Në proces-verbal përcaktohet lloji i shkeljes së vërtetuar, dëmi që shkakton, dispozita e shkelur, si dhe përgjegjësitë e personit ose personave të lidhur me të.
10. Proces-verbali nënshkruhet nga inspektoret e kontrollit dhe i dorëzohet të kontrolluarit, i cili brenda afateve të përcaktuara, është i detyruar ta nënshkruaj ose të paraqesë kundërshtimet përkatëse, duke mbajtur një kopje.
11. Akti i kontrollit hartohet në dy kopje,nënshkruhet nga inspektoret dhe njëra i lihet për të nënshkruar të kontrolluarve, të cilët janë të detyruar ta nënshkruajnë atë brenda afateve kohore ose të paraqesin kundërshtimet përkatese dhe tjetra depozitohet në arkivën e Autoritetit.
12. Pas nënshkrimit të kontrollit, hartohet raporti i cili bazohet në aktin e kontrollit.
13. Raporti i kontrollit përmban në mënyrë të përmbledhur faktet e gjetura gjatë kontrollit, pa rregullsitë dhe propozimet e grupit të kontrollit në lidhje me detyrat e lëna për zbatim.
14. Në hartimin e raportit përfundimtar te grupit të kontrollit duhet të mbahet parasysh edhe raportet e kontrolleve të ndërmjetme që janë paraqitur në Autoritet. Raporti i kontrollit paraqet rezultatet e punës së kontrollit.

15. Raporti I kontrollit ka këtë përmbajtje:
    a) Titulli-raporti duhet të fillohet me një titull ose temë te përshtatshme, duke e dalluar atë nga deklaratat e tjera.
    b) Firma dhe data (periudha) raporti duhet të firmoset. Përfshirja e datës, e informon Autoritetin së vlerësimi është dhënë për efekt të ngjarjeve apo transaksionet rreth të cilave Autoriteti vihet në dijeni deri në atë datë. Në rastin e kontrollit te rregullshmërisë financiare vendoset periudha e kontrolluar.
    c) Objektivat dhe fushat e kontrollit-raporti duhet të ketë referencën "Miratuar nga Kryetari i Autoritetit" lidhur me objektivat dhe fushën e kontrollit ne këtë informacion jepet qëllimi dhe kufijtë e kontrollit.
    d) Tërësia-raporti duhet të ketë cilësuar tërësinë e të gjithë dokumenteve dhe deklarimeve të përdorura për hartimin e materialit.
    e) Marrësi-Raporti duhet të identifikoje ata të cilëve u drejtohet, siç e kërkojnë kushtet e angazhimit dhe të kontrollit si dhe dispozitat ligjore.
    f) Verifikimi i tematikës-Raporti duhet të identifikojë deklarimet financiare të fushës së cilës i përket ky deklarim. Kjo përfshin informacionin si: emrin e subjektit të kontrolluar,datën dhe periudhën që përfshihet në deklarimet financiare dhe tematikën e kontrolluar.
    g) Baza ligjore-raporti i kontrollit duhet të identifikojë legjislacionin dhe dispozitat e tjera të parashikuara për kontrollin.
    h) Përputhja dhe standardet-në raportin e kontrollit duhet të tregohen dhe standardet dhe praktikat e kontrollit që janë ndjekur në ushtrimin e tij, duke siguruar në këtë mënyrë se kontrolli është ushtruar në përputhje me procedurat që janë miratuar.
    i) Afati kohor-raporti duhet të bëhet i disponushëm menjëherë, veçanërisht për ata që duhet të marrin masat e nevojshme.

16. Raporti përfundimtar përfshin:
    a) Një përmbledhje të shkurtër të rezultateve të kontrollit duke përfshirë përfundimet dhe konkluzionet e fushave të ndryshme të kontrolluara.
    b) Një vlerësim të përgjithshëm të Institutit privat të pensioneve suplementare.
    c) Një vlerësim të fushave të kontrolluara bazuar ne standardet kryesore të kontrollit.
    d) Një listë të të dhënave për:
        i. shpërndarjen gjeografike të institutit privat të pensioneve suplementares;
        ii. shkallën e ekspozimit ndaj riskut;
        iii. shpërndarjen e përfitimeve;
        iv. Çështje të tjera që lidhen me zbatimin e politikave të shoqërisë.

Kreu V
Standardet e Kontrollit

A) Pavarësia

17. Arritja e objektivave të kontrollit përcaktohet, në një masë të madhe, nga pavarësia e inspektoreve të kontrollit. Kontrolli i kryer nga sektori i inspektimit ndihmon Autoritetin në plotësimin e funksioneve të tij.
18. Inspektoret e kontrollit kanë autoritetin e nevojshëm për kryerjen e detyrës së tyre në zbatim të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve" (të ndryshuar), kreu XI, neni 44, germa g.

B) Niveli Profesional

19. Aftësitë organizative të inspektoreve të kontrollit duhet të reflektohen në efektivitetin e programit të kontrollit mbi institutet private të pensionit. Aftësitë teknike mund të demonstrohen përmes teknikave të kontrollit. Të tilla si kontrolli me pyetësorë të hartuar prej tyre, qe i paraqiten për miratim nga Kryetari i Autoritetit.
20. Inspektorët e kontrollit duhet të zotërojnë edukimin e duhur arsimor, kualifikimin dhe eksperiencën e nevojshme. Ata duhet të sigurojnë që i kuptojnë objektivat dhe procedurat e kontrollit që do të kryhet prej tyre.
21. Inspektorët e kontrollit duhet të zbatojnë të gjitha rregullat etike të përcaktuara në nenet 37-48 te rregullores: "Mbi marrëdhëniet e punës së punonjësve të Inspektoriatit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare".

C) Mjaftueshmëria e programit, efektiviteti dhe e drejta e propozimeve

22. Inspektorët e kontrollit, kanë të drejtë të bëjnë vlerësimin e mjaftueshmërisë së programit te kontrollit të Instituteve Private të Pensionit. Për vlerësimin e mjaftueshmërisë së programit përpara se ti propozojnë me shkrim Kryetarit të Autoritetit për zgjerimin e objektit të kontrollit, duhet të marrin në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
    a. shtrirjen dhe intesitetin e punës së kryer;
    b. përmbajtjen e programeve;
    c. dokumentet e punës së kryer;
    d. konkluzione të arritura në raportet e nxjerra.

D) Shpejtësia e informacionit

23. Inspektorët e kontrollit duhet të dorëzojnë raportin brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të kontrollit të programuar dhe brenda 5 ditëve për ato të ndërmjetme. Në raportin qe i paraqitet Kryetarit duhet të evidentohen të gjitha mangësitë e konstatuara në kontrollin e ushtruar në Institutin Privat të Pensioneve, objekt kontrolli për zbatim.

Kreu VI

Te Drejtat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Inspektoreve te Kontrollit

24. Inspektoret e kontrollit kane këto të drejta:

a) T'u kërkojnë Instituteve Private të Pensioneve çdo informacion dhe dokument që e çmojnë të nevojshëm për ushtrimin e kontrollit;

b) Të tërhiqen për nevojat e kontrollit kopje të dokumentave ose orgjinalet e tyre kundrejt vërtetimit të lëshuar.

c) Për problem që kërkojnë njohuri të veçanta kanë të drejtë të kërkojnë ekspertë të fushave të ndryshme.

d) Të ndryshojnë ose të zgjerojnë objektin e kontrollit të miratuar më parë nga kryeinspektori, nëse pas fillimit të ushtrimit të kontrollit në shoqëri e shohin të arsyeshme për arritjen e konkluzioneve sa më të drejta.

e) Të ndërpresin kontrollin në Institutin Privat të Pensioneve, nëse atyre nuk u krijohen kushtet e domosdoshme për kryerjen e rregullt të detyrës. Për këtë ata mbajmë një proces-verbal me përfaqësuesin e shoqërisë dhe njoftojnë Kryetarin e Autoritetit për arsyet e kësaj ndërprerje.

f) Në rast ndërprerje për arsye objektive, kanë të drejtë të paraqesin me shkrim propozimet e tyre të arsyetuara.

25. Inspektoret e kontrollit kane këto detyra:

a) Inspektorët e kontrollit, në ushtrimin e detyrës së tyre udhëhiqen nga Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve"(te ndryshuar) dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e Instituteve private Suplementare në Republikën e Shqipërisë.

b) Kanë detyrë të ndihmojnë në rregullimin e të metave të konstatuara gjatë periudhës së kontrollit.

c) Inspektorët e kontrollit gjatë procesit të kryerjes së kontrollit, duhet të sugjerojnë nëse kontrollet e brendshme të kryera nga Autoriteti kanë qenë ose jo të mjaftueshme, përfshirë çështjet përkatëse të dokumentimit dhe regjistrimeve të kontrollit, duke vlerësuar efektivitetin e këtyre kontrolleve dhe procedurave të ndjekura.

d) Inspektoret e kontrollit duhet të analizojnë raportet e kontrollit të brendshëm të kryera nga Instituti Privat i Pensioneve dhe nga kontrolli i fundit.

f) Inspektoret e kontrollit duhet të gjykojnë në mënyrë të kujdesshme vendimet e marra nga Instituti Privat i Pensioneve, përpara se të vendosin nëse ato janë në favor të interesave të aderuesve.

26. Inspektorët e kontrollit kanë këto përgjegjësi:
    a) Inspektorët e kontrollit kanë përgjegjësi për zbatimin e detyrave të kontrollit.
    b) Inspektorët e kontrollit janë përgjegjës për raportin e vlerësimit që i paraqesin Kryetarit të Autoritetit për Institutin Privat të pensioneve, objekt kontrolli. Ky vlerësim synon të sigurojë që këto kontrolle të pasqyrojnë saktësisht aktivitetin dhe transaksionet dhe të ruajë si duhet aktivet kundër humbjeve.
    c) Inspektorët e kontrollit kanë përgjegjësi për të nxjerrë konkluzione të sakta lidhur me gjendjen e përgjithshme aktuale dhe të ardhme të Institutit Privat të Pensioneve. Aftësitë e tyre në konkluzionet e kontrollit përcaktojnë efektivitetin e gjithë procesit të mbikëqyrjes.
    d) Inspektoret e kontrollit kanë përgjegjësi për cilësinë e kontrollit të tyre.

Kreu VII
Konflikti i Interesave

27. Inspektorët e kontrollit nuk duhet të kenë asnjë interes ose obligim financiar që bie ndesh me përgjegjësitë dhe detyrat zyrtare.
28. Inspektorët e kontrollit nuk duhet të marrin pjesë personalisht për të marrë vendime, për të aprovuar apo mos aprovuar, rekomanduar ose këshilluar, apo të marrin pjesë në një kontroll nëse ai/ajo (inspektori i kontrollit) ose ndonjë pjesëtar tjetër i familjes ka interesa financiare, n.q.s nuk aprovohet paraprakisht nga Kryetari.
29. Përpara fillimit të punës çdo inspektor duhet të deklarojë me shkrim se nuk ka papajtueshmëri apo lidhje interesash me Institutin Privat të Pensioneve që kontrollohet.
30. Inspektoret e kontrollit paraprakisht duhet të plotësojnë kushtet e vendosura në rregulloren e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit te saj.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 16, datë 8.02.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI INSTITUT PRIVAT I PENSIONEVE SUPLEMENTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, dhe nenit 40 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit Juridik dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, Sektorit Juridik, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores *"Për procedurat e licencimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si Institut Privat i Pensioneve Suplementare",* sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen institutet private të pensioneve dhe Departamenti i Licencim Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR PROEDURAT E LICENCIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI INSTITUT PRIVAT I PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 16, datë 08.02.2007

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 7943, datë 1.06.1995 "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve".

1. Kërkesa për marrjen e lejes për të kryer veprimtari si institut privat i pensioneve suplementare, bëhet me shkrim dhe paraqitet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që këtu dhe më poshtë do të quhet Autoriteti.

2. Kërkesa për marrjen e lejes duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995, "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve.", si dhe VKM nr. 908, datë 29.12.2005 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të instituteve private të pensioneve suplementare." dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes". Kërkesa si më sipër, paraqitet e nënshkruar nga themeluesit e institutit të propozuar.

3. Kërkesa për marrjen e lejes për të kryer veprimtari si institut privat i pensioneve suplementare, dorëzohet bashkë me dokumentacionin përkatës pranë specialistit të protokoll/arshivës. I gjithë dokumentacioni duhet të plotësojë përcaktimet ligjore në formë dhe në përmbajtje si më poshtë:

3.1 Dokumentacioni, që paraqitet pranë Autoritetit për hapjen e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare, duhet të jetë i plotësuar në gjuhën shqipe në tekstin origjinal ose fotokopjen e noterizuar të tij.

3.2 Kërkesa për marrjen e lejes për krijimin e institutit privat të pensioneve suplementare, duhet të shoqërohet nga:

l) një deklaratë ose marrëveshje, me qëllimin për të krijuar institutin privat të pensioneve suplementare;

m) një deklaratë, që përcakton numrin minimal të të punësuarve apo të të siguruarve të interesuar;

n) model i kontratës së pjesëmarrësve në institutin privat të pensioneve suplementare;

o) kontrata e aderimit të punëdhënësve, themelues dhe/ose jo themelues të tij;

p) statut i institutit privat të pensioneve suplementare;

q) rregullorja e pensioneve;

rr)rregullorja financiare;

s) plani i biznesit për pesë vitet e para;

t) masat administrative e financiare, që do të merren për funksionimin e rregullt të institutit privat të pensioneve suplementare;

u) vërtetimin për pagesën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore nga themeluesit ose jo themeluesit;

v) formularët që përcaktojnë përmbajtjen e dokumenteve, të cilat i paraqiten Autoritetit për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë si institutit privat pensionesh;

w) dokumentacioni i nevojshëm që paraqitet pranë Autoritetit për burimin e kapitalit, paraqitet i plotë, si përcaktohet në formularët.

3.3 Themeluesit e institutit privat të pensioneve suplementare, bashkë me kërkesën për leje për ushtrimin e veprimtarisë, njoftojnë me shkrim Autoritetin për përfundimin dhe realizimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në formularët përkatës.

3.4 Dokumentacioni që paraqitet në Autoritet për marrjen e lejes për ushtrim veprimtarie si institutit privat pensionesh, duhet të pasqyrojë të dhëna aktuale për periudha jo më të hershme se muaji paraardhës.

3.5 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat ligjore dhe nënligjore, kërkuesit i dërgohet një njoftim për mangësitë duke i kërkuar plotësimin e tyre brenda një afati prej 60 ditësh.

4. Në ditën e paraqitjes së kërkesës për leje për ushtrim veprimtarie si institutit privat pensionesh apo për zgjerim të aktivitetit, kërkuesi paguan në llogarinë e Autoritetit një komision prej 200 000 lekësh. Ky komision është i parimbursueshëm.

5. Specialisti i protokollit, pas regjistrimit në protokoll të kërkesës (regjistrimi në protokoll duhet të përmbajë numër protokolli dhe datë) e dorëzon atë bashkë me dokumentacionin tek Kryetari i Autoritetit.

6. Pasi Kryetari njihet me kërkesën, kërkesa bashkë me dokumentacionin i adresohet Drejtorit të Departamentit të Licencimit pranë Autoritetit, i cili bën shpërndarjen e materialit tek specialistët që ka nën varësinë e tij.

7. Specialisti i licencimit, menjëherë bën regjistrimin e kërkesës në regjistrin e kërkesave për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare. Ky regjistër bashkë me regjistrin e lejeve të dhëna dhe të revokuara mbahet dhe plotësohet nga specialisti i licencimit.

8. Në këtë regjistër do të pasqyrohet numri i protokollit dhe data e paraqitjes së kërkesës, emri i shoqërisë, adresa, data dhe arsyet e kthimit të dokumentacionit nëse ndodh.

9. Sektori i licencimit, fillimisht sheh nëse janë plotësuar kërkesat ligjore formale në dokumentacion.

10. Pas verifikimit të paraqitjes formale të dokumentacionit nga kërkuesit, sektori i licencimit njihet me përmbajtjen e praktikës së paraqitur duke shqyrtuar në detaje dokumentacionin që shoqëron kërkesën e paraqitur për marrjen e lejes, për ushtrim veprimtarinë si institutit privat pensionesh suplementare.

11. Sektori i licencimit para propozimit për dhënien e lejes, organizon një verifikim në vend të kushteve në të cilat instituti do të zhvillojë aktivitetin, për të përcaktuar nëse janë kryer përgatitjet e nevojshme për fillimin e tij.

12. Gjatë verifikimit të dokumentacionit, specialistët e sektorit të licencimit mund të kërkojnë bashkëpunim dhe me institucione të tjera për saktësinë e të dhënave që paraqiten me kërkesën nga aplikuesi.

13. Me urdhër të Kryetarit miratohet grupi i specialistëve, i cili do të kryejë verifikimet e nevojshme, si dhe plan-veprimi i këtij grupi, i cili ka si qëllim të vlerësojë nëse:

- instituti ka krijuar kushte për administrimin e aktivitetit;
- disponon materialet e printuara, të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të pensioneve;
- është krijuar infrastruktura e nevojshme e teknologjisë së informacionit (software dhe hardware);
- janë krijuar kushte për transparencën e plotë dhe shërbimin ndaj klientit.

14. Grupi i specialistëve të ngarkuar me verifikimet, kur vëren mangësi gjatë këtij procesi, bën raportin përkatës adresuar Kryetarit duke propozuar që aplikuesit t'i kërkohen dokumente të tjerë, ose kur nuk ekzistojnë mundësi për marrjen e tyre ata mund të propozojnë edhe kthimin e dokumentacionit aplikues-it/ve për saktësim dhe ri paraqitje.

15. Ky raport nënshkruhet nga përgjegjësi i sektorit të licencimit dhe Drejtori i Departamentit të Licencim Monitorimit dhe kundër firmohet nga specialistët përkatës të ngarkuar me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur.

16. Drejtori i Departamentit të Licencim Monitorimit vendos nëse do të kthehet dokumentacioni për plotësim ose jo. Nëse merret vendim për kthim praktike, kjo i njoftohet kërkuesit/ve me anë të një shkrese ku parashtrohen edhe arsyet përkatëse.

17. Data e pranimit të kërkesës për leje ushtrimi veprimtarie si institutit privat pensionesh, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuesit.

18. Autoriteti, brenda 60 ditëve nga data e këtij njoftimi, jep ose refuzon lejen dhe njofton me shkrim kërkuesin për vendimin e saj.

19. Në rastin kur kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në mënyrë formale janë respektuar që në momentin e fillimit ose pas rikthimit, Kryetari mund të përfshijë në procesin e shqyrtimit të përmbajtjes dhe verifikimit të dokumentacionit edhe specialistë të Departamenteve dhe njësive të tjera.

20. Nëse kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore plotësohen dhe nga verifikimi i tyre vërehet se ekzistojnë mundësitë për të ushtruar veprimtarinë si institut privat të pensioneve suplementare, Departamenti i Licencimit, mbështetur dhe nga sektorët e tjerë harton një relacion të hollësishëm dhe i propozon Bordit të Autoritetit marrjen e vendimit për dhënien ose jo të lejes brenda afatit 60-ditor nga data e dorëzimit të dokumentacionit të përfunduar, pasi:

k) ka analizuar të gjithë informacionin e siguruar nëpërmjet materialit të paraqitur, duke bërë sipas rastit edhe verifikime:

l) janë organizuar takime nga specialistët e sektorit të licencimit apo përfaqësues të Autoritetit me bordin drejtues të propozuar të institutit për të diskutuar objektivat e këtij institutit në treg, plan biznesin e paraqitur, kapitalizimin e propozuar të institutit, organizimin e tij, projektet financiare të institutit për tri vitet e ardhshme, politikat kryesore të propozuara, etj;

m) është vlerësuar i gjithë dokumentacioni i paraqitur, duke konsideruar edhe takimin e organizuar dhe sigurohet nëse pjesëtarët e bordit drejtues dhe të stafit ekzekutiv të propozuar, të institutit privat të pensioneve suplementare janë të aftë profesionalisht;

n) është shqyrtuar transparenca e burimeve dhe e strukturës së kapitalit aksionar të institutit;

o) janë vlerësuar në bazë të plan biznesit të paraqitur të rejat që do të sjellë instituti në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së tij në kushtet e ekzistencës së konkurencës së lirë në treg;

p) është vlerësuar struktura organizative të institutit të propozuar;

q) është vlerësuar plan-biznesi i paraqitur, nëse ai është real dhe bindës;

r) janë analizuar të ardhurat e parashikuara të institutit, duke synuar që instituti të jetë me fitim të programuar brenda periudhës pesë vjeçare;

s) janë vlerësuar dhe ka verifikuar (nëse ka pasur të tilla) opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;

t) janë vlerësuar mundësitë e aksionarëve të propozuar të institutit për të shtuar kapitalin, nëse do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë si institute pensionesh.

21. Vendimi për dhënien ose refuzimin e lejes për të ushtruar veprimtari si institut privat pensionesh suplementare, merret nga Bordi i Autoritetit, mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare." dhe VKM nr. 908, dt 29.12.2005.

22. Ky vendim, në mbështetje të nenit 14, pika 1, të Ligjit nr. 7043, dt 01.06.1995, "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar , i bëhet i njohur me shkrim kërkuesit brenda një afati prej pesë ditësh pune, nga data e marrjes së vendimit së bashku me arsyet përkatëse.

23. Brenda kësaj periudhe, kërkuesit i dorëzohet vendimi i marrë dhe leja e dhënë nga Autoriteti, sipas formularëve të miratuar të cilat nënshkruhen nga Kryetari.

24. Në çastin e dhënies së lejes për kryerjen e aktivitetit për të cilin është bërë kërkesa, kërkuesi paguan në Autoritet një komision prej 300 000 lekësh. Ky komision është i parimbursueshëm.

25. Leja e dhënë regjistrohet nga specialisti i licencimit, i cili është administrues i të dhënave në regjistrin e lejeve të dhëna për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare.

26. Në këtë regjistër pasqyrohet emri i shoqërisë, adresa, numri e data i vendimit të marrë nga IIPPS, një përmbledhje e shkurtër e vendimit, data e fillimit të veprimtarisë, numri i personave të siguruar, masa e kapitalit fillestar, si dhe numri dhe data e lejes së dhënë nga Autoriteti.

27. Dhënia e lejes për të vepruar si institut privat pensionesh suplementare publikohet në fletoren zyrtare të Republikës, në buletinin e Autoritetit, si dhe në një apo më shumë nga gazetat me tirazh më të madh.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SICRED" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-Life" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7/1, datë 29. 03. 2007

SHTESË E VENDIMIT NR. 7, DATË 21. 03. 2007 "PËR MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-Life" SH.A"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "KPMG ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2006, TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "INSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 21.03.2007

MBI
SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" NDAJ VENDIMIT TË BORDIT NR. 2, DATË 15.01.2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 21.03.2007

PËR
REKRUTIMIN ME KOHË TË PJESSHME PRANË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE TË PUNONJËSVE TË JASHTËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË DISA PUNONJËSVE TË AMF PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE FINANCIARE PËR PËRFTIMIN E CERTIFIKATËS SI ANALIST FINANCIAR I KUALIFIKUAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 16, datë 21.03.2007

PËR
MRATIMIN E BILANCIT TË ÇELJES TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIAR PËR VITIN 2006

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 17, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBAJTJEN DHE RUAJTJEN E REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA, AUTORIZUARA DHE MIRATUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 29, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin me ndryshimet e propozuara të projekt rregullores "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare".
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit dhe sektori i TI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR MBAJTJEN DHE RUAJTJEN E REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA, AUTORIZUARA DHE MIRATUARA NGA AUTORITETI IMBIKËQYRJES FINANCIARE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 17, datë 21.03.2007

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 57, datë 25.06.2009

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 76, datë 28.08.2009

KREU I
Dispozita të Përgjithshme

Neni 1
Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore përcakton mënyrën e mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i quajtur këtu "Autoriteti", si dhe konsultimin e publikut me këto të dhëna.

Neni 2
Baza ligjore

Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: Ligji nr. 9572, datë 3.07.2006 "Mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" neni 29; Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", Neni 42 dhe Neni 88, pika 6, Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995, "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", VKM nr. 908, datë 29.12.2004, neni 26; Ligji Nr. 8080, datë 01.03.1996 "Për Letrat me Vlerë", neni 36, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtyre ligjeve.

Neni 3
Objekti i regjistrimit

Të gjithë personat juridikë apo fizikë, të licencuar, autorizuar apo të miratuar nga Autoriteti, janë objekt regjistrimi i regjistrave sipas përkatësisë.

Neni 4

Llojet e regjistrave

Autoriteti, mban këto regjistra:

Regjistër për shoqëritë, që ushtrojnë veprimtaritë si tregje të letrave me vlerë (bursa);

Regjistër për shoqëritë publike dhe emetuesit e tjerë të letrave me vlerë;

Regjistër për shoqëritë e investimit;

Regjistër për Shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe institutet private të pensioneve;

Regjistër për Fondet e investimit;

Regjistër për Tregtarët e letrave me vlerë dhe këshilltarët e investimeve;

Regjistër për shoqëritë e sigurimeve;

Regjistër për Agjentët e sigurimeve;

Regjistër për Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari si institute private të pensioneve;

Regjistër për ndërmjetësat e tjerë në sigurime, si: shoqëritë e agjentëve, shoqëritë e brokerimit dhe brokerat;

Regjistër për vlerësuesit e dëmeve;

Regjistër për konsulentët në sigurime;

Regjistër për aktuarët e autorizuar;

Regjistër për regjistruesit e letrave me vlerë;

Regjistër për drejtuesit e investimeve;

Regjistër për subjektet që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë.

Neni 5

Mënyra e mbajtjes së regjistrave

Regjistrat mbahen në mënyrë elektronike dhe në mënyrë fizike, mbi bazën e kartelave të hapura për çdo subjekt, objekt regjistrimi.

Të dhënat që përmbajnë regjistrat në mënyrë elektronike dhe në mënyrë fizike janë të njëjta. Vetëm informacioni dhe ndryshimet e përcaktuara në këto rregulla janë subjekt i regjistrimit në regjistra.

Të dhënat që përmbajnë regjistrat janë të dhëna publike, me përjashtim të të dhënave që, me Vendim të Bordit, konsiderohen konfidenciale.

Regjistrat qëndrojnë të hapur për publikun gjatë orarit zyrtar.

KREU II

Mbajtja e regjistrave

Neni 6

Njësia përgjegjëse

Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, në bashkëpunim me Njësinë e TI janë përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e regjistrave.

Drejtori i Departamentit cakton personin që përgjigjet direkt për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave.

Neni 7

Burimi i të dhënave për regjistrin

Regjistrimi i të dhënave në regjistrin përkatës mbështetet në Vendimet e Bordit të Autoritetit – objekt regjistrimi, si dhe në dokumentet apo informacionin e paraqitur nga personi fizik apo juridik, që përmban të dhëna, objekt regjistrimi. Regjistrimi i të dhënave në regjistrin përkatës bëhet brenda 5 ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Bordit, apo paraqitjes së informacionit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 8

Regjistri elektronik

Për çdo person fizik apo juridik, objekt regjistrimi, hapet një kartelë në regjistrin elektronik me kodin përkatës, bazuar në sistemin e indeksimit, sipas përcaktimit të bërë në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje. Regjistri elektronik mbahet në paketa software me strukturë të mirëfilltë database.

Informacioni në çdo kartelë, regjistrohet në mënyrë kronologjike. Baza e të dhënave që regjistrohen në çdo kartelë janë ato të përcaktuara në ligjet përkatëse dhe në këtë rregullore. Mënyra e hedhjes së të dhënave është e njëjtë për të gjitha kartelat.

Neni 9

Hedhja e të dhënave në regjistrin elektronik

Hedhja e të dhënave në regjistrin elektronik duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të ketë gjurmë mbi datën e futjes së të dhënës, llojit të veprimit dhe emrin e personit që ka bërë hedhjen e të dhënës. Hedhja e të dhënave të reja bëhet në mënyrë të tillë që të mos ketë ndikim mbi të dhënat e mëparshme, duke ruajtur historinë e të dhënave. Kur një e dhënë e futur anulohet, ajo nuk duhet të prekë regjistrimet përkatëse ku u bë anulimi. Anulimi nuk duhet të çojë në ndonjë humbje apo dëmtim të informacionit që futet. Çdo gabim që mund të bëhet në momentin e futjes së të dhënës, korrigjohet duke marrë më parë pëlqimin e Drejtorit të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit. Korrigjimi nuk duhet të çojë në humbje apo dëmtim të informacionit që futet.

Neni 10

Regjistri fizik

Për çdo person fizik apo juridik, objekt regjistrimi, hapet një kartelë në regjistrin fizik. Informacioni, në çdo kartelë, regjistrohet në mënyrë kronologjike.

Çdo kartelë ka kodin përkatës, sipas Aneksit 1, i cili është i njëjtë me kodin që ka subjekti i regjistruar në regjistrin elektronik.

Çdo regjistrim në kartelën fizike nënshkruhet nga personi përgjegjës për mbajtjen e regjistrave.

Neni 11

Vendndodhja e regjistrave

Publiku ka të drejtë të konsultojë informacionin që përmbajnë regjistrat.

Mundësia për të parë informacionin që përmban regjistri elektronik sigurohet nga sistemi i automatizuar i informacionit, i vendosur në ambientet e Autoritetit sipas urdhrit të Kryetarit, si dhe në website-n e Autoritetit në internet.

Mundësia për të parë informacionin që përmban regjistri fizik, sigurohet duke caktuar vendin e përshtatshëm në ambientet e Autoritetit, sipas urdhrit të Kryetarit.

Neni 12

E drejta për të kërkuar informacion

Çdo person, mund të kërkojë informacion mbi të dhënat që përmbajnë regjistrat. Informacioni mund të kërkohet me mjete elektronike ose në letër.

Kërkesat për të marrë informacion nga të dhënat e regjistrave si dhe nxjerrja e informacionit bëhet në rrugë zyrtare, sipas urdhrit të Kryetarit të Autoritetit.

KREU III

Ruajtja e regjistrave

Neni 13

Personi përgjegjës

Çdo veprim që lidhet me ruajtjen e regjistrave kryhet nga personi i ngarkuar për të mbajtur regjistrat.

Neni 14

Ruajtja e regjistrit elektronik

Të dhënat elektronike ruhen në mënyrën që sigurohet integriteti i informacionit dhe akses i kontrolluar për futjen e të dhënave dhe njohjen e informacionit.

Kopjimi i të dhënave nga database në mjete elektronike bëhet me leje nga Kryetari. Një kopje e arkivës elektronike duhet të ruhet në një vend të veçantë nga mbajtja e regjistrit, sipas urdhrit të Kryetarit.

Në rastet e ndryshimeve të shpeshta në regjistrat përkatës, kopja e arkivës elektronike përditësohet në fund të çdo jave.

Në rastet e ndryshimeve jo të shpeshta në regjistrat përkatës, kopja e arkivës elektronike përditësohet në fund të çdo muaji.

Neni 15

Ruajtja e regjistrit fizik

Regjistri fizik ruhet në mënyrën që sigurohet integriteti fizik.

Kartelat e regjistrit fizik mund të nxirren nga vendi ku mbahen apo të dërgohen për përpunim të dhënash vetëm me urdhër të Kryetarit.

K R E U IV Të dhënat, subjekt i regjistrave

Seksioni 1 Të dhëna të përgjithshme

Neni 16

Të dhëna të përgjithshme, subjekt i regjistrave për personat juridike

Në skedarin apo file-n e çdo subjekti juridik, shënohen këto të dhëna:

1. Emri i shoqërisë.
2. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1.
3. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë/ ekstrakti i regjistrimit në QKR- data e regjistrimit te subjektit.
4. Numri I NIPT-it
5. Selia.
6. Adresa, nr. i tel, fax, website dhe adresa e e-mail.
7. Selia dhe adresa e degëve (nëse ka).
8. Nr. dhe data e licencës.
9. Objekti i licencës.
10. Afati i aktivitetit (jetës) të shoqërisë.
11. Kapitali themelimit.
12. Numri dhe vlera nominale e aksioneve.
13. Llojet dhe klasat e aksioneve
14. Aksionmbajtësit dhe përqindja e zotërimit.
15. Aksionarët me pjesëmarrje influencuese.
16. Personat e lidhur.
17. Mënyra e transferimit të aksioneve
18. Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria.
19. Riorganizimi i shoqërisë në rast bashkimi, ndarje, transformimi.
20. Masat administrative, gjobat të vendosura nga Bordi për shoqërinë dhe për individë të caktuar
21. shënime të tjera.

Seksioni 2
Të dhënat specifike për disa regjistra

Neni 17
Për regjistrat e tregut të letrave me vlerë

Në regjistrin e shoqërive që operojnë si treg letrash me vlerë, përveç të dhënave të përmendura në nenin 16, do të shënohen:

1. Emrat e shoqërive - anëtarë të tregut.
2. Përfaqësuesit e licencuar që operojnë në treg.
3. Rregullat mbi të cilat operon tregu.
4. Emrat e kompanive të listuara në tregun zyrtar dhe jozyrtar.

Neni 18
Për regjistrat e shoqërive emetuese të letrave me vlerë

Në regjistrin e shoqërive emetuese të letrave me vlerë shënohen këto të dhëna:

1. Emri i shoqërisë.
2. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1.
3. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë.
4. Selia.
5. Adresa, nr. i tel, fax website dhe adresa e e-mail.
6. Vlera e kapitalit aksionar.
7. Vendimi i Bordit për miratimin e prospektit.
8. Të dhëna për letrat me vlerë që do emetohen: -lloji i letres me vlerë, -madhësia e emetimit, -vlera nominale, -çmimi i ofruar.
9. Shënime të tjera.

Neni 19
Për regjistrat e shoqërive të sigurimeve

Në regjistrin e shoqërive që operojnë si shoqëri sigurimesh, përveç të dhënave të përmendura në nenin 16, në pikën objekti i licencës do të shënohen: -të dhëna për klasat e sigurimeve për të cilat është dhënë licenca, -fondi i garancisë.

Neni 20
Për regjistrat e fondeve

Në regjistrin e shoqërive që operojnë si fonde investimi apo si fonde private pensionesh, përveç të dhënave të përmendura në nenin 16, do të shënohen:

1. Të dhëna mbi shoqërinë menaxhuese,
2. Të dhëna mbi depozitarin/regjistruesin.

Seksioni 3
Të dhëna për regjistrin e personave fizike të licencuar apo përfaqësuesve të shoqërive të licencuara

Neni 21

Regjistri i personave fizike të licencuar apo përfaqësuesve të shoqërive të licencuara do të përmbajë:

1. Emrin e personit fizik të licencuar apo autorizuar,
2. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1,
3. Të dhëna mbi personin: emri i babës, datëlindja, arsimi,
4. Nr. dhe data e lëshimit të licencës apo autorizimit,
5. Shoqërinë në emër dhe për llogari të të cilës vepron,
6. Vendi dhe adresa ku kryhet aktiviteti,
7. Masat administrative, gjobat të vendosura nga Bordi,
8. Shënime të tjera.

Neni 21/1
Të dhëna për subjektet që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë

1. Për subjektet, shoqëri tregtare, që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë, regjistri përmban këto të dhëna:

a. Emri i shoqërisë.
b. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1.
c. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë/ data e regjistrimit
d. Numri i NIPT-it.
e. Selia.
f. Adresa, nr. i tel, fax, website dhe adresa e e-mail.
g. Selia dhe adresa e degëve (nëse ka).
i. Afati i aktivitetit (jetës) të shoqërisë.
j. Drejtuesi i shoqërisë.
k. Personi përgjegjës për komunikimin dhe shpërndarjen e analizave financiare.
l. Shënime të tjera.

2. Për subjektet, tregtarë, që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë, regjistri përmban këto të dhëna:

a. Emri dhe mbiemri i tregtarit
b. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1.
c. Datëlindja dhe arsimimi.
c. Data e regjistrimit.
d. Numri i NIPT-it.
e. Vendi dhe adresa ku kryhet aktiviteti.
f. Nr. i tel, fax, website dhe adresa e e-mail.
g. Shënime të tjera.

Neni 22

Ç'regjistrimi nga regjistrat e Autoritetit

Heqja e licencës së subjektit të licencuar juridik apo fizik, shoqërohet me ç'regjistrim nga regjistri përkatës i Autoritetit. Të dhënat e tyre dërgohen në një regjistër të posaçëm të quajtur "Regjistri i refuzimeve"

Neni 23

Regjistri i pranimit të kërkesave për aplikim

Përveç regjistrave të përmendura në nenin 3 të kësaj rregulloreje, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit mban dhe një regjistër paraprak të quajtur "Regjistri i pranimit të kërkesave për aplikim". Mbajtja dhe ruajtja e regjistrit paraprak bëhet në të njëjtën mënyrë si dhe regjistrave të përmendura në këtë rregullore. Regjistrimet në regjistrin paraprak fillojnë që në momentin e paraqitjes së aplikimit për licencë/autorizim/miratim me urdhër të Drejtorit të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, dhe më tej me plotësimin e gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

K R E U V

Dispozitë transitore

Neni 24

Regjistrat e mbajtura nga KLV, AMS, IIPPS arkivohen. Hapja e regjistrave të rinj sipas mënyrës të përshkruar në këtë rregullore do të bëhet vetëm për subjektet me licencë efektive. Subjektet e tjera të licencuara/autorizuara nga KLV, AMS, IIPPS, të cilave u ka mbaruar afati i vlefshmërisë së licencës mbeten në regjistrat që do arkivohen.

Për efekt të ruajtjes së vazhdimësisë, nr. i licencës në regjistrin përkatës për subjektet, që licencohen në vazhdimësi do të vendoset duke u nisur nga nr. që trashëgohet nga regjistrat ekzistues.

"Për subjektet e licencuara qe ushtrojnë veprimtari ne tregun e letrave me vlere, nr. i licencës në regjistrin përkatës do te filloje nga numri 1 dhe do vazhdoje ne mënyrë kronologjike sipas kohës se licencimit. Data e licencës është data e riformatimit të licencës. Numërimi nga 1 behet për çdo regjistër."

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas një periudhe testimi prej 3 muajsh.

Kryetar

Elisabeta GJONI

Aneksi 1

Mënyra e përcaktimit të kodit të personit juridik apo fizik, - objekt regjistrimi, përcaktohet nga informaticieni që harton programin database.

Aneksi 2 Formati i skedarit të regjistrit fizik për Personat Juridik

Kodi i caktuar sipas aneksit 1

I. Të dhëna të përgjithshme

Emri i shoqërisë:_____

Forma ligjore e organizimit shoqërisë_____

Vendimi i regjistrimit në Gjykatë_____

Afati i aktivitetit (jetës) së shoqërisë

(Selia: Adresa) _____

Tel/Fax_____

Website _____

Adresa e-mail _____

Adresa e degëve (1)_____

(2)_____

(3)_____

Shoqëria menaxhuese _____

Regjistruesi/Depozitari_____

II. Të dhëna për licencën

Nr. dhe data e licencës_____ Objekti i

licencës _____ Klasat

III. Të dhëna për kapitalin

Kapitali i themelimit _____

Fondi i garancisë _____

Nr. dhe vlera e aksioneve në momentin e licencimit _____ / _____

Llojet dhe klasat e aksioneve _____

Aksionarët e shoqërisë në momentin e licencimit_____

Nr	Emri i aksionarit	Nr. i aksioneve që zotëron	Vlera absolute	% e zotërimit

Mënyra e transferimit të aksioneve _____

IV. Të dhëna për organet drejtuese

Drejtoria: Drejtori i Përgjithshëm _____
Drejtor Dege _____

Këshilli Mbikëqyrës : _____

V. Të dhëna të tjera

Masa administrative, gjoba _____
Riorganizimi i shoqërisë_____
Të tjera_____

Shënim: Në çdo skedar hidhen të dhënat në momentin e licencimit dhe çdo ndryshim i ndodhur sipas rubrikave të përcaktuara me sipër.

(Në çdo faqe)

Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi Personi i autorizuar për mbajtjen e regjistrit

Formati i skedarit të regjistrit fizik për Personat Fizikë

Kodi i caktuar sipas aneksit 1

I. Të dhëna të përgjithshme

Emër Mbiemër _____ Emri I Babait _____ Datëlindja _____ Arsimi _____

II. Të dhëna mbi licencën

Nr. dhe data e lëshimit licencës/autorizimit _____

Objekti i licencës _____

Vendi dhe adresa ku do kryhet aktiviteti _____

Datëlindja _____

Arsimi _____

_____/ _____

Shoqëria në emër dhe për llogari të së cilës vepron _____

III. Të dhëna të tjera

Masa administrative/gjoba _____ Shënime

të tjera _____

Shënim: Në çdo skedar hidhen të dhënat në momentin e licencimit dhe çdo ndryshim i ndodhur sipas rubrikave të përcaktuara më sipër.

(Në çdo faqe)

Emri Mbiemri dhe nënshkrimi nga personi i autorizuar për mbajtjen e regjistrit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 18, datë 21.03.2007
PËR
MIRATIMIN E SHTESËS MBI PAGË TË PUNONJESVE TË TI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 19, datë 21.03.2007

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 25.04.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË AKSIONARIT PERSON JURIDIK "EURO-ALBA"SH.A NË SHOQËRINË "EUROSIG" SH.A, SI REZULTAT I RRITJES SË FONDIT TË GARANCISË DHE MIRATIMIN E NDRYHSIMEVE TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 05.04.2007

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË AKTIVITETIT VJETOR TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 25.04.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË "ASPIS HOLDING PUBLIC COMPANY LTD" NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A, NGA SHITJA 51% E AKSIONEVE DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 05.04.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS SI TREGTAR LETRASH ME VLERË TË QEVERISË NË TREGUN ME PAKICË PËR SHOQËRINË "POSTA SHQIPTARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 25.04.2007

PËR

REVOKIMIN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A, PËR NDALIMIN E SHITJES SË KONTRATAVE TË REJA TË SIGURIMIT TË KLASËS 15 (SIGURIMI I GARANCISË)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 05.04.2007

PËR

MIRATIMIN E LICENCËS SHOQËRISË "KAPITAL INVEST" SH.A SI TREGTAR LETRASH ME VLERË TË QEVERISË NË BURSË DHE NË TREGUN ME PAKICË TË PËRFAQËSUESIT TË TREGTARIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 25.04.2007

MBI

LICENCIMIN E AGJENTËVE THANAS KOÇO, QESAR GJONI DHE GJYLIZANA RUZHDI IBI, NË SIGURIMIN E JO-JETËS NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË "INSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 05.04.2007

PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SI PËRFAQËSUES I TREGTARIT TË LICENCUAR PËR PËRFAQËSUESIT E SHOQËRISË "BANKA KOMBËTARE TREGTARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 25.04.2007

PËR
PRANIMIN E TËRHEQJES SË LICENCËS SË AGJENTIT NË SIGURIMIN E JO-JETËS NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË "INSIG" SH.A, ZJ. JORIDA META

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 05.04.2007

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2006, TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 25.04.2007

PËR
VENDOSJEN E SANKSIONIT ADMINISTRATIV NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A,PËR MIOSRESPEKTIM TË PRIMEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 05.04.2007

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2006, TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "SIGAL-LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 5.04.2007

PËR
PROVIGJONET TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 05.04.2007

PËR
MIRATIMIN E LOGOS SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 2, datë 10.05.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË "SIGAL HOLDING" SH.A AKSIONER I VETËM I SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A, SI REZULTAT I TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 10.05.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË "SIGAL HOLDING" SH.A AKSIONER I VETEM I SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-LIFE" SH.A, SI REZULTAT I TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 10.05.2007
PËR
ZGJERIMIN E LICENCËS SHOQËRISË "ALPHA BANK" SI REGJISTËR I LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË SË R.SH

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (c) të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 29, pika 2/d, të Ligjit nr. 8080, datë 1.03.1996 "Për letrat me vlerë", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e zgjerimit të objektit të licencës nr. 84, datë 13.02.2006, dhënë shoqërisë "Alpha Bank", me përmbajtje:
2. "....për të ushtruar veprimtari si regjistrues i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH".
3. Licenca e regjistruesit i jepet me afat të pacaktuar.
4. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 10.05.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS SI PËRFAQËSUES I TREGTARIT TË LICENCUAR PËR SHOQËRINË "POSTA SHQIPTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (c) të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 30 dhe 31, të Ligjit nr. 8080, datë 1.03.1996 "Për letrat me vlerë", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e licencës si përfaqësues i tregtarit të licencuar për shoqërinë "Posta Shqiptare", Zj. Etleva Filja.
2. Licenca jepet me afat të pacaktuar.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 17.05.2007

PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË PRIMIT NETO TË SIGURIMIT TË DETYRUESHEM MTPL E BRENDSHME, KUFITARE 15-45 DITORE DHE 1 VJEÇARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 17.05.2007

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 63, pika 1 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe nenit 14, pika 6/gj të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit "Intersig" sh.a, për emërimin e z. Qeram Çibuku në postin e drejtorit të përgjithshëm të kësaj shoqërie, për një periudhë 4 mujore, sipas propozimit të Këshillit Mbikëqyrës.

2. Drejtoria e shoqërisë "Intersig" i raporton Autoritetit dhe aksionerëve në fund të çdo muaji për gjendjen financiare të saj.

3. Ngarkohet shoqëria "Intersig" sh.a për zbatimin te këtij vendimi dhe Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 17.05.2007

PËR
MIRATIMIN Ë NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË "ALBSIG" SH.A, SI REZULTAT I ZMADHIMIT TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (d), të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në statutin e shoqërisë së sigurimit "ALBSIG" sh.a., si rezultat i zmadhimit të kapitalit në shumën 49 milion, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja.
2. Ngarkohen shoqëria e sigurimit "ALBSIG" sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Licencimit për njoftimet në zbatim të këtij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 18.06.2007

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KRITERET E RISIGURIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores "Për kriteret e risigurimit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Rregullorja "Për përcaktimin e kritereve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në R.SH mund të lidhin marrëveshje risigurimi", miratuar me vendimin e Bordit nr. 12, datë 8.02.2007, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun për publikimin e këtij vendimi në fletoren zyrtare dhe faqen zyrtare të internetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR KRITERET E RISIGURIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 2, datë 18.06.2007

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshje risigurimi nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 107, pika 4 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime".

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Shoqëri sigurimi" nënkupton një person juridik me seli qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi, në përputhje me kërkesat e Ligjit.

b) "Shoqëri risigurimi" nënkupton një person juridik, me seli qendrore në territorin e një shteti i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi, në përputhje me kërkesat ligjore të legjislacionit të Sigurimeve të atij shteti.

c) "Marrëveshje risigurimi" nënkupton një marrëveshje të përfunduar midis shoqërisë së sigurimit dhe të risigurimit, që përcakton termat dhe kushtet për rreziqet qe do të risigurohen

d) "Risigurim" nënkupton transferimin e një pjesë të rrezikut të siguruar nga shoqëria e sigurimit te shoqëria e risigurimit, sipas një marrëveshjeje, apo kontrate risigurimi.

e) "Risigurim Fakultativ" nënkupton transferimin e një pjese të një rreziku të veçantë të siguruar nga shoqëria e sigurimit te shoqëria e risigurimit, sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.

f) "Klasifikim i shoqërisë së risigurimit" nënkupton vlerësimin e parametrave financiarë të shoqërisë së risigurimit dhe që i është bërë shoqërisë së risigurimit nga shoqëritë e specializuara për këtë qëllim.

g) "Shtresë e mbulimit me risigurim" nënkupton një segment horizontal të përgjegjësisë së risiguruar. Shtresat e mbulimit me risigurim përcaktohen bazuar në shumën e siguruar.

Neni 4

Kriteret në përzgjedhjen e shoqërive risiguruese

a) Shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë, në përzgjedhjen e shoqërive risiguruese me të cilat lidh marrëveshje risigurimi, duhet garantojë që të përmbushin kriteret e mëposhtme:

– nuk duhet të jenë në proces falimentimi;

– lideri i marrëveshjes së risigurimit nuk mund të ketë klasifikimin më të ulët se:

o BBB+ nga Standard & Poor's (apo e kuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST);

– risiguruesit e kontraktuar për shtresat e pa limituara në marrëveshjen e risigurimit, nuk mund të kenë klasifikimin më të ulët se:

o BBB+ nga Standard & Poor's (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST);

– në secilën nga shtresat e marrëveshjes risiguruese, çdo risigurues pjesë e marrëveshjes së risigurimit, i cili ka 10% ose më shumë në atë shtresë, nuk mund të ketë klasifikimin më të ulët se:

o BBB- nga Standard & Poor's (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST);

– Jo më pak se 80% e mbulimit me risigurim në marrëveshjen e risigurimit për secilën nga shtresat e limituara në marrëveshjen risiguruese duhet të përbëhet nga shoqëri risigurimi të cilat kanë klasifikim jo më të ulët se:

o BBB- nga Standard & Poor's (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST);

b) Shoqëria e sigurimit ka përgjegjësinë të garantojë që çdo risigurues pjesë e marrëveshjes risiguruese me klasifikim më të ulët se BBB- nga Standard & Poor's (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST), të mos ketë kontraktuar përgjegjësi më të mëdha se 10% e kapitaleve të veta të tij.

c) Mbulimi në risigurim nëpërmjet kontratave fakultative të risigurimit duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

– 100% e mbulimit të palimituar duhet kryer me risigurues të cilët kanë klasifikim jo më të ulët se BBB nga Standard & Poor's (apo e kuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST) ;

– Shoqëria e sigurimit ka përgjegjësinë të garantojë që çdo risigurues pjesë e kontratës fakultative të risigurimit me klasifikim më të ulët se BBB- nga Standard & Poor's (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST), të mos ketë kontraktuar përgjegjësi më të mëdha se 10% e kapitaleve të veta të tij.

d) Shoqëria e sigurimit ka përgjegjësinë të marrë dhe të depozitojë në Autoritet të gjithë informacionin e nevojshëm për gjendjen financiare dhe pozicionin e shoqërisë risiguruese që mund të bëhet pjesëmarrëse në marrëveshjen, apo kontratën e risigurimit (sipas kufizimeve në pikat a, b dhe c më sipër), para nënshkrimit të marrëveshjes apo kontratës së risigurimit në rastet kur:

– Shoqëria e risigurimit nuk është e klasifikuar nga një prej agjencive klasifikuese Standard & Poors, Fitch Ratings, Moody's dhe AM Best,

– Ka klasifikim më të ulët se BBB-nga S&P (ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY'S, AM BEST)

Neni 5

Shqyrtimi i programit të risigurimit

a) Autoriteti pas shqyrtimit të programit të risigurimit, kur gjykon që shoqëritë risiguruese të kontrakuara nga shoqëria e sigurimit nuk përmbushin kriteret e parashikuara në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe këtë rregullore i kërkon shoqërisë së sigurimit:

– të bëjë ndryshimin e programit të risigurimit të shoqërisë ;

– çdo masë tjetër që shoqëria e sigurimit i propozon Autoritetit dhe pranohet nga ky i fundit.

b) Autoriteti shprehet lidhur me lejimin ose jo të pjesëmarrjes në marrëveshjet apo kontratat e sigurimit të shoqërive të risigurimit, të cilat janë subjekt i pikës d. te nenit 4 të kësaj rregulloreje, brenda 5 ditëve pune nga depozitimi i tyre prej shoqërisë së sigurimit.

Neni 6

Dispozita kalimtare

Shoqëritë e sigurimit detyrohen të zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje edhe për lidhjen e marrëveshjeve të risigurimit, të cilat nuk janë nënshkruar deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Të fundit

Udhëzimi "Për përcaktimin e kritereve të shoqërive të risigurimit, me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të lidhin marrëveshje risigurimi, i miratuar me Vendimin nr. 12, datë 08.02.2007 të Bordit të Autoritetit Mbikëqyrës Financiare, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë Rregullore, shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datë 18.06.2007.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 3, datë 18.06.2007

PËR
PROPOZIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE, DHE INVESTIMET E TYRE NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 18.06.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a, të z. Jetnor Haxhiaj, zj. Haxhire Shuka, z. Vaid Gjyli.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatimi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 18.06.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË BUXHETIN E AMF PËR VITIN 2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 13.07.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 13.07.2007

MBI
MARJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 13.07.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQERISE SE SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 13.07.2007

MBI
MARJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 13.07.2007

MBI

MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 13.07.2007

MBI

MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 13.07.2007

MBI
MARJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr .9, datë 13.07.2007

PËR
BLERJEN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS JURIDIKE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Blerjen e shërbimit të konsulencës juridike në fushën e pensioneve suplementare, nga ekspertë të jashtëm, për shumën 260 000 lekë.

2. Ngarkohet Sektori i Administrimit Financiar dhe Sektori i Shërbimeve dhe Prokurimeve, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 13.07.2007

PËR

PROPOZIMIN E NDRYSHIMEVE NË LIGJIN NR. 9267,

DATË 29.7.2004 "PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT, TË RISIGURIMIT

DHE NDËRMJETËSIMIT NË SIGURIME DHE RISIGURIME" I NDRYSHUAR, NË LIGJIN NR. 8080, DATË 1.03.1996 "PËR LETRAT ME VLERË" I NDRYSHUAR DHE NË LIGJIN NR. 7943, DATË 1.6.1995,"PËR PENSIONET SUPLEMENTARE DHE INSTITUTET PRIVATE TË PENSIONEVE" I NDRYSHUAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 13.07.2007

PËR
ZGJATJEN E AFATIT TË LICENCËS SI TREG I LETRAVE ME VLERË

Në bazë dhe për zbatim të kreut IV, të Ligjit nr. 8080, datë 1.03.1996 "Për letrat me vlerë" dhe të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licenca dhënë shoqërisë "Bursa e Tiranes" sh.a si treg i letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë, të borxhit të shoqërive dhe aksioneve, zgjatet me afat të pacaktuar, për sa kohë nuk ka ndryshime me efekte të ndjeshme në veprimtarinë e saj.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 13.07.2007

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 13.07.2007

PËR

SHPËRBLIMIN E DISA PUNONJËSVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 30.08.2007

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LICENCIMIT TË VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 30.08. 2007

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR KRITERET DHE KUSHTET E LICENCIMIT TË NDËRMJETËSVE NË SIGURIME, SI DHE RREGULLAT PËR MBIKËQYRJEN E TYRE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 30.08. 2007

PËR

PROPOZIMIN E UDHËZIMIT MBI TRAJTIMIN E DËMEVE TË MBULUARA NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 30.08. 2007

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT UDHËZIMIT MBI ADMINISTRIMIN E MIRË TË DËMEVE NË SIGURIME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 30.08. 2007

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTRREGULLORES "RREGULLAT E BRËNDSHME TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 30.08. 2007

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE DHE SHTESAVE NË STATUTIN E SHOQËRISË "BURSA E TIRANËS" SH.A.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 30.08. 2007

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A, SI REZULTAT I ZMADHIMIT TË KAPITALIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 30.08. 2007
PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL -LIFE" SH.A, SI REZULTAT I ZMADHIMIT TË KAPITALIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 30.08.2007
PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 30.08.2007
PËR
STRUKTURËN DHE NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE DHE STRUKTURËN E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 30.08.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË TBIH FINANCIAL SERVICES GROUP N.V, SI REZULTAT I BLERJES SË 75%+1 AKSIONEVE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6/h, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe të neneve 56 dhe 57 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime", i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të shoqërisë TBIH Financial Services Group N.V., si rezultat i blerjes së 75%+1 aksioneve të shoqërisë së sigurimit "Sigma" sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkivës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 30.08. 2007

PËR

MIRATIMIN E PLANIT FINANCIAR TË RISHIKUAR PËR VITIN 2007 TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 30.08 2007

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT PLANIT FINANCIAR PËR VITIN 2008 TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Projekt Planit Financiar për vitin 2008 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas pasqyrave 1 dhe 2 bashkëngjitur.
2. Ky vendim i dërgohet Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës dhe Ministrisë së Financës.
3. Ngarkohet Sektori i Administrimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 03.10.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK"

Në bazë dhe për zbatim të 121, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, pikat 20,21,22 dhe 23, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK

Miratuar me vendimin e Bordit nr.3, datë 03.10.2007

Neni 1
Objekti

Objekti i kesaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të neneve 121, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", të nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr. 9572, date 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe pikës 20,21,22 dhe 23 të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.192 datë 25.03.2005 "Per kriteret dhe procedurat e licensimit të agjentëve në sigurime dhe rregullat e për mbikëqyrjen e veprimtarise së tyre".

Neni 3
Fusha e Veprimit

Kjo rregullore zbatohet për shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit të cilët ushtrojnë veprimtari në klasat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik, që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Policat e sigurimit të detyrueshëm motorik që janë subjekt identifikimi dhe raportimi sipas kësaj rregulloreje janë policat për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, policat e kartonit jeshil dhe policat e sigurimit kufitar.

Neni 4
Raportimi dhe Identifikimi i Policave

Shoqëria e sigurimeve identifikon dhe raporton shitjen e cdo police sigurimi të detyrueshëm motorik, vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik të sigurimeve të detyrueshme motorike, të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëritë marrin të gjitha masat për të furnizuar këtë bazë të dhënash në kohë reale online për cdo shitje policash, menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Shoqëria merr të gjitha masat për të përshtatur platformat respektive të shitjeve online për të

operuar në përputhje me pikat e mësipërme.

Shoqëria e sigurimeve autorizon nje punonjës për administrimin e platformës respektive të shitjeve online.

Shoqëria e sigurimeve njofton Autoritetin për cdo ndryshim në lidhje me punonjësin e autorizuar për administrimin e platformës respektive të shitjes online.

Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të identifikojë cdo ndërmjetës dhe punonjës që do të realizojë dhe raportojë shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike të instaluar në ambjentet e Autoritetit.

Neni 5

Kostot mbi Mirëadministrimin e Projektit

Për ngritjen e regjistrit të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe të programit përkatës për përpunimet statistikore të të dhënave, kontribuon financiarisht shoqëria e sigurimit të jo-jetës.

Për përgatitjen e një programi kompjuterik, të instaluar në serverat e Autoritetit, i cili emeton një numër unik të rastësishëm në kohë reale për të identifikuar çdo policë sigurimi që kërkohet të shitet online nga shoqëritë e sigurimit të jo-jetës, kontribuon financiarisht shoqëria e sigurimit të jo-jetës.

Për të ruajtur vazhdimësinë dhe operimin e pandërprerë të programeve të identifikimit dhe raportimit të shitjeve pranë Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare dhe për të mundësuar furnizim të pandërprerë energjie dhe alternativë back-up për operimin e sistemit, kontribuon financiarisht shoqëria e sigurimit.

Shoqëritë mbulojnë kostot për përditësimin apo përmirësimin në të ardhmen të software-ve të përmendura më sipër, sa herë që të lind nevoja.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vë në dispozicion serverat e tij për instalimin e regjistrit online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike dhe të programit të emetimit të numrit të rastësishëm unik.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ngre një njësi për administrimin e Regjistrit Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike.

Neni 6

Specifikimet Teknike

Baza e të dhënave të regjistrit, programi statistikor dhe programi i gjenerimit të numrit unik duhet të kenë karakteristikat e renditura në Aneksin 1 bashkëngjitur.

Skema e detajuar dhe karakteristikat e proçesit të identifikimit dhe raportimit të shitjeve të policave është paraqitur në Aneksin 2, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të vendosin një linjë të dyte komunikimi me server-at e vendosur në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe server-in e Back-Up.

Neni 7

Mënyra e Funksionimit

Shoqëritë e sigurimeve raportojnë cdo policë sigurimi të detyrueshëm nëpermjet këtij sistemi ku dhe këto të fundit identifikohen me anë të numrit të rastësishëm.

Të dhënat e kërkesës për shitje nga terminalet e shoqërive vijnë në kohe reale në serverat e AMF-së. për cdo kërkesë programi emeton automatikisht një numër unik të rastësishëm i

cili shtypet në policë në momentin e lëshimit nga rrjeti i shitjes. Ky numër i rastësishëm është unik dhe i trajtës alfanumerike dhe shërben për të vërtetuar raportimin e policës në bazën e të dhënave qëndrore në Autoritet.

Menjëherë pas lëshimit të policës të dhënat e policës dërgohen për efekt raportimi në regjistrin e sigurimeve të detyrueshme motorike të instaluar në serverat e AMF-së.

Anullimet e policave do të kryhen vetëm nga personel i autorizuar i shoqërisë dhe më të drejta eskluzive të atribuara në sistem nga njësia e administrimit të Regjistrit Online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Neni 8

Përgjegjësitë për Mirëmbajtjen e Programit dhe Rrjetit

Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse që të garantoj dhe të mirëmbajë në bashkëpunim me Autoritetin operimin e pandërprerë të databazës qëndrore dhe të programit të gjenerimit të numrit unik.

Shoqëria e sigurimit të jo-jetës është përgjegjëse për komunikimin midis serverit qëndror të tyre dhe serverit qëndror të vendosur në Autoritet dhe serverit të Back-Up. Shoqëritë e sigurimeve në rast ndërprerje të linjave të komunikimit detyrohen të përdorin një linjë të dytë komunikimi për rikthim në gjendje funksionaliteti të sistemit.

Autoriteti është përgjegjës për funksionimin e plotë të serverit të vendosur në Ambjentet e tij dhe të serverit Back-Up. në rast të daljes jashtë funksionimit të serverave të mësipërm, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të vënë në dispozicion servera të përshtatshëm për vazhdimin e raportimit.

Ruajtja fizike dhe elektronike e të dhenave që regjistrohen në sistem do të kryhet në ambientet e AMF-së dhe të Institucionit ku do të vendoset serveri Back-Up nga personeli i autorizuar i AMF-së

Mbështetja teknike dhe mirëmbajtja e programeve kryhet nga personeli i autorizuar nga AMF, të asistuar sipas nevojës nga specialistët e subjektit që kanë ndërtuar programet.

Regjistri elektronik i raportimit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik operon 24 orë në 7 ditë.

Suporti i ketij sistemi do të garantohet në nivel 24 orë, për 7 ditë në javë.

Neni 9

Mosrespektimi i Rregullores

Rastet e evidentimit të policave të paidentifikuara në sistemin qendror, rastet me numër identifikimi të dubluar, rastet me numër identifikimi jo korrekt, rastet e cënimit të sigurisë së sistemit, përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore në fushën e sigurimit dhe kësaj rregulloreje.

Çdo veprim i parashikuar në paragrafin e mësipërm, i cili bie në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje, është objekt sanksionimi sipas nenit 165, pika 1, shkronja (g) dhe (i), të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

Neni 10

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datë 10 nëntor 2007.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

ANEKSI 1

KARAKTERISTIKAT SPECIFIKE TË PROGRAMIT TË EMETIMIT TË NUMRIT IDENTIFIKUES (KEY GENERATOR) TË BAZËS SË TË DHËNAVE.

Formati do të jetë i formës:

- {KLASA,KODI I AGJENTI, PESE NUMRAT E FUNDIT të SHASISE, HASH}
- Në total jo më shumë së 30 karaktere, ku me HASH nënkuptohet algoritmi i enkriptimit i cili nuk do të jetë sekuencial dhe do të aprovohet nga AMF
- Për inpute do të përdoren Klasa e Automjetit sipas kategorizimit të Urdhërit të Ministrit të Financave, Kodi i agjentit, informacione të policës si koha e lëshimit, targa e automjetit, shasia, patenta.
- Të gjeneroj numra të rastësishëm sipas një algoritmi të përcaktuar nga Autoriteti.
- Ti bashkangjisë numrit serial të policës numrin e gjeneruar.
- Numrat e gjeneruar të jenë unik.
- Algoritmi të ndryshohet vetëm me miratim nga Autoriteti.
- Të mos realizohet shitja në rast së mungon numri i unik.
- Informacionet e mbledhura nga ky numër duhet të jenë të depozituar në një database i cili në pak minuta duhet të plotësohet dhe me pjesën tjetër të informacioneve të policës.

KARAKTERISTIKAT E BAZES SË TË DHËNAVE DHE TË PROGRAMIT TË PERPUNIMIT STATISTIKOR.

Karakteristikat e bazës së të dhënave

Baza e të dhënave e raportimit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm duhet të përmbajë këto të dhëna:

- Informacion nga pika e shitjes që ka leshuar kontratën e sigurimit, kodi i agjentit, ku të dallohet dhe qyteti ose rajoni.
- Numrin e policës së sigurimit.
- Serinë e policës së sigurimit.
- Emri dhe Mbiemri i policëmbajtesit të ndara si informacione.
- Emri dhe Mbiemri i secilit përdorues dhe në rastet që nuk ka ky informacion të plotësohet me një karakter të specifikuar në nivel baze të dhënash.
- Datëlindja e secilit përdorues, gjinia, adresa si dhe numri i telefonit.
- Informacion mbi patentën e seicilit përdorues, ku të përfshihen klasa dhe data e marrjes së patentës. Në rastin kur përdoruesi ka dhe klasa të vecanta si ajo e motocikletave dhe e mjeteve bujqësore të shënohet informacioni i klasës së patentës sipas kategorisë së automjetit.

- Targa e automjetit e cila duhet të jetë e standartizuar në format sipas shembullit të mëposhtëm:
  - TR 0000 A për targat e kësaj trajte shënim të vecante në një fushe të dyte në rast së kemi të bëjmë me taxi.
  - TR 000 A për targat e kësaj trajtë dhe me shënim të vecante në një fushe të dyte në rast së kemi të bëjmë me taxi.
  - Format për targat e trupit diplomatik.
  - Format për targat ushtarake.
  - Format për targat e organizatave nderkombëtare dhe me shënim të vëcantë në një fushë të dyte në rast së kemi të bëjmë me një organizatë të tillë.
  - Për sigurimin kufitar nuk është e nevojshme standartizim mbi targën.
- Marka e automjetit.
- Modeli ose tipi i automjetit.
- Shasia e automjetit.
- Kategoria e automjetit sipas Urdhërit te Ministrit te Financave.
- Fuqia motorike e automjetit .
- Numri i vëndeve të automjetit në standartin shifër totale (dhe jo e trajtës 4+1).
- Kapaciteti bartës i automjetit.
- Ngjyra e automjetit.
- Viti i prodhimit të automjetit.
- Data e lëshimit të policës në formatin dd/mm/yyyy.
- Data e fillimit të kontratës së sigurimit në formatin dd/mm/yyyy.
- Data e përfundimit të kontratës në formatin dd/mm/yyyy.
- Primi i sigurimit.
- Lloji i monedhës.
- TVSH.
- Primi Total.

Karakteristikat e programit përpunues statistikor.

- Të ketë module për gjenerimin e raporteve, statistikave dhe analizave të ndryshme.
- Module për verifikimin e policave të lëshuara në bazë të programit të gjenerimit të numrit unik.
- Module për inventarizimin e policave.
- Module për anullimin dhe dublikimin e policave.
- Module për lëshimin e policave në bazë të numrit unik.
- Module alarmi për skenar të ndryshëm abuzimi të përcaktuara nga autoriteti.
- Module krahasimi me database të tjerë të jashtëm nga sistemi.
- Të realizojë shkrirjen e databasave ekzistues.

ANEKSI 2

Skema dhe Karakteristikat specifike për Procesin e Identifikimit dhe Raportimit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik

Kërkesa për policë të re

Operacioni Fillestar i web servisit doLogin

Operacioni i dytë i web servisit doRequest

Operacioni i tretë i web servisit doSendData

Operacioni i katërt i web servisit doSavePolice

Anullimi i një policë ekzistuese

Operacioni Fillestar i web servisit doLogin

Operacioni i dytë i web servisit doCancelPoliceRequest

Operacioni i tretë i web servisit doCancelPolice

Dublikimi i një policë ekzistuese

Operacioni Fillestar i web servisit doLogin

Operacioni i dytë i web servisit doDublicatePoliceRequest

Operacioni i tretë i web servisit doSendDataForDublicate

Operacioni i katërt i web servisit doSaveDublikate

Web Servisi i hostuar në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për programin e Sigurimeve Online.

Web servisi mund të aksesohet me adresë URL të aprovuar vetëm nga Autoriteti.

Web servisi ruan gjëndjen gjatë komunikimeve të njëpasnjëshme me klientët që tentojne të përdorin funksionalitetin e tij.

Rradha e veprimeve që duhet të kryhen për të marrë në mënyrë të sukseshme kodin e gjeneruar nga AMF vijon si më poshtë.

A. Kërkesa për policë të re

1. Klienti therret një instancë të web servisit.

2. Ruan sesionin për instancën e mësipërme.

3. Thirret operacioni fillestar i web servisit doLogin.

Ky operacion merr dy parametra:

A. Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një përdorues i vlefshëm me po të njëjtin emër.
B. Fjalëkalimim - variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë.

Pas lidhjes me sukses me bazën e të dhënave me përdorues dhe fjalëkalimin e përshatshëm, kthehet një përgjigje për regjistrim të suksesshëm, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

4. Thirret operacioni i dyte i web servisit doRequest.

Ky operacion merr 4 parametra:

a) Kodin e Shoqërisë së Sigurimit – variable i tipit string.
b) Kodin e Agjensisë – variable i tipit string.
c) Kodin e Agjentit – variable i tipit string.
d) Kodin e llojit të policës – variable i tipit string.

Ne bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojnë të dhëna të vlefshme për shoqërinë e sigurimit, agjensinë e shoqërisë së sigurimit, agjentin ose punonjësin që i përket agjensisë së shoqërise së sigurimit si dhe tipin e policës (psh. TPL, Karton Jeshil ose Policë Kufitare)

Pasi është bërë kërkesa dhe ajo ka rezultuar e vlefshme, web servisi i kthen përgjigje thirrësit të tij, për pranim të kërkesës, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

5. Thirret operacioni i trete i web servisit doSendData.

Ky operacion merr si parametra të gjitha të dhënat për policën. Parametrat vijojnë si më poshtë:

Nr.	Parametri	Gjatësia	Detyrueshëm?	Pershkrimi
1	Nr. Serial i policës.	VARCHAR2(7)	PO	---
2	Nr. i shitjes së policës.	NUMBER	PO	---
3	Data e shitjes.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
4	Data e fillimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
5	Data e mbarimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
6	Data e pagesës së policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
7	Primi i policës.	NUMBER	PO	---
8	TVSH-ja.	NUMBER	PO	---
9	Total i pagesës.	NUMBER	PO	---
10	Kodi i shoqërisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
11	Kodi i agjensisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
12	Kodi i agjentit.	VARCHAR2(8)	PO	---
13	Kodi i kategorisë së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
14	Kodi i klasës së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
15	Kodi i llojit të policës.	VARCHAR2(2)	PO	1 - TPL 2 - Kartoni Jeshil 3 - Polica Kufitare
16	Kodi i periudhës së policës.	VARCHAR2(2)	PO	1 - 1 vjecare 2 - 15 ditore 3 - 20 ditore 4 - 25 ditore 5 - 30 ditore 6 - 45 ditore
17	Nr. Shasisë së mjetit.	VARCHAR2(18)	PO	---
18	Nr i lejes së qarkullimit.	VARCHAR2(7)	JO	---
19	Shënime për policën.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për policën.
20	Targa e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---

21	Marka e mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
22	Modeli i mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
23	Ngjyra e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
24	Viti i prodhimit i mjetit.	NUMBER(4)	PO	---
25	Nr. i vendeve të mjetit.	NUMBER(3)	PO	---
26	Kapaciteti bartës i mjetit.	NUMBER	PO	---
27	Fuqia motorike e mjetit.	NUMBER	PO	---
28	Shenime për mjetin.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për mjetin.
29	Nr. patentës i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
30	Emri pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
31	Mbiemri pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
32	Emri i Babait të pronarit.	VARCHAR2(30)	JO	---
33	Gjinia e pronarit.	VARCHAR2(1)	PO	M ose F
34	Datëlindja e pronarit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
35	Nipti i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Nese tipi i klientit është subjekt, atëherë plotësimi i kësaj fushe është e detyrueshme.
36	Kodi fiskal i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Nëse tipi i klientit është subjekt, atëherë plotësimi i kësaj fushe është e detyrueshme.
37	Adresa e pronarit.	VARCHAR2(100)	JO	---
38	Nr. telefoni i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
39	Nr. fax i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
40	Nr. celularit i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
41	Kodi tipit të klientit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 – përdorues 3 – subjekt
42	Nr. patentës i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
43	Data e leshimit të patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
44	Data e skadimit të patentes të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy

45	Klasa e patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(2)	JO	---
46	Emri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
47	Mbiemri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
48	Emri i babait të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	---
49	Gjinia e përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	---
50	Datelindja e përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
51	Nipti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
52	Kodi fiskal i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Ne varësi të kodit të tipit të klientit.	---
53	Adresa e përdoruesit të parë mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
54	Nr. telefonit i përdoruesit të pare të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
55	Nr. fax të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
56	Nr. Celularit të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
57	Kodi tip klienti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 - përdorues 3 - subjekt
58	Nr patentës i përdoruesit të dytë, të mjetit.	VARCHAR2(18)	JO	
59	Data e leshimit të patentes të perdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
60	Data e skadimit të patentës të përdoruesit të dytë, të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy

61	Klasa e patentës e përdoruesit të dyte të mjetit.	VARCHAR2(2)	JO	
62	Emri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
63	Mbiemri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
64	Emri i babait i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
65	Gjinia e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	M ose F
66	Datelindja e përdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
67	Nipti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Plotësohet nëse përdoruesi i dytë është subjekt.
68	Kodi fiskal i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
69	Adresa e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
70	Nr. telefonit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
71	Nr. fax i përdoruesit të dytë, të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
72	Nr. celularit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
73	Kodi tip klienti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 - përdorues 3 - subjekt

Të gjithë parametrat e këtij operacioni dërgohen si strings sipas formateve të përcaktuara më lart.

Në qoftë së të dhënat e dërguara plotësojnë kushtet e lartpërmendura atëherë, kthehet një përgjigje për marrjen me sukses të të dhënave, në të kundert, kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

6. Thirret operacioni i katërt i web servisit doSavePolice.

Ky operacion i Web Servisit nuk kërkon asnjë parametër.Në qofte së të dhënat ruhen me sukses atëherë thirrësit i kthehet kodi i policës dhe lidhja me bazën e të dhënave shkëputet, në të kundërt, gjenerohet një mesazh gabimi.

B. Anullimi i një policë ekzistuese

Rradha e operacioneve të web servisit që duhet të thirren për të kryer anullimin e një police vijon si më poshtë.

1. Klienti thërret një instancë të web servisit.

2. Ruan sesionin për instancën e mësipërme.

3. Thirret operacioni fillestar i web servisit doLogin.

Ky operacion merr dy parametra:

a) Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-se duhet të ekzistojë një perdorues i vlefshëm me po të njejtin emer.
b) Fjalëkalimim - variable i tipit string. në bazen e të dhenave të AMF-se duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë.

Pas lidhjes me sukses me bazën e të dhënave me përdorues dhe fjalëkalimin e përshtatshëm, kthehet një përgjigje për login të suksesshëm, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

4. Thirret operacioni i dytë i web servisit doCancelPoliceRequest.

Ky operacion merr një parametër të vetëm, kodin e policës që dëshirohet të anullohet.

Psh. doCancelPoliceRequest(<kodi i polices>)

Nese polica është në një status i cili mund të anullohet atëherë web servisi kthen një

përgjigje për pranim me sukses të kërkesës për anullim, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

5. Thirret operacioni i trete i web servisit doCancelPolice.

Ky operacion i web servisit nuk merr asnjë parametër në hyrje. Në qofte së anullimi kryhet me sukses atëherë kthehet një përgjigje për anullim të suksesshëm të policës, në të kundert kthehet një mesazh gabimi.

C. Dublikimi i një police ekzistuese

Rradha e operacioneve të web servisit që duhet të thirren për të kryer dublikimin e një policë vijon si me poshtë.

1. Klienti thërret një instancë të web servisit.
2. Ruan sesionin për instancën e mësipërme.
3. Thirret operacioni fillestar i web servisit doLogin.

Ky operacion merr dy parametra:

a) Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-se duhet të ekzistojë një përdorues i vlefshëm me po të njëjtin emër.

b) Fjalëkalimin - variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-se duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë

Pas lidhjes me sukses me bazën e të dhënave me përdorues dhe fjalëkalimin e përshtatshëm, kthehet një përgjigje për login të suksesshem, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

4. Thirret operacioni i dyte i web servisit doDublicatePoliceRequest.

Ky operacion i web servisit merr në hyrje një parametër të vetëm, kodin e policës që kërkohet të dublikohet. Pasi kryhet një kontroll për statusin e policës që dëshirohet të dublikohet, web servisi kthen një përgjigje për pranim të kërkesës, ose për mospranim të saj pasi në statusin që ndodhet polica nuk mund të dublikohet.

5. Thirret operacioni i tretë i web servisit doSendDataForDublicate.

Nr.	Parametri	Gjatësia	Detyrueshëm?	Pershkrimi
1	Nr. Serial i policës.	VARCHAR2(7)	PO	---
2	Nr. i shitjes së policës.	NUMBER	PO	---
3	Data e shitjes.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm. yyyy
4	Data e fillimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm. yyyy
5	Data e mbarimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm. yyyy
6	Data e pagesës së policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm. yyyy
7	Primi i policës.	NUMBER	PO	---
8	TVSH-ja.	NUMBER	PO	---
9	Total i pagesës.	NUMBER	PO	---

10	Kodi i shoqërisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
11	Kodi i agjensisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
12	Kodi i agjentit.	VARCHAR2(8)	PO	---
13	Kodi i kategorisë së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
14	Kodi i klasës së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
15	Kodi i llojit të policës.	VARCHAR2(2)	PO	1 - TPL 2 - Kartoni Jeshil 3 - Polica Kufitare
16	Kodi i periudhës së policës.	VARCHAR2(2)	PO	1 - 1 vjecare 2 - 15 ditore 3 - 20 ditore 4 - 25 ditore 5 - 30 ditore 6 - 45 ditore
17	Nr. Shasisë së mjetit.	VARCHAR2(18)	PO	---
18	Nr i lejes së qarkullimit.	VARCHAR2(7)	JO	---
19	Shënime për policën.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për policën.
20	Kodi i policës që dëshirohet të dublikohet	VARCHAR2(18)	PO	---
21	Targa e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
22	Marka e mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
23	Modeli i mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
24	Ngjyra e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
25	Viti i prodhimit i mjetit.	NUMBER(4)	PO	---
26	Nr. i vendeve të mjetit.	NUMBER(3)	PO	---
27	Kapaciteti bartës i mjetit.	NUMBER	PO	---
28	Fuqia motorike e mjetit.	NUMBER	PO	---
29	Shenime për mjetin.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për mjetin.
30	Nr. patentës i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
31	Emri pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
32	Mbiemri pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
33	Emri i Babait të pronarit.	VARCHAR2(30)	JO	---
34	Gjinia e pronarit.	VARCHAR2(1)	PO	M ose F
35	Datëlindja e pronarit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy

36	Nipti i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Nese tipi i klientit është subjekt, atëherë plotësimi i kësaj fushe është e detyrueshme.
37	Kodi fiskal i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Nëse tipi i klientit është subjekt, atëherë plotësimi i kësaj fushe është e detyrueshme.
38	Adresa e pronarit.	VARCHAR2(100)	JO	---
39	Nr. telefoni i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
40	Nr. fax i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
41	Nr. celularit i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
42	Kodi tipit të klientit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 – përdorues 3 – subjekt
43	Nr. patentës i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
44	Data e leshimit të patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
45	Data e skadimit të patentes të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
46	Klasa e patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
47	Emri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
48	Mbiemri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
49	Emri i babait të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	---
50	Gjinia e përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	---
51	Datelindja e përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy

52	Nipti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
53	Kodi fiskal i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Ne varësi të kodit të tipit të klientit.	---
54	Adresa e përdoruesit të parë mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
55	Nr. telefonit i përdoruesit të pare të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
56	Nr. fax të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
57	Nr. Celularit të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
58	Kodi tip klienti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 - përdorues 3 - subjekt
59	Nr patentës i përdoruesit të dytë, të mjetit.	VARCHAR2(18)	JO	
60	Data e leshimit të patentes të perdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
61	Data e skadimit të patentës të përdoruesit të dytë, të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
62	Klasa e patentës e përdoruesit të dyte të mjetit.	VARCHAR2(2)	JO	
63	Emri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
64	Mbiemri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
65	Emri i babait i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
66	Gjinia e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	M ose F
67	Datelindja e përdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy

68	Nipti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Plotësohet nëse përdoruesi i dytë është subjekt.
69	Kodi fiskal i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
70	Adresa e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
71	Nr. telefonit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
72	Nr. fax i përdoruesit të dytë, të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
73	Nr. celularit i përdoruesit të dytë të mjetit. Kodi tip klienti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
		VARCHAR2(1)	JO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 - përdorues 3 - subjekt

Të gjithë parametrat e këtij operacioni dërgohen si stringa sipas formateve të përcaktuara më lart.

Në qoftë së të dhënat e dërguara plotësojnë kushtet e lartpërmendura atëherë, kthehet një përgjigje për marrjen me sukses të të dhënave, në të kundërt, kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

6. Thirret operacioni i katërt i web servisit doSaveDublikate.

Ky operacion i web servisit nuk merr asnjë parametër në hyrje. Në qoftë se dublikimi i policës përfundon me sukses, atëherë web servisi kthen kodin e policës dublikate, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi ku shpjegohen arsyet e gabimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E UDHËZIMIT "MBI PARIMET DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË SIGURISË SË INFORMACIONIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 9, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2007 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

V E N D O S I:

1. Miratimin e Udhëzimit "Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen strukturat përkatëse të Autoritetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

UDHËZIM

MBI
PARIMET DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË SIGURISË SË INFORMACIONIT

1. Të Përgjithshme

1.1 Objekti

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i parimeve dhe rregullave të përgjithshme të Sigurisë së Informacionit në AMF dhe përcaktimi i përgjegjësive për veprimet që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e *integritetin*, *disponueshmërisë* dhe *konfidencialitetit* të aseteve të informacionit të Autoritetit.

1.2 Baza Ligjore

Udhëzimi hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 9 të ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Finanaciare".

1.3 Fusha e Zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për çdo pjesëtar të personelit, i cili akseson informacionin në pronësi ose të administruar nga AMF dhe synon të mbulojë në mënyrë të gjerë dhe të përgjithshme të gjitha burimet dhe sistemet e informacionit në pronësi ose përdorim nga AMF.

1.4 Parimet e Sigurisë

Në përputhje me Politikën e Sigurisë së Informacionit, objektivi kryesor për sigurinë e informacionit është të ruajë *integritetin*, *disponueshmërinë* dhe *konfidencialitetin* e aseteve të informacionit të Autoritetit. Termat e mësipërme përcaktohen si më poshtë:

Integriteti

Gjatë gjithë kohës informacioni duhet të jetë i plotë, i saktë dhe i qëndrueshëm ndaj modifikimeve të paautorizuara ose ndaj dëmtimeve.

Disponueshmëria

Informacioni bëhet i aksesueshëm sa herë që është e nevojshme. Kjo do të thotë që të gjitha informacionet dhe të gjitha sistemet e informacionit janë të disponueshme dhe operacionale (të gatshme për punë) sa herë që nevojitet një gjë e tillë.

Konfidencialiteti

Informacioni konfidencial përdoret vetëm nga persona të autorizuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për informacionet me ndjeshmëri të lartë.

Përgjegjësia

Të gjithë personat, qofshin këta nëpunës, kontraktues, konsulentë ose përdorues të jashtëm, mbajnë përgjegjësi për pasojat qe rrjedhin direkt nga veprimet e tyre dhe që kanë të bëjnë me asetet e informacionit të AMF. Çdo nëpunësi i bëhen të qarta përgjegjësit e tij në lidhje me detyrën që kryhen.

Mbrojtja fizike

Të gjitha asetet e informacionit të Autoritetit mbrohen në shkallën më të lartë nga dëmtimet fizike.

1.5 Objektivat e Sigurisë

1. Aksesimi i të gjitha sistemeve të informacionit të Autoritetit kontrollohet rreptësisht për të garantuar integritetin dhe mbrojtjen e tyre.
2. Të gjitha sistemet (përfshirë këtu mjediset e zhvillimit, të testimit dhe produktet) mbrohen nga kërcënimet dhe nga dëmtimet fizike.
3. Të gjithë individët mbajnë përgjegjësi direkte për veprimet që kryejnë mbi asetet e informacionit të Autoritetit.
4. Çdo person që autorizohet të aksesojë sistemet e AMF, për identifikimin e tij, ka një llogari përdoruesi unike të përbërë nga një emër (user name) dhe një fjalëkalim (password). Llogaria e përdoruesit do të çaktivizohet automatikisht pas tre muajsh mospërdorimi. Përdoruesi detyrohet të mbajë të fshehtë fjalëkalimin e tij dhe ta ndryshojë atë në mënyrë periodike sa më shpesh të jetë e mundur. Fjalëkalimi duhet të jetë konform politikave të njohura të sigurisë të shpjeguara më poshtë. Aksesimi i pajisjeve dhe i sistemeve të AMF bëhet në përputhje me detyrat funksionale të përdoruesit. Asnjë përdoruesi nuk i lejohet të aksesojë lirisht funksionet e ndryshme të sistemeve.
5. Ndalohet rreptësisht përdorimi i të njëjtës llogari, prej dy ose më shumë përdoruesve. Çdo rast i tillë trajtohet si një *shkelje serioze e rregullave të sigurisë*..
6. Çdo sistem i Autoritetit në përdorim është i aksesueshëm nga një sistem menush dhe mbi bazën e aksesimit unik. Asnjë nga sistemet e Autoritetit, në asnjë rrethanë, nuk do të lejojë hyrjen e njëkohshme të më shumë se një përdoruesi me të njëjtin fjalëkalim.
7. Për të gjitha përdorimet e sistemeve mbahen log-e (shënime të shkurtuara). Log-et shqyrtohen rregullisht, me qëllim identifikimin e shkeljeve (thyerjeve) të sigurisë.
8. Përpara se të bëhen zhvillime/ndryshime aplikimesh, hartohen masa/procedura sigurie, të miratuara nga Drejtoria e TI.
9. Mjediset e zhvillimit, të testimit dhe produktet janë maksimalisht të ndara. Asnjë zhvillim/ndryshim aplikimi nuk duhet të kryhet në mjedise testimi ose produkti. Për këtë do të jetë e detyrueshme kryerja me rigorozitet e kontrolleve të zëvendësimit dhe të kalimit të aplikimeve nga ambienti i tyre i zhvillimit në atë të testimit dhe nga ai i testimit, në atë te produktit.
10. Për çdo mjedis të teknologjisë së informacionit (këtu përfshihen pajisjet në dhomën e serverave, bazat e të dhënave dhe të gjitha pajisjet e rrjetit të brendshëm të Autoritetit)

hartohen masa/procedura sigurie. Ato klasifikohen si KONFIDENCIALE dhe kopja origjinale e tyre do të ruhet në mënyrë të sigurt nga administratori përgjegjës i sigurisë i teknologjisë së informacionit.

11. Masat e sigurisë zhvillohen në përputhje me funksionimin e sistemeve të Autoritetit, prej një regjimi pune 24 orë në ditë, për 7 ditë në javë.

Aksesimi i përdoruesve-Përdoruesit e brendshëm

12. Fillimisht, punonjësit e Autoritetit nuk kanë të drejta aksesimi në sistemet e saj. Më pas, atyre u jepet vetëm një nivel minimal aksesimi, i domosdoshëm për kryerjen e detyrave që ata mbulojnë.
13. Dhënia e të drejtave të aksesimit në sisteme bazohet në nevojat e institucionit dhe jo në kërkesat apo në dëshirat personale .
14. Aksesimi i sistemeve të Autoritetit përcaktohet në bazë të detyrave të punonjësve, të cilat pëcaktohen qartë.. Kur një përdorues i sistemeve ndryshon detyrë, ai humbet të drejtat e aksesimit që lidheshin me detyrën e mëparshme.
15. Akumulimi në kohë i privilegjeve duhet të monitorohet dhe të shmanget.

Aksesimi i përdoruesve-Përdoruesit e jashtëm

16. Asnjë përdorues i jashtëm nuk mund të ketë akses në sisteme të AMF-së derisa të autorizohet me shkrim nga Autoriteti.
17. Përpara se t'u jepet e drejta e aksesimit, të gjithë përdoruesit e jashtëm të sistemeve të Autoritetit nënshkruajnë një deklaratë, ku pranojnë se do të respektojnë të gjitha rregullat/procedurat e këtij udhëzimi.
18. Të gjithë përdoruesit e jashtëm identifikohen në mënyrë të qartë (log-in) para se t'u jepet e drejta e aksesimit në sisteme.
19. Të dhënat që vijnë nga përdoruesit e jashtëm të sistemeve të Autoritetit mbrohen gjatë gjithë kalimit dhe hyrjes së tyre në sisteme.

1.6 Kontrolli i dokumenteve

Administratori për sigurinë e informacionit (Personi i ngarkuar për sigurinë në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit) është përgjegjësi për këtë udhëzim dhe mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e tij.

Administratori për sigurinë e informacionit kujdeset që:

- I gjithë personeli i Autoritetit të inkurajohet vazhdimisht të bëjë komente dhe sugjerime tek administratori i sigurisë për modifikimin e udhëzimit.
- Administratori për sigurinë e informacionit paraqet një raport periodik me shkrim para *Drejtorit të Teknologjisë së Informacionit* në çdo periudhë të planifikuar, duke dhënë komentet mbi funksionimin e udhëzimit dhe rekomandimet për çdo modifikim ose shtesë të nevojshme.
- Udhëzimi të jetë objekt i një procedure zyrtare vjetore rishikimi, nën kontrollin e administratorit përgjegjës për sigurinë.

1.7 Politika dhe Procedura në Funksion të Sigurisë së Informacionit

Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit përgatit politika dhe procedura, në zbatim të këtij udhëzimi, për çështje të cilat janë të rëndësishme për ruajtjen e sigurisë së informacionit.

Nr	Titulli
1	Politika e sigurisë së informacionit
2	Politika për përdorimin të e-mailit dhe internetit
5	Procedurat e Back-up
6	Administrimi i fjalëkalimeve
6	Inventarizimi i aseteve të informacionit
7	Procedura për administrimin e kompjuterave portativë
8	Procedurat e administrimit të ndryshimeve
9	Procedura për administrimin e dokumentacioneve
10	Procedura për administrimin e sistemeve operative Windoës XP dhe Windoës 2000
11	Procedura per aksesin fizik ne dhomën e serverave

2. Siguria e Institucionit dhe përgjegjësitë

2.1 Përgjegjësitë për sigurinë

I gjithë personeli është përgjegjës për respektimin dhe për ruajtjen e nivelit të kërkuar të sigurisë gjatë kryerjes së detyrave. Ai vepron vazhdimisht në përputhje me udhëzimin për parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit. Në këtë udhëzim, me "personel" kuptojmë të gjithë ata persona të cilëve u lejohet aksesi në asetet e Autoritetit dhe në mënyrë të veçantë asetet e informacionit. Këtu përfshihen:

- punonjësit e Autoritetit;
- kontraktorët e Autoritetit;
- nëpunësit e ofruesve të shërbimeve (service providers) të Autoritetit;
- konsulentët;
- palë të tjera me të drejtë aksesi.

Administratori përgjegjës për sigurinë

Administratori përgjegjës për sigurinë mban të gjitha përgjegjësitë për sigurinë e informacionit të AMF-së.

Në veçanti ai:

- shqyrton këtë rregullore dhe përcakton të gjitha përgjegjësitë;
- monitoron ndryshimet e rëndësishme që ekspozojnë asetet ndaj kërcënimeve të mëdha;
- shqyrton, monitoron, parandalon dhe kundërvepron ndaj thyerjeve të rënda të sigurisë
- miraton projekte të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të sigurisë.
- Administratori për sigurinë raporton rregullisht (jo më pak se një herë në tre muaj) tek Eprori direkt.

Drejtorët e Drejtorive

Siguria e informacionit është përgjegjësi e çdo drejtuesi strukture. Në përputhje me këtë, të gjithë drejtuesit janë përgjegjës:

- të sigurojnë njohjen e personelit me politikën e sigurisë së informacionit, me këtë udhëzim, procedurat dhe standardet e publikuara për sigurinë e informacionit në AMF;
- për vlerësimin e vazhdueshëm të riskut të sigurisë në fushën ku ata drejtojnë;
- të sigurohen që të gjitha të drejtat për aksesimin e aseteve të Autoritetit (përfshi këtu kompjuterat, llogaritë e përdoruesve, çelësat dhe çdo gjë tjetër) të hiqen menjëherë, për çdo pjesëtar të personelit (i përhershëm ose me kontratë) që largohet nga AMF ose që kalon në një departament apo në një detyrë tjetër;
- për aplikimin e llogarive të reja për përdoruesit apo modifikimin e llogarive aktuale, për nivele të duhura sigurie dhe për të drejta aksesimi (përfshi aksesin fizik), për pjesëtarët e rinj të personelit;
- për dhënien e së drejtës për aksesimin personelit jashtë departamentit të tyre, në lidhje me asetet e informacionit dhe sistemeve kompjuterike për të cilat ata janë përgjegjës;
- për dhënien e së drejtës për ndryshimin (korrigjimin) e çdo hedhjeje gabim të të dhënave në sistemet specifike të teknologjisë së informacionit për të cilin ata janë përgjegjës.

Administratori i Sigurisë

Detyrë e Administratorit të Sigurisë është të krijojë, të zbatojë dhe të mirëmbajë një program sigurie që të ndihmojë Autoritetin në mbrojtjen e aseteve të informacionit. Administratori i Sigurisë është përgjegjës për:

- krijimin, për të gjithë Autoritetin, të standardeve dhe të udhëzuesve për sigurinë e informacionit dhe sigurinë fizike;
- përmirësimin e vazhdueshëm të këtij udhëzimi;
- imponimin e zbatimit të rregulloreve dhe për ruajtjen e standardeve të sigurisë;
- zhvillimin dhe kryerjen e një fushate të vazhdueshme për sigurinë për ndërgjegjësimin e punonjësve të AMF;
- trajnimin e personelit në lidhje politikat dhe me procedurat e sigurisë;
- kryerjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm (të paktën një herë në vit) të analizës së riskut;
- rishikimin e vazhdueshëm (një herë në tre muaj) të të drejtave të aksesimit të informacioneve;
- rishikimin e vazhdueshëm (një herë në gjashtë muaj) të masave të sigurisë ndaj ofruesve të shërbimeve të jashtme, veçanërisht personelit që punon me kontratë në ambientet e Autoritetit;
- rishikimin e rregullt (një herë në tre muaj) të privilegjeve për aksesimin e sistemeve të kompjuterave;
- kontrollin për heqjen e menjëhershme të llogarive të përdoruesve që japin dorëheqjen ose largohen nga puna për arsye të tjera;

- drejtimin e kontrolleve të sigurisë, përfshi këtu organizimin e rregullt të kontrolleve të jashtme;
- shqyrtimin e thyerjeve të sigurisë që raportohen;
- raportimin rregullisht (të paktën një herë në tre muaj) tek Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit mbi gjendjen e sigurisë.

2.2 Aksesimi i të Tretëve

Personat, të cilët nuk janë punonjës të AMF dhe institucionet (organizatat) të tjera, lejohen të aksesojnë asetet e informacionit të Autoritetit vetëm në bazë të kushteve të përcaktuara në një marrëveshje zyrtare. Këto kushte duhet të mbulojnë të drejtat dhe detyrimet e të gjithë personave dhe organizatave që janë të interesuara të aksesojnë asetet e informacionit të AMF, përfshirë këtu sipas mundësisë:

- politikën e përgjithshme për sigurinë e informacionit të Autoritetit;
- kufizimet në kopjimin dhe në shpërndarjen e informacionit;
- një përshkrim për secilin prej shërbimeve që do të ofrohet nga Autoriteti;
- nivelin e synuar dhe atë të papranueshëm të shërbimeve;
- klauzolat për ndryshimin e personelit nëse është e nevojshme;
- detyrimet respektive të palëve që bëjnë marrëveshjen;
- përgjegjësitë për të respektuar përputhjen me ligjin dhe me rregulloret;
- mbrojtjen e të drejtës së autorit të Autoritetit, si dhe të palëve të treta;
- metodat e lejuara të aksesimit dhe kontrolli i përdorimit të fjalëkalimit të përdoruesit;
- procesin e dhënies së të drejtës për aksesim;
- një kërkesë për të mbajtur një listë të personave të autorizuar për të përdorur shërbimet e kërkuara dhe të të drejtave të tyre përkatëse;
- përcaktimin e kritereve të verifikueshme të performancës, monitorimin e tyre dhe raportimin;
- të drejtën për të monitoruar dhe për të ndërprerë aktivitetin e përdoruesit;
- të drejtën për të kontrolluar/verifikuar zbatimin e përgjegjësive kontraktore;
- përgjegjësitë që kanë të bëjnë me instalimin dhe me mirëmbajtjen e pajisjeve dhe të programeve;
- një strukturë të qartë raportimi dhe miratim të formateve të raportimit;
- kërkesën për të zbatuar procedurat e Autoritetit për administrimin e ndryshimeve mbi sistemet e informacionit;
- mbrojtjen nga programet keqdashëse;
- procedurat për raportimin, për njoftimin dhe për shqyrtimin e thyerjeve të sigurisë;
- detyrimin e palëve të treta për të kërkuar zbatimin e këtyre kushteve edhe nga nën kontratorët e tyre.

3. Klasifikimi dhe kontrolli i aseteve

3.1 Përgjegjësia për asetet

Të gjitha asetet kryesore për aktivitetin normal të Autoritetit vlerësohen dhe për këtë ngarkohet një person përgjegjës i caktuar. Përgjegjësia për asetet garanton mbajtjen në mënyrë të vazhdueshme të një niveli të mjaftueshëm sigurie. Për të gjitha asetet e rëndësishme të informacionit do të përcaktohen "përgjegjësit" së bashku me përgjegjësitë përkatëse për ruajtjen e masave të duhura të sigurisë, të cilat duhet të specifikohen qartë. Zbatimi i masave të sigurisë mund të delegohet, por në çdo rast përgjegjësia duhet t'i mbetet përgjegjësit të asetit.

3.2 Regjistri i aseteve të informacionit

Për sistemet e informacionit, hartohet dhe mbahet në mënyrë të vazhdueshme një regjistër që mbulon të gjitha asetet kryesore për çdo sistem duke përfshirë:

- *asetet e informacionit*: bazat e të dhënave dhe skedarët e të dhënave, dokumentacionin e sistemeve, manualet e përdoruesit, materialet e trajnimit, procedurat operacionale, planet e vazhdueshmërisë së punës, rregullat dhe procedurat e rikuperimit të të dhënave të humbura, informacionin e arkivuar;
- *programet*: programet aplikative, programet e sistemit, mjetet për zhvillimin e mëtejshëm të tyre dhe mjetet ndihmëse;
- *asetet fizike*: pajisjet kompjuterike, pajisjet e komunikimit, shiritat magnetikë, pajisje të tjera teknike (për shembull: kabllot e energjisë elektrike, pajisjet e ajrit të kondicionuar), mobiljet;
- *shërbimet*: shërbimet kompjuterike, shërbimet e komunikimit dhe utilitetet e përgjithshme.

Për çdo aset në regjistër mbahet:

- *përshkrimi i tij;*
- *përgjegjësi i tij*. ky është administratori i njësisë (departamentit, sektorit ose degës) së AMF. Përgjegjësi është përgjegjës për pranimin e dizenjimit të sistemit dhe të funksionalitetit të tij dhe vendos rregullat për trajtimin, për administrimin dhe për aksesimin e aseteve të informacionit, në përputhje me rregullat e AMF;
- *kujdestari*. është njësia e Autoritetit e cila "kujdeset" për asetin e informacionit, domethënë zbaton dhe mbron rregullat e përcaktuar nga përgjegjësi. Derisa, të mos jetë kryer ndonjë përcaktim, për sistemet specifike, kujdestari për të gjitha sistemet e Autoritetit është Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit;
- *klasifikimi*. nënkupton një tregues të ndjeshmërisë së informacionit siç përshkruhet në 3.3;
- *niveli i rëndësisë*. përcakton rëndësinë e aseteve të informacionit për Autoritetin, në bazë të periudhës kohore maksimale gjatë të cilës Autoriteti mund të vazhdojë të punojë, pa i pasur ato në dispozicion;
- *përdoruesit e autorizuar dhe tipet e lejuara të aksesimit* (lexim, shkrim, kopjim, ndryshim, fshirje);
- *krijimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e regjistrit të aseteve të informacionit* është përgjegjësi i Drejtorisë së TI, e cila konsultohet me përgjegjësit. Regjistri duhet të rishikohet të paktën një herë në gjashtë muaj.

3.3 Klasifikimi i Informacionit

Disa nga informacionet të cilat i trajton Autoriteti, i nënshtrohen klasifikimeve zyrtare të sigurisë së informacionit, siç përcaktohet në aktet e tjera rregullatore të Autoritetit në lidhje me transparencën dhe konfidencialitetin. Nivelet e klasifikimit të informacioneve jopublike janë "Informacion sekret" dhe "Informacion konfidencial". Si rregull, dokumentet që përmbajnë informacione të klasifikuar në një vend tepër të dukshëm duhet të shënojnë dhe llojin e klasifikimit. Është e rëndësishme që Autoritetit të identifikojë:

- informacionin, që do të klasifikohet "konfidencial" ose "sekret";
- çdo informacion tjetër të Autoritetit, i cili mund të ketë nevojë për klasifikim të mëtejshëm më specifik.

Pronari i çdo aseti informacioni është përgjegjës për klasifikimin e tij në përputhje me udhëzimet e Autoritetit.

3.4 Analiza e Riskut

Administratori i sigurisë kryen një analizë vjetore zyrtare të riskut për asetet e informacionit të AMF sipas procedurave që rekomandohen në standardet ndërkombëtare të ndjekura nga institucionet e tjera homologe. Rezultatet e analizës së riskut do të përdoren për të përcaktuar strategjitë për zbutjen e çdo risku që identifikohet dhe do të rishikohen nga Drejtoria e TI, të paktën çdo vit.

3.5 Administrimi i Ndryshimit të Dokumenteve

Për të gjitha dokumentet e rëndësishme ndiqet Procedura e Administrimit të Dokumenteve. Çdo dokument duhet të përmbajë një seksion identifikues të personave të parashikuar për ta marrë ose për ta lexuar atë. Kur është e mundur, dokumenti duhet të identifikoje gjithashtu versionin, datën dhe natyrën e çdo ndryshimi në të.

4. Siguria e Personelit

4.1 Manualet e vendeve të punës dhe punësimi

Çdo punonjës ka përgjegjësitë e tij në lidhje me sigurinë. Përgjegjësia për sigurinë përcaktohet që në fazën e marrjes në punë dhe përfshihet në manualet e vendeve të punës dhe në kontratat e punësimit.

DREJTUESIT E DREJTORISË DUHET TË SIGUROJNË QË NË PËRSHKRIMIN E DETYRËS (MANUALET E VENDEVE TË PUNËS) TË ADRESOHEN ÇËSHTJET E SIGURISË QË LIDHEN ME TË.

Rolet dhe përgjegjësitë që lidhen me sigurinë, duhet të përfshihen në manualet e vendeve të punës, në mënyrë të veçantë për pozicionet drejtuese, kjo siguron përgjegjësinë e të gjithë punonjësve. Manualet e vendeve të punës duhet të përfshijnë si përgjegjësitë që kanë të bëjnë me zbatimin ose me mirëmbajtjen e rregullave të përgjithshme të sigurisë, ashtu dhe ato specifike për mbrojtjen e aseteve të veçanta ose për ekzekutimin e proceseve të veçanta.

TË GJITHA APLIKIMET PËR PUNËSIM SHQYRTOHEN ME KUJDES NGA PIKËPAMJA E SIGURISË.

Të gjitha pranimet duhet të bëhen në përputhje me rregullat e dokumentuara. Aplikimet për punësim duhet të kontrollohen me kujdes nga pikëpamja e sigurisë. Në të gjitha kontratat e pranimit në punë përfshihet një deklaratë ku punonjësit e rinj duhet të pranojnë me shkrim, se bihen plotësisht dakort me kërkesat e Autoritetit mbi konfidencialitetin .

4.2 Procedurat e Fillimit dhe të Largimit nga Puna

PËRGJEGJËSIA E DREJTORËVE TE DREJTORIVE/SEKTORËVE PËR TË GARANTUAR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË SIGURISË NË PUNËSIM.

Drejtorët e drejtorive janë përgjegjës për të garantuar që punonjësve të rinj të strukturave përkatëse u është dhënë niveli i duhur i aksesimit në pajisjet dhe në sistemet e Autoritetit, përfshi këtu llogaritë e përdoruesve për kompjuterat, miratimin e lejes së aksesimit të sistemeve, të dhomave të serverave, të nyjeve të rrjetit, kartat magnetike apo me chip për aksesimin e mjediseve, etj.

Të gjitha aplikimet që bëhen për dhënien e të drejtës së aksesimit në sistemet kompjuterike të Autoritetit (përfshi këtu llogarinë personale fillestare për pjesëtarët e rinj të personelit dhe çdo ndryshim në vazhdim në të drejtat për aksesimin e sistemeve) bëhen me shkrim, duke përdorur një formular standard, i cili firmoset nga drejtori i drejtorisë ku bën pjesë punonjësi. Ato miratohen nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit para se të kryhen veprimet nga njësia helpdesk.

Çdo pjesëtari të ri i cili i bashkohet personelit të Autoritetit, duhet t'i kërkohet aty ku është e nevojshme, të firmosë për të gjitha pajisjet e aksesimit, duke pranuar njëkohësisht kushtet e përdorimit të tyre. Të gjithë pjesëtarëve te rinj u jepen instruksione të plota për procedurat e teknologjisë së informacionit dhe në veçanti për kërkesat në lidhje me çështjet e sigurisë. Këto instruksione duhet të përfshijnë të paktën:

- përdorimin e përgjithshëm të mjeteve të teknologjisë së informacionit;
- ndihmën e kualifikuar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (TI helpdesk);
- familjarizimin me Politikën e Sigurisë së Autoritetit dhe rregullat e sigurisë;
- trajtimin e informacioneve konfidenciale;
- politikën e përdorimit të internetit, të e-mailit, etj.;
- rregulloret për fjalëkalimet.

Kjo bëhet para se atyre t'u hapet ndonjë llogari përdoruesi ose t'u jepen privilegje për të aksesuar sistemet e Autoritetit.

Drejtorët e drejtorive janë përgjegjës për të garantuar zbatimin e procedurave të sigurisë në rastet kur pjesëtarë të personelit të tyre largohen nga puna.

Është përgjegjësi e çdo drejtori departamenti/drejtorie/sektori të siguroje, që kur një pjesëtar i personelit largohet nga puna, t'i hiqen të gjitha të drejtat e aksesimit dhe t'i kërkohet të

dorëzojë të gjitha kartat e aksesimit, çelësat, shënimet, kompjuterat, etj., të cilat i ka pasur në përdorim. Procedurat e teknologjisë së informacionit për mbylljen e llogarisë së përdoruesit dhe për heqjen e të drejtave të aksesimit të sistemeve të Autoritetit, duhet të bëhen para se pjesëtari i stafit të largohet fizikisht nga ambienti i punës.

Personi përgjegjës i caktuar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (helpdesk-u) informohet, sa më shpejt që të jetë e mundur, kur ndonjë pjesëtar i personelit e lë punën ose afati i tij i punësimit mbaron për çdo lloj arsye. Është përgjegjësi e drejtorit të drejtorisë përkatëse, të sigurojë që kjo gjë të kryhet sa më parë. Punonjësit të cilëve u ndërpriten marrëdhëniet e punës, u kërkohet të largohen nga Autoriteti menjëherë. Ndërsa punonjësit, të cilët kanë kërkuar vullnetarisht largimin e tyre për arsye të ndryshme mund të vazhdojnë punën normalisht edhe për një periudhë mbasi ata të kenë kërkuar largimin. Njoftimi tek helpdesk-u, për largimin nga puna të një personi të caktuar, duhet të përmbajë udhëzimet për korrektimin e të drejtave të përdoruesit të personit qe do të largohet. Zgjedhjet për korrektimin e te drejtave do të përfshijnë:

- fshirjen e menjëhershme të llogarisë së përdoruesit;
- heqjen e disa privilegjeve të aksesimit;
- mbajtjen e nivelit aktual të privilegjeve të aksesimit që ka përdoruesi, por duke rritur nivelin e auditimit për këtë përdorues.

Është përgjegjësi e drejtorit të departamentit përkatës të kërkojë nivelin e duhur të korrektimit.

4.3 Planet e Vazhdueshmërisë dhe të Zëvendësimit

Planet për vazhdueshmërinë dhe për zëvendësimin e të gjitha pozicioneve të rëndësishme (kyçe) të punës rishikohen periodikisht. Këto plane hartohen për rastet e emergjencës, përfshi këtu pamjaftueshmërinë, largimin dhe lëvizjet e planifikuara të personelit.

Këtu përfshihen jo vetëm pozicionet e administratorëve dhe mbikëqyrësve, por gjithashtu, edhe ato që kanë lidhje me sigurinë e teknologjisë së informacionit.

4.4 Trajnimi

Personat që kanë akses në asetet e informacionit të Autoritetit janë të detyruar të jenë të vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë në Autoritetit. I gjithë personeli duhet të marrë trajnimin e nevojshëm për rregullat dhe për procedurat organizative dhe të sigurisë. Ky trajnim kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur pas fillimit të punës së punonjësve të rinj, (shih 4.2). Objektivat e edukimit në lidhje me sigurinë duhet të jenë:

- krijimi i kulturës së sigurisë në të gjithë Autoritetin;
- edukimi i personelit mbi pasojat e veprimeve të tyre mbi sigurinë e informacionit;
- udhëzimi i personelit për rregullat dhe procedurat e sigurisë sipas pozicioneve përkatëse;
- përcaktimi i përgjegjësive që mban çdo person mbi sigurinë dhe detyra e secilit për të raportuar çdo shkelje të rregullave të sigurisë.

Gjithashtu, i gjithë personeli duhet të trajnohet për përdorimin korrekt të sistemeve kompjuterike dhe të aseteve të informacionit. Kjo bëhet para se t'u jepet e drejta të aksesojnë sistemet. Drejtoria e TI përgjigjet për zhvillimin dhe për shpërndarjen e materialeve të trajnimit.

PERSONELI I DREJTORISË SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Të gjithë specialistët e teknologjisë së informacionit duhet të marrin rregullisht trajnime përmirësuese në fushat e tyre të specializimit. Kjo duhet të përfshijë veçanërisht personelin e sigurisë, administratorët e bazave të të dhënave, administratorët e sistemeve operative dhe sistemeve të sigurisë (p.sh: Firewall, IDS, IPS, Network Management, Content Filtering, Application Security, etj.) I gjithë personeli i teknologjisë së informacionit duhet të ndjekë seminare periodike në fushat e interesit të përgjithshëm, veçanërisht në ato që lidhen me sigurinë.

4.5 Përgjigja ndaj Incidenteve

Një *incident sigurie* është çdo ngjarje e cila mund të ndikojë në integritetin, disponushmërinë dhe në konfidencialitetin e informacionit. Dëmtimet si pasojë e incidenteve të sigurisë dhe të keqfunksionimeve minimizohen dhe, sa herë që është e mundur të parandalohen. Incidentet që ndikojnë mbi sigurinë duhet të vlerësohen me seriozitet dhe të raportohen menjëherë.

RAPORTIMI I INCIDENTEVE OSE DOBËSIVE TË SIGURISË

Për të gjitha rastet e ngjarjeve që lidhen me sigurinë ndiqet një procedurë formale *për* raportimin e incidenteve . Të gjithë nëpunësit, kontraktorët dhe personeli i ofruesve të jashtëm të shërbimeve duhet të jenë të vetëdijshëm (ta njohin e ta zbatojnë) për këtë procedurë. Përveç kësaj, i gjithë personeli inkurajohet për të raportuar çdo dobësi të sigurisë ose çdo kërcënim të vënë re në procedura, në sisteme dhe në shërbime.

RAPORTIMI I KEQFUNKSIONIMIT TË PROGRAMIT TEK DREJTORIA TI

Për të minimizuar çdo ndërprerje të shërbimeve apo çdo dëmtim të të dhënave, është shumë e nevojshme që keqfunksionimi i programeve të korrektohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Keqfunksionimet e dukshme të programeve i raportohen Drejtorisë së TI, e cila përgjigjet menjëherë dhe udhëzon në lidhje me mënyrën e veprimit në raste të tilla.

4.6 Shkelja (thyerja) e Rregullave dhe Procedurave të Sigurisë

Kur administratori (drejtor drejtorie/sektori) gjykon se veprimtaria e një punonjësi nuk është në përputhje me rregullat dhe procedurat e sigurisë, për çfarëdolloj arsyeje, ai është i detyruar të organizojë një takim me punonjësin për të diskutuar çështjen dhe për të planifikuar veprimet korrigjuese.

NË ÇDO RAST DYSHIMI PËR SHKELJE TË RREGULLAVE DHE PROCEDURËS SË SIGURISË, NDIQET NJË PROCES ZYRTAR DISIPLINOR.

Drejtori i drejtorisë nën përgjegjësinë e të cilit është personi i dyshuar për shkelje, njofton sa më shpejt të jetë e mundur dhe siguron dokumentacion të plotë për Drejtorinë e TI. Në rastet kur shkelja vërtetohet dhe është mjaft serioze, rishikohet vazhdimi i punës për individin në fjalë. Në rrethana të veçanta tepër serioze, shkelja mund të raportohet në organet përkatëse sipas ligjit.

4.7 Ndarja e Përgjegjësive

Për të minimizuar mundësinë e mashtrimit ose të keqpërdorimit të të dhënave, asnjë individ nuk merr i vetëm përgjegjësi të plotë për një proces të tërë. Proceset e hedhjes dhe daljes së të dhënave duhet të realizohen nga individë të ndryshëm. Në mënyrë të ngjashme, të gjitha njohuritë në lidhje me një sistem, një proces ose për një pjesë të tyre, nuk duhet të mbahen asnjëherë nga një person i vetëm. Njohuritë dokumentohen në mënyrë të qartë dhe të njihen të paktën edhe nga një person tjetër.

5. Siguria Fizike dhe e Mjediseve

5.1 Siguria e Ambienteve (ndërtesave)

Aksesimi i të gjitha ambienteve të sistemeve të informacionit në Autoritet do të kontrollohet rreptësisht dhe në çdo kohë, në mënyrë që të parandalohen humbjet ose kompromentimet e aseteve të informacionit dhe të aseteve të tjera.

KARTAT E AKSESIMIT

Të gjitha ambientet kritike sigurohen me sisteme aksesimi dhe karta elektronike, çdo punonjës i autorizuar për një ambient specifik pajiset me një kartë individuale aksesi. Administratori i ndërtesave është personi përgjegjës për mbajtjen e të dhënave në lidhje me të gjitha aksesimet e autorizuara, ku përfshihen detaje si : emri i punonjësit, drejtoria, data kur është lëshuar karta, ora dhe dita deri kur i lejohet aksesimi. Është e detyrueshme mbajtja e logeve për të gjitha aktivitetet e aksesimit, kur sistemet e aksesimit të ambienteve e lejojnë një gjë të tillë.

VIZITORËT

Vizitorëve të Autoritetit nuk duhet t'u lejohet lëvizja e lirë, e pakontrolluar në ambientet kritike. Identiteti i vizitorëve verifikohet nga rojet, të cilët janë përgjegjës për njoftimin e personave që do të shoqërojnë vizitorët. Çdo vizitor duhet të pajiset me një shenjë identifikimi të përkohshme para se të lejohet të hyjë. Vizitorët, punonjësit e mirëmbajtjes dhe persona të tjerë të huaj, duhet të shoqërohen gjatë gjithë kohës nga punonjës të autorizuar të Autoritetit. Në veçanti, vizitorëve nuk duhet t'u lejohet të aksesojnë ambientet me akses të kufizuar, sidomos në vendndodhjet e serverave, të pashoqëruar nga një person i autorizuar nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit. I gjithë personeli duhet të inkurajohet të nxjerrë jashtë çdo person të panjohur, të cilin mund ta gjejë në hapësirat me akses të kufizuar. Përgjegjësia për të siguruar largimin e vizitorit nga godina pasi puna e tij ka përfunduar, dhe rikthimi i çdo karte që i është dhënë, mbetet mbi personin e fundit i cili ka qenë në kontakt me vizitorin.

5.2 Siguria e Pajisjeve

Të gjitha pajisjet e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe të gjitha pajisjet e tjera kritike duhet të mbrohen fizikisht nga kërcënimet e sigurisë dhe nga rreziqet e mjedisit.

DHOMAT E SERVERAVE

Të gjithë serverat dhe pajisjet e komunikimit (domethënë routerat, switch-et, firewall-et, PBX etj.) duhet të vendosen në dhoma apo në ambiente të mbyllura e të sigurta. Aksesi në këto dhoma duhet të lejohet vetëm për personelin e autorizuar nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit.

Të gjitha aksesimet në dhomat e të kompjuterave dhe në nyjet e rrjetit duhet të jenë të kontrolluara dhe të mbahet log-e ku të shënohet emri i personit ose i personave, arsyet e hyrjes, data/ora dhe veprimet e kryera. Dhomat e kompjuterave duhet të pajisen me karta sigurie, ajër të kondicionuar, me kamera, me UPS, detektorë dhe me fikësa zjarri. Të gjitha pajisjet në dhomat e serverave duhet të sigurohen kundër dëmtimeve apo tërmeteve.

KOMPJUTERAT PERSONALË

Kompjuterat personalë (PC) duhet të vendosen në përputhje me standardet e Autoritetit për instalimin dhe përdorimin e PC. Në veçanti, ata nuk duhet të vendosen në vende ku personat e paautorizuar kanë mundësi të shohin informacionet sensitive që ndodhen në to. Ato duhet të instalohen ose të transferohen (lëvizen) vetëm nga një personel i trainuar dhe i autorizuar nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit.

NXJERRJA JASHTË GODINAVE

Ky seksion zbatohet për kompjuterat personalë apo çdo formë tjetër mjetesh që mbajnë ose që përpunojnë informacione. Të gjitha pajisjet e Autoritetit, të cilat duhet të nxirren jashtë ndërtesave duhet të jenë po aq të sigurta sa edhe pajisjet që ndodhen brenda tyre, duke marrë parasysh riskun e të punuarit jashtë godinave të Autoritetit. Të dhënat në hard-disk për kompjuterat portabwl (laptop), do të enkriptohen duke përdorur programe të miratuara enkriptimi. Gjithashtu, skedarët apo dokumentet në këto laptopë, duhet të sigurohen dhe t'i jepen privilegje eskluzive aksesimi vetëm ndaj llogarive të përdoruesve që kanë të drejta t'i aksesojnë ato. Pajisjet dhe mediat (përfshi këtu dokumentet sensibël në letër) që nxirren jashtë godinave të Autoritetit, nuk duhet të lihen në vende publike (përfshi këtu makinat) të pambrojtur. Është e detyrueshme që ato të shkatërrohen në mënyrë të parekuperueshme kur nxirren përfundimisht jashtë pune.

5.3 Siguria e Aseteve

I gjithë personeli është përgjegjës për të garantuar sigurinë e aseteve që janë nën kontrollin e tyre.

SENDET ME VLERA TË VEÇANTA

Pajisjet dhe media magnetike të ruajtjes të të dhënave (dispozitivët me shirit magnetik) do të nxirren jashtë vendndodhjes së tyre, vetëm në përputhje me *procedurën e dokumentuar për lëvizjet* dhe me miratimin më parë te drejtorit të drejtorisë përkatëse.

INFORMACIONI SENSITIV

Informacioni i klasifikuar *Konfidencial* ose *Sekret*, në letër ose në trajtë elektronike, duhet të nxirret jashtë vetëm në përputhje me procedurat e lëvizjes dhe duke pasur më parë miratimin e drejtorit të drejtorisë përkatëse.

LARGIMI I MEDIAVE MAGNETIKE

Asetet e informacionit mund të kompromentohen nga pakujdesia në largimin e pajisjeve. Përpara se të nxirren jashtë përdorimit ose të eliminohen, të gjitha pajisjet kompjuterike duhet të kontrollohen për t'u siguruar që të dhënat dhe programet e licencuara janë hequr në përputhje me procedurat e paracaktuara nga Autoriteti. Këtu përfshihen edhe pajisjet që nxirren jashtë Autoritetit për t'u riparuar. Tape-t magnetikë, të nxjerrë përfundimisht jashtë Autoritetit, duhet të shkatërrohen, mundësisht të digjen.

5.4 Siguria e Komunikimit

Të gjitha format e komunikimit duhet të jenë të mbrojtura kundër humbjeve, ndërhyrjeve dhe korruptimit.

TELEFONAT

Pajisjet telefonike sigurohet të jenë të mbrojtura nga aksesimi dhe përdorimi i paautorizuar. Masat që duhet të merren përfshijnë:

- kontrolle fizike për aksesimin e pajisjeve të centralit telefonik;
- kontrolle për ndalimin e përdorimit të modemeve (ose të pajisjeve të tjera) për aksesimin e rrjeteve te jashtëm duke përfshirë dhe internetin;
- ruajtjen e të dhënave (logeve) për çdo thirrje telefonike dhe ekzaminimin e tyre për të parë, nëse ka thirrje të pazakonta ose të paautorizuara.

6. Administrimi i Sistemeve të Informacionit

6.1 Procedurat e Operimit

APLIKIMET

Përgjegjësitë dhe procedurat e administrimit dhe të aktivitetit, mbi të gjitha aplikimet kompjuterike, do të jenë të dokumentuara si pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit të tyre. Procedurat e aktivitetit testohen nga Drejtoria e TI.

OPERACIONET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Të gjitha procedurat që lidhen me teknologjinë e informacionit dokumentohen. Këto përfshijnë, në mënyrë të veçantë, procedurat e hapjes dhe të mbylljes, *backup*-et dhe mirëmbajtjen rutinë për të gjitha elementet e mjedisit të teknologjisë së informacionit të Autoritetit. Procedurat e operimit mbulojnë si operacionet normale, ashtu edhe administrimin e incidenteve. Mbulohen maksimalisht incidentet e parashikueshme, duke përfshirë keqfunksionimin e pajisjeve ose të programeve, të dhënat jo të sakta ose të dëmtuara, difektet në pjesët që i përkasin afruesve të jashtëm të shërbimeve ose të partnerëve në biznes (business partner), sulmet keqdashëse dhe thyerjet e konfidencialitetit.

KONTRAKTORËT E BURIMEVE TË JASHTME

Kërkesat e sigurisë së Autoritetit duhet t'i bashkëngjiten të gjitha kontratave që bëhen me ofruesit e shërbimeve, për të garantuar sigurinë mbi veprimet e punonjësve të tyre gjatë lidhjeve me rrjetin e Autoritetin.

6.2 Kontrolli i Ndryshimeve

Të gjitha ndryshimet në pajisjet dhe në sistemet që përpunojnë informacionin i nënshtrohen procedurave zyrtare të *administrimit të ndryshimeve*.

6.3 Programet Keqdashëse

Të gjitha pajiset e teknologjisë së informacionit duhet të jenë të mbrojtura nga programet keqdashëse, (ku përfshihen viruset e kompjuterëve, si dhe çdo tip tjetër i njohur dhe i klasifikuar si kërcënim informatik). Në qëllim të kësaj instalohen sisteme për kontrollin dhe për parandalimin e veprimeve keqdashëse. Në të gjitha PC dhe serverat e Autoritetit instalohet dhe vihet në funksionim një program i licencuar antivirus. Ai duhet të *përditësohet* automatikisht, në mënyrë të vazhdueshme, nën kontrollin e punonjësve të teknologjisë së informacionit.

Çinstalimi ose çaktivizimi i programeve antivirus trajtohet si shkelje serioze.

6.4 Backup-i i të Dhënave

BAZAT E TË DHËNAVE TË AUTORITETIT

Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit është përgjegjëse për të siguruar të gjitha të dhënat sensitive të mbajtura në serverat e Autoritetit t'u bëhet *backup* (kopje) i rregullt në përputhje me procedurat e përcaktuara, për çdo sistem (përfshi këtu edhe file/print servers). Kopjet (backup-et) e të dhënave duhet të ruhen në vende të mbrojtura nga zjarri dhe jashtë ambienteve ku mbahen serverat prej të cilëve janë marrë ato. Kopjet (backup) e të dhënave duhet të testohen rregullisht për t'u siguruar që mund të përdoren në raste të nevojshme. Procedurat e rikrijimit (restore) të të dhënave duhet të testohen rregullisht për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar.

TË DHËNAT QË NDODHEN NË KOMPJUTERAT PERSONALË TË PËRDORUESVE

Çdo individ, i cili ruan të dhëna në një kompjuter personal, është *përgjegjës personalisht* për të siguruar kopjet e duhura të *backup*-it për të mbrojtur të dhënat nga humbjet duhet të firmosë një dokument të pranimit të kësaj përgjegjësië.

6.5 Mbajtja e Log-eve

Është e detyrueshme të mbahen e do të ruhen *log-e* (shënime të shkurtuara) për të gjitha aksesimet në sistemet e Autoritetit, për të gjithë përdoruesit e brendshëm e të jashtëm.

6.6 Politika e Përdorimit të Internetit dhe të Postës Elektronike

I gjithë personeli i Autoritetit (përfshi këtu kontraktorët dhe konsulentët), të cilit i është dhënë akses në Internet dhe në shërbim email-i zbaton politikën e përdorimit të internetit si dhe rregullat dhe procedurat qe rrjedhin nga ajo.

7. Kontrolli i Aksesit

Për çdo burim informacioni të Autoritetit, përdoruesve u jepet akses vetëm në përputhje me funksionet e tyre për kryerjen e detyrave dhe ky akses kontrollohet me rreptësi për të ruajtur integritetin dhe sigurinë e aktivitetit. Hapi i parë i kontrollit të aksesit është identifikimi i përdoruesit. Kjo mbulon procedurat për t'u siguruar që çdo sistem është i aftë të njohë personat e autorizuar dhe të kryejë veprimet e duhura, në rastet e përpjekjeve për aksesim të paautorizuar. Çdo përdorues i sistemeve, qoftë ai personel i brendshëm i Autoritetit, aplikues (kandidat) i jashtëm, nëpunës i një institucioni ose organizate tjetër, kontraktues, konsulent ose pjesëtar i personelit që punon për ofruesit e shërbimeve, *identifikohet në mënyrë individuale* nëpërmjet një llogarie unike përdoruesi, e cila do të caktohet vetëm nëpërmjet një autorizimi me shkrim nga një drejtues Departamenti i Autoritetit dhe me miratimin e Drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit. Kjo zbatohet për të gjithë personat, pavarësisht nga rolet e tyre.

Ndalohet rreptësisht shpërndarja e llogarisë personale në persona të tjerë. Thyerja e këtij rregulli do të trajtohet si një shkelje e rëndë.

Një llogari unike përdoruesi nuk siguron vetëm mënyrën e autentifikimit për përdoruesit e ligjshëm, por gjithashtu garanton që Autoriteti do të jetë gjithmonë e aftë të përcaktojë përgjegjësinë e individëve për aktivitetet e tyre në sistemet e saj. Ndalohet rreptësisht dy ose më shumë aksesime të njëkohshme me të njëjtën llogari përdoruesi. Fillimisht përdoruesit nuk do të kenë asnjë të drejtë aksesimi. Atyre do t'u jepet akses vetëm në pjesët minimale të sistemit, që u nevojiten për kryerjen e aktivitetin e tyre. Në të gjitha rastet, ndiqen procedura të dokumentuara për:

- regjistrimin e përdoruesve të rinj;
- ndryshimin e statusit për një përdorues ekzistues (për shembull ndërprerjen e llogarisë së përdoruesit kur ai largohet nga puna ose mungon për një kohë të gjatë, ose ndryshimin e privilegjeve të aksesit të tij);
- mbylljen përfundimtare të një llogarie përdoruesi.

Natyra e këtyre procedurave dhe përgjegjësitë për administrimin e tyre mund të ndryshojnë në varësi të kategorisë së përdoruesit. Llogaria e përdoruesit çaktivizohet nëse ajo nuk ka qenë aktive për dy muaj.

7.1. Përdoruesit e Brendshëm

Përdoruesit e brendshëm përfshijnë punonjësit e Autoritetit, kontaktorët, konsulentët dhe punonjësit e ofruesve të shërbimeve të Autoritetit. Aksesi për përdoruesit e brendshëm në sistemet e Autoritetit duhet të jetë në përputhje me detyrat që ata kanë. Detyrat do të jenë të përcaktuara qartë, dhe për të minimizuar rrezikun e aktiviteteve mashtruese ose keqdashëse, ndarja e tyre do të jetë e detyrueshme. Kur një përdorues ndryshon detyrë, ai humbet të drejtat e aksesimit që lidheshin me detyrën e mëparshme Akumulimi në kohe i privilegjeve evitohet dhe të monitorohet vazhdimisht nga Drejtoria e TI-së.

LLOGARITË E PËRDORUESVE

Llogaritë e përdoruesve krijohen dhe administrohen nga punonjësit e teknologjisë së informacionit. Ata përdoren për aksesimin e të gjitha shërbimeve të teknologjisë së informacionit

të Autoritetit, përfshi këtu rrjetin e brendshëm, pajisjet dhe sistemet e Autoritetit. Modifikimi ose heqja e një llogarie bëhet me anë të një kërkesë zyrtare, nëpërmjet plotësimit të një formulari të miratuar për këtë qëllim nga drejtorët e drejtorive. Kjo kërkesë bëhet nga drejtori i drejtorisë nën përgjegjësinë e të cilit është përdoruesi dhe miratohet nga pronari i sistemit. Procedura për administrimin e llogarive të përdoruesve të Autoritetit dokumentohet sipas një rregullore të veçantë. Kjo procedurë zbatohet në të gjitha rastet kur:

- nevojitet një llogari e re (për shembull për një punonjës të ri);
- llogaria e një punonjësi duhet të pezullohet për një periudhë kohe ose kur duhet të riaktivizohet mbas pezullimit;
- do të ndryshohen privilegjet e aksesimit (për shembull kur kalohet në një rol me përgjegjësi më të madhe);
- një nëpunës, pjesëtar i personelit të Autoritetit, largohet nga puna (fshirja e përhershme e llogarisë).

ADMINISTRIMI I FJALËKALIMEVE

Të gjithë përdoruesit e Autoritetit instruktohen në lidhje me mënyrat e administrimit të fjalëkalimeve. Këtu futet:

- zgjedhja e fjalëkalimit fillestar;
- ndryshimi i fjalëkalimit dhe këshilla të njohura sigurie për zgjedhjen e tij;
- mbrojta e fjalëkalimit, si dhe ndalimi i dhënies së fjalëkalimit midis përdoruesve;
- inicializimi ose mbivendosja e fjalëkalimit (në qoftë se një llogari përdoruesi është mbyllur ose në qoftë se përdoruesi ka harruar fjalëkalimin). Mbivendosja e fjalëkalimit duhet të bëhet vetëm nga personeli i autorizuar i teknologjisë së informacionit pas një kërkesë me shkrim.

Përdoruesve u kërkohet të firmosin një marrëveshje ku pranojnë se ata i kanë lexuar e i kanë kuptuar rregullat, dhe se do t'i zbatojnë ato. Kjo procedurë përfshihet në procedurat e punësimit të personelit të Autoritetit.

MONITORIMI I PROFILEVE TË PËRDORUESVE

Është e rëndësishme të garantohet që:

- vetëm përdoruesve të duhur u është lejuar akses në sistemet e Autoritetit (janë eliminuar të gjitha llogaritë që kanë skaduar);
- përdoruesit nuk kanë privilegje aksesimi të niveleve më të larta nga ato që u duhen për të kryer punën e tyre (është eliminuar "shtimi i privilegjeve").

Për të detyruar zbatimin e kërkesat e mësipërme, të gjithë llogaritë e përdoruesve dhe caktimi i profileve të tyre do të rishikohen nga drejtori i drejtorisë përkatëse. *Kjo bëhet një herë në gjashtë muaj*. Si rezultat i këtij rishikimi hartohet lista e emrave të të gjithë përdoruesve të brendshëm të vlefshëm, me profilet e tyre përkatës. Kjo listë do të mbahet dhe do të kontrollohet nga Departamenti i TI.

7.2. Përdoruesit e Jashtëm

Tek përdoruesit e jashtëm përfshihen të gjithë individët jashtë kategorisë së përdoruesve të brendshëm, që janë të autorizuar të aksesojnë sistemet e Autoritetit.

LLOGARITË E PËRDORUESVE

Caktimi i llogarive të përdoruesve është përgjegjësi e drejtorive përkatëse të Autoritetit. Përdoruesit e jashtëm instruktohen që të ruajnë konfidencialitetin e llogarisë së tyre, gjatë procesit të trajnimit për përdorimin e sistemeve. Formati i llogarive të përdoruesve standardizohet, aq sa është e mundur, për të gjithë përdoruesit e jashtëm, me anë të një bashkëpunimi midis teknologjisë së informacionit dhe drejtorive të Autoritetit. Ky format do të jetë pjesë e dokumentacionit të sistemeve. Lista e të gjithë përdoruesve të jashtëm të autorizuar, bashkë me llogaritë e tyre, duhet të mbahet nga Drejtoria e TI.

AUTENTIFIKIMI

Të gjithë përdoruesit e jashtëm, para se t'u jepet akses në sistemet e informacionit të Autoritetit, identifikohen në mënyrë të vetme. Niveli i autentifikimit që duhet të kërkohet për përdoruesit e jashtëm, varet nga ndjeshmëria e të dhënave që do të aksesohen dhe risku që i shoqëron, në qoftë se këto të dhëna kompromentohen. Mënyrat e autentifikimit që përdor Autoriteti janë:

- kombinimi i emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit e identifikuar me emrin *llogari;*
- përdorimi i *smart cards* ose i formave të tjera hardware të autentikimit.

Përpara kalimit të çdo aplikimi në mjedisin "produkt", përdoruesi i aplikimit duhet të ndërmarrë një vlerësim zyrtar të tij, duke u konsultuar me specialistët të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, për:

- sensitivitetin e të dhënave që përpunohen;
- nivelin e rrezikut nga aksesi i përdoruesve.

MARRËVESHJET ME KONTRATË

Kërkesat e sigurisë përfshihen në të gjitha kontratat ndërmjet Autoritetit dhe përdoruesve të jashtëm për të administruar aksesin e tyre direkt (online) në sistemet e Autoritetit. Këtu mund të përfshihet:

- një deklaratë për pranimin dhe për respektimin e të drejtave të aksesimit;
- deklaratë për pranimin e procedurës "*Administrimi i Fjalëkalimeve*";
- të marrin përsipër përdorimin e programeve antivirus të miratuara nga Autoriteti, në të gjithë kompjuterat që mund të lidhen me sistemet e Autoritetit, dhe të garantojnë që programet antivirus rinovohen (update) të paktën një herë në ditë;
- të marrin përsipër ruajtjen e konfidencialitetit të plotë për të gjitha të dhënat dhe informacionet që ata mund të marrin nga sistemet e Autoritetit.

DHËNIA E PRIVILEGJEVE

Në rastet e përdoruesve të jashtëm, privilegjet caktohen në bazë të profileve të sigurisë. Këto profile zbatohen dhe testohen zyrtarisht, përpara testimit të tyre prej përdoruesve.

Për privilegjet e përdoruesve vendos dhe firmos drejtori i drejtorisë përgjegjëse të sistemit, duke marrë në konsideratë mendimin e specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Çdo ndryshim i tyre duhet të miratohet zyrtarisht nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse të sistemit.

Privilegjet përcaktohen në dokumentacionet e aplikimeve dhe ruhen të sigurta sipas rregullave të kontrollit zyrtar të dokumenteve, nga Drejtoria e TI.

ENKRIPTIMI

Të gjitha të dhënat që shkëmbehen ndërmjet sistemeve të Autoritetit dhe përdoruesve të jashtëm duhet të enkriptohen.

8. Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Sistemeve

8.1. Zhvillimi i Programeve

Kërkesat e sigurisë dizenjohen brenda programeve/aplikimeve, duke reflektuar vlerat e aseteve të informacionit dhe dëmtimet e mundshme, të cilat mund të vijnë si rezultat i dështimit ose mungesës së sigurisë. Si rregull ato miratohen nga Drejtoria e TI, përpara fillimit të punës për zhvillimin e aplikimit. Masat e sigurisë përcaktohen qartë në dokumentacionin e programeve/ aplikimeve, përfshi këtu procedurat operacionale. *Në mënyrë të veçantë, të gjitha aplikimet dizenjohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë mundësinë e aksesimit të njëkohshëm të shumë përdoruesve, me të njëjtin kod.*

8.2. Kalimi nga Mjedisi i Zhvillimit në atë Produkt

Krijimi i çdo lloj programi kalon nëpër tri ndarje logjike (dhe zakonisht edhe fizike) të mjediseve, të cilat emërtohen Zhvillim, Testim dhe Produkt. Procesi i kalimit të programeve nga Zhvillimi në Testim dhe pastaj në Produkt, bëhet në përputhje me procedur*at e Administrimit të ndryshimeve* të Autoritetit.

MJEDISI I ZHVILLIMIT

Mjedisi i zhvillimit është nën kontrollin e ekipit që zhvillon (krijon) aplikimin, i cili është përgjegjës për sigurinë e tij. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit është përgjegjëse për funksionimin dhe për mirëmbajtjen e sistemeve që janë në zhvillim.

MJEDISI I TESTIMIT

Mjedisi i Testimit është nën kontrollin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Të gjitha profilet e sigurisë dhe lejet e aksesimit përcaktohen dhe jepen me miratimin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Kur pjesë të reja të zhvillimit të programeve janë gati për t'u testuar, ato duhet të migrohen nga mjedisi në zhvillim (krijim) në atë për testim. Kjo procedurë kryhet në përputhje me procedurat e *administrimit të ndryshimeve,* të cilat kërkojnë që:

- zhvilluesit (krijuesit) përgjegjës të shkruajnë një dokumentacion të plotë, që mbulon instalimin, testimin dhe funksionimin e programit të ri;

- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të përcaktojë se kush do ta instalojë, do ta testojë dhe do ta ekzekutojë programin, në përputhje me dokumentacionin;
- në qoftë se konstatohet ndonjë problem ose gabim, ai do të dokumentohet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe do të kthehet për korrigjim;
- kjo procedurë të përsëritet sa herë që është e nevojshme derisa të dyja palët të jenë të kënaqura me rezultatet e testimit;
- në fund, programi të përgatitet për kalimin në produkt.

MJEDISI I PRODUKTIT

Kur bëhet instalimi në mjedisin produkt, programet/aplikimet nuk mund të ndryshohen ose të modifikohen në asnjë lloj mënyrë, përveç rasteve të ndërhyrjeve urgjente, të kontrolluara rreptësisht për të rregulluar një problem operacional serioz, siç përshkruhet në pikën 8.3. Mjedisi produkt është nën kontrollin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Të gjitha profilet e sigurisë dhe lejet e aksesimit përcaktohen me miratimin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Migrimi i programeve të rinj, nga Test në Produkt, bëhet në përputhje me procedurat e *"Administrimit të ndryshimeve"*. Pas migrimit ato janë nën kontrollin e palëve përkatëse, të cilat mbajnë përgjegjësi për funksionimin në mjedisin produkt.

8.3. Aksesi në Mjediset Test dhe Produkt

Personeli i zhvillimit të aplikimit i lejohet nëse është e nevojshme të ketë akses në sistemet test dhe produkt ashtu si dhe në mjedisin në zhvillim. Aksesime të tilla duhet të kontrollohen me kujdes:

- Niveli i aksesit të lejuar, për çdo pjesëtar të grupit të zhvillimit të aplikimit, do të jetë minimumi i duhur për të kryer ndërhyrjet e nevojshme.
- Të gjitha aksesimet do të caktohen dhe do të miratohen nga drejtori i departamentit pronar të sistemit dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.
- Të gjitha aksesimet duhet të kryhen sipas procedurave të *"Administrimit të ndryshimeve"*, të shoqëruara me loge për të gjitha veprimet që kryhen.
- Të gjitha aksesimet duhet të kryhen duke u konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me përfaqësuesit e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Konsultime të tilla mund të kryhen me telefon ose brenda institucionit ose nëpërmjet takimeve direkte.
- Në mjediset produkt nuk do të bëhet asnjë ndryshim i kodit të programit pa u testuar më parë në mjedisin test. Bëjnë përjashtim rastet, kur nevojitet urgjentisht të korrigjohet menjëherë një dëmtim serioz i sistemit apo si pjesë e procedurave të rekuperimit (recovery) të tij. Të gjitha korrigjimet e tilla do të kryhen nga specialistët e Teknologjisë së Informacionit.
- Për çdo përmirësim të kodit ose për çdo ndryshim të të dhënave, që do të bëhet në mjedisin produkt, duhet të mbahen shënime të plota.

9. Administrimi i Vazhdueshmërisë së Aktivitetit

Duke u konsultuar me drejtorët e të gjitha departamenteve, Drejtoria së Teknologjisë së Informacionit zhvillon dhe mban plane për rikrijimin e të gjitha proceseve dhe shërbimeve kritike të aktivitetit, në rastet e ndërprerjeve serioze. Ndërprerje të tilla mund të shkaktohen nga shkaqe natyrore, nga aksidente, nga difekte të pajisjeve, nga veprime të qëllimshme ose nga difekte të shërbimeve.

9.1. Vazhdueshmëria

Planet për vazhdueshmërinë e aktivitetit përfshijnë masat për reduktimin e riskut, për kufizimin e pasojave të shkaktuara prej një kërcënimi që mund të ndodhë, dhe për garantimin e rifillimit sa më të shpejtë të operacioneve kritike. Planet për vazhdueshmërinë e aktivitetit përgatiten për çdo aktivitet të Autoritetit. Planet e vazhdueshmërisë duhet të mundësojnë funksionimin në vazhdimësi të aktiviteteve në raste dëmtimesh, difektesh ose humbjesh të shërbimeve apo të pajisjeve. Ato përfshijnë:

- identifikimin dhe vendosjen e prioriteteve për proceset kritike të biznesit;
- identifikimin e kërcënimeve të mundshme që mund të kenë efekt në këto procese;
- përcaktimin e ndikimit të mundshëm të katastrofave të ndryshme në aktivitetet e biznesit;
- identifikimin dhe realizimin e marrëveshjeve për çdo përgjegjësi, në rast gjendjeje të jashtëzakonshme;
- dokumentacionin për procedurat dhe proceset për të cilat është rënë dakord;
- edukimin e personelit në ekzekutimin e procedurave ;
- testimin e planeve;
- përmirësimin e vazhdueshëm të planeve.

Procesi i planifikimit të vazhdueshmërisë së aktivitetit duhet të sigurojë, mbajtjen në punë të proceseve dhe shërbimeve kritike të Autoritetit. Drejtuesit e drejtorive janë përgjegjës për planet e vazhdueshmërisë së aktivitetit për sistemet dhe pajisjet që kanë në pronësi të tyre. Të paktën një kopje e çdo plani të tillë duhet të ruhet në një vend të sigurt, jashtë ndërtesës, për të siguruar disponueshmërinë e tij në çdo kohë. Plane të tilla krijohen për sistemet e informacionit në një vit nga hyrja në fuqi e dokumentit.

9.2. Rikrijimi i Informacionit në Rast Katastrofash

Për të rindërtuar (rikrijuar) sistemet dhe shërbimet prioritare kompjuterike në raste katastrofash, është e domosdoshme krijimi dhe të ruajtja e planeve për këtë qellim. Rifillimi i këtyre sistemeve duhet të bëhet në një interval kohe sa më të shkurtër. Për çdo sistem dhe shërbim krijohet një plan rindërtimi (recovery), i cili mbahet nga një person i caktuar. Këtu përfshihen edhe shërbimet që sigurohen nga ofruesit e jashtëm. Përgjegjësia për procedurat në raste katastrofash, për manualet dhe planet e zëvendësimit të të dhënave të humbura dhe për planet e vazhdueshmërisë, është e departamenteve që janë pronarë të tyre.

9.3. Përmirësimi

Të gjitha planet për vazhdueshmërinë e aktivitetit dhe planet e rikrijimit rishikohen e përmirësohen të paktën një herë në vit. Planet të cilat vjetërohen shpejt, si rezultat i ndryshimeve që ndodhin brenda ose jashtë institucionit, përmirësohen (updating) në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim mbrojtjen e investimit mbi planin fillestarë dhe për të garantuar efektshmërinë e vazhdueshme të vazhdueshmërisë.

Çdo departament, drejtori apo sektor duhet të ketë një person të autorizuar, i cili do të jetë përgjegjës për identifikimin dhe për aplikimin e ndryshimeve në këto plane. Nevoja për ndryshime të veçanta mund të rishikohet çdo muaj. I tërë plani duhet të jetë subjekt i një rishikimi vjetor nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

10. Përputhja me Ligjin

10.1. Kërkesat Ligjore

LEGJISLACIONI

Drejtorëve të drejtorive u kërkohet të njohin kërkesat e legjislacionit dhe akteve nënligjore, në të cilat AMF mbështet veprimtarinë e saj dhe të sigurohen që personeli i tyre vepron në pajtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

PRONA INTELEKTUALE (E DREJTA E AUTORIT)

Shkelja e të drejtës së autorit çon në veprime antiligjore dhe, për çështje serioze në procedim penal. Pronësia e programeve përcaktohet nëpërmjet licencës, e cila kufizon përdorimin e produktit në kompjutera të caktuar.

- Asnjë program nuk instalohet në kompjuterat e Autoritetit pa pasur një dokument të shkruar e të firmosur nga përgjegjësi i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha programet instalohen vetëm nga personeli i *helpdesk-ut*.
- Programet nuk lejohet të kopjohen nga një kompjuter në një tjetër, pa pasur të dokumentuar të drejtën e kopjimit nga pronari i tij;
- Kopjimi i programeve që janë në pronësi të Autoritetit, për t'u përdorur në kompjuterat që nuk i përkasin Autoritetit, për çfarëdo lloj qëllimi të ndryshëm nga aktivitetet e autorizuara, përbën thyerje të të drejtës së autorit dhe do të trajtohet si shkelje serioze.

10.2. Politika e Sigurisë

KONTROLLET

Të gjitha departamentet dhe degët janë subjekt i një kontrolli zyrtar vjetor për të siguruar zbatimin e rregullave dhe standardeve të sigurisë. Pronarët e aseteve të informacionit mbështesin rregullisht auditime për përputhjen e sistemeve të tyre me këtë udhëzim. Të gjitha pajisjet kompjuterike kontrollohen nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit për përputhjen me standardet e implementimit të sigurisë. Këto kontrolle përfshijnë ekzaminimin e sistemeve operacionale për t'u siguruar që kontrollet e sigurisë të pajisjeve dhe të programeve janë zbatuar me korrektësi.

KRYETAR

ELISABETA GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 03.10.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I KONSTATIMEVE NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 03.10.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I KONSTATIMEVE NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 03.10.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I KONSTATIMEVE NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 03.10.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I KONSTATIMEVE NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 03.10.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I KONSTATIMEVE NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 03.10.2007

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I KONSTATIMEVE NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, për një afat tre vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a, të personave sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi;
2. Licencimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, për një afat tre vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a: Shoqërinë "Riva" sh.p.k dhe përfaqësuesin e saj Arjana Reçi, shoqërinë "Victory travel" sh.p.k dhe përfaqësuesin e saj Eva Mene, shoqërinë "Ujori" dhe përfaqësuesin e saj Xhuljana Sejdini.
3. Refuzimin e licencës për zj. Marjeta Dosti, z. Altin Gjorduni dhe z. Astrit Lashi për shitje të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me kuadrin ligjor të sigurimeve.
4. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11/1, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, për një afat tre vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a, të personave: z. Uran Alcani, z. Robert Kararaj, zj. Arta Bozha, zj. Albana Myshtaku, z. Besnik Mukollari, z. Ardian Dardha, z. Zyhdi Mustafa, z. Man Doci dhe z. Hilmi Lakti.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, të Ligjit Nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, për një afat tre vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a, të zj. Anthulla Bezhani, z. Koçi Ismailaj, z. Marksi Leka, z. Pëllumb Metohu, z. Harilla Sema, zj. File Faruku (Shera), z. Albert Tato dhe z. Selman Bici.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 62, pika 3 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe nenit 14, pika 6/gj të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të miratojë, sipas kërkesës së Asamblesë së Aksionarëve dhe Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit "Intersig" sh.a, emërimin e zj. Shpresa Breçani në postin e drejtorit të përgjithshëm të kësaj shoqërie.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 30.10.2007

PËR
"PAJISJEN ME NUMER TELEFONI CELULAR TË DREJTUESVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 16, datë 03.10.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 30.10.2007

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "MBI TREGUN ME PAKICË TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË SË RSH-SË"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 30.10.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 30.10.2007

PËR
MIRATIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË "BURSA E TIRANËS" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (d), të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Dhënien e pëlqimit për emërimin e z. Lavdosh Zaho, si Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 30.10.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, te Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin si agjentë në sigurime të jo-jetës, për një afat tre vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a, të personave Irma Kadra, Agron Çela e Thanas Idrizi.
2. Refuzimin e licencës për aplikanten Besiana Belli, për mosplotësim të kritereve të parashikuar në pikën 7, Gërma A (b) të VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime, si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", pasi figuron nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore, e dënuar për fallsifikim të akteve të gjendjes civile.
3. Në lidhje me piken 2 të këtij vendimi, i tërhiqet vëmendja shoqërisë për të paraqitur aplikues për licencë si agjent në sigurime, të cilët përmbushin kërkesat e profesionalizmit, besueshmërisë dhe reputacionit, të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore.
4. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM
Nr. 6, datë 30.10.2007

PËR
RINOVIMIN E AFATIT TË PUNËSIMIT PART TIME TË SHOFERIT TË ADMINISTRATËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 7, datë 30.10.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 21.11.2007

PËR
MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR PROCEDURAT E INSPEKTIMIT NË SUBJEKTET FINANCIARË JO-BANKARË"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 21.11.2007

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3 të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

V E N D O S I:

1. Në rregulloren "Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare", miratuar me vendimin e Bordit nr. 15, datë 8.02.2007, në fund të pikës, 6.2 (a) të saj shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:
2. Për realizimin e kontrollit mbi dokumenta sipas germës (a) të kësaj pike, raportimet periodike do të formatohen dhe plotësohen sipas pasqyrave bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Afatet e raportimit përcaktohen në fund të çdo pasqyre.
3. Në pikën 6.2 (a), shprehja "në zbatim të aktit normativ përkatës", shfuqizohet.
4. Pasqyrat e raportimit bashkëngjitur këtij vendimi janë pjesë e rregullores "Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare".
5. Ngarkohet Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës dhe Drejtoria e Raportim Analizës në AMF për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 21.11.2007

PËR
REVOKIMIN E SANKSIONIT ME GJOBË NDAJ DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ZV/DREJTORIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 21.11.2007

PËR
MOSPRANIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV DHE LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 5, DATË 3.10.2007 TË BORDIT TË AMF

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 6, datë 21.11.2007

PËR
PRANIMIN PJESËRISHT TË ANKIMIT ADMINISTRATIV DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 5, DATË 3.10.2007 TË BORDIT TË AMF

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 21.11.2007

PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË SHËNDETIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 21.11.2007

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË BRENDSHME PËR TRAJTIMIN E ELEMENTEVE TË NJË KONTRATE SIGURIMI

Në bazë dhe në zbatim të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e procedurave të brendshme për trajtimin e elementëve të një kontrate sigurimi sipas skemës bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, Departamenti i Mbikëqyrjes dh Disiplinimit dhe Departamenti i Licencim Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 21.11.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin si agjentë në sigurime të jo-jetës për një afat 3 vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a, të Zj. Nexhmije Elezi, Z. Klajdi Ballhysa, Zj. Albana Hoxha dhe Zj. Lavdije Bego.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 21.11.2007

PËR
MRATIMIN E PLANIT VJETOR TË AUDITIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2008 DHE PLANIT STRATEGJIK PËR VITIN 2009-2011

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 21.11.2007

PËR
MRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PLANIT FINANCIAR TË VITIT 2007 TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 21.11.2007

PËR

NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK"

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Neni 10 i Rregullores "Për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik", miratuar me vendimin e Bordit nr. 3, datë 03.10.2007, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

Neni 10

Hyrja në Fuqi

Detyrimi i shoqërive për identifikim dhe raportim të policave në regjistër fillon në datën 1 Dhjetor.

Periudha nga data 10 nëntor deri në datën 1 dhjetor do të shërbejë për shoqëritë e sigurimit për të përshtatur sistemet e tyre elektronike të shitjeve me mënyrën e re të identifikimit dhe raportimit.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike për azhornimin e ndryshimit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 17.12.2007

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, datë 17.12.2007

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 17.12.2007

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SICRED" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 17.12.2007

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ INSTITUTIT PRIVAT TE PENSIONEVE "GARANTSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 17.12.2007

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ INSTITUTIT PRIVAT TE PENSIONEVE "CAPITAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 17.12.2007

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ INSTITUTIT PRIVAT TE PENSIONEVE "APFA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 17.12.2007

MBI

MARRJEN E MASAVE PËR KORIGJIMIN E SITUATËS PROBLEMATIKE QË PARAQITET NË TREGUN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MTPL

Si rezultat i problematikës së konstatuar nga monitorimi i tregut të sigurimit të detyrueshëm, që ka të bëjë kryesisht me funksionimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm konform kërkesave që paraqet legjislacioni në fuqi, bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Zbatueshmërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Shoqëritë e sigurimit me qëllim parandalimin e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij , si dhe për të korrigjuar situatën problematike që paraqet tregu të marrin masa si më poshtë:

- Nënshkrimi i kontratave të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta të bëhet vetëm nga ndërmjetësit në sigurime ose nga punonjës të shoqërive të sigurimit, sipas nenit 3 dhe 76 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.
- Shoqëritë e sigurimit të marrin masa të menjëhershme për licencimin e agjentëve në sigurime.
- Shoqëritë e sigurimit të depozitojnë në Autoritet listën e punonjësve të autorizuar për nënshkrimin e kontratave të sigurimi, si dhe dokumentin që vërteton se është punonjës pranë kësaj shoqërie sigurimi.
- Agjentët në sigurime nuk duhet të ushtrojnë veprimtari të tjera përveç atyre që parashikohen në legjislacionin në fuqi.
- Agjentët në sigurime ose punonjësit e shoqërisë duhet të disponojnë ambiente të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit (konsiderohet i përshtatshëm ambienti me një hapësirë normale dhe pajisje të nevojshme pune), si

dhe të kenë të instaluar sistemin on line të raportimit.

- Çdo agjent ose punonjës në ambientet që ushtron veprimtarinë të ketë të afishuar në vende të dukshme:
- Tarifat minimale të primit të sigurimit të detyrueshëm konform legjislacionit në fuqi (sipas aneksit 1" Njoftim Tarifa" bashkëngjitur).
- Kopje te kushteve te kontratave te sigurimit te detyrueshëm.
- Licencën e agjentit ose autorizimin e punonjësit për të nënshkruar kontrata sigurimi.
- Çdo agjent ose punonjës duhet të pajiset me dokument identifikimi (shenjë dalluese) i cili të jetë lehtësisht i identifikueshëm nga publiku dhe të përmbajë të paktën këto elementë: Emër mbiemër si dhe statusin e personit që nënshkruan kontrata sigurimi (agjent/punonjës), logon e shoqërisë së sigurimit, numrin e licencës dhe vlefshmërinë e saj/ kontratës dhe vlefshmërinë e saj (kur është agjent/punonjës) si dhe foto të personit (formati i dokumentit të identifikimit paraqitet në aneksin 2 bashkëngjitur).
- Agjenti në sigurime nuk ka të drejtë të autorizojë asnjë person tjetër që të nënshkruaj kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij.
- Çdo agjent ose punonjës duhet të jetë përgjegjës për plotësimin me rigorozitet të elementëve të policës së sigurimit (udhëzimet paraqiten në aneksin 3 " Udhëzim" bashkëngjitur). Elementet e policës së sigurimit duhet të plotësohen duke u mbështetur në lejen e qarkullimit ose të ndonjë dokumenti tjetër që vërteton të dhënat e mjetit.
- Agjenti ose punonjësi i shoqërisë se sigurimit gjatë nënshkrimit të kontratës duhet ta pajisë drejtuesin e mjetit (personin e siguruar) me një kopje të kushteve të kontratës së sigurimit të detyrueshëm.
- Agjentët ose punonjësit duhet të disponojnë evidencat për furnizim me polica sigurimi, akt rakordimet me degën e shoqërisë ose me drejtorinë e përgjithshme.
- Çdo agjent ose punonjës gjatë ushtrimit të inspektimit nga ana e Autoritetit duhet të vënë në dispozicion gjithë dokumentacionin e kërkuar.

2.Afati për marrjen e masave për korrigjimin e situatës së mësipërme do të jetë deri më 15.01.2008.

3.Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit pranë Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë pranë Departamentit të Çështjeve Ligjore për ndjekjen e zbatimin e këtij Vendimi.

4.Vendimi i bëhet i njohur të gjitha shoqërive të sigurimit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 17.12.2007

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e formatit të licencës "Agjent i shoqërisë së Sigurimit.....", të miratuar me vendimin e Bordit nr. 13, datë 29.01.2007, duke shtuar si element të këtij formati fotografinë e personit të licencuar.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për zbatimin dhe njoftimet në zbatim këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 17.12.2007

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT"

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Neni 8, pika 8.1 e Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", miratuar me vendimin e Bordit nr. 7, datë 08.02.2007, ndryshon me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit, e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kryen kontrollin në të njëjtën shoqëri sigurimi për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë së sigurimit pas mbarimit të një afati kohor prej të paktën 2 vjetësh."

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike për azhornimin e ndryshimit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 17.12.2007

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SICRED" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin ekspertit kontabël të autorizuar "Deloitte Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Sicred" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve "Sicred" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i bëhet i njohur Drejtorisë së shoqërisë "Sicred" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin ekspertit kontabël të autorizuar "Deloitte Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Atlantik" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve "Atlantik" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i bëhet i njohur Drejtorisë së shoqërisë "Atlantik" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 17.12.2007

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin ekspertit kontabël të autorizuar "Deloitte Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Albsig" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve "Albsig" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i bëhet i njohur Drejtorisë së shoqërisë "Albsig" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 14, datë 17.12.2007

PËR
REFUZIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "A.S.I.E" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 15, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (d), të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", nenit 62, të Ligjit nr. 9276, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe Rregullores nr. 14, datë 08.02.2007 "Për disa kritere që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit "Sigma" sh.a, të z.Christoph Wolf, z.Guy Sedeh, z.Ilan Wunsh, z.Naim Isufi, z. Ilir Elmazi dhe z.Behar Shehu.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 17, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 18, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SICRED" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 19, datë 17.12.2007

PËR
REFUZIMIN E MIRATIMIT TË NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 20, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 21, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË 51% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "GARANTSIG" SH.A NGA AKSIONERI "ILIRIA B" SH.P.K TEK AKSIONERI "SIGMA" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të pikës 23, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", nenit 27, të VKM nr. 908, datë 29.12.2004, me propozim të Departamentit të Licencimit e Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e transferimit të 51% të aksioneve të shoqërisë "Garantsig" sh.a nga aksioneri "Iliria B" sh.p.k tek aksioneri "Sigma" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
3. Vendimi i bëhet i njohur shoqërisë "Garansig" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 22, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të, VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e liçensimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin si agjent në sigurim të jo-jetës për një afat 3 vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a, të Z. Abdyl Vokopola.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 23, datë 17.12.2007

PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SI PËRFAQËSUES I TREGTARIT TË LICENCUAR PËR PËRFAQËSUESIT E SHOQËRISË "BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (c) të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 29 dhe 31 të Ligjit nr. 8080, datë 1.03.1996 "Për letrat me vlerë", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Rinovimin e licencës për të vepruar si përfaqësues tregtari në letrat me vlerë të Qeverisë për llogari të shoqërisë "Banka Amerikane e Shqipërisë" sh.a, për zj. Suela Totokoçi dhe zj. Elona Korini.
2. Licenca miratohet me afat një vjeçar.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 24, datë 17.12.2007

PËR
MRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PLANIT FINANCIAR TË VITIT 2007 TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 25, datë 17.12.2007

PËR
MRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR PUNONJËSIT E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 26, datë 17.12.2007

PËR
PËRFTIMIN E NJË SHTESE MBI PAGËN MUJORE TË SPECIALISTES SË ADMINITSRIMIT FINANCIAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 27, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" sh.p.k, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin ekspertit kontabël të autorizuar "Deloitte Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve "Sigal" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i bëhet i njohur Drejtorisë së shoqërisë "Sigal" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 28, datë 17.12.2007

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" sh.p.k, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-LIFE" sh.a

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin ekspertit kontabël të autorizuar "Deloitte Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Sigal-Life" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve "Sigal-Life" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i bëhet i njohur Drejtorisë së shoqërisë "Sigal-Life" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

Vendime Bordi të AMF-së, miratuar gjatë vitit 2008

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 30.01.2008

PËR
MRATIMIN E PLANIT FINANCIAR PËR VITIN 2008 TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 3, Datë 30.01.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 30.01.2008

PËR
ZGJERIMIN E OJEKTIT TË LICENCËS SË REGJISTRUESIT TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË PËR BANKËN "CREDINS" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (e) të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 29, pika 9, e Ligjit nr. 8080, datë 01.03.1996 "Për letrat me vlerë", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Objekti i licencës nr. 85, datë 08.05.2006, dhënë Bankës "Credins" sh.a zgjerohet duke përfshirë veprimtarinë e regjistrimit për të gjitha letrat me vlerë të Qeverisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 30.01.2008

PËR PROPOZIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STRUKTURËN E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 9, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Kryetarit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Propozimin e ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98, datë 30.04.2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", si më poshtë.
   (a) Në lidhjen nr. 1, "Struktura e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare" propozohet të ristrukturohet Drejtoria e TI me dy sektorë në përbërjen e saj: Sektori i sistemeve dhe sektori i mirëmbajtjes, të pasqyruara në lidhjen me të njëjtin numër, bashkëlidhur.
   (b) Në lidhjen nr. 2 "Organika e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", propozohen këto shtesa dhe ndryshime:
      - Zëvendësohet emërtimi "specialist" në Sektorin e Aktuaristikës, Drejtoria e Administrimit të Riskut, me emërtimin "aktuar".
      - Shtohet pozicioni i Drejtorit të Kabinetit.
      - Shtohet pozicioni i përgjegjësit të sektorit dhe një specialist në Drejtorinë e TI.
      - Shtohet pozicioni i përgjegjësit të sektorit në Sektorin e Kërkimit dhe Statistikës, Drejtoria e TI Kërkim dhe Statistikës.
      - Shtohet pozicioni i përgjegjësit të sektorit në Drejtorinë e Licencimit dhe Monitorimit.
      - Shkurtohet një pozicion specialist në Drejtorinë e Zbatueshmërisë.

   Ndryshimet sipas pikës (b) pasqyrohen në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur.
2. Propozimet i dërgohen për miratim Kuvendit të Shqipërisë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Sektori i Burimeve Njerëzore për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 30.01.2008

PËR

MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË AKSIONERIT JO TË DREJTPËRDREJTË TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 56 e 57 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 45,62% të shoqërisë "UNIQA International Beteiligungs-Verwatungs GmbH", aksionar jo i drejtpërdrejtë i shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a, në shoqërinë "Sigal Holding" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit në AMF, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 30.01.2008

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË AKSIONERIT JO TË DREJTPËRDREJTË TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-LIFE" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 56 dhe 57 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 45,62% të Shoqërisë "UNIQA International Beteiligungs-Verwatungs GmbH", aksionar jo i drejtpërdrejtë i Shoqërisë së Sigurimit "Sigal-Life" sh.a, në shoqërinë "Sigal Holding" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit në AMF, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 30.01.2008

PËR

NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TE SHITJEVE TE SIGURIMIT TE DETYRUESHEM MOTORIK"

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Në Rregulloren "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik", miratuar me vendimin e Bordit nr. 3, datë 03.10.2007, paragrafi i dytë i nenit 4, ndryshon me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Shoqëritë marrin të gjitha masat për të furnizuar këtë bazë të dhënash në kohë reale online, për çdo shitje policash, me përjashtim të rasteve kur Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare vendos ndryshe, menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje."

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike për azhornimin e ndryshimit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 30.01.2008

PËR

FURNIZIMIN E BAZËS SË TË DHENAVE TË REGJISTRIT ELEKTRONIK PËR SHITJEN E POLICAVE TË SIGURIMIT KUFITAR

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 4, paragrafi 2, i rregullores "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Raportimi dhe identifikimi i policave kufitare nëpërmjet regjistrit elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, i parashikuar në rregulloren "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik", duhet të kryhet brenda orës 09.00, të ditës që pason ditën e lëshimit të policës kufitare.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 30.01.2008

MBI MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË PROPOZUARA SI REZULTAT I SHKELJEVE TE KONSTATUARA NGA SHITJA E POLICAVE TË SIGURIMIT KUFITAR

Në bazë të nenit 124, 125 dhe nenit 165, pika 1, paragrafi i fundit dhe Rregullores "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik", miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 03.10.2007, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes e Disiplinimit dhe Drejtorisë së Zbatueshmërisë, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të urdhërohet Shoqëria e Sigurimit "Albsig" sh.a, të eliminojë shkeljet e konstatuara nga inspektimi duke marrë masa për raportimin e policave të sigurimit të detyrueshëm kufitar konform nenit 115, të Ligjit nr. 9267 dhe paragrafit të parë të nenit 4, të Rregullores "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik".
2. Shoqëria e sigurimit "Alsig" sh.a, për zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi, të paraqesë një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e shkeljeve, brenda datës 10.02.2008.
3. Të pezullohet nga funksioni që mban, për një periudhë një vjeçare, Drejtori i Degës Durrës të shoqërisë "Albsig" sh.a, për mos raportim të policave të sigurimit të detyrueshëm kufitar.
4. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë pranë Departamentit të Çështjeve Ligjore për ndjekjen dhe njoftimet në zbatimi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 1, datë 22.02.2008

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBIKËQYRJEN E INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13 e 14 pika 3, si dhe nenit 20, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2007 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve" me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e instituteve private të pensioneve suplementare", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkivës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
PËR MBIKËQYRJEN E INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 11, datë 22.02.2008

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 13 dhe nenit 14, pika 3, 20 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve"

Neni 1
Mbikëqyrja, qëllimi, format e ushtrimit dhe objektivat e saj

1.1 Mbikëqyrja

Mbikëqyrja e instituteve private të pensioneve nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që këtu e më poshtë do të quhet Autoriteti, garanton dhe siguron që institutet private të pensioneve suplementare të ushtrojnë aktivitetin e tyre të sigurt dhe të qëndrueshëm, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe objektin e veprimtarisë së tyre.

1.2 Qëllimi

Mbikëqyrja në institutet private të pensioneve suplementare, ka si qëllim parandalimin dhe zbulimin e të metave, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe marrjen e masave për korrigjimin e tyre. Mbikëqyrja kryhet nëpërmjet :

a) Mbikëqyrjes në vend (on site) dhe analizës se gjendjes financiare të këtyre subjekteve (off site) bazuar në raportimet periodike dhe informacionet e siguruara nga mbikëqyrja në vend ose nga institucione të tjera, mbi bazën e marrëveshjeve paraprake me këto të fundit.
b) Ndjekjes e zbatimit të kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore që lidhen me mbikëqyrjen e këtyre subjekteve.

1.3 Forma

Format e kryerjes së mbikëqyrjes janë :

a) Mbikëqyrje mbi dokumente (off site).

Kjo formë e mbikëqyrjes kryhet nga Drejtoria e Analizës dhe Raportimit dhe konsiston

në ndjekjen e raportimeve periodike të bëra nga institutet private të pensioneve suplementare. Për këtë arsye, raportimet periodike do të formatohen dhe plotësohen sipas pasqyrave bashkëngjitur kësaj rregulloreje.Afatet e raportimit përcaktohen në fund të çdo pasqyre. Sektori i Raportimit ndjek raportimet e subjekteve të mbikëqyrura duke bërë dhe kërkesat apo rikujtimet përkatëse.

b) Inspektimi në vend

Inspektimi në vend mund të jetë, inspektim i plotë mbi të gjithë aktivitetin e subjektit, inspektim me objekt të kufizuar dhe inspektim tematik për fusha apo çështje të caktuara.

Neni 2

Për ushtrimin e mbikëqyrjes në vend, Drejtoria e Inspektimit harton plane veprimi për hapat që duhen marrë për të arritur një sistem mbikëqyrës efektiv dhe ndjek listën e inspektimeve periodike ndaj subjekteve të mbikëqyrura. Paraqet në Departamentin e Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, objektin dhe programin e inspektimit 2 javë përpara afatit të inspektimit periodik.

Objekti, procedura, përmbajtja e raportit të inspektimit dhe etika gjatë kryerjes së Inspektimit, realizohen mbështetur në Udhëzimin " Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare" dhe modelit sipas aneksit bashkëngjitur këtij udhëzimi, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 21.11.2007.

Neni 3

Programi dhe objekti i inspektimit

3.1 Drejtoria e Inspektimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës, Raportimit dhe të Administrimit të Riskut, harton çdo fillim viti planin vjetor të inspektimeve të plota dhe atyre periodike dhe ia paraqet atë Nënkryetarit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Inspektimit ushtron edhe inspektime të përbashkëta me njësi të tjera të Autoritetit ose në bashkëpunim me institucione të tjera, si Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj, në bazë të marrëveshjeve që Autoriteti ka lidhur me to.

3.2 Drejtoria e Inspektimit, kur disponon informacion zyrtar dhe jozyrtar, i cili kërkon hetim, me iniciativën e vet, në bashkëpunim me sektorin juridik dhe/ose me kërkesë të Drejtorisë së Analizës, Raportimit dhe të Administrimit të Riskut, i propozon Nënkryetarit të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, objektin dhe programin e inspektimeve pa paralajmërim për verifikimin e informacionit.

Neni 4

Inspektimi

4.1 Grupi i inspektimit duhet të përqendrohet në inspektimin e:

a) Gjendjes financiare të institutit privat të pensioneve dhe aftësinë e tij paguese për shlyerjen e përfitimeve, nivelin e fondit te garancisë, mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e

strukturës së kapitalit, si dhe plan biznesin për periudhat e ardhshme;

b) Llogarive individuale duke verifikuar përbërjen e informacionit;

c) Rezervave, llogaritjet aktuariale;

d) Investimeve dhe aktiveve në mbulim të rezervave teknike dhe vlerësimi i tyre;

e) Vlerësimit të aktiveve;

f) Detyrimeve të institutit privat të pensioneve suplementare, i cili përbëhet nga detyrime për kontribute, interesa për kontribute dhe detyrime te tjera;

g) Të ardhurave, të cilat përbëhen nga të ardhurat nga investimet dhe të ardhura të tjera;

h) Shpenzimeve për periudhën, e cila përbëhet nga kosto e përfitimit të të siguruarve, shpenzime operative të veprimtarisë dhe shpenzime për investime;

i) Verifikimin e garancisë se institutit privat të pensioneve suplementare ndaj të siguruarve;

j) Marrëdhëniet e institutit privat të pensioneve me degët dhe agjentët, identifikimi i ndonjë problemi financiar me origjinë nga ndonjë subjekt tjetër.

4.2 Grupi i inspektimit duhet të verifikojë gjithashtu dhe përfitimet e paguara në lidhje me :

Afatet dhe pagesat;

a) Identifikimin e praktikave dhe vlerësimin e shkaqeve në rastet e refuzimit të përfitimeve;

b) Identifikimin e ankesave të ngritura nga aderuesit në institutin privat të pensioneve;

c) Evidentimin e padive të ngritura kundër institutit privat të pensioneve;

d) Inspektimin e dokumentacionit që ka të bëjë me kushtet e përgjithshme të përfshirjes në institutin privat të pensioneve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe respektimin e përgjegjësive kontraktuale;

e) Zbatimin e kuotave të kontributeve, në përputhje me ligjin dhe kushtet e vendosura në kontratë dhe transferimin e tyre midis instituteve;

f) Zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të rregulloreve dhe urdhrave të nxjerra nga Autoriteti dhe Këshilli i Ministrave, që rregullojnë veprimtarinë e instituteve private të pensioneve;

g) Verifikimin e të dhënave statistikore dhe financiare sipas pasqyrave IPP-1 dhe IPP-2 (bashkëngjitur kësaj rregulloreje) të raportuara në Autoritet;

h) Verifikimin e transferimin e pjesëmarrësve, së bashku me kontributet e tyre nga një institut në tjetrin, me rastin e shkrirjes së institutit;

i) Saktësinë e llogaritjes së përfitimeve sipas kontratës me kontribuesin;

j) Inspektimin e procedurës së vlerësimit të aseteve të instituteve private të pensioneve;

k) Vlerësimin e eksperiencës dhe aftësitë menaxhuese për drejtimin e instituteve private të pensioneve;

l) Nivelin e informacionit të përgjithshëm, të shpërndarë kontribuesve dhe përfituesve të instituteve private të pensioneve;

m) Protokollin e mbledhjeve;

n) Efektivitetin e drejtimit;

o) Vlerësimin e drejtimit dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm;

p) Organizimin e sistemit të informacionit, mbajtja e një informacioni analitik dhe periodik që ka lidhje me gjendjen financiare të institutit privat të pensioneve suplementare;

q) Të tjera që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore.

Neni 5

Kohëzgjatja e inspektimit

Inspektimi duhet të kryhet në mënyrë efikase, me qëllim që të kufizohet koha e gjatë e qëndrimit në institutin privat të pensioneve suplementare. Inspektimi, në varësi të objektit, përcakton kohëzgjatjen dhe në raste të veçanta, kur nuk realizohen objektivat e Inspektimit, afati mund të shtyhet me miratim të përgjegjësit të sektorit të Inspektimit.

Neni 6

Dokumentimi i Rrezultateve

Dokumenti përfundimtar që evidenton rezultatet e inspektimit të ushtruar nga grupi i inspektimit është Raporti i inspektimit.

Neni 7

Analiza e gjendjes financiare e IPPS

7.1 Me marrjen e raportimeve periodike financiare Drejtoria e Analizës kryen analizën e pasqyrave financiare tre mujore të raportuara dhe përgatit raportin e analizës. Raporti i analizës i përcillet Departamentit të Mbikëqyrjes brenda 2 javësh, pasi ta këtë konsultuar fillimisht me Drejtorinë e Inspektimit dhe atë të Administrimit të Riskut.

7.2 Analiza e gjendjes financiare duhet të përqendrohet kryesisht në:

1) Gjendjen financiare të institutit privat të pensioneve dhe aftësinë e tij paguese për shlyerjen e përfitimeve, nivelin e fondit të garancisë, mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e strukturës së kapitalit.
2) Investimet dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike dhe vlerësimi i tyre.
3) Analizimin e procedurës së vlerësimit të aseteve të instituteve private të pensioneve.
4) Zbatimin e kuotave të kontributeve, në përputhje me ligjin dhe kushtet e vendosura në kontratë dhe transferimin e tyre midis instituteve.
5) Zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të rregulloreve dhe urdhrave të nxjerra nga Autoriteti dhe Këshilli i Ministrave, që rregullojnë veprimtarinë e instituteve private të pensioneve.
6) Organizimin e sistemit të informacionit, mbajtja e një informacioni analitik dhe periodik që ka lidhje me gjendjen financiare të institutit privat të pensioneve suplementare.

Neni 8
Raporti i analizës

8.1 Raporti i analizës duhet të përmbajë analizën e pasqyrave financiare duke u shprehur për:

a) Përmbushjen e detyrimit ligjor për fondin e garancisë;
b) Detyrimet për kontribuesit, detyrimet e tjera si dhe aktivet në mbulim të këtyre. detyrimeve;
c) Aktivet e papërshtatshme në llogaritjen e Aftësisë paguese;
d) Aftesinë Paguese, llogaritjen e aktiveve të lira të institutit;
e) Të ardhurat nga investimi, të ardhura të tjera;
f) Shpenzimet e institutit për periudhën që analizohet;
g) Rezultati financiar i institutit për periudhën që analizohet.

8.2 Raporti i analizës përveç konkluzioneve që rrjedhin nga analiza duhet të përmbajë rekomandime:

a) Lidhur me veprime ose masa ndaj subjektit raportues;
b) Për kërkim informacioni shtesë;
c) Për inspektim në vend (on-site), për të sqaruar apo konfirmuar çështje të ndryshme të ngritura gjatë analizës.

Neni 9
Aftësia paguese

"Aftësia paguese" nënkupton aktivet e institutit privat të pensioneve suplementare, të lira nga çdo detyrim ose përgjegjësi, pas zbritjes së elementeve të patrupëzuara, e cila shërben për të garantuar në vazhdimësi plotësimin e detyrimeve të përgjegjësive të kontraktuara gjatë veprimtarisë së tij, nga burimet e veta.

Aftësia paguese i përgjigjet vlerës së aktiveve të institutit privat të pensioneve suplementare, të lira nga çdo detyrim ose përgjegjësi e parashikuar.

Neni 10
Llogaritja e aftësisë paguese

10.1. Aftësia Paguese është e barazvlefshme me Totalin e Aktivit të Shoqërisë pasi janë zbritur aktivet të konsideruara të papërshtatshme dhe detyrimet e shoqërisë. Aftësia Paguese e shoqërisë pas llogaritjes së mësipërme, përbën Kapitalin e institutit privat të pensioneve suplementare.

10.2. Në Aktivet që nuk përfshihen në llogaritjen e Aftësisë Paguese bëjnë pjesë:

a) Aktivet me shkallë të ulet likuiditeti: Aktive të tjera, të cilat nuk mund të kthehen në likuiditet brenda periudhës që nevojitet për të shlyer detyrimet e shoqërisë. Bëhet fjalë

kryesisht për aktive të grupit AQT (përveç toka dhe ndërtesa). Si p.sh: Gjendje inventari, shpenzime instalimi (për t'u shpërndarë gjatë periudhave), etj;

b) Aktivet e institutit privat të pensioneve suplementare, të cilat nuk janë të lira nga çdo detyrim ose përgjegjësi e parashikuar, (si p.sh ndërtesë ose depozitë e bllokuar si kolateral për një kredi te marrë nga një bankë e nivelit të dytë, etj);
c) Kapitali i nënshkruar i papaguar.
d) Aktive të patrupëzuara;
e) Aktive që nuk konsiderohen Aktive të përshtatshme nga Autoriteti;
f) Detyrime që rrjedhin për pagesat, që i përkasin fondit të garancisë dhe enteve shtetërore.

Neni 11
Të Drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë

11.1. Të drejtat

Punonjësit e Departamentit të Mbikëqyrjes kanë këto të drejta:

a) Të kërkojnë nga institutet private të pensioneve çdo informacion dhe dokument që e çmojnë të nevojshëm për ushtrimin e kontrollit.
b) Të tërheqin për nevojat e mbikëqyrjes kopje të dokumenteve ose origjinalet e tyre kundrejt vërtetimit të lëshuar, si dhe të kërkojnë dokumente shtesë në përputhje me detyrën e ngarkuar.
c) Për probleme që kërkojnë njohuri të veçanta, të kërkojnë ekspertë të fushave të ndryshme.
d) Të bëjnë vlerësimin e mjaftueshmërisë së programit të inspektimit duke ndryshuar ose zgjeruar objektin e inspektimit të miratuar më parë. Zgjerimi i objektit të inspektimit do t'i propozohet me shkrim Kryetarit të Autoritetit, nëse pas fillimit të ushtrimit të inspektimit në institutet e pensioneve e shohin të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve sa më të drejta.
e) Të ndërpresin inspektimin në institutin privat të pensioneve, nëse atyre nuk u krijohen kushtet e domosdoshme për kryerjen e rregullt të detyrës. Për këtë ata mbajnë një proces-verbal me përfaqësuesin e institutit dhe njoftojnë Kryetarin e Autoritetit për arsyet e kësaj ndërprerjeje.
f) Në rast ndërprerjeje për arsye objektive, kanë të drejtë të paraqesin me shkrim propozimin e tyre të arsyetuar.

11.2 Detyrat

Punonjësit e Departamentit të Mbikëqyrjes, në ushtrimin e detyrës së tyre duhet udhëhiqen nga Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve." (të ndryshuar) dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e instituteve private të pensioneve suplementare në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë procesit të kryerjes së inspektimit, duhet të gjykojë mbi mjaftueshmërinë dhe vërtetësinë e inspektimit ne vend, të kryera nga Autoriteti, përfshirë çështjet përkatëse të dokumentimit dhe regjistrimeve të inspektimit:

a) Të analizojnë raportet e inspektimit ne vend të kryera nga instituti privat i pensioneve dhe nga inspektimi i fundit.
b) Te japin rekomandime për Raportin e Analizës së gjendjes financiare, lidhur me veprimet ose masa ndaj subjektit raportues.
c) Të gjykojnë në mënyrë të kujdesshme vendimet e marra nga Instituti Privat i Pensioneve, nëse ato janë në favor të interesave të kontribuesve.

11.3. Përgjegjësitë

Punonjësit e Departamentit të Mbikëqyrjes kanë përgjegjësi për:

a) Raportin e vlerësimit që i paraqesin Kryetarit të Autoritetit për institutet private të pensioneve.
b) Nxjerrjen e konkluzione të sakta lidhur me gjendjen e përgjithshme aktuale dhe të ardhme të institutit privat të pensioneve.
c) Cilësinë e raporteve të nxjerra mbi bazën e detyrave të ngarkuara.
d) Për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave që ka në zotërim gjatë inspektimit.
e) Zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes etike.

Neni 12
Konflikti i interesave

12.1. Punonjësit e Departamentit të Mbikëqyrjes:

a) Nuk duhet të kenë asnjë interes ose obligim financiar që bie ndesh me përgjegjësitë dhe detyrat zyrtare;
b) Nuk duhet të marrin pjesë personalisht për të aprovuar apo mos aprovuar, rekomanduar ose këshilluar, apo të marrin pjesë në një inspektim nëse ai/ajo (inspektori) ose ndonjë pjesëtar tjetër i familjes ka interesa financiare, në qoftë se nuk aprovohet paraprakisht nga Kryetari i Autoritetit.
c) Përpara fillimit të inspektimit, duhet të deklarojë me shkrim se nuk ka papajtueshmëri apo lidhje interesash me institutin privat të pensioneve që inspektohet.

12.2 Rregullorja "Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare", miratuar me Vendim Bordi nr. 15, datë 08.02.2007, shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 12, datë 22.02.2008

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "KPMG ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71, të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar "KPMG Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Sigma" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 13, datë 22.02.2008

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "FICADEX ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71, të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar "FICADEX Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Eurosig" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 22.02.2008
PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË RI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 22.02.2008
PËR
MIRATIMIN E UDHËZUESIT "PËR PËRMBAJTJEN E RAPORTIT TË AUDITIMIT MBI SHOQËRITË E SIGURIMIT NGA SHOQËRITË E EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR"

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 4, pika 4.1 të rregullores " Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e udhëzimit "Për përmbajtjen e raportit të auditimit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar" sipas projektit bashkëngjitur.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkivës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

U D H Ë Z U E S

PËR PËRMBAJTJEN E RAPORTEVE TË AUDITIMIT MBI SHOQËRITË E SIGURIMIT NGA SHOQËRITË E EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 15, datë 22.02.2008

Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4 dhe 20, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2007 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe neni 4, pika 4.1, të Rregullores " Për ekspertet kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit"

1. Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë raporti i auditimit mbi shoqëritë të sigurimit, hartuar nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar.

2. Raporti i auditimit

Raporti i auditimit duhet te përmbajë:

a) Raportet për pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit;
b) Raportin për nivelin dhe ndryshimet e provigjoneve teknike;
c) Raportin për nivelin dhe strukturën e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike;
d) Raportin për nivelin dhe strukturën e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike;
e) Raportin për zbatimin e rregulloreve të menaxhimit të riskut;
f) Raportin për funksionimin e shërbimit të kontrollit të brendshëm;
g) Raportin për metodën e mbajtjes së librave të llogarive;
h) Raportin për cilësinë e sistemit të informacionit të shoqërisë së sigurimit;
i) Raportin për metodën e vlerësimit të zërave të bilancit, të atyre jashtë bilancit dhe politikat e kontabilitetit.

3. Niveli dhe ndryshimet e provigjoneve teknike

Raporti për nivelin dhe ndryshimet e provigjoneve teknike, duhet të përmbajë, sa më poshtë vijon:

1) Shumën e provigjoneve teknike në fillim të vitit, shumën e provigjoneve teknike në fund të vitit dhe ndryshimin në shumën e provigjoneve teknike gjatë vitit;
2) Përshkrimin e metodave të llogaritjes së provigjoneve teknike të miratuara nga shoqëritë e sigurimeve dhe çdo devijim nga metoda e llogaritjes së provigjoneve teknike dhe efekteve në rezultatin financiar të shoqërisë së sigurimit. Gjetjet e auditorit që përfshijnë tregimin e parregullsive;
3) Nëse janë ndjekur ose jo rekomandimet e auditorit të dhëna në vitet e mëparshme;
4) Opinionin për nivelin e provigjoneve teknike.

4. Struktura e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike

Raporti për nivelin dhe strukturën e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike do të përbehet, të paktën, nga sa më poshtë vijon:

a) Përshkrim i shkurtër i nivelit dhe strukturës së aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike dhe niveli i tyre në lidhje me provigjonet teknike, në formë tabelore;
b) Shuma e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike në fillim të vitit, shuma e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike në fund të vitit dhe ndryshimi në shumën e tyre gjatë vitit;
c) Gjetjet e auditorit që përfshijnë tregimin e parregullsive të gjetura;
d) Nëse janë ndjekur ose jo rekomandimet e auditorit të dhëna nga vitet e mëparshme;
e) Opinioni mbi nivelin e strukturës së investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike dhe mbi sigurinë, kthimin dhe marketimin e investimeve, mbi përshtatshmërinë e shumëllojshmërisë së investimeve dhe shpërndarjen e riskut, lokalizimin e aktiveve, monedha dhe përputhja kohore.

5. Struktura e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike

Raporti për nivelin dhe strukturën e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike të menaxhuara nga shoqëria e sigurimeve duhet të përbëhet, te paktën nga sa më poshtë vijon:

a) Një përshkrimi i shkurtër i nivelit dhe strukturës së investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike; e njëjta do të jepet edhe në formë tabelore;
b) Shuma e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike në fillim të vitit, shuma e investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike në fund të vitit dhe ndryshimi në shumën e tyre gjatë vitit;
c) Gjetjet e auditorit që përfshijnë tregimin e parregullsive;
d) Nëse janë ndjekur ose jo rekomandimet e auditorit të dhëna në vitet e mëparshme;
e) Opinion mbi nivelin e strukturës së investimeve të aktiveve që mbulojnë provigjonet matematike dhe mbi sigurinë, kthimin dhe marketimin e investimeve, mbi përshtatshmërinë e shumëllojshmërisë së investimeve dhe shpërndarjen e riskut, lokalizimin e aktiveve, monedha dhe përputhja kohore.

6. Zbatimi i rregulloreve të menaxhimit të riskut

Raporti për zbatimin e rregulloreve të menaxhimit të riskut duhet të përmbajë, të paktën, sa më poshtë vijon:

a) Një përshkrim të shkurtër të secilit risk;
b) Opinionin e kontrollorëve për menaxhimin e secilit risk;
c) Të metat sipas secilit risk;
d) Shpjegimin lidhur me çdo rregullim të vlerës në llogaritjen e kapitalit dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit, metodën e përdorur për menaxhimin e risqeve të likuiditetit, risqet e investimit, risqeve që vijnë nga sigurimi dhe risigurimi në vitin financiar;
e) Opinionin e auditorit mbi mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
f) Nëse janë ndjekur ose jo rekomandimet e auditorit të dhëna nga vitet e mëparshme;
g) Rekomandimet e auditorit për përmirësimin e procedurave dhe të politikës së menaxhimit të riskut individual. Auditori do të përshkruajë investimet e burimeve të veta të shoqërisë së sigurimeve.

7. Shërbimi i kontrollit të brendshëm

Raporti mbi funksionimin e shërbimit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimeve do të përmbajë, të paktën, sa më poshtë vijon:

1) Një përshkrim të shkurtër të shërbimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm dhe informacion për kualifikimet e stafit të kontrollit të brendshëm, duke treguar personat që kanë marrë titullin e kontrollorit ose të kontrollorit të miratuar në përputhje me Ligjin për Kontrollin;
2) Opinionin e auditorit për funksionimin e shërbimit të kontrollit të brendshëm;
3) Të metat e shërbimit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimeve;
4) Nëse janë ndjekur ose jo rekomandimet e auditorit të dhëna në vitet e mëparshme;
5) Rekomandimet e auditorit për përmirësimin e funksionimit të shërbimit të kontrollit të brendshëm.

8. Cilësia e sistemit të informacionit

Raporti për cilësinë e sistemit të informacionit të shoqërisë së sigurimit do të përmbajë një vlerësim të përgjithshëm, si dhe gjetjet e rekomandimet për sa më poshtë vijon:

a) Pajtueshmërinë e sistemit të informacionit me objektivat e biznesit;
b) Efektivitetin e sistemit të informacionit;
c) Politika dhe organizimi i sistemit të informacionit si dhe siguria e mbrojtja e të dhënave;
d) Mjaftueshmëria e sistemit dhe e kontrolleve të tjera në përgjithësi;
e) Mbështetja teknike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 16, datë 22.02.2008

PËR

DHËNIEN E PËLQIMIT PËR STATUTIN E SHOQËRISË "ALAM FINWEST" SH.A

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6/d, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Dhënien e pëlqimit paraprak për statutin e shoqërisë "Alam Finwest" sh.a, për ushtrim veprimtarie në tregtim letrash me vlerë, me kushtin e plotësimit të kapitalit themeltar në përputhje me kërkesat ligjore sipas Ligjit "Për Tituj".

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 17, datë 22.02.2008

PËR
PRANIMIN E TERHEQJES SË LICENSËS SË AGJENTIT NE SIGURIME TË JO-JETËS

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe pikës b) të nenit 85 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Tërheqjen e licencës Nr. 33, datë 18.06.2007, për agjentin Jetnor Haxhiaj pas dorëheqjes vullnetare nga ushtrimi i veprimtarisë si agjent në sigurime.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 18, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES " PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT PËR VLERËSUESIT E DËMEVE NË SIGURIME"

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 89, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe pika 14 e VKM-së, nr. 164, datë 28.01.2008, "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i AMF-së i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores "Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime" sipas projektit bashkëngjitur.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT PËR VLERËSUESIT E DËMEVE NË SIGURIME

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 89, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" e pikës 14 të VKM-së, nr. 164, datë 28.01.2008, "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime", Bordi i AMF-së, miraton sa më poshtë:

Neni 1
Të përgjithshme

1. Personat fizikë, drejtuesit, si dhe punonjësit e angazhuar me vlerësimin e dëmeve të personit juridik, që kërkojnë të pajisen me licencë si vlerësues të dëmeve u nënshtrohen testimit për njohuritë në fushën e sigurimeve.
2. Testimit do t'i nënshtrohen dhe subjektet e përcaktuara në pikën 1, të cilët kërkojnë të rinovojnë licencën si vlerësues të dëmeve në sigurime.
3. Testimit do t'i nënshtrohen vetëm ata aplikantë që plotësojnë më parë dokumentacionin e kërkuar, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 164, datë 28.01.2008.
4. Departamenti Licencimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesit për licencë, i paraqet Kryetarit te Komisionit te Organizimit te Testimit, listën e personave që do t'i nënshtrohen testimit.

Neni 2
Testimi në varësi me llojin e licencës

Testimi do të bëhet në përputhje me fushën e veprimtarisë dhe sipas kërkesës për llojin e licencës që kërkohet, sipas përcaktimit të pikës 4, të VKM nr. 164, datë 28.01.2008, "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime".

Neni 3
Komisionet

3.1 Testimi organizohet nga Komisioni i Organizimit të Testimit, anëtarët e të cilit caktohen nga Kryetari i AMF-së.

3.2 Korrigjimi i testit, do të bëhet nga Komisioni i Korrigjimit, anëtarët e të cilit caktohen nga Kryetari i AMF-së.

3.3 Komisioni i Organizimit të Testimit, do të përbëhet nga 5(pesë) anëtarë:

- 3 anëtarë nga punonjësit e AMF-së;
- 1 anëtar, përfaqësues i Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë/ Byroja e Sigurimit;
- 1 anëtar, përfaqësues i Shoqatës së Vlerësuesve të Dëmeve në Sigurime.

3.4 Kryetar i Komisionit të Organizimit të Testimit, caktohet një anëtar nga punonjësit e AMF-së.

3.5 Komisioni i Korrigjimit do të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit të Organizimit të Testimit.

3.6 Komisionet e mësipërme nuk janë të përhershme.

Neni 4
Detyrat e K.O.T dhe komisionit të korrigjimit

4.1 Komisioni i Organizimit të Testimit është përgjegjës për:

- Organizimin e testimit;
- Hartimin e tërësisë së pyetjeve teorike dhe ushtrimeve praktike të testit, sipas llojit të veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca;
- Përgatitjen e përgjigjeve të testit, ditën që do të zhvillohet testimi.

4.2 Komisioni i Korrigjimit është përgjegjës për:

- Korrigjimin e testeve të aplikantëve duke mbajtur parasysh përgjigjet e përgatitura nga Komisioni i Organizimit të Testimit, si dhe
- Nxjerrjen e rezultateve.

4.3 Ankesat për korrigjimin e testit mund të paraqiten në AMF, brenda 1 jave pas shpalljes së rezultateve.

4.4 Kryetari i AMF-së, pas marrjes së ankesave, cakton numrin dhe përbërjen e Komisionit të rikorrigjimit.

Neni 5

Organizimi i testimit

5.1 Testimi do të zhvillohet një herë në muaj, të enjten e fundit të çdo muaji.

5.2 Vendi dhe ora e zhvillimit të testimit, do njoftohen në faqen web të AMF-së.

5.3 Testimi do të zhvillohet me shkrim në një ditë dhe kohëzgjatja e tij nuk do të jetë më shumë se dy orë.

5.4 Gjatë testimit, salla e zhvillimit të testimit do të jetë nën mbikëqyrjen e një grupi individësh që nuk kanë lidhje me fushën e testimit.

5.5 Ndalohet përdorimi dhe mbajtja e telefonave celulare si dhe e pajisjeve të tjera.

Neni 6

Procedura e testimit

6.1 Në testim, aplikanti duhet të ketë me vete vetëm dokumentin e identifikimit. Materialet për zhvillimin e testimit do të jepen nga Komisioni i Organizimit të Testimit.

6.2 Fletët ku do të shkruhen përgjigjet e testimit do të jenë të gjitha të vulosura me vulën e AMF-së.

6.3 Në përfundim të testimit, të gjitha fletët do të sekretohen nga Kryetari i Komisionit të Organizimit të Testimit.

6.4 Fletët e sekretuara do të vendosen në një kuti të vulosur dhe do të depozitohen në zyrën e protokollit të AMF-së.

6.5 Kutia me fletët e testimit do të hapet vetëm në ditën e korrigjimit në praninë e Komisionit të Korrigjimit.

6.6 Korrigjimi i testimit me shkrim do të bëhet në një sallë të mbyllur (ambient zyrtar) brenda godinës së AMF-së.

6.7 Asnjë anëtar i Komisionit të Korrigjimit nuk lejohet që të marrë me vete fletët e testimit.

Neni 7

Rezultatet e testimit

7.1 Totali i pikëve të tezës është 100 dhe pikët minimale për kalimin janë 55.

7.2 Shpallja e rezultateve të testimit do të bëhet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e zhvillimit të testimit.

Neni 8

Përsëritja e testimit

Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të kësaj rregulloreje, të cilët marrin vlerësim negativ në testim, kanë të drejtën e përsëritjes së provimit, por jo më parë se 3(tre) muaj nga data e testimit të parë.

Neni 9

Fusha e testimit

9.1 Testimi do të përfshijë njohuri nga:

a. Aktet ligjore dhe nënligjore në sigurime dhe risigurime si: kërkesat për marrjen e licencës, kushtet për ushtrimin e veprimtarisë si vlerësues dëmi në sigurime, procedurat e rinovimit të licencës në rast se ka, detyrimet ndaj Autoritetit Mbikëqyrës, detyrimet mbi mbrojtjen konsumatore.

b. Llojet e shoqërive të sigurimit ose risigurimit, kushtet e kontratës në sigurime ku përfshihen elementët ligjore të kontratës së sigurimit, karakteristikat e kontratës së sigurimit, tipet e kontratave të sigurimit, marrjen në sigurim të përgjegjësive.

c. Rolin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime si: detyrat dhe përgjegjësitë kundrejt shoqërisë së sigurimit, të siguruarit ose palës së tretë, standardet profesionale dhe etika në ushtrimin e veprimtarisë.

d. Procedurat e trajtimit të dëmit si: procedurat e trajtimit të demit, parapagesat e dëmshpërblimit, trajtime të veçanta të dëmit, procedurat e subrogimit, procedurat e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit.

e. Mbulimet te veçanta, në të cilat përfshihen njohuri mbi tipe të veçanta si: mbulimi në sigurim respektivisht për probleme të trajtimit të humbjeve të mundshme siç janë ato për pasurinë dhe rreziqet që merren në sigurim, përjashtimet, detyrimet e të siguruarit dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të tipeve të kontratave si: sigurimi i detyrueshëm, sigurimi kasko, sigurimi i përgjegjësive në transportin ajror, sigurimi i përgjegjësisë profesionale, sigurimi nga zjarri dhe shpërthimi eksplozioni.

f. Etika profesionale.

9.2 Aplikantët mund përdorin materialet e mëposhtme:

a. Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004, " Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime";

b. VKM nr. 164, datë 28.1.2008, "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime";

c. Udhëzimin nr. 24,datë 15.11.2007,"Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta";

d. Dekretin e Presidentit nr. 295, datë 15.09.1992, "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", i ndryshuar me Ligjin nr. 7641, datë 1.12.1992;

e. Rregulloren e Ministrit të Financave nr. 622/1, datë 15.12.1992, "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta";

f. Rregulloren e Ministrit të Financave, datë 7.05.2002, " Për disa shtesa në rregulloren 622/1, datë 15.12.1992, "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta";

g. Udhëzimin metodologjik miratuar me Vendimin e Bordit nr. 6, datë 30.08.2007, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime";

h. Kodi Civil – Pjesa për sigurimet;

i. Module për etikën e vlerësuesit të dëmeve në sigurime;

j. Njohuri të tjera në lidhje me fushën e testimit.

Neni 10

Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 19, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E FORMULAR-KËRKESËS PËR PAISJEN ME LICENCË AGJENTI NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formular-kërkesës për pajisjen me agjenti në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 20, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E FORMULAR-KËRKESËS PËR PAISJEN ME LICENCË BROKERI NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës ", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formular-kërkesës për pajisjen me broker në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 21, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E FORMULAR-KËRKESËS PËR PAISJEN ME LICENCË VLERËSUESI DËMESH NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të VKM-së nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formular-kërkesës për pajisjen me licencë vlerësuesi dëmesh në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 22, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI BROKER NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 5, të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", pikës 2, të nenit 81 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe te rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës",me propozim të Departamentit Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formatit të licencës për ushtrim veprimtarie si Broker në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 23, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI SHOQËRI BROKERI NË SIGURIME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 24, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI VLERËSUES DËMESH NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 5, të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", pikës 2, të nenit 81 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të VKM-së nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formatit të licencës për ushtrim veprimtarie si vlerësues dëmesh në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 25, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI SHOQËRI VLERËSUES DËMESH NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 5, të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", pikës 2, të nenit 81 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të VKM-së nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formatit të licencës për ushtrim veprimtarie si shoqëri vlerësues dëmesh në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 26, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI SHOQËRI AGJENTËSH NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 5, të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", pikës 2, të nenit 81 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të VKM-së nr. 76, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formatit të licencës për ushtrim veprimtarie si shoqëri agjentësh në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 27, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË RI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 28, datë 27.03.2008

PËR
REFUZIMIN E MIRATIMIT TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 29, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/h, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 56 dhe 57 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit te Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 35,493% të aksioneve në shoqërinë e sigurimit "INTERSIG" SH.A, të aksioneres Fitnete Meta (Sula), si rezultat i blerjes së 790 aksioneve nga aksioneri Faruk Baburi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 30, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E LICENCËS SI TREGTAR LETRASH ME VLERË TË QEVERISË NË BURSË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (c) të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", nenit 31, të Ligjit nr. 8080, datë 01.03.1996 "Për letrat me vlerë" dhe nenit 18, pika 2 e Rregullores "Mbi licencimin e tregtarit të letrave me vlerë, këshilltarit të investimeve dhe përfaqësuesve të tyre" me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Bankës Ndërkombëtare Tregtare, sh.a, si tregtar letrash me vlerë të Qeverisë në Bursë për një periudhë pa afat.
2. Licencimin e Zj. Merita Mojsia si përfaqësuese e Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a në Bursë për një afat një vjeçar.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 31, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 32, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 33, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 34, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL-LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 35, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 36, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM
Nr. 37, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 38, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SiCRED" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 39, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 40, datë 27.03.2008

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 41, datë 27.03.2008

PËR

REVOKIMIN E PIKËS 6 TË VENDIMIT TË AUTORITETIT NR 18, DATË 28.07.2006 " MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 42, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të, VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime, si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin si agjent në sigurim të jo-jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a, të Z. Genci Topi dhe Z. Dhimitri Llazari dhe si agjent në sigurim të jetës të Z. Nebi Noka.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 43, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VITIN 2007, TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 14 pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Kërkimit dhe Statistikës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Raportit Vjetor për vitin 2007, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas projektit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen strukturat e Autoritetit për Raportim në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 44, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË SHËNDETIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 45, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 46, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 47, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIT TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 63 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

V E N D O S I:

1. Miratimin e Z. Luan Sanxhaku, në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit "Eurosig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 48, datë 25.04.2008

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "KPMG ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT INTERSIG SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar "KPMG Albania" sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit "Intersig" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Intersig" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 48/1, datë 25.04.2008

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "KPMG ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2007, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT INTERALBANIAN SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar "KPMG Albania" SH.P.K, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë të sigurimit "Interalbanian" sh.a, për vitin ushtrimor financiar 2007.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Interalbanian" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes e Disiplinimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr.49, datë 25.04.2008

PËR

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT PËR AUTORIZIMIN E DHËNIES SË INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Në bazë dhe për zbatim nenit 18, pika 1 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Formulari i autorizimit për dhënien e informacionit konfidencial, si pjesë e aneksit të rregullores "Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë", duhet të plotësohet nga aksionarët e shoqërive të sigurimit edhe në rastet e blerjes së aksioneve ose të zmadhimit të kapitalit.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr 50, datë 25.04.2008

MBI
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT " EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr 51, datë 25.04.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE PËR ELEMINIMIN E SHKELJEVE TË KONSTATUARA NGA RAPORTI I INSPEKTIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 52, datë 25.04.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE PËR ELEMINIMIN E SHKELJEVE TË KONSTATUARA NGA RAPORTI I INSPEKTIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 53, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 54, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr 55, datë 25.04.2008

PËR
REFUZIMIN E MIRATIMIT TË VENDIMEVE TË SHOQËRISË "CAPITAL IPP" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/j dhe n, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 29, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe procedurat e licencimit e të mbikëqyrjes" me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë "Capital IPP" sh.a, për miratimin e vendimeve të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve në lidhje me transferimin e pronësisë së aksioneve, pasi:

- Veprimet e kryera nga shoqëria duke shitur 97 % të aksioneve, jashtë aksionerëve ekzistues, janë kryer pa marrë miratimin paraprak të Autoritetit.
- Shoqëria "AVEL" sh.p.k, e cila pretendon të marrë pronësinë e 97% të aksioneve të shoqërisë "Capital" sh.a, nuk garanton për qëndrueshmëri financiare afatgjatë të përshtatshëm për aktivitet në fonde pensionesh. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të shoqërisë "AVEL" sh.p.k, 83% e pasivit në bilancin vjetor të 2007 përbëhet nga detyrime ndaj të tretëve, shumica e të cilave të kërkueshme brenda një viti.
- Nuk janë në përputhje me rezolutën "Mbi situatën e tregut të pensioneve private dhe suplementare" miratuar nga AMF, e cila konfirmon angazhimin zyrtar të Qeverisë Shqiptare kundrejt FMN-së për pezullimin e dhënies së licencave të reja për fonde pensionesh private dhe suplementare, si dhe kufizon çdo zhvillim në tregun ekzistues të pensioneve private që nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare deri në plotësimin e kuadrit të ri ligjor.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 56, datë 27.03.2008

PËR
MIRATIMIN E LICENSËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të, VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Z. Edmond Meçe si agjent ne sigurime jo-jete, në emër dhe për llogari të shoqërisë "Insig" sh.a, me kushtin që vlefshmëria e licencës të fillojë pas lidhjes së kontratës me shoqërinë e sigurimit dhe instalimit të programit on-line të shitjes.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 57, datë 25.04.2008

PËR
MIRATIMIT TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË "CAPITAL IPPS" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/j, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 20 të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Z. Naim Hasa, në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë "Capital IPPS" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 58, datë 22.05.2008

MBI

MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE "APFA" SH.A.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 59, datë 22.05.2008

MBI

MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE "GARANTSIG" SH.A.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 60, datë 22.05.2008

MBI

MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ INSTITUTIT PRIVAT TË PENSIONEVE "CAPITAL" SH.A.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 61, datë 22.05.2008
PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT E TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË TË SIGURUARVE "

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 163, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores "Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve".
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR

PROCEDURAT E TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË PARAQITURA NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve, lidhur me pretendimet e tyre për t'u dëmshpërblyer nga shoqëritë e sigurimit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si dhe nenit 163, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Neni 3

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen për personat e siguruar ose përfituesit, që ankohen pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, po ashtu edhe për punonjësit e këtij institucioni, të cilët janë të ngarkuar me trajtimin e këtyre ankesave.

Neni 4

Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen dhe rritjen e efikasitetit në trajtimin e ankesave me korrektësi dhe shpejtësi me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve.

Neni 5

Përkufizime

"Ankues" -Personi i interesuar që i drejton një ankesë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

"I siguruar"-nënkupton personin, i cili ka nënshkruar një kontratë sigurimi.

"Përfitues"- nënkupton personin që gëzon të drejtën e dëmshpërblimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit.

Të gjithë termat e tjerë, të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 3, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime"

PJESA E DYTË

TRAJTIMI I ANKESAVE

Neni 6

E drejta për t'u ankuar

Çdo person fizik ose juridik, publik dhe privat, që pretendon se i është shkelur një e drejtë e ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e shoqërive të sigurimit, ka të drejtë të ankohet në Autoritet.

Neni 7

Kushtet e pranimit të ankesave

7.1 Ankimi pranë Autoritetit bëhet në çdo kohë nëse i siguruari/përfituesi, mbetet i pakënaqur nga trajtimi te shoqëria e sigurimit nga e cila pretendon dëmshpërblim.

7.2 Autoriteti është i detyruar të shqyrtojë çdo ankesë të personit të siguruar.

7.3 Autoriteti ndërpret trajtimin e ankesës në qoftë se çështja është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata, ose është marrë vendimi i formës së prerë.

7.5 Autoriteti pranon ankesa me shkrim, telefon, fax ose postë elektronike.

7.6 Autoriteti nuk pranon ankesa anonime.

Neni 8

Dokumentet që shoqërojnë ankesën

8.1 Autoriteti i kërkon të siguruarit/përfituesit, i cili pretendon se i është shkelur e drejta për dëmshpërblim, dokumentacionin bazë që ai disponon dhe që është i nevojshëm për shqyrtimin e çështjes së ankimuar:

a) emrin, mbiemrin dhe adresën e të siguruarit;

b) emrin e shoqërisë së sigurimit, ndaj të cilës i siguruari ankohet;

c) datën dhe vendin e ndodhjes së ngjarjes;

d) përshkrimin e ngjarjes për të cilën kërkohet dëmshpërblim;

e) kopje të policës së sigurimit;

f) përgjigjen e dhënë nga shoqëria e sigurimit, në rast se ka;

g) si dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me çështjen e ankimuar.

Neni 9

Procedura e trajtimit të ankesës

9.1 Autoriteti menjëherë me marrjen e ankesës fillon trajtimin e saj me kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

a. kërkon nga shoqëria e sigurimit çdo informacion dhe dokument të nevojshëm për shqyrtimin e ankesës së bërë;

b. kërkon informacion shtesë nga i siguruari;

c. organizon takime të përbashkëta midis të siguruarit dhe shoqërisë së sigurimit, ndaj së cilës është ngritur pretendimi.

d. kërkon t'i vihet në dispozicion dosja e dëmit për çdo rast konkret, shoqëruar nga raporti i vlerësuesit të dëmit që vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Neni 10

Veprimet pas përfundimit të shqyrtimit dhe kompetencat

10.1 Pas përfundimit të shqyrtimit, nëse Autoriteti konstaton që ankuesi ka të drejtë bazuar në ligj, i sugjeron shoqërisë të rishikojë praktikën e dëmit duke i vënë në dukje shkeljet dhe mangësitë.

10.2 Me marrjen e përgjigjes nga shoqëria, Autoriteti njofton menjëherë ankuesin.

10.3 Nëse shoqëria nuk pranon të marrë në rishqyrtim çështjen, Autoriteti i sugjeron të siguruarit, rrugën ligjore për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10.4 Autoriteti nëse gjatë shqyrtimit të ankesës konstaton se pagesa e dëmshpërblimit nuk është kryer në masën dhe afatin e duhur, propozon sanksione për shoqërinë e sigurimit.

Neni 11

Ruajtja e konfidencialitetit

Autoriteti është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit për çdo informacion apo dokument të vënë në dispozicion nga i siguruari ose shoqëria e sigurimit, në lidhje me çështjen në shqyrtim.

Neni 12

Shërbimi pa pagesë

Çdo shërbim që bëhet nga Autoriteti lidhur me trajtimin e ankesave është pa pagesë.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

13.1 Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit, për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

13.2 Drejtoria e Zbatueshmërisë ka detyrimin e raportimit një herë në vit në mbledhjen e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për numrin e ankesave të paraqitura pranë saj si dhe për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Kjo rregullore hyn në fuqi më datë 22.05.2008

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 62, datë 22.05.2008

PËR
MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE INDIVIDUALE TË PUNONJËSVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe Udhëzimit nr. 5, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve civlil", me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Udhëzimit "Për vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësve".
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

UDHËZIM

PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE INDIVIDUALE TË PUNONJËSIT

Vlerësimi i Punës (VP) është një proces sistematik e praktik, i cili ka të bëjë me gjykimin dhe vlerësimin e pozicioneve të punës. Përveç kësaj, ky proces ndihmon stafin menaxherial të kuptojë qartë ecurinë konkrete të punës nga çdo njësi e institucionit dhe njëkohësisht, të bëjë të mundur edhe krahasimet ndërmjet tyre.

Procedura e VP, nuk vendos direkt nivelet e pagesës, por përcakton një renditje të pozicioneve të punës brenda institucionit.

Për ndërtimin e një VP ekzistojnë disa lloj kriteresh të cilat institucioni i përdor për krijimin e një liste që do të vlerësojë dhe diferencojë poste të ndryshme pune.

Sektori i Burimeve Njerëzore në AMF ka detyrë, organizimin dhe funksionimin e procesit të vlerësimit të arritjeve individuale të çdo punonjësi.

Vlerësimi bëhet mbi bazën e mbarëvajtjes në punë për një periudhë 12 mujore. *Viti i vlerësimit* fillon nga 01 Nëntori deri më 31 Tetor të vitit pasardhës. Në fillim të tij, i gjithë stafi duhet të njohë objektivat e punës mbi të cilat do bëhet vlerësimi.

Mbarëvajtja në punë bazohet në vlerësimin e dy lloj faktorëve:

a) arritjes së objektivave

b) vlerësimit të aftësive kryesore që nevojiten për të përmbushur këto objektiva

Vlerësimi i mbarëvajtjes në punë, është një procedurë e hapur, e cila kryhet nga Eprori Raportues dhe Eprori Autorizues.

Eprori Raportues vlerëson punën e punonjësve të cilët janë në varësi direkte të tij / saj.

Eprori Autorizues është eprori, i cili në shkallë hierarkike është më lart se ai Raportues. Duke firmosur, Eprori Autorizues konfirmon atë çka ka vlerësuar Eprori Raportues.

Shkalla hierarkike e vlerësimit jepet si më poshtë:

a) Për vlerësimin e specialistëve:

- Eprori Raportues-Përgjegjës i Sektorit (ose Drejtori i Drejtorisë kur sektori ka numër të kufizuar specialistësh).
- Eprori Autorizues-Drejtori respektiv i Drejtorisë së Përgjithshme (Departamentit).

b) Për vlerësimin e Përgjegjësve të Sektorit :

- Eprori Raportues-Drejtori i Drejtorisë.
- Eprori Autorizues-Drejtori respektiv i Drejtorisë së Përgjithshme (Departamentit).

c) Për vlerësimin e Drejtorit të Drejtorisë:

- Eprori Raportues-Drejtori respektiv i Drejtorisë së Përgjithëshme (Departamentit).
- Eprori Autorizues-Kryetari.

Brenda një viti vlerësues kryhet një vlerësim i përgjithshëm në fund të muajit tetor.

Eprori Raportues duhet të vëzhgojë me kujdes e në vazhdimësi, mbarëvajtjen e punonjësve për të cilët do raportojë. Ai /Ajo duhet të regjistrojë në mënyrë specifike ecurinë e punës, duke vënë në pah çdo problem **sapo** ai lind.

Punonjësit duhet t'i vihen në dukje veprimtaritë (fushat) ku mbarëvajtja është e dobët dhe epërsitë që ai disponon. Në rast se mbarëvajtja është e pakënaqshme**, atëhere punonjësi vihet menjëherë në dijeni me shkrim nga Eprori Autorizues.**

Vlerësimi i mbarëvajtes në punë bazohet në objektivat e vendit të punës. Rekomandohet të paraqiten 4-5 objektiva të cilat duhet të përmbajnë veprimtaritë kryesore që përdor punonjësi për realizimin e produktit të tij. (p.sh: Sektori i Burimeve Njerëzore ka si objektiv ecurinë e trajnimeve të stafit e për realizimin e këtij objektivi, ai do të përdorë disa veprimtari siç janë: kontaktet me drejtuesit e njësive për kërkesat aktuale për trajnim; konsultim me degën e financës; përpunimi i të dhënave, si dhe nxjerrja e konkluzioneve).

Objektivat duhet të renditen sipas: rëndësisë, kohës që kërkohet për t'i realizuar dhe përcaktohen duke u konsultuar direkt me punonjësin. Për të arritur qëllimin e punës, duhet pasur parasysh, rëndësia relative e çdo objektivi, p.sh, në se punonjësi ka 3 objektiva dhe ato vlerësohen: njëri në një nivel dhe dy të tjerët në nivel tjetër, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që, vlerësimi i përgjithshëm i punës të jetë ai që është bërë për dy objektivat, në se objektivi tjetër është më i rëndësishëm se dy të tjerët të kombinuar bashkë.

Shumë i rëndësishëm është konsideruar edhe vetëvlerësimi i performancës që kryhet nga vetë punonjësi. Forma e Vetëvlerësimit realizohet duke ngritur disa pyetje të cilave duhet t'u përgjigjet çdo punonjës, e nga ku eprori bashkëbisedues merr informacion të drejtpërdrejtë.

Aneksi A

Moment tjetër në vlerësimin e performancës është edhe *"Vlerësimi i Aftësive Kryesore"* të seicilit punonjës. Kjo rrugë, ndihmon në evidentimin e dobësive dhe epërsive të çdo punonjësi: Aftësitë Kryesore vlerësohen për dy lloj nivelesh:

Për nivelin Pergjegjes sektori + Specialist Aneksi B-1

Për nivelin menaxherial (Drejtor Dep't; Drejtor Drejtorie) / Aneksi B-2

Vlerësimi ndahet në 4 nivele:

Shkëlqyer = Mbarëvajtja është ndjeshëm mbi nivelin e kërkuar.

Shume Mirë = mbarëvajtje mbi nivelin e pritshëm.

Mirë = mbarëvajtja arrin plotësisht nivelin e pritshëm.

Mjaftueshëm = arritjet janë nën nivelin e pritshëm (pra kërkohet më tepër përkushtim dhe aftësi).

Sektori i Burimeve Njerëzore shpërndan (elektronikisht) formularët e vlerësimit (tabelat përkatëse + shpjeguesin) dhe sigurohet që ato të kthehen të plotësuar dhe arkivohen në dosjen personale të secilit punonjës për një afat 3-vjeçar.

Personi në provë që në fillim, duhet të ketë tepër të qarta objektivat për vendin e punës që mbulon. Mbarëvajtja në punë e kësaj kategorie punonjësish, duhet të diskutohet ndërmjet vetë punonjësit dhe Eprorit Raportues. Për punonjësin në provë shënohet fjala: *"Në Provë"* sipër formularit standard.

Në rastin kur punonjësi lëviz (ndërron) vendin e punës brenda institucionit ku punon, vlerësimi i mbarëvajtjes së tij në punë kryhet nga eprori i ri. Ky i fundit duhet të konsultohet patjetër edhe me eprorët e mëparshëm të punonjësit që po vlerësohet. Duhet pasur parasysh të vlerësohet sa më drejtë koha e shpenzuar në secilin vend pune.

Ankimi-Punonjësi, pasi njihet me vlerësimin e tij/saj ka të drejtën e ankimimit në një afat 10 ditë nga dita e marrjes së vlerësimit. Zakonisht mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen duke diskutuar me Eprorin Raportues. Kur kjo nuk është e mundur, punonjësi paraqet ankesë me shkrim ku reflekton të gjitha argumentet e tij. Pas kësaj, eprorët raportues dhe autorizues duhet të komentojnë me shkrim të gjitha pikat e ankesës së punonjësit. Nëse eprorët nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje të përbashkët lidhur me vlerësimin, do të jetë Eprori Autorizues ai që do të vendosë përfundimisht e në mënyrë zyrtare për këtë gjë.

Si ndikon ky proces në aktivitetin e institucionit.

Procesi i vlerësimit të mbarëvajtjes individuale në punë, është një proces suportiv si për sektorin e Burimeve Njerëzore ashtu dhe për stafin menaxherial, i cili mund të informohet saktë e në çdo moment për ecurinë e punës, vështirësitë aktuale apo nevojat për trajnim.

Aneksi C shpjegon fazat e kryerjes së vlerësimit të punës. Viti i vlerësimit shtrihet nga 01 nëntori i vitit aktual deri më 31 tetor të vitit pasardhës (p.sh.: nëntor 2008- tetor 2009)

1. shtator = Vendosen objektivat për vitin e ardhshëm, i prezantohen ato punonjësve.

(në rastin tonë: në shtator 2008 do të vendosen objektivat e punës për vitin 2009 dhe do t'u bëhen të ditura punonjësve.)

2. tetor = Kryhet vlerësimi i mbarëvajtjes në punë për vitin aktual (në rastin tonë do të vlerësohet performanca e punës për periudhën deri më 31tetor 2008).

Shënim: Meqenëse kjo procedurë sapo është aprovuar, mendohet që vlerësimi i parë i punës vetëm për vitin aktual 2008, të kryhet në fund të muajit tetor 2008.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 63, datë 22.05.2008

PËR

MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË SHËNDETIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 64 , datë 22.05.2008

PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË PRIMIT TË PASTËR TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

Në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr 7641, datë 01.12. 1992, "Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike ndaj personave të tretë"(i ndryshuar), dhe Rregullores së Ministrit të Financave 622/1, datë 15 dhjetor 1992, (e ndryshuar) në 07. 05. 2002 "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Të miratojë në parim tabelat me primin e pastër sipas kategorive për produktet TPL e brendshme dhe kontratë e sigurimit kufitar, sipas propozimit të Komitetit të Aktuarëve. (Tabelat bashkëlidhur)
2. T'i propozojë Ministrit të Financave për miratim:

Tabelat e primit të pastër sipas kategorive për produktet TPL e brendshme dhe kontratë e sigurimit kufitar sipas pikës 1 të këtij Vendimi.

Përfshirjen në urdhrin e ri të Ministrit të Financave të paragrafëve të mëposhtëm:

- Primi i sigurimit (pa përfshirë TVSH) për çdo policë të sigurimit për çdo kontratë TPL e brendshme, apo kontratë e sigurimit kufitar, nuk mund të jetë më i lartë se primi i pastër sipas këtij urdhri plus 25% të këtij primi të pastër.
- Provigjoni i primit të pafituar duhet të llogaritet për çdo policë sigurimi, si pjesë përpjesëtimore e primit të pastër sipas këtij urdhri, për periudhën e paskaduar të policës së sigurimit.
- Disa ndryshime në Rregulloren nr 622/1 të ndryshuar në 07. 05. 2002 " Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta" (Ndryshimet, bashkëlidhur)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 65, datë 22.05.2008

PËR
PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIT "GJEOGRAFIA E SIGURIMEVE 2007"

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 14 pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Kërkim Statistikës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e publikimit "Gjeografia e Sigurimeve 2007" sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimit dhe Statistikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 66, datë 22.05.2008

PËR
MARRËVESHJEN MIDIS AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Kërkim Statistikës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Për lidhjen e Marrëveshjes midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit "Për aksesin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik".
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

MARRËVESHJE

MIDIS
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE
Përfaqësuar nga Elisabeta GJONI, Kryetar

dhe

BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT
Përfaqësuar nga Valbona KADUKU, Drejtor Ekzekutiv

Për
PËR AKSESIN E BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT NË REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK

Lidhur më datë 22.05.2008, Tiranë

Neni 1
Baza ligjore dhe interpretimi

1.1 Në mbështetje të nenit 14, pika 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Autoriteti lidh këtë Marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni me Byronë Shqiptare të Sigurimit.

1.2 Marrëveshja së bashku me Aneksin përbën një marrëdhënie të vetme kontraktore. Për këtë arsye, mospërmbushja e ndonjë prej detyrimeve të Marrëveshjes nga njëra palë përbën mospërmbushje të Marrëveshjes në tërësi.

1.3 Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, palët bien dakord që termat e mëposhtëm kurdoherë që përdoren, përveç kur parashikohet ndryshe, kanë kuptimin që vijon:

Përkufizime:

Autoriteti

Nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, të krijuar me Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006.

Byroja

Nënkupton Byronë Shqiptare të Sigurimit, sipas Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Regjistri

Nënkupton Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që mbulon sigurimet e detyrueshme të kontraktuara pas datës 01.12.2007.

Marrëveshje

Nënkupton këtë Marrëveshje

Faqja e internetit

Nënkupton faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (www.amf.gov.al) me faqen specifike të kërkimit të arritshme nëpërmjet zërit 'Përdorim i Brendshëm' të menysë 'Hyrje e Autorizuar' (http://www.amf.gov.al/loginForm.asp).

Motori i kërkimit

Nënkupton aplikimin nëpërmjet të cilit Autoriteti mundëson marrjen e informacionit, objekt i kësaj marrëveshje nga ana e Byrosë.

Akses i kufizuar

Nënkupton përdorimin e emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit për të aksesuar hapësirën aplikative të motorit të kërkimit.

Palë

Nënkupton ose Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ose Byronë Shqiptare të Sigurimit, sipas kontekstit në të cilin përdoret.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i rregullave për dhënien e aksesit Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, për të hyrë në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik .

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është garantimi dhe siguria në marrjen e informacionit, ruajtjen e integritetit të databazës, si dhe identifikimin e historikut të përdorimit të databazës nga Byroja.

Neni 4

Detyrime të Autoritetit

4.1 Autoriteti merr përsipër dhënien e informacionit të:

- konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil për automjetet shqiptare;
- konfirmimit të mbulimit në sigurim të mjeteve shqiptare me TPL apo mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

4.2 Autoriteti merr përsipër dhënien e informacionit më të zgjeruar lidhur me:

- Policën e gjetur.
- Mjetin e mbuluar.
- Policmbajtësin.
- Shoqërinë e Sigurimit që ka kontraktuar policën.

Neni 5

Detyrime të Byrosë

5.1 Byroja merr përsipër ta përdori informacionin vetëm për qëllimet e veta dhe të mos e përdori për qëllime të tjera.

5.2 Byroja merr përsipër dhe ruajtjen e këtij informacioni vetëm për përdorim të brendshëm.

Neni 6

Aksesi i Byrosë

6.1 Byroja do ketë akses online në databazën e Regjistrit përmes një hapësire të veçantë në faqen e internetit të Autoritetit.

6.2 Personi i autorizuar nga Byroja mund të hyjë në regjistër vetëm përmes përdorimit të emër përdoruesit dhe fjalëkalimit.

6.3 Fjalëkalimi fillestar do të vihet në dispozicion nga Drejtoria e TI, pranë Autoritetit.

Neni 7

Konfidencialiteti

Byroja angazhohet që informacionet e përftuara do t'i përdori vetëm për qëllim të kryerjes së funksioneve të saj, si dhe do të ruajë sigurinë e këtij informacioni.

Çdo veprim i Byrosë për marrje informacioni nga Regjistri, do të ruhet në një log të veçantë pranë Autoritetit.

Neni 8

Kostot teknike

Të gjitha kostot e zgjidhjes teknike mbulohen nga Autoriteti. Në të ardhmen mbulimi i kostove në rast të ndryshimeve të mundshme të Regjistrit, do të përballohen nga Byroja ose, nëse bien dakord, do të ndahet midis Palëve.

Neni 9

Afatet

Byroja mund të ketë akses mbi Regjistrin vetëm pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Dispozita të fundit

Neni 10

Përfaqësimet dhe Garancitë e Palëve

10.1 Çdonjëra nga palët, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje siguron Palën tjetër se:

a) është e autorizuar të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara nga kjo

Marrëveshje;

b) përmbushja e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe e të gjithë Marrëveshjes në tërësi nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi; dhe që

c) detyrimet e kësaj Marrëveshjeje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të detyrueshme për tu zbatuar.

Neni 11

Cënimi i ndonjë neni të Marrëveshjes

11.1 Në rast se ndonjë prej neneve të kësaj Marrëveshje bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pamundur për t'u zbatuar sipas legjislacionit në fuqi që rregullon këtë Marrëveshje, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatimi i neneve të tjera të Marrëveshjes nuk cënohet.

11.2 Palët, në mirëbesim, mund të negociojnë për të zëvendësuar dispozitën e mësipërme me një dispozitë tjetër.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje apo konflikt që rrjedh apo është i lidhur me këtë Marrëveshje, ta zgjidhin në mënyrë miqësore me bisedime midis tyre.

Neni 13

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

13.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

13.2 Marrëveshja është e vlefshme për një afat të pacaktuar.

13.3 Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë duke njoftuar paraprakisht me shkrim Palën tjetër të paktën 1 muaj para.

13.4 Detyrimet e krijuara apo të marra përsipër nga Palët deri në momentin e njoftimit për ndërprerjen e Marrëveshjes vazhdojnë të përmbushen nga Palët deri në përmbushjen e tyre të plotë.

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, nga të cilat 2 (dy) për Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe 2 (dy) për Autoritetin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Elisabeta Gjoni, Kryetar

Për Byronë Shqiptare të Sigurimit, Valbona Kaduku, Drejtor Ekzekutiv

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 67, datë 22.05.2008

PËR

MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës b) të nenit 85, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të, VKM nr. 192, datë 25.03.2005 "Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime, si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Tërheqjen e licencës për Z. Nebi Noka si agjent në sigurimin e jetës pas heqjes dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë.
2. Licencimin e Z. Nebi Noka si agjent në sigurime jo-jete, në emër dhe për llogari të shoqërisë "Insig" sh.a, për një periudhë 3-vjeçare.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 68, datë 22.05.2008

PËR
MIRATIMIN E DEKLARATËS MBI DETYRIMET E PAPAGUARA NË AFAT

Në bazë dhe për zbatim nenit 14, pika 23 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 28.01. 2008 "Për caktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës" me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e deklaratës mbi detyrimet e papaguara në afat për agjentët në sigurime, sipas formatit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 72, datë 25.06.2008

PËR
DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË "GARANTSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 73, datë 25.06.2008

PËR
DISA NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 74, datë 25.06.2008

PËR
DISA NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 75, datë 25.06.2008

PËR

MIRATIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14 pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 63, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimit të Z. Luan Leka si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit "Atlantik" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 76, datë 25.06.2008

PËR
PËRFTIMIN E NJË SHPËRBLIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 77, datë 25.06.2008

PËR
TËRHEQJEN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1/b të nenit 85, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Tërheqjen e licencës për Z. Hysni Shalla, Z. Agim Sharra dhe Zj. Nexhmije Elezi si agjent në sigurimin e jo-jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë "Sigal" sh.a, pas heqjes dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr.78, datë 25.06.2008

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË MBIKËQYRJES PËR TREGUN E SIGURIMEVE PËR VITIN 2007

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 14 pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Kërkim Statistikës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Raportit të Mbikëqyrjes për Tregun e Sigurimeve për vitin 2007, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimit dhe Statistikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 79, datë 25.06.2008

PËR

LICENCIMIN E SHOQËRISË "AK INVEST" PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1/b të nenit 85, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe VKM nr.79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë "AK INVEST" sh.a, si agjent në sigurime të jo-jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë "Sigal" sh.a, me kushtin që vlefshmëria e licencës të fillojë pas lidhjes së kontratës me shoqërinë e sigurimit dhe instalimit të programit on line të shitjes.
2. Licencimin e Z. Vedat Asllani, si agjent në sigurime të jo-jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë "AK INVEST" sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 80, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 81, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 82, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 83, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 84, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 85, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 86, datë 10.07.2008
PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 87, datë 10.07.2008

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 89, datë 10.07.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 90, datë 10.07.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SiCRED" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 91, datë 10.07.2008

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 92, datë 14.08.2008

PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE STANDARDE MINIMALE TË SIGURIMIT NË GRUP TË PUNONJËSVE TË MINIERAVE NGA AKSIDENTET PERSONALE NË PUNË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 122, pika 1, gërma e dhe pika 3 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentit *"Kushtet standarde minimale të sigurimit në grup të punonjësve të minierave nga aksidentet personale në punë",* sipas lidhjes nr. 1 bashkëngjitur.
2. Kushtet e miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, shërbejnë si kushte minimale të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet personale në punë.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 93, datë 14.08.2008

PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE STANDARDE MINIMALE TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË LIGJORE TË TREGTUESVE TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 122, pika 1, gërma e dhe pika 3 të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit te Mbikëqyrjes, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentit *"Kushtet standarde minimale të sigurimit të përgjegjësisë ligjore të tregtuesve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre",* sipas Lidhjes nr. 1 bashkëngjitur.
2. Kushtet e miratuara sipas pikës 1 të këtij Vendimi, shërbejnë si kushte minimale të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit për sigurimin e përgjegjësisë ligjore të tregtuesve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre për dëmet që mund t'u shkaktojnë palëve të treta.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 94, datë 14.08.2008
MBI
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT NR. 8, DATË 17.12.2007 "MBI MARRJEN E MASAVE PËR KORRIGJIMIN E SITUATËS PROBLEMATIKE QË PARAQITET NË TREGUN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MTPL"

Në bazë të nenit 14 dhe 32 të Ligjit nr. 9572 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe Rregullores, datë 07. 05. 2002, të Ministrit të Financave "Për disa shtesa në Rregulloren 622/1, datë 15.12.1992 dhe në Urdhërin nr. 82, datë 19.06.2008 të Ministrit të Financave "Për miratimin e primit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Bordi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Pika 1, paragrafi 6 i Vendimit të Bordit nr. 8, datë 17.12.2007, të ndryshojë si vijon:
   Çdo agjent ose punonjës në ambientet që ushtron veprimtarinë të ketë të afishuar në vende të dukshme:
   - Aneksin 1 me tabelat 1, 2 dhe 3 të primeve, të cilat publikohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe përditësohen prej tij në funksion të ndryshimeve të kuadrit ligjor që lidhet me to.
   - Kopje të kushteve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm.
   - Licencën e agjentit, ose autorizimin e punonjësit për të nënshkruar kontrata sigurimi.
   - Përditësimin e Aneksit 1 me tabelat 1, 2 dhe 3 të primeve për të pasqyruar ndryshimet që vijnë nga hyrja në fuqi e Urdhërit nr. 82, datë 19. 06. 2008 të Ministrit të Financave "Për miratimin e primit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta".
   - Publikimin në faqen e internetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në seksionin e përbashkët të shoqërive të sigurimit të këtij vendimi dhe të Aneksit 1 të përditësuar.
   - Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.
   - Ngarkohet Drejtoria TI, të reflektojë të gjitha ndryshimet në zbatim të këtij vendimi, në Rregjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.
   - Vendimi u bëhet i njohur të gjitha shoqërive të sigurimit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 95, datë 14.08.2008

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe në VKM nr 742, datë 07.11.2007 dhe Urdhrin nr 65, datë 05.05.2008, të Ministrit të Financave, me propozim të Drejtorisë së Raportimit dhe Analizës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Neni 2, pika 2.3 e Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit nr. 10, datë 17.12.2007, të ndryshojë si më poshtë :

"Vërtetimin nga IEKA që ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë si shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar në auditimin e subjekteve të sektorit financiar.

Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar, duhet të depozitojë në Autoritet të dhëna se ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë në auditimin e subjekteve, të cilat kanë zbatuar standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar".

2. Ngarkohet Drejtoria e Raportimit dhe Analizës për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 96, datë 14.08.2008
PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 97, datë 14.08.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SE SIGURIMIT "SIGAL LIFE" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 98, datë 14.08.2008

PËR
MIRATIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË
BURSA E TIRANËS SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6 (d), të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Dhënien e pëlqimit për emërimin e z. Hysen Muceku, si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 99, datë 14.08.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË "KAPITAL INVEST" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 100, datë 14.08.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, Pika 1 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Engjëll Gina si vlerësues i *dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *i dëmeve shëndetësore* në sigurime për këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurime motorike, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 101, datë 14.08.2008

PËR
LICENSIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, Pika 1 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Mikel Caka si vlerësues i *dëmeve materiale (motorrike dhe të pronës)* dhe *i dëmeve shëndetësore* në sigurime për këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 102, datë 14.08.2008
MBI
SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ATLANTIK" NDAJ VENDIMIT TË BORDIT NR. 83 DATË 10.07.2008

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 103, datë 14.08.2008
MBI
SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" NDAJ VENDIMIT TË BORDIT NR.84 DATË 10.07.2008

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 104, datë 14.08.2008
PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË BUXHETIN E AMF PËR VITIN 2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 105, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIMIN E BORDIT DREJTUES TË SHOQËRISË SË PENSIONEVE "SIGMA IPP" SH.A

Ne zbatim të nenit 14, pika 6/j, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 18, të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve" me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Bordit Drejtues të shoqërisë së pensioneve "SIGMA IPP" me këtë përbërje:
   - Halit LLeshi - Kryetar
   - Klaidi Citozi
   - Lavdi Avllaj
   - Denada Josifi
   - Behar Shehu
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 106, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIMIN E BORDIT TË DREJTORËVE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 63, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit "SIGMA" sh.a, me këtë përbërje:
   - Z. Qemal Disha – Kryetar
   - Z. Lavdi Avllaj – Nënkryetar
   - Z. Klaidi Citozi – Anëtar
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 107, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SË PENSIONEVE "CAPITAL IPP" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572 datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", nenit 45 të Ligjit nr. 7943 datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve" dhe nenit 29 të VKM nr. 908, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e inspektoriatit të instituteve private të pensioneve suplementare dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e transferimit të pronësisë të aksioneve, që përfaqësojnë 12% të kapitalit themeltar të shoqërisë së pensioneve "Capital IPP" sh.a nga aksionerët "Bruçi" sh.p.k dhe "Shpresa" sh.p.k tek aksioneri i ri propozuar, shoqëria "Avel" sh.p.k.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 108, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIM TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 62, 63 dhe 64 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Zj. Fitnete Sula (Meta), në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit "Intersig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 109, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SiCRED" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 110, datë 11.09.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Zj. Irena Bejko për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime për *dëmet materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *dëmet shëndetësore* në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe i shëndetit, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi i avionëve, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 111, datë 11.09.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Mynever Baholli për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime për *dëmet materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *dëmet shëndetësore* në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në prone.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 112, datë 11.09.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Astrit Zenelaj në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime për *dëmet materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *dëmet shëndetësore* në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi i avionëve, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 113, datë 11.09.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e licencës për një periudhë 1 vjeçare për Z. Artur Zhegu, si pasojë e shkeljes së gërmës c) të pikës 15 të VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime".
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI|

VENDIM

Nr. 115, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORE "MBI PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E RUAJTJES TË LIBRIT TË POROSIVE DHE TË LIBRIT TË TRANSAKSIONEVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3 dhe 20, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2007 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores "Për përmbajtjen dhe mënyrën e ruajtjes së librit të porosive dhe të librit të transaksioneve", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike në publikimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKEQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

MBI PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E RUAJTJES TË LIBRIT TË POROSIVE DHE TË LIBRIT TË TRANSAKSIONEVE

Miratuar me vendimin e Bordit nr 115, datë 11.09.1008

I. Dispozita të Përgjithshme

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive, të cilat duhen të mbahen nga shoqëritë komisioneve, përsa u përket transaksioneve në lidhje me titujt referuar në nenin 42 pikat 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr. 9876, datë 21.2.2008 "Për Titujt".

Neni 2
Përkufizime

Në këtë rregullore, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:

1. "Autoriteti" nënkupton Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
2. "Ligji" nënkupton ligjin "Për Titujt" nr. 9876, datë 21.2.2008.
3. "Shoqëri komisionere" nënkupton një shoqëri brokerimi ose bankë, që ka marrë një licencë nga Autoriteti për të kryer transaksione me tituj dhe që e ka regjistruar këtë aktivitet sipas kërkesave të legjislacionit.
4. "Klient" nënkupton personin kryesor në emër ose për llogari të së cilit një shoqëri komisionere kryen transaksione me titujt.

II. Libri i Porosive

Neni 3

Libri i porosive nënkupton një grupim të të gjitha porosive individuale të pranuar nga një shoqëri komisionere.

Neni 4
Përmbajtja e librit të porosive

1) Libri i porosive duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme në lidhje me porosinë e pranuar:

1. numrin në librin e porosive;
2. llojin e porosisë (blerje/shitje);
3. datën dhe kohën (orë dhe minuta) të pranimit dhe të paraqitjes së porosisë në sistemin e tregtimit të bursës;
4. kohëzgjatjen e ekspozimit të porosisë, nëse është në mënyrë specifike përcaktuar ndryshe;
5. mënyra e marrjes së porosisë;
6. emrin dhe mbiemrin e personit që ka marrë porosinë;
7. emër, mbiemër, adresën në rastin kur klienti është person fizik, dhe emrin e shoqërisë, adresën e selisë kryesore dhe emrin e personit të autorizuar në rastin e një personi juridik;
8. përshkrimin e llogarisë së klientit;
9. llojin dhe indeksin e titullit ose të derivativëve;
10. sasinë e titujve dhe të derivativëve;
11. çmimin e shprehur në njësi:

    për aksionet në lekë;

    për huanë e titujve si përqindje e vlerës nominale;

    për derivativët në lekë;

    (çmimi mbi porosinë për blerje shprehet si çmimi maksimal që klienti pranon të paguajë, ndërsa çmimi mbi porosinë e shitjes është i shprehur me minimumin e çmimit me të cilën klienti pranon të shesë).
12. një shënim që tregon që klienti është i informuar mbi të drejtat dhe detyrat e tij gjatë procesit të rregullimit dhe të ekzekutimit të transaksioneve me titujt;
13. statusi i klientit;
14. periudhën e vlefshmërisë të porosisë;
15. data e modifikimit të porosisë: data, ora dhe mënyra e modifikimit;
16. data e anulimit të porosisë: data, ora dhe mënyra e anulimit, dhe gjithashtu edhe numrin e porosisë së re nëse është hapur një e tillë;
17. përshkrimin e statusit të porosisë; hapur, anuluar, ekzekutuar, pjesërisht e ekzekutuar, modifikuar, skaduar;
18. të dhëna që transaksioni në fjalë është një tregtim në bllok.

2) Përveç të dhënave referuar në paragrafin 1 të këtij neni, libri i porosive duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme në lidhje me ekzekutimin e porosisë:

1. datën dhe kohën (orë, minutë dhe sekondë) e ekzekutimit;
2. përshkrimin e Bursës;

3. numrin e transaksionit në Bursë;
4. sasinë e titujve ose të derivativëve në lidhje me mënyrën e ekzekutimit, nëse porosia është kryer në mënyrë të pjesshme në transaksione të ndryshme ose në një ekspozim të përbashkët të porosive;
5. çmimin;
6. vlerën totale;
7. vlerën totale dhe çmimin mesatar të ekzekutimit;
8. emrin dhe mbiemrin e komisionerit qe ka ekzekutuar transaksionin.

3) Një libër porosish mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera shtesë përveç atyre të përcaktuar nga kjo rregullore.

III. Porositë në bllok

Neni 5

1) Gjatë kryerjes së shërbimit referuar nenit 42, pika 3 të Ligjit, për një porosi në bllok sipas nenit 71 të Ligjit, një shoqëri komisionere duhet të veprojë në përputhje me Udhëzimet për Ekzekutimin e Porosive në Bllok, sipas aneksit bashkëngjitur, pjesë e kësaj Rregulloreje.

2) Gjatë dhënies së një porosie në bllok për blerjen ose shitjen e titujve, shoqëria komisionere duhet përveç të dhënave referuar nenit 4 të kësaj rregullore, të përfshijë në librin e porosive edhe të dhënat e mëposhtme:

1. të dhëna mbi klientët për të cilët shoqëria ka emetuar porosinë e përbashkët;
2. të dhëna mbi shpërndarjen e aktiveve të blera apo të shitura të klientëve;
3. emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar i cili ka dhënë porosinë.

IV. Libri i Transaksioneve

Neni 6

Libri i transaksioneve do të përfshijë një listë të të gjithë transakioneve të kryera brenda sistemit të veçantë të tregtimit në bursë.

Neni 7

Përmbajtja e librit të transaksioneve

Libri i transaksioneve duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

1. numrin në librin e transaksioneve;
2. llojin e transaksionit (blerje ose shitje);
3. llojin dhe indeksin e titullit;
4. datën dhe kohën (orë,minutë, sekondë) të ekzekutimit;

5. përshkrimin e Bursës;
6. sasinë e titujve në lidhje me mënyrën e ekzekutimit;
7. çmimin;
8. vlerën totale;
9. vlerën totale dhe çmimi mesatar i ekzekutimit të transaksionit;
10. numrin e transaksionit në Bursë;
11. emrin dhe mbiemrin e komisionarit, i cili ka ekzekutuar transaksionin;
12. datën e parashikuar të shlyerjes.

Neni 8
Mënyra e mbajtjes së librit të transaksioneve

Një shoqëri komisionere duhet që pas ekzekutimit të transaksionit të regjistrojë menjëherë në librin e transaksioneve të dhënat referuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

V. Raportimi
Neni 9
Raportimi tek Autoriteti

Shoqëria komisionere duhet që pas ekzekutimit të transaksionit të paraqesë menjëherë në Autoritet një raport nga libri i porosive dhe një raport nga porositë individuale ose një raport nga libri i transaksioneve dhe duhet ta bëjë këtë në mënyrën dhe formën e kërkuar.

VI. Dispozita të Fundit
Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta Gjoni

ANEKS

Udhëzime për ekzekutimin e porosive në bllok

Këshilltari merr vendime për blerjen ose shitjen e titujve gjatë administrimit të një portofoli titujsh për llogari të klientit me të cilin shoqëria komisionere ka një kontratë për administrimin e portofolit të titujve.

Në rastin kur është marrë një vendim për shitjen apo blerjen e të njëjtit titull për disa klientë të ndryshëm, këshilltari mund të emetojë një porosi në bllok në përputhje me Nenin 71 të Ligjit.

Porosia në bllok futet në librin e porosive, së bashku me të dhënat që klienti është shoqëria komisionere për palët e treta, dhe porosia shoqërohet me specifikimet mbi personat që po shesin apo po blejnë tituj, së bashku me shumën përkatëse.

Transaksionet e mbyllura mbi bazën e porosive të përbashkëta do të shlyhen në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve ashtu si transaksionet e tjera të tregut dhe i shpërndahen llogarive të klientëve. Qendra e Regjistrimit të Aksioneve, në përputhje me rregullat e brendshme të saj, informon klientët për shumën dhe çmimin e titujve të shitur apo të blerë.

Pas kryerjes së transaksionit të përbashkët shoqëria është e detyruar të krijojë një faturë paguse, që do t'i paguhet klientit sipas çmimit mesatar të ekzekutimit.

Në rast kur ka një shumë të pamjaftueshme të titujve të shitur apo të blerë, të cilat janë të përmendura në porosi, shpërndarja bëhet nga shoqëria komisionere në përputhje me metodën e brendshme të zgjedhur, e cila maksimizon më shumë barazinë ndërmjet personave për të cilët është kryer porosia.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 116, datë 11.09.2008

PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË "MAI" SH.A PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI BROKER NË SIGURIME DHE RISIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe VKM nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë "MAI" *sh.a*, si *"Broker në sigurimeve dhe risigurime",* me një licencë pa afat.
2. Licencimin e z. Plarent Hamzaj dhe z. Elnar Gashi, në emër dhe për llogari të shoqërisë "MAI" sh.a, *si "Broker fizik ne sigurime dhe risigurime"* me afat 3 vjet me te drejte rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 117, datë 11.09.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË PENSIONEVE "SIGMA IPP" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të pikës 6/j të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", me propozim të departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 6, të statutit të shoqërisë së pensioneve "Sigma IPP" sh.a, si rezultat i zmadhimit të kapitalit me 12.600.000 lekë, duke e ndryshuar kapitalin e shoqërisë nga 2.000.000 lekë në 14.600.000 lekë.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 118, datë 11.09.2008

MBI
SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" NDAJ VENDIMIT TË BORDIT NR. 87, DATË 10.07.2008

Në bazë dhe për zbatim të nenit 124, pika 1 dhe nenit 8, të Kodit të Procedurave Administrative", Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pasi mori në shqyrtim të gjitha objeksionet e ngritura nga shoqëria e sigurimit "Eurosig" sh.a, me propozim të Departamentit të Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Zbatushmërisë,

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të AMF nr. 87, datë 10.07.2008 "Për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë së sigurimit "Eurosig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 119, datë 11.09.2008

PËR
PËRFTIMIN E NJË SHPËRBLIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 120, datë 02.10.2008

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI LICENCIMIN DHE MBIKËQYRJEN E BURSËS SË TITUJVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" si dhe të nenit 78 paragrafi 1, neni 81 paragrafi 1 dhe neni 88, paragrafi 1, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores " Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e Bursës së Titujve" sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për publikimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
MBI LICENCIMIN DHE MBIKËQYRJEN E BURSËS SË TITUJVE

Miratuar me vendimin e Bordit nr 120, datë 02.10.2008

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore hartohet në përputhje me Nenin 78, paragrafi 1, Neni 81, paragrafi 1, dhe Neni 88, paragrafi 1 i Ligjit nr. 9879, datë 21 shkurt 2008 "Për Titujt", dhe në përputhje me të drejtat dhënë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nga Ligji nr.9572, datë 3 korrik 2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të parashikojë:
   a) kushtet, kërkesat dhe procedurat për licencimin e shoqërisë që do të veprojë si bursë titujsh; dhe
   b) kushtet dhe kërkesat për rregullimin dhe mbikëqyrjen e një shoqërie që vepron si bursë titujsh.
3. Termat "bursë titujsh" dhe "shoqëri që vepron si bursë titujsh" përdoren me të njëjtin kuptim në këtë rregullore.

Neni 2
Themelimi dhe funksionet e bursës së titujve

1. Bursa e titujve themelohet vetëm si një shoqëri aksionere .
2. Shoqëria që vepron si bursë titujsh kryen vetëm aktivitete që lidhen me veprimtarinë si bursë titujsh, si dhe aktivitete të tjera që lidhen me organizimin e tregtimit të titujve dhe instrumentave të tjerë financiarë.
3. Shoqëria e cila vepron si bursë titujsh mund të përfshihet edhe në aktivitete të lidhura me edukimin, promovimin, dhe furnizimin me informacione në lidhje me veprimtaritë e tregut të kapitalit.
4. Tregtimi i titujve në bursë organizohet nëpërmjet përdorimit të sistemit elektronik përmes të cilit kryhen të gjitha transaksionet.
5. Shoqëria që vepron si bursë titujsh duhet të ketë detyrimin dhe të drejtën eksluzive të përfshijë fjalët "bursë titujsh" ose "bursë" në emrin e shoqërisë.

Neni 3
Të drejtat e pronësisë në bursën e titujve

1. Aksionet e shoqërisë që vepron si bursë titujsh duhet të zotërohen vetëm nga Qeveria Shqiptare, shoqëri që veprojnë si bursë titujsh, shoqëri komisionere, banka, dhe shoqëri të administrimit të portofoleve.
2. Aksionerët e bursës së titujve duhet të jenë persona juridikë me seli në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rastit kur aksioneri është një shoqëri tjetër që vepron si bursë titujsh.

Neni 4
Aksionerët e bursës së titujve

1. Shoqëria që vepron si një bursë tjetër titujsh dhe Qeveria Shqiptare në cilësinë e aksionerit të bursës mund të zotërojnë ose mund të kenë të drejtën të ushtrojnë 100% të drejtave të votave të shoqërisë që vepron si bursë titujsh.
2. Një bursë titujsh e huaj që vepron në cilësinë e aksionerit të bursës së titujve duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme në mënyrë që të ketë të drejtën të ushtrojë më shumë se 20% të drejtave të votave në shoqërinë që vepron si bursë titujsh:
    a. të jetë një shoqëri që vepron si bursë ose bursa titujsh në një ose më shumë vende të BE-së;
    b. të jetë një shoqëri që vepron një rrjet bursash të titujve ku të paktën një nga bursat duhet të jetë e vendosur në një nga vendet e OECD-së; ose
    c. të jetë një shoqëri që ka vepruar si bursë titujsh për të paktën pesë vitet e fundit, ka të paktën 100 tituj të listuar dhe një volum tregtimi vjetor prej të paktën 2 miliard Euro.
3. Shoqëritë komisionere, bankat, shoqëritë e adminstrimit të portofoleve, nuk mund të zotërojnë ose të kenë secila të drejtën e ushtrimit të më shumë se 10% të votave të shoqërisë që vepron si bursë titujsh.

Neni 5
Ndryshimet në pronësi dhe në të drejtat e votës

1. Autoriteti duhet të njoftohet paraprakisht për çdo transferim aksionesh, dhe ndryshim të të drejtave të ushtrimit të votave në shoqërinë që vepron si bursë titujsh.
2. Autoriteti miraton paraprakisht çdo zotërim, nënshkrim të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të aksioneve në një shoqëri që vepron si bursë titujsh të cilat:
    a. përfaqësojnë 10% ose më shumë të votave totale të kapitalit aksioner; ose
    b. arrijnë apo tejkalojnë 10%, 20%, 33% ose 50% të votave totale të kapitalit aksioner.
3. Pala e cila synon të marrë në zotërim aksione ose të drejtat e votimit është e detyruar që të paraqesë pranë Autoritetit njoftimet sipas pikës 1 ose kërkesës sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Zotërimi i aksioneve dhe të drejtave të votës në një shoqëri që vepron si bursë titujsh nga subjektet të cilat i përkasin të njëjtit grup shoqërish, konsiderohet si zotërim i këtyre aksioneve apo të drejtave të votimit nga një subjekt i vetëm.

5. Marrja në zotërim jo e drejtpërdrejtë e aksioneve dhe të drejtave të votimit në një shoqëri që vepron si bursë titujsh do të jetë blerja ose nënshkrimi për aksione në çdo subjekt i cili zotëron, drejtpërdrejtë apo jo drejtpërdrejtë, aksione në këtë shoqëri që vepron si bursë titujsh, nëse blerja apo nënshkrimi rezulton në arritjen apo tejkalimin e zotërimit të 50% të votave totale, ose 50% të kapitalit aksioner të këtij subjekti.
6. Autoriteti duhet që brenda 60 ditësh nga kërkesa referuar në pikën 3 të këtij neni të njoftojë me shkrim palën kërkuese mbi vendimin e tij për të aprovuar apo jo transferimin e aksioneve apo të të drejtave të votës. Autoriteti duhet t'i kërkojë palës kërkuese çdo informacion shtesë që e gjykon si të nevojshëm. Marrja në zotërim do të konsiderohet e aprovuar, nëse Autoriteti nuk përgjigjet brenda 60 ditëve nga data që ka marrë informacionin e fundit të kërkuar.
7. Autoriteti nuk miraton asnjë marrje në zotërim, të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të aksioneve dhe të drejtave të votës të një shoqërie që vepron si bursë titujsh, nëse ka baza të arsyeshme për të besuar që subjekti që ka propozuar marrjen në zotërim të aksioneve apo të drejtave të votës mund të ushtrojë një influencë të dëmshme mbi administrimin e shoqërisë që vepron si bursë titujsh. Nëse Autoriteti e miraton marrjen në zotërim, mund të vendosë një datë përfundimtare brenda së cilës mund të merren në zotërim aksionet e shoqërisë që vepron si bursë titujsh.
8. Nëse aksionet e një shoqërie që vepron si bursë titujsh do të zotërohen nga:
    a. një shoqëri e huaj, subjekt rregullimi dhe mbikëqyrje financiare në vendin e vet; ose
    b. një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë, e cila:
        i. është filial i një subjekti të përshkruar në paragrafin (a), ose
        ii. mbi të cilën një subjekt i përshkruar në paragrafin (a) ushtron një influencë të konsiderueshme,

    atëherë Autoriteti mund të kërkojë opinion mbi këtë subjekt nga autoritetet kompetente rregullatore të shtetit ku është i vendosur subjekti.
9. Njoftimi i referuar në pikën 1 dhe kërkesa e referuar në pikën 2 të këtij neni duhet të specifikojnë numrin e aksioneve që do të merren në zotërim, përqindjen në kapitalin aksioner dhe numrin dhe përqindjen e votave që blerësi do të zotërojë në asamblenë e përgjithshme të aksionerëve, dhe duhet të përfshijë edhe një deklaratë mbi burimin e fondeve që do të përdoren për të paguar aksionet në shoqërinë që vepron si bursë titujsh.

Neni 6
Kriteret për emërimin e këshillit mbikëqyrës dhe të drejtorisë

1. Autoriteti miraton emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe të drejtorisë të bursës së titujve në përputhje me parashikimet e nenit 84 të Ligjit nr. 9879, datë 21 shkurt 2008 "Për Titujt".
2. Të paktën një nga anëtarët e këshillit duhet të ketë eksperiencë profesionale në kontabilitet.
3. Raporti vjetor i bursës së titujve duhet të publikojë të dhëna mbi pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhjet e këshillit mbikëqyrës dhe mbi shpërblimin e tyre.
4. Anëtarët e drejtorisë dhe këshillit mbikëqyrës të bursës së titujve, dhe gjithashtu edhe të punësuarit e bursës nuk mund të jenë anëtarë të drejtorisë apo këshillit mbikëqyrës të shoqërive komisionere apo emetuesve, titujt e të cilëve janë të listuar në bursën e titujve.
5. Anëtari i drejtorisë të bursës së titujve duhet të ketë kualifikime afatgjata, si dhe eksperiencë pune të paktën pesë vjet në tregun financiar.

6. Kërkesat për emërimin e drejtorit apo të anëtarit të këshillit mbikëqyrës, duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:
    a. një biografi të shkurtër ose një CV;
    b. një vendim nga organi i autorizuar për emërimin e drejtorit ose anëtarit të këshillit mbikëqyrës;
    c. dokumente zyrtare që vërtetojnë kualifikimet dhe eksperiencën profesionale;
    d. vërtetim që anëtari ose drejtori nuk ka qënë subjekt i një dënimi gjyqësor për shkelje kriminale në fushën e shoqërive tregtare, taksave, ekonomisë dhe financës; dhe
    e. një letër rekomandimi ose reference nga punëdhënësi.
7. Autoriteti miraton emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe të anëtarëve të drejtorisë brenda 60 ditëve kalendarike që nga data e marrjes së kërkesës referuar në paragrafin 2 të këtij neni, përveç rasteve kur evidenton që anëtari i Këshillit ose drejtori i propozuar:
    a. nuk i përmbush kriteret mbi eksperiencën profesionale dhe kualifikimet akademike;
    b. është subjekt i masave penale apo civile që ndalojnë ushtrimin e aktivitetit apo detyrave profesionale;
    c. është vendosur nga gjykata në mënyrë të pakthyeshme që ka kontribuar ose ka shkaktuar falimentimin e një personi juridik; ose
    d. ka paraqitur të dhëna të rreme në dokumentet e paraqitura në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
8. Autoriteti jep një sqarim të arësyeshëm me shkrim për çdo vendim për mos miratimin e kërkesës për emërimin e drejtorit apo anëtarit të këshillit mbikëqyrës të një burse titujsh. Emërimi do të konsiderohet i miratuar nëse Autoriteti nuk përgjigjet brenda 60 ditëve që nga data që janë marrë të dhënat e fundit.

Neni 7
Përmbajtja e statutit

Statuti i bursës së titujve duhet të përcaktojë minimalisht kërkesat e mëposhtme:

a. kriteret, detyrat dhe të drejtat e anëtarëve të bursës së titujve;
b. kushtet, kriteret dhe dokumentet e kërkuar për pranimin e anëtarëve individual të bursës së titujve dhe të drejtat e detyrat e tyre;
c. arsyet e mundshme për refuzimin e pjesëmarrjes së anëtarëve në bursë;
d. parimet themelore të veprimtarisë së bursës të titujve;
e. detyrat për të lëshuar rregulla, udhëzime dhe strukturat përkatëse që i amendojnë dhe i miratojnë këto rregulla;
f. metodën e kontrollit, e kryer nga vetë bursa e titujve, për veprimtarinë e ushtruar në bursë dhe metoda e mbikëqyrjes së anëtarëve;
g. metodën e zgjidhjes së kontraditave të mundshme midis anëtarëve të bursës së titujve;
h. metodën e parandalimit të abuzimit me informacionin që nuk është i aksesueshëm nga të gjithë anëtarët e bursës së titujve;
i. çështje të tjera në lidhje më aktivitetin e bursës së titujve.

Neni 8
Anëtarët e bursës së titujve

1. Bursa e titujve miraton rregullat e anëtarësimit, në përputhje me aktet nënligjore të saj, të cilat vendosin në mënyrë të hollësishme kriteret e anëtarësimit, detyrat dhe të drejtat e anëtarëve të bursës së titujve.
2. Bursa e titujve është e detyruar që të lejojë çdo pjesëmarrës të licencuar në treg në përputhje me paragrafin 3.a të këtij neni, të bëhet anëtar i bursës së titujve nëse ai i përmbush kushtet e parashtruara në rregullat e Anëtarësimit të kësaj burse.
3. Rregullat e anëtarësimit të bursës së titujve duhet të kërkojnë që një anëtar i saj:
    a. të jetë i licencuar nga Autoriteti për ushtrimin e veprimtarive me titujt;
    b. të jetë i pajisur në mënyrë të përshtatshme për sa i përket anës organizative dhe paisjeve teknike;
    c. të ketë një marrëveshje shërbimi me një subjekt që kryen funksione regjistrimi për bursën e titujve; dhe
    d. të plotësojë çdo kriter tjetër që Autoriteti dhe bursa e titujve mund të përcaktojnë.
4. Rregullat e Anetarësimit të bursës së titujve duhet të parashikojnë që një shoqëri që aplikon për anëtarësim të paraqesë dokumentet e mëposhtme:
    a. aplikim me shkrim në një formë dhe përmbajtjeje të përcaktuar nga bursa e titujve;
    b. një kopje të akteve nënligjore;
    c. një kopje të licencës për ushtrimin e veprimtarive me titujt të lëshuar nga Autoriteti; dhe
    d. ndonjë inormacion shtesë që bursa e titujve mund të kërkojë në bazë të Rregullave te Anëtarësimit, Tregtimit, Listimit dhe Kleringut.
5. Pjesëmarrësit e licencuar që ju është refuzuar anetarësimi në bursën e titujve mund të apelojnë kundër këtij vendimi pranë Autoritetit brenda 15 ditësh nga marrja e vendimit. Brenda 60 ditëve nga apelimi Autoriteti do të konfirmojë vendimin e bursës së titujve ose do t'ja kthejë asaj për rishikim.
6. Të gjithë anëtarët e bursës së titujve duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha rregulloret e bursës.

Neni 9
Rregullat e listimit

1. Rregullat e Listimit të bursës së titujve përcaktojnë kriteret, kushtet dhe procedurat e listimit, pezullimin dhe heqjen e listimit të titujve dhe instrumentave të tjerë financiarë nga bursa e titujve.
2. Rregullat e Listimit mund të specifikojnë kushte shtesë për pranimin e titujve dhe intrumenteve të tjerë financiarë për tregtim, qëllimi i vetëm i të cilave do të jetë mbrojtja e interesave të konsumatorëve. Në raste të tilla subjekti që aplikon për pranimin e titujve apo instrumentave të tjerë financiar të caktuar për listim duhet të informohet për këto kushte shtesë para dorëzimit të aplikimit.

3. Bursa e titujve nxjerr një vendim për listimin dhe heqjen nga listimi të titujve dhe instrumentave të tjerë financiarë nga bursa e titujve.
4. Rregullat e Listimit përcaktojnë kërkesat për ekspozim të informacionit, njoftimet dhe kërkesave të tjera për qeverisjen e shoqërive në lidhje me shoqëritë e listuara. Këto kushte nuk do jenë më pak të detajuara ose më pak të rrepta se kërkesat e parashtruara nga ligji dhe aktet nënligjore të Autoritetit, për shoqëritë e listuara. Rregullat e Listimit duhet të përmbajnë një procedurë që do të ndiqet në rast se emetuesi nuk i plotëson kërkesat e lartpërmenduara, të specifikuara në rregullore.
5. Asambleja e aksionarëve e emetuesit nxjerr vendim për aplikimin për listimin e titujve në bursë.
6. Titujt dhe instrumenta të tjerë financiare listohen pas paraqitjes nga emetuesi të kërkesës me shkrim dhe formularit të aplikimit.
7. Për listimin e titujve në bursë, duhet të jetë si parakusht që ato të jenë të paguara plotësisht dhe të transferueshme pa kufizim.
8. Bursa e titujve duhet të mbajë një regjistër të veçantë për çdo emetues, ku do të regjistrojë dhe të mbajë të gjitha të dhënat e duhura dhe dokumentet në lidhje me emetuesin, titujt e të cilit janë listuar në bursën e titujve.
9. Rregullat e Listimit do të përcaktojnë klasifikimin e titujve dhe instrumentave të tjerë financiarë në bursë.
10. Rregullat e Listimit përcaktojnë tarifat që do të paguajnë emetuesit që aplikojnë për listimin e titujve të tyre.
11. Emetuesi, titujt e të cilit janë listuar në bursën e titujve duhet t'i përmbahet të gjitha Rregullave të Listimit.
12. Heqja e listimit të titujve nga bursa e titujve me kërkesë të emetuesit kryhet vetëm në rast vendimi të marrë nga Asambleja e Aksionerëve.

Neni 10
Rregullat e Tregtimit

1. Bursa e titujve miraton Rregullat e Tregtimit të cilat duhet të përcaktojnë sa më poshtë:
    a. kushtet dhe mënyrën e tregtimit të titujve dhe instrumentave të tjerë financiarë në bursën e titujve;
    b. llojet e transaksioneve që do të ekzekutohen në bursën e titujve;
    c. radhën e tregtimit të titujve dhe instrumentave të tjerë financiarë në bursën e titujve;
    d. metodën e përcaktimit dhe publikimit të çmimeve;
    e. ditët dhe orët e tregtimit;
    f. procedurat për anullimin e transaksioneve;
    g. organizimin e sistemit të informacionit;.
    h. tarifat fikse vjetore për përdorimin e faciliteteve të bursës së titujve, tarifat së tregtimit dhe metodat e llogaritjes së këtyre tarifave;
    i. masa që synojnë parandalimin dhe zbulimin e ndonjë manipulimi të tregut;
    j. kushte sipas të cilave bursa e titujve mund të pezullojë përkohësisht ose ndalojë në

mënyrë të përhershme tregtimin, me qëllim shmangjen e veprimeve manipulative të paligjshme ose për të mbrojtur interesat e investitorëve dhe të tregut; dhe

k. çështje të tjera në lidhje me veprimtarinë e bursës së titujve.

2. Rregullat e tregtimit të bursës së titujve duhet të mundësojnë krahasime dhe konfirmime të transaksioneve, transferimin e informacionit tek regjistri dhe tek subjekti që kryen kleringun, në mënyrë që të lehtësojnë shlyerjen dhe kleringun e të gjithe tregtimeve në bursën e titujve, jo më vonë së tre ditë pune nga data e kryerjes së transaksionit.

Neni 11

Rregullat e kleringut

1. Bursa e titujve miraton rregullat e kleringut që do mund të lejojnë organizimin dhe operimin e një sistemi që garanton përmbushjen e duhur të detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet.
2. Rregullat e kleringut duhet të parashikojnë dhe përcaktojnë procedurat për:
   a. shlyerjen dhe kleringun e transaksioneve në bursën e titujve;
   b. operimin e një sistemi që siguron likuiditet, dhe që përfshin një sistem të garantimit të shlyerjes së transaksioneve të ekzekutuara në bursë; dhe
   c. aktivitete që lidhen me funksionimin e sistemit të regjistrimit, kleringut dhe shlyerjes së transaksioneve me instrumenta të tjerë financiarë që nuk janë tituj.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve

1. Bursa e titujve miraton Rregullat e Arbitrazhit të krijuara për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve në mënyrë të drejtë, efikase dhe të besueshme.
2. Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve të bursës së titujve do të adresohen fillimisht nëpërmjet arbitrazhit, përpara se të ndiqet rruga gjyqësore.

Neni 13

Rregullat e sjelljes dhe disiplinës

Bursa e titujve krijon dhe operon një sistem mbikëqyrës, i cili siguron që anëtarët dhe emetuesit e titujve të listuar veprojnë në përputhje me rregullat e bursës dhe rregullore apo procedura të tjera që qeverisin operimin e bursës.

Neni 14

Të dhënat, regjistrimet dhe sistemi informativ

1. Bursa e titujve duhet të ketë një sistem të përshtatshëm të kompjuterizuar nëpërmjet së cilit informon rregullisht publikimin mbi:
   a. emrin e emetuesit dhe llojet e titujve apo instrumentave financiar të tregtuar në bursë;

b. çmimin e transaksionit të parë ose të hapjes, çmimin e transaksionit të fundit, çmimin më të lartë, çmimin më të ulët dhe çmimin mesatar të ponderuar me volumin e tregtimit për çdo titull apo instrument tjetër financiar të tregtuar;

c. vëllimin dhe vlerën e titujve apo instrumentave të tjerë financiarë të tregtuar në treg; dhe

d. të dhëna të tjera me rëndësi në veprimtarinë e bursës.

2. Bursa e titujve mbron sistemin elektonik dhe të dhënat e mbajtura kundrejt përdorimit të pa autorizuar dhe ndryshimit apo humbjes të të dhënave.
3. Bursa e titujve ruan në një vend të sigurtë në formën origjinale dokumentat të cilat janë përdorur për regjistrimin e të dhënave në sistemin elektronik për të paktën pesë vjet.
4. Dokumentet origjinale ne lidhje me aktivitetet e tregtimit duhet të regjistrohen dhe ruhen në formate elektronike.
5. Të dhënat e regjistruara dhe të ruajtuar në formate elektronike duhet të ruhen në mënyrë të përhershme.

Neni 15
Aplikimi për licencë për krijimin e Bursës së Titujve

Personi juridik që aplikon për një licencë për krijimin dhe funksionimin e bursës së titujve duhet të dorëzojë si më poshtë:

a) një aplikim të shkruar, në formën dhe me përmbajtjen siç është përcaktuar nga Autoriteti;
b) vërtetim mbi pagesën e tarifave të licencimit të Autoritetit;
c) një kopje -projekt e Statutit të saj;
d) një kopje -projekt e Rregullave të Anëtarësimit;
e) një kopje -projekt e Rregullave të Tregtimit;
f) një kopje -projekt e Rregullave të Listimit;
g) një kopje -projekt e Rregullave të tij Kleringut;
h) një kopje -projekt e Rregullave të tij të Arbitrazhit;
i) një kopje -projekt e Rregullave të tij të Sjelljes dhe Disiplinës;
j) një kopje e kontratës ose para kontratës me një regjistër të autorizuar ku do të regjistrohen të gjitha letrat me vlerë të listuara; dhe
k) një plan biznesi mbi krijimin dhe funksionimin e bursës.

Neni 16
Pajisja dhe refuzimi i licencës për krijimin e Bursës së Titujve

1. Autoriteti merr një vendim lidhur me aplikimin për lincencimin për bursën e titujve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pasi ka njoftuar aplikantin që e ka marrë aplikimin e plotë. Autoriteti duhet të paraqesë njoftimin për përfundimin e procesit të aplikimit tek aplikanti brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të dokumentacionit të fundit të kërkuar.

2. Autoriteti miraton aplikimin për licencë për krijimin e bursës së titujve nëse konstaton se:
    a. struktura aksionare dhe struktura e të drejtave të votimit përputhet me kushtet e përcaktuara në nenet 3 dhe 4;
    b. kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë që vepron si bursë titujsh është marrë nga burime legjitime.
    c. emri i shoqërisë që vepron si bursë titujsh përputhet me kërkesat e përcaktuara në nenin 2, parag. 5;
    d. Rregullat e anëtarësimit parashikojnë një akses të hapur dhe të barabartë për të gjithë aplikantët e përshtashëm;
    e. Rregullat e Tregtimit dhe të Kleringut parashikojnë një sistem tregtimi në përputhje me nenin 2, parag. 4, dhe për një shkallë të lartë:
        i. të kleringut dhe shlyerjes të transaksioneve;
        ii. aksesi të hapur për të gjithë investitorët dhe trajtim të barabartë të anëtarëve;
        iii. ndershmërie në veprimtaritë e biznesit;
        iv. mbrojtjeje të informacionit konfidencial të konsumatorit;
        v. transparence në tregtim; dhe
        vi. ekspozimi të informacionit para dhe pas tregtimit;
    f. Rregullat e Listimit janë krijuar me qëllim provimin e informimit të plotë dhe të drejtë të tregut nga emetuest e titujve të listuar;
    g. Rregullat e Sjelljes dhe të Disiplinës janë të përshtatshëm për të siguruar një zbatim të plotë dhe të drejtë të rregullave të bursës;
    h. Rregullat e Arbitrazhit mundësojnë një zgjidhje efikase, të drejtë dhe në kohë të mosmarrëveshjeve;
    i. Bursa është e aftë të kryejë të gjitha funksionet e kërkuara për sa i përket stafit, pajisjeve teknike dhe organizimit;
    j. Këshilli Mbikëqyrës dhe drejtorët duhet të përmbushin kërkesat në përputhje me nenin 6;
    k. Bursa ka kontratë ose marrëveshje me të paktën tre shoqëri komisionere;
    l. Bursa ka një strukturë të përshtatshme organizative që siguron një kryerje efikase dhe uniforme të të gjithë funksioneve të saj; dhe
    m. Subjekti aplikues ka paguar tarifat e licencimit të Autoritetit.
3. Autoriteti merr një vendim për refuzimin e aplikimit për dhënie licence për krijimin e një burse titujsh nëse:
    a. vëren që kushtet sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk përmbushen;
    b. arrin në përfundimin që dhënia e licencës do të jetë në dëm të interesit publik. Në këtë rast Autoriteti do të nxjerrë një rezolutë që shpjegon vendimin e tij.
4. Vendimi lidhur me aprovimin e një licence duhet të publikohet nga Autoriteti në Fletoren Zyrtare dhe në faqen elektronike të Autoritetit.

Neni 17
Veprime që kërkojnë miratim nga Autoriteti

1. Bursa duhet të marrë miratim nga Autoriteti për:
    a. statutin dhe çdo ndryshim apo amendim të tij;
    b. miratimin e Rregullave të Anëtarësimit, Rregullave të Tregtimit, Rregullave të Listimit, Rregullave të Kleringut, Rregullave të Arbitarazhit dhe Rregullat e Sjelljes dhe Disiplinës, dhe çdo akt tjetër të bursës, si dhe çdo amendim të tyre;
    c. çdo akt ose vendim që lidhet me tarifat ose komisionet që i duhen paguar bursës, dhe çdo amendim të rasteve kur duhen të paguhen këto detyrime;
    d. adoptimin e formave të lidhjes ose shkrirjes me bursat e tjera.
2. Kërkesat për aprovimin e rregullave dhe akteve të tjera ose amendimeve të këtyre rregullave dhe akteve duhet të shoqërohet me dokumenta të cilat vërtetojnë pagesën e tarifave përkatëse të Autoritetit.
3. Autoriteti miraton rregullat dhe aktet e tjera brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së dokumenteve të fundit dhe të plota të kërkuara nga Autoriteti.
4. Me qëllim mbrojtjen e investitorit ose për të siguruar një tregtim të drejtë dhe korrekt të titujve apo instrumentave të tjerë financiar, Autoriteti mund t'a urdhërojë bursën e titujve të bëjë ndryshime ose të miratojë akte ose rregulla të reja të lidhura me punën dhe veprimtarinë e saj.
5. Me një kërkesë me shkrim të Autoritetit, drejtoria ose këshilli mbikëqyrës i një shoqërie që vepron si bursë titujsh:
    a. thërret një mbledhje të jashtëzakonshme të asamblesë së aksionerëve; ose
    b. përfshin çështjet e sugjeruara nga Autoriteti në axhendën e mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së aksionerëve.
6. Autoriteti mund të urdhërojë këshillin mbikëqyrës të bursës që mënjëherë, dhe në raste të tjera jo më vonë se brenda 10 ditëve pune, të miratojë një zgjidhje apo rezolutë mbi një çështje specifike.

Neni 18
Mbikëqyrja mbi veprimtaritë e Bursës së Titujve

1. Autoriteti kryen mbikëqyrjen mbi aktivitetin dhe funksionimin e bursës së titujve.
2. Autoriteti e kryen mbikëqyrjen nëpërmjet:
    a. rishikimit të raporteve periodike dhe vjetore dhe raporteve të tjera të kërkuara, si dhe gjithashtu dokumentacioneve shtesë të bursës së titujve të paraqitur tek Autoriteti. Autoriteti mund të imponojë çdo kërkesë për raportim dhe sa shpesh e shikon të përshtatshme;
    b. kryerjes së inspektimeve në zyrat e bursës së titujve.

3. Me qëllim kryerjen e procesit të mbikëqyrjes, Autoriteti rishikon në mënyrë të veçantë çdo dokumentacion që lidhet me:
    a. tregtimin e titujve në bursë në përputhje me kushtet e parashikuara për tregtimin, si dhe me ligjshmërinë e aktiviteteve që lidhen me tregtimin;
    b. zbatimin nga ana e bursës së titujve dhe anëtarëve të saj të rregullave që lidhen me veprimet me titujt dhe instrumentat e tjerë financiar, si dhe gjithashtu dhe rregullat e bursës, aktet nënligjore dhe akte të tjera në bazë të të cilave lëshohet një licencë për të vepruar si bursë titujsh;
    c. kontrollimin e situatës financiare të bursës së titujve; dhe
    d. kushtet dhe mënyra e funksionimit të bursës së titujve të cilat ndihmojnë anëtarët në përmbushjen e detyrimeve të tyre në kryerjen e kleringut dhe shlyerjes së transaksioneve.

Neni 19
Raporti vjetor

1. Bursa e titujve paraqet pranë Autoritetit raportin e plotë vjetor mbi veprimtarinë e saj për vitin paraardhës, jo më vonë se data 31 maj e çdo viti.
2. Raporti vjetor i bursës së titujve duhet të përmbajë midis të tjerash, pasqyrat financiare në mbylljen e vitit paraardhës, të përgatitura sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të audituara nga një auditor i certifikuar, sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit.
3. Nëqoftëse, sipas opinionit të Autoritetit, nevojitet që të rishikohen pjesë të raportit vjetor të bursës së titujve, Autoriteti do t'ja kthejë raportin bursës së titujve, e cila duhet të reflektojë ndryshimet brenda një periudhe kohe të arsyeshme, por jo me vonë se brenda 30 ditësh.
4. Bursa e titujve duhet të publikojë raportin e plotë vjetor në faqen e saj elektronike.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 121, datë 02.10.2008

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË BURSËS SË TIRANËS

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr.9572, datë 03.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" si dhe të nenit 151 të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt" me propozim të shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së Bursës së Tiranës.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimet e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

E SHOQËRISË ANONIME "BURSA E TIRANËS" SH.A

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, SELIA DHE OBJEKTI

Neni 1
Forma Juridike

"Bursa e Tiranës" sh.a themelohet në formën e shoqërisë anonime pa ofertë publike dhe do të funksionojë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të nenit 36 të Ligjit nr. 8745, datë 22.02.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8080 datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", ndryshuar me Ligjin nr. 8168, datë 5.12.1996.

Neni 2
Emërtimi i Shoqërisë

Emërtimi i plotë i shoqërisë është "Bursa e Tiranës" sh.a.

Shoqëria ka dhe emrin e saj te shkurtuar I cili është "BT".

Emërtimi i shoqërisë në gjuhë të huaj është "Tirana Stock Exchange"

Neni 3
Vula Stema

Shoqëria "Bursa e Tiranës", ka stemën dhe vulën e saj që përmbajnë emërtimin e plotë të saj "Bursa e Tiranës" sh.a.

Konfiguracioni i stemës përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe mund të ndryshohet prej tij kohe pas kohe.

Vula e shoqërisë do të përdoret vetëm për dokumentet në marrëdhënie me të tretët.

Stema, emërtimi i plotë i shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a dhe adresa e plotë e selisë së saj duhet të përfshihet në të gjitha aktet dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a është në Tiranë në adresën Rr. "Dora D'Istria" nr. 2.

Neni 5
Kohëzgjatja

Bursa e Tiranës themelohet për të ushtruar veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut për një afat kohor të pacaktuar.

Neni 6
Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a është krijimi i një tregu kapitalesh apo letrash me vlerë duke krijuar një sistem tregtimi me anë të të cilit:

a) oferta për shitje, blerje apo këmbim të letrave me vlerë kryhen apo pranohen rregullisht;

b) oferta apo kërkesat kryhen rregullisht kur janë oferta apo kërkesa të paracaktuara, apo janë të pritshme, që rezultojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në bërjen apo pranimin e ofertave për shitje, blerje apo këmbim të letrave me vlere, ose

c) jepet informacion rregullisht lidhur me çmimet dhe shpërblimet që persona apo grupe të veçanta propozojnë apo presin, të shesin, të blejnë apo të këmbejnë letra me vlerë.

KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

Neni 7
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë "Bursa e Tiranes" sh.a është 20 milion lekë, i cili zotërohet nga shteti Shqiptar i përfaqësuar nga Ministri i Financave.

Ai është i ndarë në 20 mijë aksione me vlerë nominale prej 1000 lekë për çdo aksion.

Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri në 20.000, përfshirë numrin e fundit të aksionit.

Neni 8
Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerën nominale të aksioneve ekzistuese.

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar mund të kryhet vetëm me vendim unanim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve, në bazë të raportit të Drejtorisë sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Çdo vendim për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë duhet të përfshijë me hollësi afatet dhe mënyrën e pagesës së një zmadhimi të tillë.

Certifikimi i zmadhimit të kapitalit themeltar bëhet pas regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve.

Neni 9
Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet vetëm me vendim unanim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve, në bazë të raportit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit dhe në pajtim me dispozitat e ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Bursa e Tiranës nuk e zvogëlon kapitalin e saj, nëse pas një zvogëlimi të tillë, kapitali i mbetur do të jetë më i vogël se niveli i kapitalit minimal të përcaktuar nga ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 10
Shlyerja e Aksioneve

Aksionet për kapitalin në para', të nënshkruara në zbatim të një vendimi për zmadhimin e kapitalit, do të shlyhen të paktën për ¼ e vlerës së tyre që në momentin e nënshkrimit.

Pjesa tjetër e vlerës do të shlyhet me një ose disa këste në bazë të kërkimit për shlyerje nga

Drejtoria në një afat prej 3 vjetësh nga dita kur zmadhimi i kapitalit është bërë përfundimtar.

Asambleja e jashtëzakonshme e Aksionarëve, që vendos zmadhimin e kapitalit, ka të drejtë të marrë një vendim për shlyerjen tërësore të aksioneve qysh në momentin e nënshkrimit ose brenda një afati më të shkurtër nga ai i përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

Kërkimi i fondeve u njoftohet nënshkruesve të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për çdo derdhje, me letër rekomande dhe me kthim përgjigje, drejtuar çdo titullari të aksioneve.

Neni 11
Forma e Aksioneve

Aksionet e Shoqërisë "Bursa e Tiranës" janë të formës nominative. Këto aksione janë të regjistrueshme të emetuara në formë të dematerializuar.

Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga shoqëria, në kushtet dhe sipas mënyrave të parashikuara nga ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 12
Shitja dhe Transferimi i Aksioneve

Sa kohë që Bursa e Tiranës do të jetë shoqëri me kapital tërësisht shtetëror, aksionet nuk mund të transferohen të tretëve, veçse në rastin e privatizimit të kësaj shoqërie, ose në rast kur legjislacioni në fuqi do të kërkojë ndryshim të përqindjes së pronësisë së shtetit.

Neni 13
Pamundësia për tu Thyer

Aksionet janë, të pathyeshëm përkundrejt Shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a.

Neni 14
Të Drejtat dhe Detyrimet e Lidhura me Aksionet

Çdo aksion jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndara vjetore të Bursës dhe në tepricën e aktivit të mbetur në rastin e një likuidimi, në një pjesë përpjestimore me kuotën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

Përveç kësaj ai jep të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në asambletë e përgjithshme në kushtet ligjore dhe statutore.

Aksionarët janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë. Çdo kërkim i fondeve përtej kësaj shume është i ndaluar.

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionin e shoqërojnë atë në transferimin e pronësisë të kushdo pronar që ai kalon.

KAPITULLI III
DREJTIMI ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI
A. KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 15
Përbërja, emërimi dhe Shkarkimi

Bursa e Tiranës drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 5 anëtarë.

Anëtarët emërohen nga Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve, me të drejtë rizgjedhje.

Ata mund të shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve.

Neni 16
Vendet Bosh në Këshillin Mbikëqyrës

Në qoftë se një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh midis dy mbledhjeve të përgjithshme të aksionarëve, si rrjedhojë e vdekjes apo dorëheqjes, Këshilli Mbikëqyrës mund të bëjë një ose disa emërime të përkohshme. E drejta e zëvendësimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ushtrohet nga Ministri i Financave.

Emërimi i anëtarëve nga vetë Këshilli Mbikëqyrës duhet të ratifikohet nga Asambleja e zakonshme më e afërt e Aksionareve. Ne rastin kur mbledhja e përgjithshme e aksionarëve nuk ratifikon anëtarët e emëruar nga këshilli vendimet e marra më parë nga këshilli mbeten gjithmonë të vlefshme.

Neni 17
Kryetari

Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij Kryetarin, që ngarkohet me mbledhjen dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij.

Kryetari është detyrimisht person fizik. Ai i ushtron funksionet e tij gjatë tërë periudhës së mandatit si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë, gjithashtu, një sekretar qoftë edhe jashtë anëtarëve të tij, duke caktuar kohëzgjatjen e funksioneve dhe shpërblimin e tij.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, dhe sekretari janë të rizgjedhshëm.

Neni 18
Mbledhjet e Këshillit

1. Këshilli Mbikëqyrës është organ kolegjial, përgjegjës, vendim marrës dhe mbikëqyrës për shoqërinë. Ai bën shqyrtim dhe ka të drejtë të marrë vendime vetëm nëpërmjet mbledhjeve të tij me përjashtim të atyre që janë kompetencë ekskluzive e Mbledhjes së Aksionarëve.

2. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet të paktën një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i bursës. Ai mblidhet gjithashtu në fund të çdo tremujori për të dëgjuar raportin e Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari.
4. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë t'i kërkojë Kryetarit të thërrasë mbledhjen e Këshillit. Kryetari i jep anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës njoftim paraprak me shkrim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
5. Në qoftë se kërkesës nuk i jepet rrugë autorët e saj mund të procedojnë vetë në thirrjen e mbledhjes të Këshillit Mbikëqyrës, duke treguar rendin e ditës të mbledhjes.
6. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës njoftohen me shkrim të paktën 10 ditë para mbi mbledhjen e Këshillit, njoftim i cili përmban kohën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës dhe materialet përkatëse.
7. Për mbledhjet e jashtëzakonshme afati i njoftimit është tre ditë përpara mbledhjes.
8. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohen nga kryetari dhe në mungesë të tij, Këshilli Mbikëqyrës zgjedh midis anëtarëve të pranishëm kryetarin e mbledhjes.

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen:

a) Në selinë e Bursës së Tiranës;
b) Në ndonjë vend tjetër të përcaktuar në njoftim.

Mundësi tjetër është që të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të votojnë në favor duke nënshkruar një rezolutë me shkrim (votim qarkullues) pa qenë nevoja për të mbajtur mbledhjen.

Neni 19
Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës merr vendime të vlefshme kur në mbledhjen e tij janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve në funksion.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës mund ti japë mandat një anëtari tjetër për ta përfaqësuar në mbledhjen e Këshillit. Çdo anëtar mund të japë vetëm një mandate për të njëjtën mbledhje. Anëtari I përfaqësuar nuk merret parasysh në llogaritjen e quorumit të anëtareve të pranishëm, siç përcaktohet në paragrafin e parë.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuesve. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ka vetëm një votë dhe nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar tjetër.

Megjithatë kur Këshilli është mbledhur për të vendosur mbi një projekt të shitjes së aksioneve një të treti jo aksionar në kushtet e parashikuara në nenin 12 të këtij statuti, vendimi i miratimit merret me shumicën e tre të katërtave të votave të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Në qoftë se shitësi i aksioneve është anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ai nuk merr pjese ne votim

Në rast votimi të barabartë, Kryetari do të ketë votën përcaktuese.

Neni 20
Dokumentimi i Mbledhjeve dhe i Vendimeve

Këshilli mban një libër të veçantë të procesverbaleve me faqe të numërtuara dhe të vulosura, që mbahet në selinë e Bursës së Tiranës.

Në procesverbalin e çdo mbledhje tregohen emrat e anëtarëve të pranishëm, të përfaqësuar ose të munguar.

Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës evidentohen me anë të procesverbaleve të mbajtura në librin e posaçëm.

Procesverbalet nënshkruhen nga Kryetari dhe nga sekretari.

Neni 21
Kompetencat e Këshillit

Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj Drejtorisë për administrimin e shoqërisë nga ana e saj.

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e politikave të Bursës së Tiranës dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së saj, me përjashtim të çështjeve që janë kompetencë eksluzive e Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me këtë statut apo me legjislacionin për shoqëritë tregtare.

Këshilli Mbikëqyrës ka kompetenca të plota të marrë vendime në emër të Bursës së Tiranës. Këshilli Mbikëqyrës mund t'ia delegojë marrjen e vendimeve, Drejtorit të Përgjithshëm.

Vendimet që kërkojnë miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës, janë:

- shqyrtimi i pasqyrave financiare të kontrolluara dhe rekomandimin e tyre Mbledhjes së Aksionarëve;
- shqyrtimi i planit financiar dhe rekomandimin e saj Asamblesë së Aksionarëve;
- thirrja e Asamblesë Vjetore të Aksionarëve;
- përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të komiteteve të
- Bursës së Tiranës;
- miratimi i masave disiplinore te propozuara nga Komiteti Disiplinor;
- emërimi i anëtarëve të komiteteve të Bursës së Tiranës;
  përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm;
- emërimi, paga dhe shpërblimet e Drejtorit të Përgjithshëm;
- miratimi i strukturës organizative të Bursës së Tiranës;
- miratimi i numrit të përgjithshëm të punëmarrësve të Bursës së Tiranës, kriteret e vendeve të punës, pagat dhe shpërblimet e personelit;
- pezullimi ose heqja nga listimi te çdo letre me vlerë kur ajo e gjykon te arsyeshme me qellim mbrojtjen e investitorëve apo ruajtjen e një tregu të rregullt;
- vendimi mbi heqjen e letrës me vlerë nga tregtimi në Bursën e Tiranës;
- miratimi apo heqja e të drejtës për listim;
- miratimi apo heqja e të drejtës për anëtarësimin;

- pezullimi ose përjashtimi i anëtarëve dhe/ose të përfaqësuesve nga anëtarësimi kur nuk përmbushin apo nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me rregullore të veçanta;
- miratimi paraprak i çdo ndryshimi në statut, i përfaqësuesve apo i aksionarëve të anëtarëve të Bursës së Tiranës;
- vendosja e komisioneve, tarifave si dhe përcaktimi i kohës dhe mënyrës së pagimit të tyre;
- miratimi i librit të urdhrave të Bursës së Tiranës;
- përcaktimi i ditëve dhe orëve të tregtimit në Bursën e Tiranës;
- në raste të veçanta vendos vazhdimin ose pezullimin e tregtimit në një letër me vlerë të pezulluar më parë nga Drejtori i Përgjithshëm;

  përcaktimi i procedurës së tregtimit të letrave me vlerë në Bursën e Tiranës;
- si dhe miraton të gjitha rregullat dhe rregulloret e funksionimit të Bursës së Tiranës si treg si dhe çdo vendim tjetër përveç atyre që ligji ia njeh Asamblesë së Aksionarëve.

Neni 22
Informimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme informacion për çështje të natyrës administrative, teknike dhe financiare që i mundësojnë atij të verifikojë dhe gjykojë për kushtet në të cilat zhvillohet veprimtaria e shoqërisë dhe të jetë plotësisht e qartë për vendimet që duhen marrë apo që do të merren nga ana e Këshillit Mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm ka përgjegjësinë për t'i vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës informacionet e kërkuara prej tyre.

Çdo anëtar i këshillit Mbikëqyrës duhet të njoftohet personalisht për mbledhjet e Këshillit dhe ti vihen në dispozicion në selinë e shoqërisë apo ti dërgohen bashkë me thirrjen dokumentet dhe raportet që do të shqyrtohen në mbledhje.

Neni 23
Përgjegjësitë e Anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mbajnë përgjegjësi civile solidarisht dhe individualisht, sipas rastit, ndaj të tretëve dhe ndaj shoqërisë për shkeljet e dispozitave ligjore ose të rregullimeve të zbatueshme për shoqërinë, për shkelje të statutit si dhe për gabimet e bëra në administrimin e shoqërisë.

Neni 24
Shpërblimi i Veçantë për pjesëmarrjen në Këshillin Mbikëqyrës dhe Shpërblimet e Jashtëzakonshme

Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve mund t'iu caktojë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës si shpërblim një shumë vjetore fikse për pjesëmarrjen në Këshill.

Këshilli Mbikëqyrës mund të caktojë shpërblime të jashtëzakonshme për anëtarët të cilëve iu ngarkohen misione apo iu jepen mandate për shërbime apo detyra të caktuara.

Shpërblimet e veçanta dhe të jashtëzakonshme përballohen nga llogaria e shoqërisë dhe kalohen në shpenzimet e saj.

Përveç shpërblimeve të përmendura në këtë nën dhe shpërblimeve që rrjedhin nga një kontratë punësimi me shoqërinë në kushtet e parashikuara nga ligji, anëtarëve të Këshillit nuk u caktohet asnjë shpërblim tjetër i përhershëm apo jo.

Neni 25
Detyrimi për Fshehtësinë e të Dhënave

Anëtarët e Drejtorisë dhe të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe çdo person tjetër që thirret për të marrë pjesë në mbledhjet e këtyre organeve, duhet të ruajnë fshehtësinë për të dhënat që kanë karakter të brendshëm dhe që cilësohen si të tilla nga Kryetari.

B. DREJTORIA

Neni 26
Përbërja e Drejtorisë dhe Kontrolli mbi të

Bursa e Tiranës drejtohet nga drejtoria e përbërë nga një anëtar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Anëtari i Drejtorisë së Bursës së Tiranës është person fizik dhe emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët me kompetenca të plota në kufijtë e objektit të saj,me përjashtim të kompetencave që ligji ia ka caktuar shprehimisht asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve dhe të kompetencave të specifikuara të Këshillit Mbikëqyrës.

Anëtari i Drejtorisë së Bursës së Tiranës shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës për shkaqe të përligjura te parashikuara nga Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" .

Drejtori i Përgjithshëm mund t'i delegoje një pjesë të kompetencave personave të tjerë por që janë të punësuar të shoqërisë.

Neni 27
Detyrat dhe Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

Detyrat dhe Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm :

- Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit te Bursës së Tiranës;
- Përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët me kompetenca të plota Brenda dhe jashtë vendit;
- Raporton në Këshillin Mbikëqyrës të Bursës së Tiranës të paktën një herë në tre muaj, mbi administrimin e shoqërisë si dhe brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar mbi bilancin vjetor me qëllim verifikimi dhe kontrolli;

- Përgjigjet për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe drejtimin e përditshëm të Bursës së Tiranës, për të siguruar funksionimin e saj normal, si dhe për kryerjen e punës me efektivitet dhe arritjen e objektivave të përcaktuara;
- Mbikëqyr aktivitetin e tregtimit në Bursën e Tiranës, pastrimin dhe rregullimin e tregtimeve të ekzekutuara në Bursën e Tiranës sipas akteve rregullative të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
- Relaton në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha problemet, që rrjedhin nga aktiviteti i Bursës së Tiranës, lidhur me tregtimin, listimin dhe anëtarësimin;
- Brenda tre muajve nga përfundimi i çdo viti financiar, Drejtori i Përgjithshëm duhet të paraqesë bilancin e plotë vjetor, të kontrolluar nga eksperti kontabël i autorizuar;
- Lidh kontratat e punës me personelin e Bursës së Tiranës, sipas kritereve të vendit të punës të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
- Kryen çdo detyrë apo kompetencë tjetër që i shërben kryerjes normale të veprimtarisë së përditshme në Bursën e Tiranës;
- Lidh dhe nënshkruan kontrata, marrëveshje, aktmarrëveshje me të tretet sipas objektit të funksionimit të shoqërisë.

Neni 28
Zëvendësimi i Përkohshëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Këshilli Mbikëqyrës cakton një punonjës të Bursës së Tiranës, që të zëvendësojë përkohësisht në të gjitha funksionet Drejtorin e Përgjithshëm në rastet kur ky i fundit:

- Për arsye sëmundje të zgjatur ose te një ngjarje tjetër të papritur pengohet për të ushtruar funksionet e tij,
- Jep dorëheqjen ose vdes dhe nuk është e mundur të bëhet menjëherë emërimi i Drejtorit te ri.

Neni 29
Drejtorët Teknikë

Drejtorët teknikë janë të punësuar të shoqërisë dhe emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili përcakton edhe funksionet e tyre, në pajtim me rregulloren e shoqërisë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës .

Drejtorët teknike nuk kanë asnjë kompetencë për ta angazhuar shoqërinë ndaj të tretëve, përveç rastit kur Drejtori i Përgjithshëm u ka deleguar atyre me mandat një pjesë të kompetencave të tij.

D. EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Neni 30
Emërimi dhe Shpërblimi

Mbledhja e zakonshme e Aksionerëve emëron një ekspert kontabël të autorizuar, të kualifikuar për një vit financiar me të drejtë përsëritje.

Në caktimin e ekspertit kontabël të autorizuar mbahen parasysh papajtueshmëritë e përcaktuara nga ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

Shpërblimi i ekspertit kontabël të autorizuar përballohet nga shoqëria.

Neni 31
Detyrat dhe të Drejtat

Detyrat dhe të drejtat e ekspertit kontabël të autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

Asambleja e zakonshme e Aksionarëve i kërkon ekspertit kontabël të autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje në interes të shoqërisë.

KAPITULLI IV
ASAMBLEJA E AKSIONERËVE

Neni 32
Natyra e Asamblesë së Aksionarëve dhe Karakteri Detyrues i Vendimeve

Asambletë e Përgjithshme të aksionarëve cilësohen asamble të zakonshme ose të jashtëzakonshme sipas natyrës së vendimeve që ato janë thirrur për të marrë.

Çdo asamble e përgjithshme e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksionarëve me të drejtë vote.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme detyrojnë të gjithë aksionarët madje edhe ata që mungojnë në mbledhje apo që votojnë kundër.

Neni 33
Thirrja dhe Vendi i Asamblesë

Mbledhja e Asamblesë thirret nga Këshilli Mbikëqyrës, ose Drejtoria.

Ajo mund të thirret edhe nga:

- eksperti kontabël i autorizuar;
- mandat mbajtës i caktuar nga gjykata;
- nga likuiduesit.

Mbledhjet e Asamblesë mbahen në:

- selinë e Bursës së Tiranës;
- ndonjë vend tjetër të shkruar në lajmërim.

Thirrja e Asamblesë së Aksionarëve bëhet me anë të njoftimit që i dërgohet çdo aksionari në adresën e tij me letër rekomande.

Njoftimi duhet të bjerë në dorë të aksionarëve ose të njihet prej tyre 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë dhe duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e asamblesë dhe rendin e ditës.

Kur Asambleja e mundur nuk ka mundur te marrë vendim për shkak se nuk është siguruar quorumi I kërkuar mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes e mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

Neni 34
Rendi i Ditës

Rendi i ditës të mbledhjes së asamblesë përcaktohet nga autori i thirrjes.

Një ose disa aksionarë që përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit themeltar të "Bursa e

Tiranes"' kanë të drejtë të kërkojnë që të futen në rendin e ditës një apo disa projektrezoluta.

Këto projektrezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me një kërkesë në të cilën tregohen edhe arsyet, si dhe me një dokument që provon zotërimin e pjesës të kapitalit themeltar të kërkuar nga paragrafi i dytë i këtij neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

Asambleja e aksionareve nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje që nuk është përfshirë në rendin e ditës. Megjithatë ajo mund të shkarkojë një ose disa anëtare të Këshillit Mbikqyres dhe te procedoje për zëvendësimin e tyre ne çdo rrethane.

Rendi i ditës të mbledhjes së asamblesë nuk mund te ndryshohet me një njoftim të dytë.

Neni 35
Evidenca e Pjesëmarrjes, Drejtimi i Mbledhjes dhe Procesverbalet

Në çdo mbledhje të asamblesë plotësohet një evidencë pjesëmarrjeje.

Mbledhjet e asamblesë drejtohen nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij, nga një anëtar i Këshillit i caktuar posaçërisht për këtë qëllim. Në rastet kur thirrja e mbledhjes është bërë nga kontrollori i pavarur, mandat mbajtësi i caktuar nga gjykata apo likuiduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Për çdo mbledhje të asamblesë hartohet një procesverbal i cili përmban:

- datën dhe vendin e mbledhjes,
- mënyrën e thirrjes,
- rendin e ditës,
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vëzhgimit,
- numri i aksioneve që marrin pjesë në votim,
- quorum-i i arritur,
- përmendjen e dokumenteve dhe të raporteve që janë shtruar në mbledhje,
- një përmbledhje të debateve,
- tekstet e projektrezolutave të vëna në votim, ato të miratuara dhe ato të hedhura poshtë nga aksionarët,
- rezultatet e votimeve.

Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve mbahen në një regjistër të posaçëm, i numërtuar dhe i vulosur, i cili ruhet në selinë e shoqërisë.

Neni 36
Quorum-i, Votimi, numri i votave

Në mbledhjen e Asamblesë së zakonshme dhe të jashtëzakonshme, quorum-i llogaritet për tërësinë e aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë.

E drejta e votës që u përket aksioneve është përpjestimore me kapitalin që ato përfaqësojnë.

Çdo aksion i kapitalit i jep zotëruesit të paktën të drejtën e një vote. Megjithatë kur aksionet e shoqërisë zotërohen nga një ose disa persona juridikë në të cilët shoqëria ka drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontrollin, e drejta e votës të aksioneve të personave juridikë nuk mund të jetë më shumë se 10 për qind e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Votimi kryhet me dorën ngritur, me thirrje emërore ose i fshehtë sipas vendimit të drejtuesit të mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve.

Votimi kryhet i veçantë për çdo çështje apo vendim.

Neni 37

Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve

Asambleja e përgjithshme e zakonshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve të vitit pasardhës, për të vendosur mbi llogaritë e shoqërisë për ushtrimin financiar te mbyllur.

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim që nuk sjell ndryshime të statutit.

Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë vetëm kur aksionarët e pranishëm ose te përfaqësuar zotërojnë të paktën ¼ e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se mbledhja e pare nuk realizohet për mbledhjen e dyte nuk kërkohet asnjë lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 38

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mblidhet sa herë që duhet të merret një vendim që sjell ndryshime të këtij statuti.

Ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionarëve përveç operacioneve që rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në mbledhjen e parë vetëm kur aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën ½ e aksioneve me të drejtë vote. Për mbledhjen e dyte ky qourum është jo më pak se 1/4 e aksioneve më të drejtë vote.

Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme merren me shumicën prej 3/4 te votave që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 39

Vënia në Dispozicion të Aksionarëve të Dokumenteve dhe Informacioneve

Bursa e Tiranës mban dhe vë në dispozicion të aksionarëve, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton asambleja.

Dokumentet që duhet t'u vihen në dispozicion aksionarëve u dërgohen bashkë me njoftimin për mbledhje.

KAPITULLI V
KONTABILITETI, GJENDJET FINANCIARE, CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 40
Kontabiliteti, Inventari, Gjendjet Financiare

Bursa e Tiranës mban kontabilitetin e saj sipas kërkesave të ligjit "Për kontabilitetin" dhe në Planin Kontabël të Përgjithshëm.
Në mbyllje të çdo viti financiar, por jo më vonë se 3 muaj nga data e mbylljes së vitit, shoqëria përgatit llogaritë vjetore duke u mbështetur në regjistrimin kontabël dhe në të dhënat e inventarit.
Viti ushtrimor kontabël i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik. Ai fillon me 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 41
Rezultati Financiar

Rezultati financiar i shoqërisë përcaktohet në mbyllje të çdo viti si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Neni 42
Fitimi Neto i Shoqërisë

Fitimi neto i shoqërisë përcaktohet pasi të zbritet tatimi mbi fitimin.

Neni 43
Humbjet dhe Mbartja e tyre

Pas miratimit të gjendjes financiare vjetore nga Asambleja e zakonshme e Aksionarëve, humbjet e rezultuara për vitin financiar mbarten në vitet pasuese për t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri në shuarjen e humbjes.

Neni 44
Rezerva e Domosdoshme

Shoqëria nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, lenë mënjanë një shumë me vlerë të paktën 1/20 e tij e cila destinohet për formimin e një fondi rezerve, të quajtur "rezerve e domosdoshme". Kjo lënie nuk është e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Neni 45
Fitimi i Shpërndarë – Dividenti

Fitimi i shpërndarë si dividend përbëhet nga fitimi neto i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit apo statutit dhe nga ana tjetër janë zbritur apo janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e mëparshme.

Shoqëria nuk mund të shpërndajë dividendë, në qoftë se kapitalet e veta janë ose do të bëheshin, si rrjedhojë e shpërndarjes, më të vogla nga shuma e kërkuar nga ligji.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 122, datë 02.10.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14 pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 55 pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5 të statutit të shoqërisë së sigurimit "ALBSIG" sh.a, si rezultat i zmadhimit të kapitalit për investimin e kryer në Maqedoni, me përmbajtje si më poshtë:

"Kapitali themeltar i shoqërisë është 584 710 000 lekë. Ai është i ndarë në 584 710 aksione me vlerë nominale prej 1 000 lekë secili. Aksionet janë të numëruara nga numri 1 deri 584 710, përfshirë edhe numrin e fundit të aksionit".

Kapitali themeltar i shoqërisë posedohet nga aksionerët e mëposhtëm:

- *Shefqet Kastrati, zotërues i 356 671 aksioneve të kapitalit të shoqërisë, që përfaqësojnë 61% të kapitalit.*
- *Faik Bruci, zotërues i 111 095 aksioneve të kapitalit të shoqërisë, që përfaqësojnë 19% të kapitalit.*
- *Bajram Xhaja, zotërues i 58 471 aksioneve të kapitalit të shoqërisë, që përfaqësojnë 10% të kapitalit.*
- *Frida Mucmata, zotërues 29 236 aksioneve të kapitalit të shoqërisë, që përfaqësojnë 5% të kapitalit.*
- *Gëzim Huqi, zotërues i 17 542 aksioneve të kapitalit të shoqërisë, që përfaqësojnë 3% të kapitalit.*
- *Natasha Dhoqina, zotërues i 11 695 aksioneve të kapitalit të shoqërisë, që përfaqësojnë 2% të kapitalit.*

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 123, datë 02.10.2008

PËR
MIRATIMIN E INVESTIMIT PËR USHTRIM VEPRIMTARIE JO-JETE, JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6/ë, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 43 e 58 pika 2, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e investimin prej 91 500 000 lekë, të kryer nga shoqëria e sigurimit "ALBSIG" sh.a për veprimtari sigurimi Jo-Jete, në territorin e Maqedonisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit e Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 124, datë 02.10.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Stefan Thomagjini, si *Vlerësues i dëmeve materriale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi i avionëve, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 125, datë 02.10.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Arben Breshani, në profesionin e vleresuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës) dhe Vlerësues i dëmeve shëndetësore, në keto grupe sigurimi të jo-jetes: Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit, sigurime motorike.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 126, datë 02.10.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Arben Lloja, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimit të aksidenteve dhe shëndetit.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 127, datë 02.10.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Asqeri Xhani, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimit të aksidenteve dhe shëndetit.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 128, datë 02.10.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Gramoz Ylli, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimit të aksidenteve dhe shëndetit.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 129, datë 02.10.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Anesti Vako, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimit të aksidenteve dhe shëndetit.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 130, datë 02.10.2008
PËR
CAKTIMIN E AFATIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, të Ligjit nr.9267 datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime" me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Njoftimin e shoqërive të sigurimit, se vlerësimi i dëmeve në sigurime, pas datës 01 janar 2009, do të behet vetëm me vlerësues të licencuar.
2. Njoftimin e gjykatave të vendit të të gjitha shkallëve, se vlerësimi i dëmeve në sigurime pas datës 01 janar 2009, do të bëhet vetëm me vlerësues të licencuar.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 131, datë 02.10.2008
MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SIGURIMIT " EUROSIG" SH.A
PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 87, DATË 10.07.2008

Në bazë të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 " Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Drejtorisë së Zbatueshmërisë pranë Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të pranohet kërkesa e shoqërisë "Eurosig" sh.a, për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 5 të Vendimit të Bordit nr. 87, datë 10.07.2008 "Për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë së sigurimit "Eurosig" sh.a.
2. Të urdhërojë kontrollin e brendshëm të shoqërisë, që brenda datës 31.10.2008, të bëjë një inventar duke kryer evidentimin fizik të hollësishëm lidhur me zërin (aktive të qëndrueshme të trupëzuara deri në datën 31.10.2008)
3. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 132, datë 02.10.2008

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 133, datë 02.10.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 134, datë 02.10.2008

MBI
SHTYRJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË LICENCËS PËR SHOQËRITË "BALLKAN GROUP -01" SH.A DHE "TRIUMP GROUP" SH.A

Në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 " Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe të paragrafit të parafundit të nenit 57, në referim të pikës 11 të po ketij neni, të Ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 " Për titujt" me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të shtyjë afatin e vlefshmërise së licencës deri ne 6 muaj, për shoqëritë "Ballkan Group-01" sh.a dhe "Triumf Group" sh.a, me kushtin e plotësimit të kapitalit dhe kërkesave të tjera të akteve nënligjore, brenda një periudhe 6-mujore.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 135, datë 05.11.2008

PËR
MIRATIMIN E E KËRKESËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14 të Ligjit nr.9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit" (të ndryshuar)si dhe kërkesës së shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a, me nr. 3647 Prot, datë 05.11.2008, lidhur me mospërjashtimin e shoqërisë KPMG sh.p.k, nga procesi i tenderimit për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2008,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a, për mospërjashtimin e shoqërisë KPMG sh.p.k, nga procesi i tenderimit për auditimin e pasqyrave të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a për vitin ushtrimor financiar 2008, sipas argumenteve bashkëlidhur.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Insig" sh.a dhe Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit në AMF, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM
Nr. 137, datë 25.11.2008
PËR
MIRATIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË REGJISTRIT TË DËMEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME MOTORIKE

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 12 dhe 13, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 115, 121 pika 2 dhe 3 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e projektit të ndërtimit të Regjistrit të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike.
2. Miratimin e fondit prej 1.000.000 Lekë, për ndërtimin dhe vitin e parë të mirëmbajtjes së Regjistrit të Dëmeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.
3. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtoria e Sherbimeve të Brendshme, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 138, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE TË SIGURIMIT TË VETË MJETIT MOTORIK (KASKO)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 8, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 157 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike dhe Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit të vetë mjetit motorik (kasko), formularit të policës dhe udhëzimit, të paraqitura nga shoqëria e sigurimit "Intersig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 139, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E KANDIDATURËS SË Z. SAIMIR ZËMBLAKU, NË POSTIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 63 të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kandidaturës së z. Saimir Zëmblaku, në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit "Insig" sha.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 140, datë 25.11.2008
PËR
REFUZIMIN E MIRATIMIT TË SHOQËRISË "FICADEX ALBANIA" SH.P.K, SI EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2008, TË SHOQËRISË E SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e miratimit të shoqërisë "Ficadex Albania" sh.p.k, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2008, të shoqërisë të sigurimit "Eurosig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 141, datë 25.11.2008

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITEVE 2008 DHE 2009, NË SHOQËRITË E SIGURIMIT "SIGAL" SH.A DHE "SIGAL-LIFE" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqerisë "Deloitte Albania" sh.p.k në cilesinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të viteve 2008 dhe 2009 të shoqërisë së sigurimit "Sigal" sh.a dhe "Sigal-Life" sh.a.
2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit "Sigal" sh.a dhe "Sigal-Life" sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 142, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2008, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "SIGMA" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë "Deloitte Albania" sh.p.k, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2008 të shoqërisë së sigurimit "Sigma" sh.a.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Sigma" sh.a, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 142/1, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2008, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "ALBSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë "Deloitte Albania" sh.p.k, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2008 të shoqërisë të sigurimit "Albsig" sh.a.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Albsig" sh.a, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 142/2, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2008, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "ATLANTIK" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë "Deloitte Albania" sh.p.k, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2008 të shoqërisë së sigurimit "Atlantik" sh.a.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Atlantik" sh.a, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 143, datë 25.11.2008

PËR

MIRATIMIN E SHOQËRISË "KPMG ALBANIA" SH.P.K, SI EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2008, TË SHOQËRISË E SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë "KPMG Albania" sh.p.k, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2008 të shoqërisë të sigurimit "Intersig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 142/3, datë 25.11.2008

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR "DELOITTE ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2008, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT "INTERALBANIAN" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 të Ligjit nr.9267, datë 29.03.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pikës 11 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe Rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë "Deloitte Albania" sh.p.k, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2008 të shoqërisë së sigurimit "Interalbanian" sh.a.
2. Ngarkohet shoqëria e sigurimit "Interalbanian" sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 144, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Kristaq Lipe, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi i avioneve, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 145, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Maqo Stratobërdha, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në prone.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 146, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Rasim Berisha, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilesimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këtë grup sigurimi të jo-jetës: Sigurime motorike.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 147, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Hetem Xhameni, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 148, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Ramazan Sula, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 149, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Bexhet Lata, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 150, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Astrit Celanji, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 151, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Arben Kocibellinj, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këtë grup sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 152, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Ajet Bakiu, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këtë grup sigurimi të jo-jetës: Sigurimi i aksidenteve dhe shendetit.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 153, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Hajredin Gjomakaj, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në keto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi i avionëve, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 154, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TE DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Agron Lama, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin: *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 155, datë 25.11.2008
PËR
PRANIMIN E TËRHEQJES SË LICENCËS SË AGJENTIT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6 dh) të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe pikës 1, b) të nenit 85, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Pranimin e tërheqjes së licencës si agjent në sigurime në emër dhe për llogari të shoqërisë "Insig" sh.a, të z. Edmond Meçe.
2. Çregjistrimin e tij nga regjistri i agjentëve.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 156, datë 25.11.2008

MBI
SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV NDAJ VENDIMIT TË BORDIT NR. 113, DATË 11.09.2008

Në bazë dhe për zbatim të nenit 124, pika 1 dhe nenit 8, të Kodit të Procedurave Administrative", me propozim të Drejtorisë së Zbatueshmërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas shqyrtimit të ankimit administrativ të z. Artur Zhegu,

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.113, datë 11.09.2008, të Bordit të AMF-së "Për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime".
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 157, datë 25.11.2008

PËR
PËR MIRATIMIN E BULETINIT ZYRTAR TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 11, dhe nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Kërkimit, TI dhe Statistikës, Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formatit dhe strukturës së Buletinit Zyrtar të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimit, TI dhe Statistikës dhe Departamenti i Çështjeve Juridike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 158, datë 25.11.2008

PËR
MRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PLANIT FINANCIAR TË VITIT 2008

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.20046, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit në planin financiar të vitit 2008 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas 3 pasqyrave bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Sektori i Administrimit Financiar në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 159, datë 25.11.2008

PËR

MRATIMIN E PLANIT VJETOR TË AUDITIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2009 DHE PLANIT STRATEGJIK PËR VITET 2010-2012

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika d) të Rregullores "Rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare" miratuar me Vendim nr.7, datë 30.08.2007, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e planin vjetor të Auditit të Brendshëm për vitin 2009 dhe planin strategjik 2010-2012 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, sipas pasqyrave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Administrimit Financiar në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 160, datë 25.11.2008

PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË "WVP- NDËRMJETËSIM NË SIGURIME" PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe VKM nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë "WVP Ndërmjetësim në sigurime" sh.a, si agjent në sigurime jete në emër dhe për llogari të shoqërisë "Sigal-Life" sh.a, për një afat 3-vjeçar, me të drejtë rinovimi.
2. Licencimin si agjent në sigurime jete në emër dhe për llogari të shoqërisë "WVP-Ndërmjetësim në sigurime" sh.p.k, me afat 3-vjet me të drejtë rinovimi, të:
   a) Zj. Mimoza Reme
   b) Zj. Xheka Lamaj
   c) Zj. Alma Drishti
   d) Z. Arbri Lamaj
   e) Z. Bilal Avdia
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 161, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NE STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INTERSIG" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 162, datë 25.11.2008

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 163, datë 25.11.2008

PËR
MBËSHTETJEN FINACIARE PËR PJESËMARRJEN NË KURSIN PËR ADMINISTRATOR RRJETI (Cisko Certified Network Associate)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 164, datë 25.11.2008

PËR
MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT PËR PUNONJËSIT E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 165, datë 23.12.2008

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR LICENCIMIN E SHOQËRIVE TË BROKERIMIT/ KËSHILLIMIT, BROKERIT DHE KËSHILLTARIT TË INVESTIMEVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2007 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 48, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt", me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores "Për Licencimin e Shoqërive të Brokerimit/Këshillimit, Brokerit dhe Këshilltarit të Investimeve", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
LICENCIMIN E SHOQËRIVE TË BROKERIMIT/KËSHILLIMIT, BROKERIT DHE KËSHILLTARIT TË INVESTIMEVE

Miratuar me vendimin e Bordit nr.165, datë 23.12.2008

Kreu I
Të përgjithshme

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore përcakton:

- dokumentacionin shoqërues të kërkesës dhe kriteret për licencim për veprimtari të tregtimit të titujve dhe të këshillimit në investime;
- përmbajtjen dhe procedurën e trajtimit të kërkesës për licencim;
- procedurën e miratimit të statutit të një shoqërie, që krijohet për të ushtruar veprimtari të tregtimit dhe këshillimit në tituj, si dhe ndryshimet në këto akte;
- dokumentacionin për dhënien e miratimit të anëtarëve të bordit drejtues dhe drejtuesit kryesor të shoqërisë së brokerimit dhe këshillimit në investime.

Neni 2
Terminologji

Për qëllim të kësaj rregullore termi:

a) **Shoqëri brokerimi** ka të njëjtin kuptim me termin shoqëri komisionere në Ligjin nr.9879 datë 21.02.2008 "Për titujt". Shoqëria e brokerimit kryen veprimtari të tregtimit të titujve/blerje dhe shitje të titujve me porosi të klientit (broker) dhe blerje dhe shitje të titujve në emër ose për llogari të vet (dealer).
b) **Shoqëri këshillimi në investime** nënkupton shoqërinë e brokerimit e cila kryen vetëm veprimtari këshillimi për investimin ne tituj.
c) **Broker** ka të njëjtin kuptim me termin **komisioner burse.**

d) **Identitet i kapitalit aksioner** nënkupton: të dhënat mbi aksionerin dhe origjinën apo burimin e kapitalit.
e) **Autoritet** nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
f) **Kërkues** nënkupton shoqërinë apo personin fizik që i drejtohet Autoritetit me kërkesë për përftimin e një licence.

Neni 3
Veprimtaria e tregtimit të titujve

Veprimtaria e tregtimit të titujve përfshin:
a) blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit nëpërmjet marrjes dhe ekzekutimit të urdhërave (broker).
b) blerjen dhe shitjen e titujve në emër ose për llogari të vet (dealer).
c) këshillimin e rastësishëm të klienteve në lidhje me blerjen dhe shitjen e titujve si pjesë e veprimtarisë së tij.

Neni 4
Veprimtaria e këshillimit

Veprimtaria e këshillimit përfshin këshillimin e vazhdueshëm me qëllim fitimi apo ofertën për një shërbim të tillë. Kjo veprimtari përfshin shërbimet e mëposhtme:

a) këshillim mbi titujt dhe tregtimin e tyre, ofertën publike, marrjen e paketës kontrolluese, krijimin e portofoleve, si dhe operacione të tjera të ngjashme me to.
b) organizimin e blerjeve, shitjeve apo këmbimin e titujve nëpërmjet shoqërisë së brokerimit.
c) studim, përgatitje, mbikqyrje e zbatim i plani të investimit në tituj.
d) përgatitje të dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit mbi titujt dhe legalizimin përkatës.

Neni 5
Kërkesa mbi dokumentacionin e kërkesës për licencim

a) Të gjithë deklaratat dhe kopjet e dokumentave të kërkuara sipas kësaj rregullore duhet të jenë në gjuhën origjinale. Për dokumentin gjuha origjinale e të cilave është e ndryshme nga shqipja, bashkëngjitur me këtë dokument duhet të dorëzohet dhe përkthimi i noterizuar në gjuhën shqipe dhe vërtetimi nga institucionet përkatesë sipas legjislacionit në fuqi.
b) Dokumentacioni duhet të jetë jo më i vonë se i tre muajve të fundit nga dorëzimi i kërkesës me përjashtim të raporteve financiare.
c) Kërkuesi i licencës është përgjegjës për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar në AMF.
d) Nëse e konsideron të nevojshme Autoriteti mund të kërkojë dokumenta ose informacion shtesë në lidhje me kërkuesin.
e) Autoriteti gëzon të drejtën e kontrollit të vërtetësisë së dokumentacionit të dorëzuar.

KREU II
KËRKESAT PËR LICENCIM

PJESA I
Miratimi i projektstatutit

Neni 6
Kërkesa për miratimin e projektstatutit

a) Projektstatuti i një shoqërie që nuk është bankë dhe që ka për objekt të aktivitetit të saj, veprimtarinë e kryerjes së transaksioneve me titujt, përpara depozitimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, duhet t'i paraqitet Autoritetit.
b) Projekti shoqërohet me një kërkesë zyrtare, me anë të së cilës kërkohet miratimi nga Autoriteti.
c) Emri i shoqërisë duhet të prezantojë aktivitetin që do të kryhet dhe objekti duhet të parashikojë veprimtarinë/veprimtaritë e përcaktuara sipas nenit 42 të Ligjit nr.9879 datë 21.2.2008 "Për titujt".
d) Në rastet kur një Bankë kërkon të kryejë veprimtari të lidhur me transaksionet e titujve, në Statut, në nenin që përcakton objektin e aktivitetit të shoqërisë, duhet të jetë parashikuar veprimtaria për të cilën kërkohet licenca.

Neni 7
Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e projektstatutit

a) Autoriteti, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë, shqyrton kërkesën dhe projektin e marrë, përputhjen e përmbajtjes së statutit me aktivitetin për të cilin do të kërkohet licencim dhe merr vendim për miratimin apo udhëzon ndryshime në të dhënat e projektit.
b) Vendimi, i dërgohet kërkuesit, brenda pesë ditë pune dhe është pjesë e praktikës që depozitohet në QKR.
c) Miratimi i projektstatutit, nuk kushtëzon Autoritetin, në marrjen e vendimeve të mëvonshme në lidhje me licencimin e të njëjtit subjekt si shoqëri brokerimi.

PJESA II
Kërkesa për licencë e shoqërisë së brokerimit/këshillimit

Neni 8
Formë kërkesa

a) Kërkesa për licencim e shoqërisë së brokerimit për të vepruar si broker apo këshilltar investimesh bëhet sipas formë kërkesës, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

b) Formë kërkesa e noterizuar nënshkruhet dhe vuloset nga themeluesit e shoqërisë dhe nga drejtuesi kryesor.

I. *Dokumentacioni mbi identitetin e kapitalit aksioner:*

a) Cdo aksioner i shoqërisë kërkuese duhet të deklarojë se nuk ka aksione apo interesa në shoqëri të tjera brokerimi.

Neni 9

Dokumentacioni që shoqëron formë kërkesën

a)Dokumentacioni mbi shoqërinë kërkuese:

1. kopje të noterizuar të statutit dhe aktit të themelimit;
2. ekstrakti i regjistrimit në QKR, dokument i cili sigurohet nga Autoriteti;
3. struktura organizative e shoqërisë së brokerimit;
4. dokument që vërteton pagesën e kapitalit fillestar në përputhje me nenin 44 të Ligjit "Për tiujt", dokument i cili qëndron i bllokuar në një nga bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Shqipërisë, deri në marrjen e licencës;
5. Vendim i bordit drejtues për llojin e veprimtarisë që do kryejë shoqëria;
6. Dokument që vërteton se shoqëria e brokerimit/këshillimit ka punësuar një broker dhe/ose një këshilltar investimi;
7. Një përshkrim mbi infrastrukturën dhe software që do të përdorë shoqëria e brokerimit gjatë tregtimit të titujve;
8. Të dhëna për emrin, adresën dhe numrin në regjistrin tregtar të shoqërisë për të cilën kërkuesi për shoqëri brokerimi është aksionar/ortak kryesor ose ushtron kontroll mbi të;
9. Nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të vepruar si shoqëri brokerimi apo këshillimi në investime, atëherë përveç dokumentave të mësipërme, duhet të dorëzojë:

- kopje të bilancit të fundit dhe gjendjes së fundit të pasqyrës financiare, fitim-humbje, kopje kjo e vërtetuar nga eksperti kontabël i shoqërisë, përfshirë çdo dokument që kërkohet me ligj;
- ekstrakt nga QKR se ky subjekt nuk i është nënshtruar procedurave të falimentimit;

10. Vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatimtaksave.
11. Një dokument për shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.

b) Kur shoqëria aplikuese është një bankë, përveç dokumentave të mësipërme, duhet të përfshijë edhe dokumentat si më poshtë:

- licencë për ushtrim veprimtarie si bankë, lëshuar nga Banka Qendrore, së bashku me aneksin shoqërues ku të jetë përfshirë edhe veprimtaria për të cilën kërkohet licenca.
- vendim i bordit drejtues për të ushtruar veprimtari të tregtimit të titujve dhe/ose të këshillimit.

I. Dokumentacioni mbi identitetin e kapitalit aksioner:

a) Çdo aksioner i shoqërisë kërkuese duhet të deklarojë se nuk ka aksione apo interesa në shoqëri të tjera brokerimi.

b) Kur aksioneri është person juridik, shoqëria kërkuese duhet të dorëzojë:

1. ekstraktin e regjistrimit në QKR;
2. raporte financiare për dy vitet e fundit,
3. dokument që vërteton që ky person ka apo jo detyrime të papaguara ndaj shtetit;
4. deklaratë mbi origjinën e kapitalit e cila të tregojë që kapitali nuk përbëhet nga hua nga publiku, kredi nga banka apo paradhënie nga subjekte dhe palë të treta;

c) Kur aksioneri është individ duhet të dorëzojë:

1. dokumente që vërtetojnë gjendjen e tij financiare (dokument mbi zotërimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, vërtetime për llogari bankare, dokumente që vërtetojnë borxhin, etj);
2. deklaratë mbi origjinën e kapitalit e cila të tregojë që kapitali nuk përbëhet nga hua nga publiku, kredi nga banka apo paradhënie nga subjekte dhe palë të treta;

Dokumentacioni mbi aktivitetin që do të kryhet dhe organizimin e tij

a) kopje të kontratës tip me klientin;

b) rregullat e brendshme që rregullojnë 1) marrëdhënien me klientin, 2) masat për veçimin dhe identifikimin e mjeteve të klientëve, 3) ruajtjen e konfidencialitetin e të dhënave, 4) ushtrimi i kontrollit të brendshëm që të sigurojë përputhjen e aktivitetit të brokerit/këshilltarit me ligjet dhe rregulloret në fuqi, 5) shqyrtimin e ankesave të klientëve dhe marrja e masave në lidhje me to, 6) mënyren e sigurimit dhe e mbajtjes së burimeve financiare të mjaftueshme për të përmbushur përgjegjësitë dhe premtimet në tregtimin e letrave me vlere apo në këshillim dhe masat për përballimin e rrezikut të humbjes se tyre, 7) mbajtjen e regjistrimeve të duhura.

Pjesa e III

Kërkesa për licencë e brokerit dhe këshilltarit të investimeve

Neni 10
Formë kërkesa

a) Kërkesa për pajisje me licencë si broker apo këshilltar i investimeve bëhet sipas formë kërkesës bashkëngjitur kësaj rregullore.

b) Kërkesa nënshkruhet nga personi fizik kërkues për pajisje me licencë në prezencë të noterit.

c) Formë kërkesa vuloset dhe nënshkruhet nga persona të autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë ku kërkuesi është punësuar dhe do të kryejë transaksione me titujt. Në këtë mënyrë shoqëria konfirmon me vërtetësi mbi të dhënat e punësimit në këtë kërkesë.

Neni 11

Dokumentacioni

a)Dokumentacioni që shoqëron formë kërkesën është:

1. kërkesë për llojin e veprimtarisë që do të kryejë dhe shoqërinë që përfaqëson, të nënshkruar nga kërkuesi;
2. dokument identifikimi;
3. dokumenti që përcakton dhe rregullon marrëdhënien mes shoqërisë dhe kërkuesit;
4. dokument që vërteton që ky person nuk është i dënuar për ndonjë vepër që përbën arsye për refuzim licence;
5. dokument që vërteton adresën e përkohshme ose të përhershme të personit shqiptar, si dhe për personin e huaj dëshminë e rezidencës në teritorin e Republikës së Shqipërisë;
6. një kopje e noterizuar e diplomës së arsimit të lartë;
7. CV së bashku me dëshmitë përkatëse që përcaktojnë kualifikimin dhe përvojën përkatëse;
8. referenca pozitive mbi reputacionin;
9. dokumenti që vërteton se brokeri/këshilltari ka kaluar testin e njohurive profesionale nëse Autoriteti ka vendosur zbatimin e tij;
10. dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit;

    dokument që verteton përfundimin e një kualifikimi profesional në fushën e veprimtarive në tituj;

b) Kur kërkuesi paraqet kërkesën për licencim si këshilltar investimesh, përveç dokumentave të mësipërme, formë kërkesa duhet të shoqërohet edhe nga dokumenti që vërteton plotësimin e njërit prej këtyre kushteve:

- përfundimin e një kualifikimi pasuniversitar në fushën e investime financiare, ose të analizës financiare për një periudhë jo më të shkurtër se 1 vit;
- përvojë profesionale brenda ose jashtë vendit për një periudhë jo më të shkurtër se 3 vjet në fushën e këshillimit në tituj.

Neni 12

Kërkesa të besueshmërisë për këshilltarin dhe brokerin

Këshilltari i investimeve dhe brokeri duhet:

a) të mos jetë dënuar për krime në ekonomi si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj, për mashtrim dhe falsifkim;

b) të mos jetë administrator, drejtues apo kontrollues të shoqërive ndaj të cilave kanë filluar procedurat e falimentimit ose të cilat kanë falimentuar;

c) të mos jetë në të njëjtën kohë punonjës, anëtar i këshillit mbikqyrës apo i bordit drejtues në një shoqëri tjetër brokerimi apo keshillimi;

ç) të jetë resident ne Republikën e Shqipërisë ose të ketë leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente;

d) të ketë një gjendje financiare të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e tij.

dh) të ketë reputacion të mirë.

Pjesa e IV
Miratimi i organeve drejtuese

Neni 13
Paraqitja e kërkesës

a) Kërkesa për marrjen e aprovimit nga Autoriteti për kandidaturat në funksionin e anëtarit të bordit drejtues dhe drejtuesit kryesorë të shoqërisë së brokerimit paraqitet nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë.
b) Në rastin e një banke, kërkesa për marrjen e aprovimit nga Autoriteti për kandidaturën në funksionin e drejtuesit për transaksionet me titujt që kryen një bankë paraqitet nga bordi drejtues i bankës.

Neni 14
Kërkesa për anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë komsionere

Anëtari i organeve drejtuese të shoqërisë së brokerimit/këshillimit duhet:

a) të mos jetë dënuar për krime në ekonomi si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj, për mashtrim dhe falsifkim;
b) të mos jetë administrator, drejtues apo kontrollues të shoqërive ndaj të cilave kanë filluar procedurat e falimentimit ose të cilat kanë falimentuar;
c) të mos jetë në të njëjtën kohë punonjës, anëtar i këshillit mbikëqyrës apo i bordit drejtues në një shoqëri tjetër brokerimi;
d) të jetë rezident në Republikën e Shqipërisë ose të ketë leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente;
e) të ketë një gjendje financiare të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e tij.
f) të paktën një prej anëtarëve të bordit të organeve drejtuese duhet të njohë gjuhën shqipe në rastin kur të gjithë kandidatët për anëtarë të bordit drejtues janë qytetarë të huaj
g) të ketë reputacion të mirë

Neni 15
Dokumentacioni

Dokumentacioni që shoqëron kërkesën në lidhje me kandidaturën për anëtar të organeve drejtuese është:

1. dokument identifikimi;
2. CV së bashku me dëshmitë përkatëse që përcaktojnë kualifikimin dhe përvojën përkatëse, sidomos në fushën e transaksioneve me titujt;
3. një kopje e noterizuar e diplomës;
4. dokument që vërteton adresën e përkohshme ose të përhershme të personit shqiptar si dhe për personin e huaj dëshminë e rezidencës në territorin e Republikës së Shqipërisë;
5. kontratë punësimi me shoqërinë e brokerimit,
6. certifikatë për njohjen e gjuhës shqipe të njërit prej anëtarëve të organit drejtues të përbërë nga shtetas të huaj;
7. dokument, i lëshuar nga institucioni përkatës shtetëror, që vërteton që ky person nuk është i dënuar për vepra që përbëjnë arsye për refuzim licence;
8. të dhëna mbi zotërim pronësie në shoqëri të tjera, duke specifikuar emrat, adresat dhe madhësinë e kapitalit;
9. vërtetim mbi detyrimet financiare të pashlyera në afat;
10. referencë mbi reputacionin e tij;
11. deklarata për plotësimin e kërkesave të pikave a), b) dhe c) të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

KREU III
PROCEDURA LICENCIMI

Neni 16
Provimi për pajisjen me licencë

a) Kërkuesi për pajisje me licencë si broker apo këshilltar i investimeve, në varësi të gjykimit nga Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, mund t'i nënshtrohet testimit profesional të organizuar nga Autoriteti.
b) Testimi profesional duhet të përsëritet çdo tre vjet. Në rast se brokeri apo këshilltar i investimeve nuk kalon me sukses testimin profesional Autoriteti vendos revokimin e licencës.

Neni 17
Dhënia e licencës

a) Brenda 60 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, Autoriteti merr vendim për kërkesën, për të cilin njofton kërkuesin.
b) Kërkuesi brenda 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje.
c) Departamenti i Licensimit dhe monitorimit, 20 ditë para përfundimit të afatit njofton Kryetarin e Bordit te Autoritetit për plotësimin e afatit përfundimtar për shqyrtimin e kërkesës.

d) Autoriteti mund të vendosë miratimin apo refuzimin e kërkesës, ose mund të kërkojë plotësimin e disa kushteve të caktuara për lëshimin e licencës, duke përcaktuar edhe afate. Nëse kërkuesi, që ka paraqitur kërkesën, nuk arrin t'i eliminojë të metat e specifikuara në njoftimin e marrë nga Autoriteti brenda afatit të përcaktuar prej këtij të fundit, atëherë konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa.

e) Në vendimin për dhënien e licencës për kryerjen e transaksioneve të titujve, Autoriteti specifikon se për cilat transaksione jepet licenca.

Neni 18
Karakteristikat e licencës

a) Forma dhe përmbajtja e licensës miratohet nga Bordi i Autoritetit. Ajo përmban këto elemente të domosdoshme:

1. bazën ligjore për dhënien e licencës;
2. emrin dhe adresën e personit të licencuar;
3. llojin e veprimtarisë që do ushtrohet. Licenca jepet për:

a. veprimtari tregtimi;
b. veprimtari keshillimi;
c. broker;
d. këshilltar investimesh;

4. llojin e titujve që do tregtohen sipas licensës. Licenca do të jepet për një titull ose për disa tituj;
5. në mënyrë të specifikuar bursën apo tregun e rregulluar dhe territorin brenda të cilit do ushtrohet veprimtaria e specifikuar në licencë;
6. numrin e licencës;
7. firmën e kryetarit të Bordit;
8. vulën e Autoritetit;

b)Licenca jepet për një afat të pacaktuar.

a) Licenca përgatitet në dy kopje, në gjuhën shqipe. Një kopje i jepet të licencuarit dhe një kopje arkivohet ne AMF.

b) Licenca është e patransferueshme.

c) Licenca duhet të paraqitet gjithmonë në vendet ku i licencuari ushtron veprimtarinë e parashikuar në licencën e tij ose sa herë që kërkohet një gjë e tillë. Kjo kërkesë konsiderohet si e paplotësuar kur paraqitja e licencës nuk bëhet në mënyrë të dukshme.

d) I licencuari duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin për fillimin, pezullimin, rifillimin e veprimtarisë për të cilën është licencuar, si dhe për çdo ndryshim të propozuar, apo ndodhjen e ndonjë ngjarjeje e cila mund të ndikojë dukshëm në veprimtarinë e tij apo në të dhënat mbi bazën e te cilave është lëshuar licenca.

Neni 18
Karakteristikat e licencës

a) Forma dhe përmbajtja e licencës miratohet nga Bordi i Autoritetit. Ajo përmban këto elemente të domosdoshme:

1. bazën ligjore për dhënien e licencës;
2. emrin dhe adresën e personit të licencuar;
3. llojin e veprimtarisë që do ushtrohet. Licenca jepet për:
   a. veprimtari tregtimi

KREU IV
PAGESAT

Neni 19
Pagesat ndaj Autoritetit

a) Për depozitimin e dokumentacionit për licencë si shoqëri brokerimi/këshillimi, shoqëria detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit shumën prej 5.000 lekë.
b) Për depozitimin e dokumentacionit për licencë si broker apo këshilltar investimesh, personi fizik detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit shumën prej 500 lekë.
c) Për marjen e licencës si shoqëri brokerimi/këshillimi, shoqëria detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit shumën prej 60.000 lekë.
d) Për marrjen e licencës si broker apo këshilltar investimesh, personi fizik detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit shumën prej 30.000 lekë.
e) Për ushtrimin e aktivitetit si shoqëri brokerimi, shoqëria detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit një komision vjetor të barabartë me 0.1 % të volumit të përgjithshëm të transaksioneve të kryera në një bursë apo në një treg të rregulluar.
f) Për ushtrimin e aktivitetit si shoqëri brokerimi, në kryerjen e transaksioneve në titujt afatshkurtër dhe afatgjatë të Qeverisë në tregun me pakicë, shoqëria detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit komisionin vjetor prej 100.000 lekë.
g) Për ushtrimin e aktivitetit si shoqëri këshillimi, shoqëria detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit komisionin vjetor prej 50.000 lekë.
h) Shlyerja e detyrimeve ndaj Autoritetit është një nga kushtet për vlefshmërinë e licencës.

KREU IV
HYRJA NË FUQI

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 166, datë 23.12.2008

PËR
DISA NDRYSHIME NË VKM NR. 96, DATË 03.02.2008
PËR AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE DHE INVESTIMET E tyre NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105, të Ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozimin të Departamentit të Mbikëqyrjes e Disiplinimit, Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Ti propozojë Ministrit të Financave disa ndryshime në VKM nr.96, datë 03.02.2008 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit e Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 167, datë 23.12.2008

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 168, datë 23.12.2008

PËR
TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të neni 14, të Ligjit nr.9572 datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", nenit 45, të Ligjit nr.7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private te pensioneve", nenit 29 të VKM nr.908 datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të instituteve private të pensioneve suplementare dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e transferimit të pronësisë të aksioneve në masën 100%, të shoqërisë "Instituti Amerikan i Pensioneve Suplementare të Shqipërisë" sh.a, tek aksioneri i ri shoqëria "Banka Raiffeisen" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 169, datë 23.12.2008

PËR
NJË NDRYSHIM NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SICRED" SH.A DHE MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 170, datë 23.12.2008

PËR

MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË PENSIONEVE "CAPITAL IPP" SH.A

Në zbatim të nenit 14, pika 6/j, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë "Capital IPP" sh.a, me përbërje si me poshtë:
   - *Z. Adrian Totokoci*
   - *Zj. Albana Shtylla*
   - *Zj. Shpresa Breçani*
   - *Z. Abdyl Sarja*
   - *Z. Mihal Tase*
   - *Z. Dardan Mustafaj*
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 171, datë 23.12.2008

PËR
NJË NDRYSHIM NË STATUTIN E SHOQËRISË "KAPITAL INVEST" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 172, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË "GREEN MARKET" SH.P.K, PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI AGJENT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe VKM nr.79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë "Green Market" sh.p.k, si agjent në sigurime të jo-jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.
2. Licencimin e Z. Ermir Llagami, si agjent në sigurime të jo-jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë "Green Market" sh.p.k.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 173, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TE DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Kito Mihani, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës*), në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 174, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Ligor Vezuli, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe i shëndetit, sigurime motorike, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 175, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Pavli Papajani në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 176, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TE DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Ardjan Jeshili, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe i shëndetit, sigurime motorike, sigurimi i marinës dhe transportit, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 177, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Zj. Sanije Reka, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës*) dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurime motorike.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 178, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Zj. Enkeleida Tola, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës)* dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe i shëndetit, sigurimi i avionëve, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 179, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TE DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Rudi Monari, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës*) dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore,* në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit, sigurime motorike, sigurimi i marinës dhe i transportit, sigurimi i avionëve, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, sigurimi i përgjegjësive, sigurimi i kreditit dhe i garancisë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 180, datë 23.12.2008

PËR
LICENCIMIN E VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 89, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dhe VKM nr.164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e Z. Raimond Xhixho, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin *Vlerësues i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës*) dhe *Vlerësues i dëmeve shëndetësore,* në këto grupe sigurimi të jo-jetës: Sigurime motorike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.
2. Licenca jepet me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 181, datë 23.12.2008

PËR
MIRATIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "EUROSIG" SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe nenit 63 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin Z. Muharem Bardhoci, në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit "Eurosig" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencim Monitorimit për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

amf ALBANIA
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Rruga "Perlat Rexhepi", Pallati nr. 10, Tiranë
Tel: +355 42 247 148 Tel/Fax: +355 42 250 686
web: www.amf.gov.al; e-mail: amf@amf.gov.al